

ENVER HOXHA

VEPRA

44

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

44

QERSHOR 1970 – NËNTOR 1970

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANE, 1985

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 44-t

Vëllimi i 44-t i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës qershori-nëntor 1970. Një pjesë e mirë prej tyre botahen për herë të parë.

Ky vëllim hapet me fjalën që shoku Enver Hoxha mbajti në mbyllje të Plenumit të 10-të të Komitetit Qendror të Partisë: «Mbi kuptimin teorik e praktik të organizimit të punës». Në të shtrohen detyra dhe jepen porosi të rëndësishme me vlera aktuale për përsosjen dhe për revolucionarizimin e gjithë punës organizuese e drejtuese të Partisë që ajo të jetë sa më efektive në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme teorike e praktike dhe për realizimin e detyrave në të gjitha frontet.

Punën e saj organizative Partia jonë e ka parë dhe e ka zhvilluar kurdoherë në kompleks, duke përfshirë në të politikën e ideologjinë, ekonominë e kulturën, shkencën e teknikën, qeverisjen e mbrojtjen e vendit etj. Ajo i ka dhënë asaj kurdoherë një kuptim të gjerë dhe nuk e ka thjeshtëzuar e ngushtuar atë vetëm në disa norma apo rregulla organizative. Çështjet organizative të Partisë, theksohet në vëllim, duhen kuptuar e zbatuar në jetë duke i kushtuar vëmendje të madhe forcimit të rolit drejtues dhe organizues, edukues e zbatues të Partisë, përsosjes së punës drejtuese për konkretizimin e vënien në praktikë të vijës së saj të

gjithanshme. Theks të veçantë i jepet në vëllim mësimit se puna organizuese e Partisë, format, metodat dhe stilë i saj nuk janë diçka e ngurtë, e pandryshueshme dhe e dhënë një herë e përgjithmonë. Ato janë dinamike, të lëvizshme dhe që duhet të ndryshojnë e të përsosen vazhdimisht sipas statit të zhvillimit, sipas detyrave e problemeve të reja që nxjerr jeta, sipas nevojave të forcimit të vetë Partisë, të pushtetit e të krejt rendit ekonomiko-shoqëror socialist.

Një problem i rëndësishëm ku ndalet gjerësisht autor i në këtë vëllim është edhe puna e Partisë me njerëzit, revolucionarizimi i pandërprerë i metodës dhe i stilit të kësaj pune. Analiza dhe zbirthimi i këtij problemi janë një ndihmë e madhe për të gjithë komunistët dhe kuadrot, të cilët, me punën e tyre edukuese, është e domosdoshme të depërtojnë në mendjet dhe në zemrat e masave e të njerëzve të veçantë, t'i bindin ata individualisht e kolektivisht, t'i prekin, t'i emocionojnë, t'i nxitin e t'i hedhin në aksione, duke qenë vetë në ballë të tyre, t'u çojnë zemrat peshë në luftën për çështjen e madhe të Partisë e të revolucionit. Puna me njerëzit vlerësohet si një punë e ndërlikuar, si një art i veçantë, të cilin duhet ta zotërojnë e gjithë Partia, të gjithë kuadrot. Në vëllim nënvízohet ideja se kjo punë bëhet jo vetëm në format e organizuara dhe të përgjithshme në kolektiv për kalitjen e ndërgjegjes sociale, por edhe në punën me individë të veçantë, kokë më kokë me njerëzit, duke pasur parasysh veçoritë individuale të tyre, preokupacionet e veçanta, mentalitetin dhe kërkessat që ata kanë jo vetëm në kuptimin material, por edhe në vështrimin social e psikolo-

gjik. Partia jonë e ka parë dhe e sheh punën e saj, mbi të gjitha, punë me njerëzit dhe për njerëzit tanë, që krijojnë e realizojnë, por edhe kaliten, formojnë e rritin personalitetin e tyre.

Kjo punë e Partisë, mobilizimi i masave nën udhëheqjen e drejtë të saj bënë që detyrat e pesëvjeçarit të katërt për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës në tërësi të realizoheshin me sukses dhe para kohe. Këto arritje udhëheqësi i Partisë i sheh si një bazë e shëndoshë për fryshtimin e për mobilizimin e mëtejshëm të masave punonjëse për rritjen e rendimenteve në punë, për forcimin e disiplinës e të organizimit, për të përballuar me sukses objektivat e pesëvjeçarit të ri. Ai thekson domosdoshmérinë e pjesëmarrjes aktive të masave në hartimin e planit, të nxitjes dhe të përkrahjes së iniciativës krijuese të tyre, domosdoshmérinë e kryerjes së studimeve të gjera e të hollësisht me përtuar një plan me të vërtetë real, mobilizues e revolucionar.

Ndërmjet materialeve me vlera të mëdha teorike dhe shkencore të këtij vëllimi është edhe fjala e mbajtur në Shkollën e Partisë «V. I. Lenin»: «Të mësojmë teorinë marksiste-leniniste në lidhje të ngushtë me praktikën revolucionare». Në të bëhen analiza dhe përgjithësime filozofike të transformimeve revolucionare të kryera në vendin tonë, të rolit të faktorëve materialë dhe atyre subjektivë dhe jepen orientime të çmuara për domosdoshmérinë e kuptimit dhe të shikimit materialist të historisë, të fenomeneve shoqërore mbi bazën e metodës dialektike marksiste të analizës klasore, të sintezës shkencore e të përgjithësimit të praktikës revolu-

lucionare. Studimi dhe përvetësimi i teorisë marksiste-leniniste, vë në dukje shoku Enver Hoxha, u jep mundësinë kuadrove e komunistëve të ngrihen mbi empirizmin dhe prakticizmin e rëndomtë. Ky studim është e vetmja rrugë për t'i shpjeguar drejt fenomenet dhe faktet e jetës, e vetmja rrugë që të sqaron të tashmen e të ndriçon perspektivën. Ai nuk duhet bërë si qëllim në vete, as për të kënaqur kureshtjen dhe vetëm për të zhvilluar intelektin, por për të qenë të dobishëm në jetë, për t'i kryer sa më me sukses detyrat, për të çuar përpara çështjen e revolucionit e të ndërtimit socialist. Këto arrihen nëpërmjet përvetësimit krijues të shkencës së marksizëm-leninizmit, duke e mësuar atë jo në mënyrë libreske, abstrakte, por në lidhje të ngushtë me praktikën revolucionare, duke zhvilluar me konsekuençë luftën parimore kundër filozofisë dhe teorive borgjeze e revizioniste kundër falsifikimeve që i bëhen doktrinës marksiste-leniniste nga revisionistët modernë. Autori nën vizion kërkesën që, jo vetëm të njihen ligjet e përkufizimet marksiste, por, në radhë të parë, të udhëhiqemi në jetë nga to, për të zgjidhur problemet teorike e praktike dhe detyrat që na dalin përpara.

Në shumë materiale të tjera të vëllimit trajtohen probleme të përmirësimit të metodës e të stilit revolucionar në luftë me të metat e mangësitë, jepen orientime e porosi për të thelluar luftën ideologjike, politike dhe organizative kundër shfaqjeve të burokratizmit e të teknokratizmit, për të shëndoshur gjendjen jo të mirë të krijuar në atë kohë në Ministrinë e Mbrojtjes etj. Në to, gjithashtu, u bëhet kritikë parimore teorive

borgjeze e revizioniste që e konsiderojnë revolucionin proletar të panevojshëm, ngaqë e zëvendësojnë atë me revolucionin tekniko-shkencor.

Problemeve të politikës së jashtme, të lëvizjes marksiste-leniniste dhe të luftës kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, u kushtohen mjaft artikuj, biseda e materiale të tjera të këtij vëllimi. Në to jepen qartë politika e drejtë parimore dhe e pavarur që ndjenkin shteti ynë socialist dhe PPSH në marrëdhëniet me shtetet e tjera, e sidomos me vendet fqinje, qëndrimet e patundura e revolucionare të Partisë e të vendit tonë ndaj ngjarjeve e problemeve të ndryshme ndërkontinentare, si edhe lufta e vendosur që bëjnë ato për demaskimin e imperializmit dhe të socialimperializmit, të synimeve e planeve të tyre djallëzore në dëm të lirisë së popujve. Përkrahja që u bëhet aspiratave e luftërave të drejta të popujve për liri e pavarësi, veçanërisht atij palestinez dhe popujve arabë, është një qëndrim marksist-leninist dhe një mbështetje e fuqishme për këtë popuj.

Materialet e këtij vëllimi, të cilin komunistët dhe tërë masat punonjëse të vendit tonë e marrin në dorë në një kohë kur janë hedhur në sulm për të myllur me sukses vitin e fundit të pesëvjeçarit të shtatë, janë një ndihmë tjetër e fuqishme për rritjen e frysës së mobilizimit të tyre në punë, për rritjen e efektivitetit të ekonomisë, për kalitjen e mëtejshme të ndërgjegjes së tyre revolucionare.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

MBI KUPTIMIN TEORIK E PRAKTIK TË ORGANIZIMIT TË PUNËS

Fjala e mbylljes në Plenumin e 10-të të KQ të PPSH¹

26 qershor 1970

Shokë,

Një dinamizëm i paparë zhvillimi e transformimi të pandërprerë përshkon sot gjithë jetën e vendit tonë. Lëvizjet revolucionare, iniciativat dhe ndryshimet ndje-kin kudo e me ritëm të shpejtë njëra-tjetren. I gjithë ky zhvillim kompleks e i harmonishëm, që natyrisht nuk bëhet pa vështirësi, pa pengesa e kontradikta, kri-jon një gjendje të re, shtron vazhdimisht përpëra Partisë detyra dhe probleme të reja e të shumanshme, me karakter teorik dhe organizativ, nga zgjidhja e të cilave varen shumë edhe ritmet e ecjes së mëtejshme përpëra drejt socializmit e komunizmit. Marksizëm-leni-

1 Plenumi i 10-të i KQ të PPSH, që u mblohdh më 25-26 qershor 1970 dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Ta ngremë punën organizuese të Partisë në nivelin e detyrave të etapës së sotme të ndërtimit socialist» mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Hysni Kapo.

nizmi dhe eksperienca e ndërtimit tonë socialist na tregojnë qartë se zgjidhja e tyre e drejtë, e shëndoshë e revolucionare kërkon medoemos që ato të studiohen e të trajtohen në mënyrë shkencore, të thellë e të gjith-anshmë, që e gjithë puna organizuese e Partisë përzbatimin e tyre në jetë të ngrihet në një shkallë të rmë të lartë. Kështu duhet t'i kuptojmë, me këtë sy duhet t'i shohim edhe të gjitha ato detyra e probleme që u shtruan e u rrahën gjerësisht në këtë Plenum dhe që kanë një rëndësi të posaçme për ndërtimin tonë socialist në stadin e sotëm.

Gjithëjeta e vendit, çdo vepër dhe fitore e klasës punëtore, e fshatarësisë kooperativiste dhe e inteligen-cies popullore në revolucionin dhe në ndërtimin socialist janë të pandara nga vija, nga puna e madhe organi-zative e Partisë, sepse kjo është forca udhëheqëse e drejtuese e shoqërisë sonë. Punën e saj organizative Partia jonë e ka parë dhe e ka zhvilluar kurdoherë në kompleks, duke përfshirë në të politikën e ideologjinë, ekonominë e kulturën, shkencën e teknikën, qeverisjen e mbrojtjen etj., etj. Në këtë kuptim puna organizative e Partisë ka qenë kurdoherë shumë e gjerë, ndërsa zbatimi i saj në jetë ka kërkuar një mendim të vërtetë kri-jues dhe forma që i përshtaten realitetit.

Prandaj, kur flasim për problemet organizative të Partisë, nuk na lejohet asnjëherë të biem në thjeshtëzi-me, t'i ngushtojmë e t'i zvogëlojmë ato, duke i reduk-tuar vetëm në disa norma apo rregulla organizative të njohura. E theksoj këtë, sepse nganjëherë kuptohet si-kur këto probleme përmbledhin vetëm disa çështje të tillë, si: organizimi i Partisë në organizata-bazë, shtrir-

ja e Partisë, pranimet në Parti, organizimi i mbledhjeve dhe disa veprime të tjera si këto. Një kuptim i tillë mekanik i problemeve organizative të Partisë jo vetëm që është shumë i ngushtë, por nuk është i drejtë as koncepti që puna organizuese e Partisë të kuptohet e të kufizohet vetëm në caktimin apo në marrjen vetëm të disa masave thjesht praktike, pa përmbajtje politiko-ideologjike dhe pa perspektivë të qartë të gjerësisë dhe të thellësisë së rezultatit që kërkohet të arrihet.

Mësuesit tanë të mëdhenj, Marks, Engels, Lenini dhe Stalini, na mësojnë se në luftën kundër borgjezisë, për triumfin e revolucionit proletar, forcës shtypëse e shfrytëzuese të rendit kapitalist klasa punëtore nuk ka ç't'i vërë përballë veçse forcën e organizimit të saj të hekurt, ndërgjegjen e saj të klasës. Edhe pas marrjes së pushtetit politik, për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, klasa punëtore përballon shumë vështirësi e pengesa, sidomos në sajë të organizimit dhe të veprimit të saj të ndërgjegjshëm revolucionar klasor. Mirëpo si për përblysjen e borgjezisë nga pushteti politik, ashtu edhe për ndërtimin e shoqërisë së re, organizimi i hekurt i klasës punëtore kërkon patjetër e, në radhë të parë, organizimin e partisë së proletariatit. Pa këtë organizim nuk mund të realizohet me sukses vija politike dhe ideologjike e proletariatit. Ai ndihmon, rregullon e shpejton procesin që në kushte materiale e revolucionare të arritura, faktori subjektiv, klasa punëtore, të japë grushtin e fundit e vendimtar për të shkatërruar botën e vjetër të kapitalit dhe për ta zëvendësuar atë me botën e re të socializmit e të komunizmit.

Kështu, pra, që ideologjia dhe politika e klasës pu-

nëtore të realizohen me sukses, lypset t'u kushtohet një vëmendje e madhe rolit e forcës organizuese të Partisë. Përndryshe nuk mund të arrihen fitore apo suksese të qëndrueshme as në luftën kundër kapitalit, as në mbajtjen e pushtetit politik nga ana e proletariatit, pa të cilin nuk mund të hidhet asnjë hap përpara në ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Në këtë prizëm duhen kuptuar e duhen zbatuar në jetë çështjet organizative të Partisë, duhet luftuar për përsosjen e punës drejtuese e organizuese të Partisë. Një kuptim i thellë i rolit drejtues e organizues, edukues e zbatues i Partisë është një premisë e domosdoshme për të pasur një parti të proletariatit të fuqishme, të kalitur në beteja, të aftë për t'i kuptuar drejt, politikisht dhe ideologjikisht, të gjitha problemet në çdo kohë dhe në çdo situatë, parti që të dijë të organizojë në mënyrë të përsosur punën për të vënë në praktikë vijën. Dhe vija e Partisë është e gjerë, e shumanshme. Prandaj ta kemi mirë të qartë se, duke i kuptuar si duhet çështjet organizative të Partisë, ne armatosemi njëkohësisht për ta organizuar punën si duhet kudo, në të gjithë sektorët, për të realizuar detyrat që na shtron stadi i ri i zhvillimit.

Çështjet organizative të Partisë nuk mund të shkëputen nga puna organizuese e saj për të gjitha detyrat dhe problemet e ndryshme që përbëjnë vijën e Partisë. Politika nuk mund të kuptohet e shkëputur nga organizimi për konkretizimin në jetë të kësaj vije dhe as njëra, as tjetra nuk mund të kuptohen, as të zbatohen për Partinë tonë, pa qenë frymëzuar, mbrujtur dho udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste. Ecja pa.

lëkundje dhe me temp revolucionar e bën Partinë tonë të çeliktë dhe të aftë t'i zgjidhë drejt problemet politike, ideologjike, ekonomike, kulturore dhe ushtarake.

Por të mos mendojmë se kemi arritur përsosmëri në këto probleme, të mos mendojmë se të gjithë komunistët i kuptojnë dhe i zbatojnë drejt këto çështje, të mos mendojmë se nuk kemi të meta dhe gabime.

Dihet, dhe për këtë është folur shpesh, se puna organizuese e Partisë, format, metoda dhe stili i saj nuk janë diçka e ngurtë, e pandryshueshme, e dhënë njëherë e përgjithnjë. Jo, ato janë dinamike, të lëvizshme dhe duhet të ndryshojnë sipas studit të zhvillimit të faktorëve materialë dhe atyre subjektivë, sipas detyrave e problemeve të reja që nxjerr në shesh jeta, sipas nevojave të forcimit të vetë Partisë, të pushtetit e të krejt rendit ekonomiko-shoqërор socialist.

Siq e dimë të gjithë, sot e tërë jeta e vendit tonë karakterizohet nga shumë iniciativa e lëvizje revolucionare dhe me një pjesëmarrje të gjerë të masave. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, gjithë punonjësit e punës fizike e mendore janë hedhur në aksione masive me goditje të përqendruar. Rinia shkollore dhe studenteske po merr pjesë gjerësisht në punë prodhuese në qytet dhe në fshat. E gjithë popullsia është përfshirë në një përgatitje e stërvitje ushtarake sistematike për mbrojtjen e atdheut. Kudo punonjësit po luftojnë për forcimin dhe për thellimin e demokracisë socialiste, për të rritur e për të zgjeruar pjesëmarrjen e tyre aktive në drejtimin e vendit, të ekonomisë e të kulturës.. Si këto që zura në gojë ka edhe shumë të tjera. Vihet pyetja: A na lejohet neve që puna organizuese e Partisë të

vazhdojë me format, me ritmin e me metodat e më-parshme, a mund të shërbejnë këto për të zgjidhur detyrat e reja, problemet e reja që nxjerr kjo gjendje revolucionare, ky hov revolucionar? Është e qartë dhe e kuptueshme se jo. Atëherë ç'duhet bërë? Duhen menduar, kërkuar e gjetur forma pune e organizimi të reja që t'u përshtaten situatave të reja, që t'u hapin rrugën senomeneve të reja dhe të ndihmojnë për zhvillimin e përsosjen e tyre. Me metodat e format e vjetra të punës organizuese nuk mund të zgjidhen detyrat e problemet që nxjerrin hedhja në aksione masive e ndihma reciproke jo e një skuadre apo e një brigade në kooperativë, por e gjithë kooperativës, dhe jo vetëm brendapërbrenda saj, por edhe në shkallë rrithi, bile edhe jashtë tij. E njëjta gjë duhet thënë edhe për ndërmarrjet shtetërore.

Organet e Partisë e të pushtetit, shkollat, mësuesit e pedagogët, gjithashtu, detyrat e problemet që nxjerr pjesëmarrja në prodhim e rinasë shkollore e studenteske, nuk mund t'i përballojnë me metodat organizative e pedagogjike që përdorin në klasë. Këtu lindin detyra të reja, probleme të reja, që janë karakteristike të fabrikës, të minierës, të arave me bimë apo të blektorisë, dhe të cilat duan medoemos trajtim të ri të punës organizuese. Programet e vjetra shkollore u përmbyssën dhe ato po rishikohen e po përpunoohen frontalisht e rrënjosht. Ose stërvitja ushtarake e popullsisë së rritur a mund të bëhet me po ato forma pune, me po ato programe që bëhet edhe stërvitja në kazermë e atyre që kryejnë shërbimin ushtarak të rregullt? Edhe në kë-të rast lypset menduar një trajtim i ri i problemit.

Kur del një direktivë, përcaktohen edhe format e organizimit të punës që ajo të mund të gjejë zbatim në jetë. Të gjithë, dhe, në radhë të parë, komunistët, duhet të kontribuojnë fuqimisht që direktiva që lëshohet, si dhe format organizative që e shoqërojnë, të jenë sa më të drejta, sa më të përshtatshme. Gjithashtu, të gjithë, dhe, në radhë të parë, komunistët, duhet ta kenë kuptuar plotësisht direktivën, pasi kështu do të mund pastaj edhe ta zbatojnë plotësisht. Sigurisht, përcaktimi në vija të përgjithshme i direktivës dhe i formave organizative bëhet në mbledhje të organizatave-bazë, të komiteteve të Partisë, të organeve të pushtetit dhe të ekonomisë, sipas nevojave dhe realitetit objektiv që e kanë kërkuar daljen e kësaj direktive.

Por megjithëkëtë, qoftë direktiva, qoftë organizimi i zbatimit të saj në jetë, mund të kenë gabime. Këto i vërteton praktika, por kësaj duhet t'i qëndrosh në kokë, jo në mënyrë pasive, por revolucionare. Ç'dua të them me këtë? Me këtë dua të them se, duke punuar, çdo punëtor, qoftë komunist ose i paorganizuar në Parti, kur konstaton defekte dhe ka mendime të mira për korrigjim, kur i janë hapur perspektiva akoma më të qarta, duhet të propozojë ndryshime. Por ç'ngjet? Shumë herë ka indiferentizëm nga ana e tij, ai ka turp apo druajtje për të bërë vërejtje mbi një direktivë të lëshuar nga lart, ka frikë se mos i ngjitin etiketën e mendjemadhit, të kritizerit, të grindavecit. Të gjitha këto janë mendime të gabuara, jorevolucionare.

Gjithashtu, edhe mendimi se komunisti ose punonjësi i paorganizuar në Parti këto sugjerime duhet t'i

shtrojë vetëm në organizatën-bazë ose në drejtori nuk është i drejtë.

Diskutimin në rrugë të drejtë për përmirësimin e punës nuk e ndalon kush, përkundrazi, Partia e përkrah atë, e inkurajon. Sa më të përgatitura e të rrahura që jashtë t'i venë mendimet e propozimet organizatës-bazë ose drejtorisë, aq më mirë është. Me diskutimet e tyre edhe jashtë organizatave e rrugëve zyrtare, punëtorët, komunistë ose të paorganizuar në Parti, s'bëjnë asgjë të keqe, përkundrazi, ata bëjnë mirë që diskutojnë një udhëzim o direktivë që ka gabime, një formë organizimi që çalon dhe, pasi rrahin mendimet, e kjo nuk është e domosdoshme në takime zyrtare, e shtrojnë problemin parimisht në organizatën-bazë ose në drejtori, sipas rastit, për ta diskutuar këtë radhi në mënyrë kollegiale dhe për të marrë vendime, po ta lypë nevoja.

Kur themi që organizata-bazë të vetëveprojë, të tregohet revolucionare dhe luftarake, kjo nuk duhet kuptuar vetëm si forum, por në shembullin e organizatës duhet të veprojë në jetë edhe çdo pjesëtar i saj. Pa komunistë revolucionarë nuk mund të ketë organizatë revolucionare. Pra, në qoftë se komunisti, i armatosur me vendimet dhe me direktivat e Partisë, nuk vepron aktivisht për çdo gjë dhe për çdo aktivitet të tij revolucionar të përditshëm, në qoftë se ai nuk përpinqet të gjejë format e përshtatshme të organizimit, të metodës e të stilit, ai nuk mund ta kryejë si duhet rolin si udhëheqës, si komunist. Ai, kur është rasti, mundet dhe duhet të veprojë edhe i shkëputur për të zbatuar direktivën dhe të mos presë, siç bëjnë disa komu-

nistë, që nuk ngrenë qimen nga qulli dhe gjoja ruajnë format organizative, duke pritur mbledhjen e organizatës-bazë për të kritikuar ndonjë shok që shkel direktivën o disiplinën.

E përse të presë komunisti në fabrikë a gjetkë mbledhjet e rregullta për të kritikuar një shok? Ai që në minutat e pushimit i thërret shokët rrëth tij, si dhe shokun në fjalë, dhe ia thotë të katër të vërtetat në sy. Ç'rregull u prish këtu? Asnjë. Bile shoku ndreqet. Dhe në rast se nuk ndreqet, atëherë çështja e tij ngritet edhe në mbledhje të organizatës-bazë.

Po të veprohet kështu për të gjitha problemet që u dalin në jetën e përditshme komunistëve, sa gjëra e direktiva do të ndreqen, sa forma të organizimit të punës do të përmirësohen, sa probleme parimore frytdhënëse do të dalin për organizatat-bazë dhe për forumet e Partisë dhe të shtetit!

Qoftë në sektorët e punës së Partisë, qoftë në ata të ekonomisë, të arsimit e të kulturës, të ushtrisë apo në çdo sektor tjeter ku punohet e prodhohet, në punën fizike apo në atë mendore, çështjet organizative janë të një rëndësie vendimtare. Çfarëdo pune që parashikohet të kryhet, më parë ajo duhet organizuar mirë.

Ne themi që mendimi është pasqyrimi i botës materiale, por shpesh, sidomos me disa që nuk thellohen, ndodh që atë e konsiderojnë si diçka që nuk u nënshtronhet renditjes dhe organizimit, kurse në fakt të menduarit në çdo rast, në çdo formë dhe në çdo trajtë që ai merr, shoqërohet me një formë organizimi, koordinimi, renditjeje. Çështja është se në mendimet tona, kur ato e pasqyrojnë drejt realitetin, shprehet lidhja organike

e sendeve dhe e fenomeneve që na rrrethojnë, shprehen ai organizim, ajo renditje që ekzistojnë në botën e jashtme, me fjalë të tjera, shprehen logjika, dialektika objektive e botës materiale. Nga ana tjetër, që mendimi të jetë i qartë e i kuptueshëm, si për vete dhe aq më tepër për të tjerët, ai duhet patjetër të organizohet, të renditet, të sistemohet. Ndryshe, idetë dalin të errëta, problemet shtrohen rrëmujë, konkluzionet nuk dalin logjike.

Çështjeve organizative, lidhur me të gjitha problemet, duhet t'u vëmë rëndësi të madhe, sepse organizimi ka një kuptim të thellë teoriko-filosofik. Jeta e shoqërisë zhvillohet sipas disa ligjeve, ashtu siç ka ligjet e veta edhe natyra. Duam s'duam ne, këto ligje veprojnë, bëjnë punën e tyre. Por njerëzit nuk janë të pafuqishëm para tyre. Ata janë në gjendje t'i njohin dhe t'i përdorin këto ligje për të çuar përpara prodhimin dhe gjithë jetën e shoqërisë. Mundësitë e njohjes dhe të përdorimit të ligjeve janë të ndryshme në rende të ndryshme shoqërore. Me kalimin në socializëm këto mundësi rriten në mënyrë kolosale. Këtu bëhet ai hop i madh cilësor në zhvillimin e shoqërisë të cilin Engelsi e ka karakterizuar si një kalim nga mbretëria e domosdoshmërisë në atë të lirisë. Por mundësitë janë një gjë dhe realizimi i tyre në praktikë një gjë tjetër. Përdorimi i gjerë dhe i drejtë i ligjeve të shoqërisë dhe të natyrës në dobi të zhvillimit të gjithanshëm të shoqërisë dhe të njeriut varet drejtpërsëdrejti nga puna jonë organizuese, nga krijimi i atyre kushteve dhe nga marrja e atyre masave të domosdoshme që bëjnë të mundur veprimin e tyre me sukses. Pa organizuar

punën në përshtatje me kërkesat e ligjeve objektive, ekzistojnë rreziqe serioze që shpien në dështime të mëdha.

Organizimi nuk duhet konsideruar, pra, si diçka e dorës së dytë, ai është bazë dhe pjesë përbërëse e zbatimit të ligjit, të direktivës. Organizimi i mirë e i përsosur në çdo gjë është diçka shkencore e një rëndësie të madhe. Një organizim i tillë i përsosur shkencor jo vetëm bën të realizohen ligji, direktiva, shkenca, por e çon përpara shkencën, ndihmon të zbulohen anët e panjohura të ligjeve dhe të fenomeneve. Kurse organizimi i keq, joshkencor, që nuk merr parasysh të gjitha të dhënat objektive dhe subjektive, dëmton, ai frenon teorinë dhe praktikën. Pra, organizimi është ajo diçka e rëndësishme që është e lidhur me teorinë dhe me praktikën.

Kur fizikani apo kimisti nuk e organizojnë mirë punën e tyre, ligjet shkencore nuk mund të gjejnë zbatimin e duhur, ato nuk mund të veprojnë dhe as mund të dilet me konkluzione dhe shpikje të mëtejshme nga fenomenet dhe ndodhitë që, në fakt, nuk kanë ndodhur ose kanë ndodhur, por kanë ndodhur të çala, për arsy se organizimi i punës nuk ka qenë i përsosur e shkencor, por ka qenë i çalë. Kështu ndodh në të gjitha fushat e tjera: në industri, në bujqësi, në arsim e kulturë; natyrisht, kështu ndodh edhe në punën teorike, si dhe në praktikën revolucionare të Partisë.

Në të gjitha kooperativat bujqësore po luftohet për të marrë rendimente të larta nga kulturat bujqësore. Por a mund të arrihet kjo atje ku nuk u kushtohet kujdes mbjelljes në afatet optimale, zgjedhjes së farës, kryerjes së të gjitha shërbimeve në kohë e me cilësi të

lartë? Kuptohet se jo. Si ndodh që në tërë kooperativat e Durrësit që kultivojnë oriz merren mesatarisht mbi 53 kuintalë për hektar, kurse në Krujë e në Shkodër — 26? Po diferencat e mëdha që vërtetohen në rendimentet e brigadave të së njëjtës kooperativë në kushte të barabarta, ose të kooperativave me të njëjtitat kushte, si mund të shpjegohen? Të gjitha këto flasin për rolin e madh që luan organizimi, marrja në kompleks e të gjitha masave për sigurimin e suksesit.

Lexova një ditë në «Zërin e popullit» një artikull shumë instruktiv për bibliotekat e vatrave të kulturës në kooperativa. Në mënyrë të veçantë atje bëheshin qortime të drejta që në këto biblioteka nuk gjeje asnjë libër ose revistë bujqësore. Çfarë organizimi për studim i thonë këtij? A mund të përvetësohen dituria, mendimi krijues i njerëzve dhe eksperienca e më të mirëve, që na rekomandon vazhdimisht Partia, pa vënë në rrugë të drejtë çështjen e organizimit të këtyre problemeve? Një organizim i keq i përdorimit të diturisë dhe të eksperiencës shkakton mosbatimin si duhet të vijës së Partisë në bujqësi. Por të mos mendohet se kjo mungesë organizimi ka efekt vetëm në mospërvetësimin si duhet të agroteknikës dhe është pa efekt edhe në punën praktike në fusha. Ka njerëz që mendojnë se kooperativisti mund të dalë të punojë në fusha edhe pa qenë i ditur, se puna praktike bëhet edhe pa organizim të shëndoshë. Asnjë lloj pune, qoftë e lehtë ose e rëndë, qoftë mendore, qoftë fizike, nuk mund të shkëputet nga organizimi, nuk mund të kryhet pa organizim dhe, sa më i përsosur të jetë ky organizim, aq më mirë mësohet, punohet, prodhohet.

Organizimi është një mjet i fuqishëm që çon përparrë zhvillimin, punët, mendimin, është një dituri që nuk lind vetveti te njeriu, por fitohet duke punuar, është një dituri pa kufi të caktuar, jo e njëllojtë për çdo punë dhe për çdo kohë, ose e vendosur si një formë shablloni përngahera. Organizimi i përsosur është një art që mbështetet te njohuritë e gjera teorike, politike, shkencore e organizative, që di të kombinojë si duhet të dhënët dhe i ka të qartë objektivat ku duhet të arrijë, që karakterizohet nga një frymë përparimtare, revolucionare, që nuk u trembet vështirësive, por i parashikon ato. Organizimi i përsosur bazohet në vullnetin e fortë e në punën e palodhur, ai merr parasysh fitimin e kohës, zbatimin e teknikës së fundit e të dhëna të tjera.

Të para, pra, në këtë prizëm mund të kuptohet sa rëndësi të madhe duhet t'u vëmë çështjeve organizative.

Desha të ndalem pak tani edhe në një çështje tjeter, në atë të punës me njerëzit, për kuptimin e metodës dhe të stilit të kësaj pune. Për të gjithë ne është e qartë se organizimi sa më i lartë dhe i përsosur i veprimtarisë së gjithanshme të Partisë, organizimi i madh socialist i prodhimit, puna e gjerë me pjesëmarrjen gjithnjë e më të madhe e kolektive të masave, kërkijnë edhe një punë më të organizuar, më të kualifikuar dhe më të kujdeshshme me njerëzit. Në realizimin e këtij pikësynimi, krahas brendisë marksiste-leniniste, frymës së saj luftarake klasore revolucionare, një rol shumë të rëndësishëm luajnë metoda dhe stili i punës së Partisë. Çështja është që me punën tonë të depërtojmë në mendjet dhe zemrat e masave e të njerëzve të ve-

çantë, t'i bindim ata kolektivisht dhe individualisht, t'i prekim dhe t'i emocionojmë, t'i nxitim dhe t'i hedhim në aksione, t'u çojmë zemrat peshë në luftë për çështjen e madhe të Partisë e të revolucionit. Kjo është një punë e ndërlikuar që kërkon një propagandë bindëse me baza të thella shkencore. Në të njëjtën kohë ajo është një art i veçantë, të cilin duhet ta zotërojnë e gjithë Partia, të gjithë kuadrot, organizatorët dhe propagandistët tanë.

Formimi i ndërgjegjes socialiste është një proces kompleks. Në këtë proces ne ndeshemi si me psikologjinë shoqërore të njerëzve, ashtu edhe me psikologjinë individuale të tyre. Prandaj është e domosdoshme të njihen mirë si opinioni shoqëror në përgjithësi ashtu edhe njerëzit si individë, të njihen jo vetëm pikëpamjet ideopolitike dhe qëndrimet e përgjithshme të tyre, por edhe psikologjia, mentaliteti i tyre për jetën, nevojat dhe kërkesat që ata kanë jo vetëm në kuptimin material, por edhe në vështrimin social e psikologjik. Dhe po të punojmë me vëmendje, do të shohim se këto fenomene kanë theksimet, diferencimet e nuancat e veta në shtressa të ndryshme shoqërore, në mosha të ndryshme, në sekset e ndryshme, në qytet dhe në fshat, në fushë e në malësi, në krahinat e ndryshme të vendit, pa folur për shfaqjen e tyre të veçantë tek individët e ndryshëm. Në punën tonë me njerëzit, në veprimtarinë tonë organizative, propagandistike dhe edukative me ta ne duhet t'i marrim patjetër parasysh të gjitha këto fenomene.

Si märksistë-leninistë ne e kemi të qartë se lulëzimi i personalitetit të çdo individi të veçantë është

i mundur vetëm në gjirin e kolektivit. Prandaj edhe u kushtojmë rëndësi të posaçme formave e metodave të organizimit të gjithanshëm të punës kolektive, si dhe të edukimit të njerëzve në kolektiv. Por krahas kësaj Partia thekson gjithmonë nevojën që të mos kënaqemi vetëm me punën e përgjithshme që zhvillohet në kolektiv, të mos ngelemi vetëm te kjo punë, të mos injorojmë veçoritë individuale të njerëzve, preokupacionet e tyre të veçanta, përkundrazi, të tregohemi të kujdesshëm ndaj tyre, t'i njohim e t'i trajtojmë thellë, t'i zgjidhim drejt, duke adaptuar edhe qëndrimet e nevojshme individuale.

Pikërisht kështu, si shkencë dhe si art, e ka shkuar gjithmonë Partia punën me njerëzit. Kështu ka vepruar ajo që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, duke zhvilluar, si një punë të gjerë masive, ashtu edhe një punë të diferencuar e individuale me pionierët, me të rinjtë e pleqtë, me gratë, me fshatarët, me intelektualët e të tjerë. Mjafton të përmendim për këtë punën e madhe dhe nje shumë rezultat, të zhvilluar gjatë viteve të fundit, pér zgjidhjen e problemeve të mprehta sociale dhe ideologjike në luftën pér emancipimin e gjithanshëm të gruas dhe pér rritjen e gjithanshme të personalitetit të rinisë, në luftën kundër fesë dhe zakoneve prapanike, zotësinë dhe zhđervjelltësinë e Partisë sonë në luftë pér zgjidhjen e këtyre problemeve pikërisht duke depërtuar në ndërgjegjen dhe në psikologjinë e njerëzve, si të masave, ashtu edhe të individëve, duke shkallmuar me guxim të vjetrën dhe duke përkrahur me të gjitha forcat të renë revolucionare e socialiste, që po lulëzon edhe në këto fusha.

Por nuk është e drejtë të kënaqemi me ato çka kemi arritur dhe të mos shikojmë të metat serioze që vërehen akoma në punën me njerëzit. Nuk duhet të kënaqemi vetëm me pamjen e përgjithshme të jashtme dhe me tablotë masive të fenomeneve shoqërore, sidomos të atyre të botës së brendshme shpirtërore të njerëzve. Po të mbetemi këtu, nuk mund të luftojmë aktivisht kundër formalizmit dhe burokratizmit në punën me njerëzit, kundër standardizimit dhe uniformitetit në këtë punë. Kështu do të na lindin probleme të mprehta të karakterit ideopolitik.

Puna e Partisë është, mbi të gjitha, punë me njerëzit dhe kjo punë është e gjithanshme, sepse vetë njerëzit janë të gjithanshëm, me interesa, kërkesa, probleme e shqetësime të shumëlojta. Jeta e tyre është një kompleks i tërë, prandaj edhe Partia duhet ta kapë të gjithë këtë kompleks dhe të mos jetë e njëanshme në punën e saj. Nga njerëzit nuk duhet kërkuar vetëm punë, prodhim, rendiment, realizim plani. Të gjitha këto janë kërkesa të drejta, të domosdoshme dhe të rëndësishme, por ato nuk janë qëllim në vetvete. Te ne çdo gjë që prodhohet e krijohet bëhet në emër dhe në interes të njeriut punonjës. Nga kjo pikëpamje duhet kritikuar ashpër e duhet dënuar rëndë ajo metodë e praktikë e disa kuadrove, sidomos të organeve të push-tetit e të ekonomisë, të cilat interesohen për çdo gjë, për bulona a për lopë, por harrojnë atë që është kryesore e vendimtare në çdo punë — njeriun, kujdesin për të, për jetën dhe shëndetin e tij, për sigurimin e tij teknik, për higjienën dhe ambientet e kulturuara, për pushimin, edukimin dhe argëtimin e tij etj..

Gjatë vizitës në Tropojë¹ u takova e bisedova me një grup gjeologësh që punonin në malet e Dragobisë. Ata bëjnë me të vërtetë një punë heroike në dobi të popullit e të atdheut. I pyeta si venë me punën, si jetojnë, ç'probleme i shqetësojnë, ç'nevoja kanë etj. Në fillim u duk sikur çdo gjë ishte në rregull, por pastaj doli se ata kishin disa nevoja urgjente e të domosdoshme. «E shikon, ku punojmë, — më thanë dhe më treguan majat e maleve të mbuluara me re, — atje dëbora është me metër tanë në behar, pale në dimër, kurse rrrobat e pajisjet tona janë si për në fusha». Mos vallë shteti ynë nuk është në gjendje t'i plotësojë këto nevoja që ata të punojnë në kushte normale edhe në vende të tilla të ashpra midis Majës së Kollatës dhe Majës së Hekurave? Jo, shokë. Sa janë këta gjeologë që punojnë në këto zona e kushte? Nuk janë më shumë se 100, ja qofshin edhe 200. Dhe fjala është për këta dhe jo edhe për ata që punojnë, ta zëmë, në Divjakë të Lushnjës. Pra, nuk është çështje mundësish materiale, por kryesisht çështje kujdesi dhe vlerësimi të drejtë të problemit. Partia ka tërhequr vëmendjen edhe më parë për këtë problem. Janë marrë edhe disa masa, por del se problemi akoma nuk është zgjidhur si duhet.

E solla këtë shembull vetëm sa për të ilustruar idenë, për të theksuar atë që Partia e ka ngritur vazhdimisht që, në tërë punën tonë, të mos harrojmë kurrë njeriun me të gjithë interesat e tij jo vetëm materialo-ekonomikë, por edhe shpirtërorë, moralë, politikë,

1 Këtë vizitë shoku Enver Hoxha e bëri më 30-31 maj 1970. Shih: Enver Hoxha. Vepër, vëll. 43, f. 349-448.

ideologjikë, psikologjikë, kulturorë, arsimorë e profesionalë.

Njerëzit tanë janë të mrekullueshëm. Ata i karakterizojnë thjeshtësia proletare, shpirti i sakrificës dhe i vetëmohimit, gatishmëria e vendosmëria për t'u hedhur edhe në zjarr për çështjen e Partisë e të popullit. Kjo është një shprehje e lartë e besimit te Partia, e lidhjeve të saj të ngushta me popullin. Kjo është një forcë kolosalë, është ajo forcë që e bën Partinë tonë të pathyeshme dhe popullin tonë të paepur. Këtë gatishmëri, këtë besim te Partia duhet ta kanalizojmë mirë, ta përdomrim si një armë të fuqishme për të kapërcyer çdo pengesë e për të mposhtur çdo vështirësi, për t'i çuar gjithnjë përpara revolucionin, ndërtimin tonë socialist. Por, lidhur me këtë, desha të theksoj se nuk duhet të lejojmë, bile, duhet të dënojmë çdo shfaqje të spekulimit me këto virtute të larta të punonjësve tanë. Sepse njerëzit tanë janë të thjeshtë e pa pretendime, kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të pakësojë kujdesin tonë për të plotësuar të gjitha ato nevoja e kërkesa të drejta e të ligjshme materiale e shpirtërore që ata kanë, ose sepse njerëzit tani janë të gatshëm t'i përgjigjen çdo thirrjeje të Partisë, nuk është e drejtë dhe s'ka asnjë arsyet i nxjerrim ata në mitingje e manifestime me orë të tëra para fillimit të tyre, ashtu siç nuk është e drejtë dhe nuk ka arsyet i ngremë njerëzit medoemos natën në aksione, kur puna fillon ditën e kryhet brenda pak orëve. Këtu ka dy gjëra: Ose disa shokë nuk kanë besim në gatishmërinë e masave, ose me këto veprime përpinqen të mbulojnë dobësitë e tyre në organizimin e punës, ose është edhe njëra, edhe tjetra.

Puna me njerëzit është një punë që kërkon njohjen e thellë të vijës së Partisë dhe zgjuarsi e takt në zbatimin e saj. Jo çdo gjë mund të trajtohet e të zgjidhet në format masive të punës, në mbledhjet e Frontit, të rinisë, të bashkimeve profesionale apo në shtyp. Sidomos kur është fjala për problemet shoqërore e familjare, të jetës intime të njerëzve, ndërhyrja me vend e pa vend për to, shpesh, në vend të bëjë mirë, dëmon, krijon shqetësime të mëdha e të panevojshme në njerëzit, prek rëndë sedrën e tyre dhe ndonjërin e shtyn deri në veprime të dhimbshme e të dënueshme nga morali ynë proletar. Të mos harrojmë se njerëzit janë me ndjenja e me zemër, ata kanë dinjitetin dhe personalitetin e tyre, të cilat jo vetëm nuk duhet t'i marrim nëpër këmbë, por t'i mbrojmë e t'i forcojmë në rrugën që na mëson Partia, duke luftuar çdo qëndrim e veprim arbitrar nga kushdo që të bëhet. Këtu nuk është çështja të mbulojmë dobësitë apo gabimet e njërit apo të tjeterit, por të dimë të gjejmë rrugët, format dhe metodat e punës më të përshtatshme për arritjen e qëllimit.

Kjo është një punë e tillë që, për ta bërë me sukses, duhet të futesh në shpirtin e njerëzve, të njohësh thellë mendimet e shqetësimet e tyre, interesat dhe preokupacionet e tyre. Për t'i njohur të gjitha këto duhet *bon sens*, duhet elasticitet, duhet takt në punën me njerëzit, me qëllim që të krijohet në marrëdhënet me ta ai ambient i ngrohtë e shoqëror ku secili të shfaqë lirisht mendimet e tij, të shtrojë hapur problemet, të qajë hallet si me njeriun e tij më të afërt. Dihet se, gjatë diskutimit mbi kontrollin punëtor, punëtorët e

fshatarët ngritën shumë gjëra, shtruan shumë probleme, bënë shumë vërejtje për punën dhe njerëzit. Por deri atëherë këto gjëra ishin mbajtur të mbyllura, të fshehta. Pse? Sepse i mbyste burokratizmi, zyrtarizmi. Nga këto raste Partia ka nxjerrë dhe duhet të nxjerrë vazhdimit mësimë. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me lidhjet e saj me masat, me marrëdhëniet e kuadrove me punonjësit, me mbrcjtjen dhe zhvillimin e demokracisë së masave.

Për të kriuar këtë ambient të ngrontë, të lirë e shoqëror ne duhet t'i shpallim një luftë të vendosur zyrtarizmit, që shfaqet si në sjelljet e qëndrimet e disa kuadrove me punonjësit, ashtu edhe në propagandën, në stilin dhe në gjuhën me të cilët ne u drejtohem e flasim me masat. Kuadrot tanë duhet të jenë shembull modestie, thjeshtësie proletare, të papajtueshëm me çdo shfaqje kapadaillëku e megalomanie intelektuale, me çdo fryshtë autoritare që ndrydh e mbyt iniciativën, lirinë e mendimit e të veprimit, kritikën dhe autokritikën e shëndoshë revolucionare. Jo vetëm në marrëdhëniet me masat, por edhe me shokët e punës në organet e Partisë apo të pushtetit ata duhet të krijojnë një ambient të tillë shoqëror ku secili të shfaqë pa druajtje dhe hapur mendimet e tij, të këshillohet për çdo problem, të bëjë vërejtje e të kërkojë ndihmë.

Në këtë drejtim ka të bëjë shumë edhe stili, mënyra, gjuha se si ne flasim me njerëzit, si shkruajmë në gazetat tonë. E kam theksuar edhe herë tjetër që në këtë drejtim duhet të emancipojmë vetveten, sepse jemi ne vetë, janë shumë shokë që shpesh japid një shembull të keq në këtë drejtim, që futin në propagan-

dën e Partisë një stil e gjuhë burokratike, zyrtare, me fraza stereotipe, me fjalë bombastike, me terma intelektualistë, gjë që e bën të vështirë komunikimin me njerëzit, krijon distancë me ta, marrëdhënie shumë zyrtare. E kuqtoj se kthesa është e vështirë, pasi jemi mësuar me këtë traditë, ajo është shndërruar në një shprehi, por ne kemi thyer shumë tradita e shprehi të tjera akoma më të forta, pra mund dhe duhet t'i thyejmë edhe këto tradita e shprehi dhe t'i japim propagandës sonë një forcë e shtytje të re përpara.

Në punën e Partisë me njerëzit ndikojnë negativisht edhe metoda konservatore e patriarkale që përdoren disa herë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqërore, si dhe mbeturinat e edukatës patriarkale, të cilat janë akoma mjaft të përhapura në familje, në shkollë, në ushtri e gjetkë. Peshën e këtyre koncepteve dhe formave të vjetruara të punës e ndiejnë sidomos gratë dhe brezi i ri. Neve, si Parti, nuk mund të mos na tërheqin vëmendjen këto fenomene, qoftë edhe atëherë kur zhvillohen në familje ose në ambientin e përditshëm shoqëror.

Po të vërejmë me kujdes jetën e familjes, do të shohim se mjaft prindër, edhe kur kanë një nivel të ngritur ideopolitik, nuk dinë të punojnë siç duhet me fëmijët e tyre, sidomos kur ata arrijnë moshën e rinisë, nuk marrin parasysh personalitetin gjithnjë në rritje të të rinjve dhe nuk i ndihmojnë ata që ta afirmojnë këtë personalitet, injorijnë shumë dëshira e kërkesa të drejtë dhe përparimtare të rinisë, nënvleftësojnë aftësitë, mundësinë e përvojën e saj dhe veprojnë mbi të kryesisht në rrugën e qortimeve dhe të moralizimeve të tha-

ta e të mërzitshme, në rrugën e diktatit e të tutelës. Por është akoma më keq kur këto metoda konservatore e patriarchale përdoren edhe në shkollë, në marrëdhëniet midis mësuesve e nxënësve, midis pedagogëve e studentëve, pikërisht atje ku duhet të përdoren metodat më të kualifikuara dhe më përparimtare të edukimit, të bazuara shkencërisht në psikologjinë dhe në pedagogjinë revolucionare.

Disa herë ndodh që kuadrot tanë bëhen skllevër të këtyre metodave padashur dhe pa e kuptuar dëmin e tyre. Më kanë treguar se vitet e fundit në ushtri, përfundit, tek ata ushtarë që thyejnë disiplinën ushtarake ose normat e moralit komunist, përdoret edhe kjo rrugë: u dërgohet familjeve të tyre letër. Disa shokë bilejanë shumë entuziastë për këtë mënyrë veprimi dhe e konsiderojnë si një novacion në stilin e punës së tyre edukative. Ndoshta kjo rrugë mund të përdoret në ndonjë rast ekstrem dhe, ndoshta, në ndonjë rast ajo mund të ketë njëfarë efekti, së paku të përkohshëm e të jash-tëm. Por përgjithësisht ajo është një mënyrë veprimi mjaft primitive. Kjo është njëlloj si veprimi i atyre mësuesve që i paditin nxënësit te prindët apo te drejtori për sjelljet jo të hijshme, duke menduar me këtë se e kanë kryer detyrën, apo e kanë zgjidhur problemin. Kurse në fakt, ashtu siç duhet të jetë, mësuesi është një shok më i madh e më i pjekur dhe një prind i dytë për nxënësin, kështu duhet të jenë edhe nënoficeri apo oficeri për ushtarin, ndërsa reparti ku ai kryen shërbimin duhet të jetë një familje e re e vërtetë për të. Pastaj a nuk kemi të bëjmë këtu me një metodë tipike patriarchale? Në vend që t'i drejtohem i vetë të

riut, t'i bëjmë thirrje personalitetit të tij, e kapërcejmë dhe e injorojmë atë dhe i drejtohemë forcës së jashtme mekanike të autoritetit patriarkal prindëror, ose, po ta themi më shqip, shfrytëzojmë frikën dhe turpin që mund të kenë sidomos të rinjtë fshatarë, e veçanërisht malësorë, ndaj prindërvë të tyre. Dhe nuk duhet të harrojmë se pikërisht me këta të rinj malësorë, pikërisht nga turpi dhe sedra që këta kanë, nga veprime të tillë të nxituara e të pamenduara mirë, mund të ndodhin edhe trauma të rënda psikike. A nuk kemi të bëjmë këtu, pra, edhe me injorimin e disa karakteristikave të rëndësishme psikologjike të personalitetit të tyre?

E keqja është se nga familja, nga shkolla, nga ushtria dhe nga ambiente e kolektiva të tjerë shoqërorë këto metoda konservatore e patriarkale edukimi transplantohen edhe në jetën e kolektivave punonjës, në veprimtarinë e organizatave shoqërore, në punën e Partisë me njerëzit, duke ndikuar negativisht sidomos në marrëdhëni e kuadrove me masat, duke mbajtur gjallë frymën komanduese burokratike dhe formalizmin e uniformitetin mekanik në punën edukative.

Në këtë mënyrë të gjitha këto probleme, që kanë gjithmonë anën e vet sociale, psikologjike dhe pedagogjike, marrin një karakter të mprehtë ideopolitik, pengojnë forcimin e mëtejshëm të unitetit moralo-politik të popullit, si dhe zgjidhjen e pandërprerë të kontradiktave joantagoniste në gjirin e tij. Për këtë arsyе Partia i ngre me forcë këto probleme, të cilat, në vështrim të parë, ndokujt mund t'i duken si çështje sociale dhe pedagogjike që nuk kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me punën e Partisë. Aq më tepër në këtë prizëm duhen vle-

rësuar seriozisht problemet e mprehta me karakter të drejtpërdrejtë ideopolitik për të cilat folëm më parë.

Shokë,

Para se ta mbyllim mbledhjen desha të them edhe dy fjalë për çuarjen në bazë të këtyre problemeve që shtruam në Plenumin tonë, për zërthimin dhe për organizimin e zbatimit të tyre.

Para së gjithash, nuk duhet menduar se këto çështje mund të zgjidhen duke organizuar një plenum apo aktiv dhe duke i analizuar ato globalisht në një mbledhje të organizatës-bazë të Partisë. S'do të ishte e drejtë, gjithashtu, të mendohej se nga njëra anë kemi përpara plot detyra për t'i kryer, ekonomike, politike, ideologjike etj., kurse nga ana tjetër kemi edhe çështjet që shtroi Plenumi ynë i 10-të, pra si të veçanta. Jo. Çështjet që shtroi Plenumi i 10-të, duhet t'i shikojmë dhe t'i vëmë në jetë tok dhe duke luftuar për zbatimin e detyrave të rëndësishme që kemi përpara.

Jemi në prag të zgjedhjeve për Kuvendin Popullor, këshillat popullorë, gjyqtarët e ndihmësgjyqtarët popullorë. A ka rast më të mirë për të bërë një punë organizuese të gjerë, të gjithanshme, nga e gjithë Partia? Dhe këtu është fjala jo për të caktuar drejt ca masa organizativo-teknike që të bëhen zgjedhjet në rregull e me përfundime të mira. Këto patjetër kanë rëndësinë e tyre, por s'janë kryesoret. Kryesore është ta përdorim fushatën për një propagandë të fuqishme nga ana e Partisë dhe për një diskutim të vërtetë popullor lidhur me forcimin e mëtejshëm të demokracisë sonë soci-

listë, për t'i bërë më të ndërgjegjshme masat për rolin e tyre si zot vendi, për të përmirësuar kontrollin punëtor, për të rritur rolin dhe përgjegjësinë e njerëzve që zgjidhen si përfaqësues të popullit në organet e ndryshme të pushtetit etj. Pikërisht këtu duhet t'i luftojmë të metat që vihen re në propagandën tonë e që theksoshezin në raport, si: globalizmi, formalizmi, frazeologjia boshe etj.

Ose, ne jemi përpara një pune serioze lidhur me diskutimin e orientimeve për planin e ri pesëvjeçar. A ka rast më të mirë se këtu për të punuar në ato drejtime që u theksuan në këtë Plenum, të sigurojmë pikërisht me këtë rast tërheqjen efektive të mendimit të masave, të sigurojmë mendime e propozime të tilla që do t'i revolucionarizonin vërtet planet tonë?

Perspektiva të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës shtrohen përpara klasës punëtore, kooperativistëve dhe inteligjencies sonë popullore. Një hop i madh sasior dhë cilësor i paparë ndonjëherë do të vazhdohet të bëhet në vendin tonë, gjë që kërkon shpërthimin e mëtejshëm të energjive krijuese të njerëzve, kërkon dërrminin e prangave burokratike, kërkon krijimin e fushave të gjera në të cilat duhet të zbatohen mendimet racionale të novatorëve, ku të zbërthehen në mënyrë të organizuar (e kam fjalën të një organizimi shkencor e racionall) shumë shpikje, studime e projekte të maturuara, që janë fryt i përpjekjeve të punëtorëve, të kooperativistëve, të teknikëve, të inxhierëve e të specialistëve të tjyre.

Ka ardhur tani koha të kuptohet se e gjithë kjo krijimtari kaq e madhe kërkon zbatim të menjëher-

shëm në praktikë, ajo është në kontradiktë me mënyrën e vjetër të drejtimit, kur horizontet ishin akoma të ngushta dhe mundësítë të pakta. Projektet e shumta, frys i qindra punëtorëve dhe inxhinierëve, nuk mund të presin tani vendimin e ngadalshëm të një drejtori dikasteri. Në qoftë se anekënd Shqipërisë, në të gjitha rrethet, nuk organizohet puna në shkallë të gjerë për t'i vënë në jetë shpikjet, planet dhe sugjerimet e shumta të punëtorëve dhe të inxhinierëve të ndërtimit, për shembull, që i shohim të ekspozuara në ekspositën e Tiranës, ndërtimet nuk do të ecin me ritmin e nevojave që na dalin dhe të mundësive ekzistuese. Këto mundësi ne duhet t'i njohim dhe t'i shfrytëzojmë në maksimum, por duhet të njohim në të njëjtën kohë edhe format e punës burokratike që na pengojnë, të cilat duhet t'i luftojmë, ndryshe nuk mund të ecet përpala.

Duhet të bëhet një kthesë në mendimet se qendra duhet të bëjë çdo gjë, kurse rrethi nuk është në gjendje të bëjë gjëra të mëdha. Në qoftë se nisemi nga realiteti i madh objektiv, që Partia ka krijuar kudo, se rrethi dhe deri baza mund të drejtojë mirë dhe të organizojë gjëra më të mëdha, atçherë do të dalim në një konkluzion më të drejtë dhe më real, se kështu edhe qendra do të drejtojë e do të ndihmojë më mirë. Ndryshe do të ketë frenim, do të ketë burokratizëm. Shumë herë kemi frikë se mos baza gabon, por harrojmë se edhe ne vetë kemi gabuar në këto punë kur kemi qenë të rinj, bile edhe tani mund të gabojmë, ndërsa baza sot është ngritur e gabon më pak se më parë.

Pastaj ne c dimë mirë fjalën e urtë se «kush punon, gabon». Prandaj të kemi besim të plotë te baza, e

cila tani ka grumbulluar një eksperiencë kolosale. Do të jetë krim në rast se nuk vihet në veprim kjo eksperiencë, në qoftë se nuk kihet besim, nuk ndihmohet dhe nuk ushtrohet kontroll për përhapjen e saj.

Gjithë Partia, duke u thelluar në punimet e këtij Plenumi të Komitetit Qendror, duhet të zbërthejë shumë probleme kyç organizative si këto që solla si shembull dhe të mos i kalojë ato përciptazi.

Pas punimeve të këtij Plenumi, nga ana e Komitetit Qendror dhe e Qeverisë kuadrore kryesorë të rretheve do t'u shtrohen disa orientime dhe detyra për të punuar me kooperativistët projektplanin e pesëvjeçarit të ri (1971-1975) për bujqësinë, që do të diskutojë dhe do të aprovojë kongresi i ardhshëm i Partisë. Ju, shokë, e kuptioni shumë mirë rëndësinë e madhe jetike të këtij problemi. Unë nuk do të hyj këtu në thelbin e kësaj çështjeje, pasi ju do të njiheni nga afër me konkluzionet që Byroja Politike ka nxjerrë nga eksperiencia e deritashme në bujqësi, nga mundësitë dhe nga nevojat që kanë dalë. Por desha të thoja me këtë rast se këto orientime dhe detyra duhet të studiohen dhe të diskutohen me seriozitetin më të madh nga udhëheqja e çdo rrethi, para se të shkohet në bazë, në kooperativat dhe në ndërmarrjet bujqësore. E theksoj këtë sepse shumë herë u bihet shkurt çështjeve, pranohen këto me bindje ose disa herë edhe pa shumë bindje në fillim, nuk u bëhet atyre asnjë ndryshim, në plus ose në minus, dhe me këtë frysë shkohet edhe në bazë. E përgatitur puna kështu, na duket sikur ruajmë forma pune gjoja demokratike, por në thelb shumë gjëra ua imponojmë nga lart masave kooperativiste. Mirëpo

këto, në rast se nuk formojnë bindjen për realizimin e rendimenteve dhe për të gjitha orientimet që u jepen nga lart, në rast se këto u imponohen jashtë bindjes, bëhen të rënda dhe atëherë edhe kërkesat do të janë të parealizueshme.

Vijmë, pra, edhe këtu te problemi i madh, i organizimit të punës për të zberthyer direktivën e Komitetit Qendror. Me pesë rupë në xhep nuk mund të shkohet në këtë dasmë të madhe. Prandaj është e domosdoshme të organizohet në shkallë të madhe propaganda e këtij problemi, që nga qendra e deri në bazë. Qendra, nga ana e saj, duhet ta marrë në dorë këtë problem dhe ta ndjekë atë me një propagandë të zgjuar, këmba-këmbës, jo në tym, jo me sloganë të përgjithshme, por as edhe të humbasë në cikërrima. Edhe rrethi, nga ana e vet, duhet ta përgatitë propagandën në shkallë të gjerë, ta lidhë hartimin e projektplanit të bujqësisë me propagandën e prodhimit, me shërbimet e bimëve që janë mbi tokë e nën tokë, me emulacionin luftarak dhe origjinal të vetin, t'u punojë koka shokëve të çdo rrethi për ta organizuar gjithçka në mënyrë të përsosur.

Kjo nuk është një punë e thjeshtë, shokë, dhe as që mund të kryhet nga një ose dy persona, prandaj të ngjallet të të gjithë shpirti i organizimit luftarak për punën konkrete politike, për anët teknikë, për anët shkencore, për anën financiare etj. Duhet të dimë t'i kombinojmë mbledhjet, diskutimet, konsultat e shpjegimet me punët e shumta të stinës dhe të mos harrojmë se rezultatet e këtij viti sa më të mëdha që të janë në arritjen e rendimenteve, aq më shumë do të zënë vend edhe mbledhjet, konferencat, diskutimet e debatet për

hartimin e projektplanit pesëvjeçar të bujqësisë. Të luftohet çdo mënyrë pune automate, burokratike, ose, si të thuash, sa «për të transmetuar atë që më transmetohet», pa bindur më parë njerëzit, pa marrë masa të mira organizative, pa bërë një punë krijuese në këtë drejtim. Një punë e tillë, kuptohet, është pa telashe, por pa frysht dhe, natyrisht, një punë si kjo nuk është për ne komunistët.

Vitin që vjen do të jemi para Kongresit të 6-të të Partisë. Kemi përpara mbledhjet e organizatave-bazë për dhënie llogari e zgjedhje, kemi konferencat e Partisë etj. A nuk duhen konsideruar këto si objektiva që duhen arritur me rezultate sa më të mëdha në drejtim të forcimit të Partisë, të rolit të saj drejtues në të gjitha hallkat, duke përmirësuar përbërjen dhe shtrirjen e saj, duke ngritur nivelin e anëtarëve të saj, duke revolucionarizuar gjithnjë e më tej komunistët dhe kuadrot?

Që të mund të ngrihen probleme të thelluara e të argumentuara nga të gjitha anët në konferencat e Partisë e në kongres, do të jetë e domosdoshme, gjithashtu, që qysh tani të ndërmerren studime të ndryshme, të bëhet përgjithësimi i eksperiencës së grumbulluar, pra, të bëhet një punë më shkencore, siç porositi edhe Plenumi.

Në mbledhjen e Plenumit u fol shumë për iniciativë e vetëveprim. Pikërisht në luftën për zbatimin e çështjeve që shtroi ky Plenum duhet të duken në tërë madhështinë e vet iniciativa dhe vetëveprimi i bazës. Të mos pritet urdhër apo udhëzim nga lart për mënyrën si duhen punuar këto materiale. Kujt i shërben ai

uniformizëm që vihet re në këtë drejtim? Pse duhet domosdo të gjitha çështjet të shtrohen kurdo dhe kudo njëloj? Sipas problemeve, detyrave dhe hallkave që ka, çdo organizatë në rreth apo në bazë të kapë, të analizojë e të zgjidhë njërin pas tjetrës ato çështje që e shqetësojnë, duke i parë në prizmin e orientimeve që dha Plenumi i 10-të.

Ka ardhur koha të bëjmë një kthesë më të fortë në këtë drejtim. Le të shërbejë mbledhja e këtij Plenumi si një shtytje serioze për këtë kthesë të domosdoshme në metodën tonë të punës, në tërë punën tonë organizative!

*Botuar për herë të parë
në gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 154 (6818), 30 qershor 1970*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fjalimeve 1969-1970», f. 368.
Tiranë, 1970*

PAS «NDIHMËS» SOVJETIKE FSHIHET NJË DEMAGOGJI E RREZIKSIIME E REVIZIONISTËVE HRUSHOVIANË

*Nga biseda me një delegacion të Asamblesë Kombëtare
të Republikës Demokratike të Vietnamit*

27 korrik 1970

Jemi shumë të lumtur që në vendin tonë na erdhi për një vizitë miqësore delegacioni i Asamblesë Kom-bëtare të Republikës Demokratike të Vietnamit. Partia, Qeveria dhe gjithë populli shqiptar janë gëzuar shumë që kanë sot në gjirin e tyre përfaqësuesit, bijtë e luftëtarët e popullit heroik vietnamez, shokë dhe nxënës të luftëtarit e të udhëheqësit tuaj të shquar, Ho Shi Minit. Me këtë rast ne ju urojmë nga zemra mirëseardhjen në vendin tonë! Megjithëse gjeografikisht vendet tona ndodhen larg njëri-tjetrit, popujt tanë janë afër me shpirt dhe me zemër. Të dyja palët na afron lufta e përbashkët që bëjmë kundër të njëjtëve armiq: imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve modernë.

Duke marrë fjalën, kryetari i delegacionit vietnamez falënderoi për mikpritjen që iu bë në Shqipëri dhe foli për sukseset e arritura nga populli shqiptar si

dhe për luftën e popujve të Indokinës kundër imperialistëve amerikanë.

Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ne ju falënderojmë shumë si për ardhjen në Shqipëri, ashtu edhe për bisedën lidhur me situatën në Indokinë. Ne jemi në dijeni për luftën që bëjnë popujt e Indokinës, por me ato që na thatë ju, i zgjeruam edhe më shumë njojuritë tona.

Ne i përkrahim plotësisht popujt vietnamez, laosian dhe kamboxhian në luftën e tyre. Populli shqiptar është shumë i interesuar për luftën që bën populli juaj, sepse e konsideron atë si luftën e vet. Këtë ua kemi thënë vazhdimisht edhe shokëve të tjerë vietnamezë që kanë pasur rastin të vijnë në Shqipëri. Kjo shprehje e Partisë sonë nuk është një formulë e thjeshtë, po konkluzion i një bindjeje konkrete, reale, të formuar historikisht. Në gjendjen aktuale Shqipëria është ndodhur dhe vazhdon të jetë në luftë të vazhdueshme dhe të ashpër me imperialistët amerikanë dhe me revisionistët modernë që udhëhiqen nga revisionistët sovjetikë.

Në luftën e ashpër, kundër imperialistëve amerikanë, populli heroik vietnamez lufton për lirinë dhe për pavarësinë e tij, por me luftën që bën kundër armiqve tanë të përbashkët, ai lufton njëkohësisht edhe për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së popullit shqiptar. Kështu e kuptojmë ne luftën tuaj, prandaj themi se populli heroik vietnamez me luftën e vet mbron edhe çështjen e popullit shqiptar. Duke qenë të angazhuar që të gjithë së bashku në këtë luftë të madhe të përbashkët kundër imperializmit amerikan, ne i ndiejmë

nga afër vuajtjet, mundimet, disfatat dhe fitoret tuaja. Fitoret tuaja ne na gjëzojnë pa masë, pse ato ju çojnë drejt objektivit përfundimtar, ato forcojnë edhe pozitat tona dhe na bëjnë ta shtojmë më shumë mirënjojhen për luftën heroike të popullit tuaj, na nxitin të bëjmë një luftë akoma më të vendosur e të ashpër kundër armiqve tanë të përbashkët. Këtë luftë ne e bëjmë për të ndihmuar veten tonë, popullin heroik vietnamez dhe gjithë lëvizjen komuniste dhe nacionalçirimitare në botë. Natyrisht lufta jonë është modeste, se jemi një popull i vogël, po në raport me mundësitë tona përpinqemi të japim edhe ne kontributin tonë.

Ne mendojmë se, po të mos u bëjmë një luftë të pamëshirshme në të gjitha drejtimet imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye, nuk e ndihmojmë si duhet luftën e popullit heroik vietnamez.

Në luftën tuaj ju keni edhe ndihmën e përkrahjen e popujve të tjerë të Indokinës e të botës. Kjo ndihmë dhe përkrahje është me të vërtetë e madhe, por megjithatë, lufta e vetë popullit vietnamez është kryesoria për çlirimin e atdheut tuaj, ajo qëndron mbi të gjitha; fitorja do t'ju vijë, në radhë të parë, në sajë të luftës heroike, në sajë të gjakut dhe të sakrificave të popullit tuaj, kurse ndihmat nga jashtë, megjithëse kanë edhe ato shumë rëndësi, nuk mjaftojnë për të siguruar fitoren.

Në qoftë se nesër dikush do të thotë se Vietnami fitoi se «e ndihmuam ne», kjo nuk do të jetë aspak e drejtë. Ai «dikush» mund të thotë se ka ndihmuar me kaq ose me aq furnizime apo armë, por një pretendim

i tillë nuk është aspak marksist-leninist. Qëndrim inter-nacionalist është kur ndihma e dhënë nuk zihet fare në gojë, sepse disa ushqime e veshmbathje, ose pesë mortaja apo topa që ju dërgohen nga të tjerët kurrën e kurrrës nuk mund të barazohen e aq më shumë të mbivlerësohen në krahasim me gjakun dhe me sakrificat e panumërta të popullit heroik vietnamez, i cili me luftën e tij heroike përballon të gjitha presionet ushtarake dhe truket e imperialistëve amerikanë. Sipas pikëpamjes sonë askush s'ka të drejtë të kërkojë përfitime nën maskën e ndihmës që jep.

Bashkekzistencën paqësore Partia e Punës e Shqipërisë e kuption ashtu siç e ka shtruar Lenini, siç e ka zbatuar Stalini dhe jo ashtu siç e zbatojnë revizionistët sovjetikë. Të pretendohet se janë duke ndihmuar Vietnamin apo popujt arabë, në një kohë kur thurin intriga kundër tyre dhe bëjnë aleancë me imperialistët amerikanë, siç veprojnë revizionistët sovjetikë, kjo nuk ka të bëjë fare me bashkekzistencën paqësore leniniste. Ne e dimë që revizionistët hrushovianë ju japidisë armë, mirëpo sikur edhe të mos jua jepnin ato, ju nuk do të thyheshit, amerikanët nuk do t'ju mundnin, përkundrazi, në fund të fundit, edhe pa këto ndihma ju do t'i mundnit imperialistët agresorë amerikanë.

Ju i mundët edhe trupat franceze, megjithëse ato nuk ishin të një fuqie të vogël dhe luftuan barbarisht kundër popullit tuaj. Dë Kastri¹ nuk mundi t'i reziston te dot sulmit të ushtrisë suaj heroike në Dien Bien Fu².

1 Komandanti i trupekspeditës franceze.

2 Beteja në Dien Bien Fu, mars-maj 1954, shënoi fitoren

Një pjesë të armëve, me të cilat ju luftonit kundër imperialistëve francezë ua rrëmbyet ushtarëve francezë, kurse për gjithë pjesën tjetër që ju nevojitej, krijuat punishte të thjeshta në pyje, ku filluat të shkrinit hekurishte nga më të ndryshmet për të prodhuar armë e predha. Me këto mjete, sido që primitive, ju fituat kundër ushtrisë franceze me një traditë luftarake shumë më të madhe nga ajo amerikane.

Në qoftë se revizionistët sovjetikë, të cilët ne nuk i përziejmë me Bashkimin Sovjetik të Leninit e të Stalinit, dhe me popujt e vërtetë sovjetikë nuk do të kishin tradhtuar marksizëm-leninizmin, imperializmi amerikan tashmë do të ishte dobësuar jashtëzakonisht shumë dhe, për mendimin tonë, lufta në Vietnam do të kishte mbaruar me kohë me fitoren e shkëlqyer të popullit vietnamez. Me gjithë dredhitë që bëjnë revizionistët sovjetikë, populli vietnamez do të fitojë se ka një eksperiencë të madhe luftarake.

Por ne mendojmë se, po të futesh në ingranazhet e pseudorevolucionarëve, do ta humbasësh davanë. Ne besojmë se Vietnami as është futur dhe as do të futet në këtë rrugë. Sipas mendimit tonë lufta është rruga që do ta zgjidhë përfundimisht problemin e çlirimt të vërtetë të Vietnamit.

Bindja jonë është se imperialistët amerikanë nuk shporren nga Vietnami, po nuk u futët bajonetën e vdekjes në shpinë. Këtë çështje populli dhe komunistët

e luftës së popullit vietnamez (1945-1954) mbi kolonizatorët francezë.

vietnamezë e shikojnë drejt. Revisionistët sovjetikë që pretendojnë se bëjnë politikë, në të vërtetë bëjnë matrapazllëqe në kurriz të popujve, prandaj ata duhet të largohen nga Vietnami, ku nuk lejohen që të bëjnë si të duan.

Për Lindjen e Mesme revisionistët sovjetikë shohim se kanë rënë në ujdi me imperialistët amerikanë, prandaj ata i «ndihmojnë» arabët jo për të çliruar tokat e pushtuara nga Izraeli, po për të forcuar pozitat e tyre kolonialiste në Egjipt, në Siri dhe në shumë vendë në kontinentin e Afrikës. Duke u nisur nga këto qëlliime, revisionistët sovjetikë dëshirojnë të vazhdojnë bisidimet, si i thonë fjalës «hiq e mos këput». Për të gjithë popujt që bëjnë luftëra nacionalçlirimtare, ata përgatitin plane pas planesh «për t'i ndihmuar» dhe asgjë më tepër. Kësaj politike që ndjekin revisionistët e Bashkimit Sovjetik nuk i trembet aspak Niksoni, se, në të vërtetë, kjo nuk i dëmton interesat e imperialistëve amerikanë.

Me një politikë të tillë nga ana e revisionistëve sovjetikë, duke folur pallavra, duke mbajtur fjalime, duke bërë diskutime pas diskutimesh e duke hequr dhe duke tërhequr ambasadorët nga Parisi, duke dërguar grupe ambasadorësh me Jaringët dhe Xhon Bullet e të tjerë, imperialistët janë në gjendje të vazhdojnë kështu me vite të tëra, në të njëjtën kohë të vazhdojnë luftën në Vietnam, të financojnë Izraelin etj. Izraeli po e bombardon çdo ditë Egjiptin, shkatërron qendrat e tij kundër rajrore dhe bazat e raketave që kanë vendosur atje revisionistët sovjetikë. Këta, si kompensim për zëvendësimin e armëve të asgjësuara që i

japin Egjiptit, rrëmbejnë koncesione prej tij, duke vepruar atje si fajdexhinjtë më të këqij.

Luftha që bëni ju kundër imperialistëve amerikanë na mbush me shpresa se në të ardhmen sukseset tuaja do të jenë akoma më të mëdha dhe fitorja përfundimtare nuk do të jetë e largët.

Ndërhyrja e imperialistëve amerikanë në Kamboxhia ka qenë një disfatë tjetër për ta, sepse, tani, nga një vend neutral, ajo u bë një vend që lufton kundër tyre. Imperialistët amerikanë u përpinqën që Kamboxhian ta futnin në sferën e vet për ta përdorur në luftë kundër Vietnamit, po nuk ia arritën dot qëllimit. Edhe me këtë vend duken qartë manovrat e revisionistëve sovjetikë.

Ne, që i shikojmë këto çështje nga jashtë, mendojmë se revisionistët sovjetikë do të përpiken të gjejnë forma për ta sabotuar unitetin e përbashkët luftarak të popujve të Indokinës, që u vendos në konferencën e shteteve të Indokinës për luftë gjer në fund kundër imperialistëve amerikanë.

Përse revisionistët sovjetikë dhe satelitetët e tyre nuk e njohin qeverinë e re kamboxhiane të kryesuar nga Norodom Sihanuku, të cilën e kishin njohur para se të bëhej grushti i shtetit? Ata nuk e njohin atë se nuk duan të prishin marrëdhëni me imperialistët amerikanë, ky qëllim duket qartë.

Në qoftë se revisionistët sovjetikë do të ishin përçlirimin e Vietnamit, atëherë përse nuk e njohin ata qeverinë e ligjshme të Kamboxhias, për sa kohë që kjo bashkë me Vietnamin dhe Laosin bën pjesë në fron-

tin indokinez kundër imperialistëve amerikanë? Përse ata mbajnë marrëdhënie me qeverinë e tradhtarit Lon Nol, që ndihmoi imperialistët amerikanë të futeshin në Kamboxhia? Vetëm nga ky gjykim fare i thjeshtë mund të nxirret konkluzioni se revisionistët sovjetikë, gjersa mbajnë të tilla qëndrime, janë me imperialistët amerikanë dhe jo për çlirimin e popujve.

Ka rëndësi të madhe që të njihen mirë si miqtë edhe armiqjtë. Revisionistët sovjetikë, me ato që bëjnë, del e qartë se ç'tradhtarë janë.

Lenini na mëson se ndihma e jashtme nuk është faktori kryesor. Ne nuk e dimë me hollësi si sillen revisionistët sovjetikë me ju, por ne i njohim mirë ata. Kur të jasin diçka, kërkojnë të veprosh sipas dëshirave të tyre. Në marrëdhëniet me ne, shqiptarët, revisionistët sovjetikë arritën gjer atje sa të na kërcënonin dhe na paralajmëruan se, po të mos bënim si thoshin ata, nuk do të na jepnin asnje ndihmë. Ne nuk vepruam si deshën ata, prandaj marrëdhëniet me ne i acaruan aq shumë, sa erdhën deri në thikë, dhe ne u thamë në bazën e Vlorës: «O lini anijet këtu dhe largohuni sa më parë, ose do t'ju biem me top!». Nga eksperiencia jonë e «miqësisë» me revisionistët sovjetikë, kemi arritur në konkluzionin se ata janë shantazhierrë të mëdhenj dhe e vërteta është siq thoni ju, ata janë «miq» vetëm për një të katërtën ose për gjysmën e rrugës, me një fjalë janë miq sa për sy e faqe. Ata veprojnë njëlloj si kapitalistët. Revisionistët e ish-demokrative popullore të Evropës kanë nxjerrë tanë një «teori» të bukur, sipas së cilës ata mund të marrin me

miliarda dollarë kredi nga imperialistët amerikanë apo nga ata të Gjermanisë Perëndimore për të blerë makina e pajisje dhe me anë të tyre do të ndërtokan gjoja socializmin!

Nikita Hrushovi dhe pasardhësit e tij, revisionistët sovjetikë, e degjeneruan keqas atë ndihmë të singertë dhe vëllazërore që jepte Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit. Hrushovi vazhdoi të na i jepte më vonë «ndihmat» me qëllime shumë armiqësore, por shkallë-shkallë këto qëllime u sqaruan derisa më në fund u kuptua se ato ishin një veprim imperialist që synonte kolonializimin e Shqipërisë. Të tilla synime ai i shfaqi edhe kundër vendeve të tjera. Të njëjtën politikë vazhdojnë sot edhe Brezhnjevi me Kosiginin.

Këtu në Evropë po bëhen përpjekje të mëdha për «sigurimin evropian». Në pamjen e parë duket sikur Bashkimi Sovjetik me këtë përpjeket që të mos ketë luftë në kontinentin tonë. Po përse jemi ne kundër këtij «sigurimi» për të cilin po bën përpjekje kaq të mëdha qeveria sovjetike? Sepse ky i ashtuquajtur sigurim evropian s'ka aspak karakter evropian, ai dallohet nga një mbrojtje false në Evropë, pse në fakt synohet që këtu të sundojnë Bashkimi Sovjetik revisionist dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse janë një shtet jashtë Evropës. Kjo mbrojtje false del qartë nga fakti se sovjetikët pranojnë që në mbledhje të marrë pjesë një shtet joevropian, gjë që do të thotë se ligjet në botë duhet të bëhen nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Popujt e Evropës nuk duan bashkëjetesë nën shkopin e Bashkimit Sovjetik

dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Prandaj ky «sigurim» për popujt e kësaj zone përgjithësisht dhe për Republikën Popullore të Shqipërisë në mënyrë të veçantë jo vetëm nuk ka vlerë, por në të kundërtën do të thotë skllavërim.

«Sigurimi evropian» është një orvatje për të shuar kontradiktat midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga njëra anë dhe midis Bashkimit Sovjetik e shteteve të Evropës Perëndimore nga ana tjetër. Në të vërtetë këto kontradikta nuk kanë për t'u shuar me «sigurimin evropian», ato e shumta mund të zbuten për një kohë. Gjermania Perëndimore, së cilës revisionistët sovjetikë ia kanë frikën, do të vihet përkohësisht në fre; mundet të nënshkruhet edhe një traktat mossulmimi me revanshistët gjermanë. Kjo orvatje e revisionistëve sovjetikë me Gjermaninë Perëndimore që ka provokuar dy luftërat botërore, në pamjen e jashtme duket si një gjë e mirë, se me traktatin e mossulmimit gjoja shmanget lufta, ndërsa me «sigurimin evropian» «sigurohet paqja në Evropë» nën sundimin e bashkëpunimin amerikano-sovjetik!

Por është e qartë se gjithë këto orvatje bëhen që dy fuqitë e mëdha imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, të mos kenë telashe në Evropë, t'i kenë duart të lira për të zgjeruar luftën në Azi, në Afrikë, në Amerikën Latine, për t'u dalë përpara rreziqeve që u kanosen interesave të këtyre dy fuqive në kontinentet e ndryshme, ku janë krijuar vatra luftërash nacionalçirimitare e revolucionare. Shtypja e luftërave nacionalçirimitare, e luftës në Vietnam,

në Laos e në Kamboxhia, në vendet afrikane apo në ato latino-amerikane dhe kudo gjetkë u intereson shumë si imperialistëve amerikanë dhe gjithë kapitalistëve të Evropës, ashtu edhe socialimperialistëve sovjetikë.

Partia e Punës e Shqipërisë është e vetmja në Evropë që është kundër të ashtuquajturit sigurim evropian. Udhëheqësit rumunë, megjithëse hiqen sikur janë kundër revizionistëve sovjetikë, janë pro këtij «sigurimi». Në fakt ata rezistojnë kundër sovjetikëve duke u nisur nga pozitat borgjeze, pse mendojnë që, duke përkrahur këtë aleancë, largojnë rrezikun që u kanoset nga socialimperialistët sovjetikë, por me këtë qëndrim ata në asnjë mënyrë nuk e largojnë rrezikun.

Partia jonë mendon se, po të shtypen lëvizjet revolucionare në botë, po të lejohen më tej imperialistët amerikanë që të vrasin njerëzit në Vietnam, të shtypin çdo lëvizje çlirimtare në Indi, në vendet arabe, në Amerikën Latine apo kudo gjetkë, atëherë çfarë sigurimi i thonë këtij? I vetmi sigurim për popujt janë luftërat nacionalçlirimtare të popujve. Në këtë kuadër e shikojmë ne këtë problem, prandaj politikën e Qeverisë sonë e ndërtojmë duke i parë në këtë prizëm çështjet.

Përfaqësuesit e shteteve skandinave, si ata të Norvegjisë, të Suedisë, të Finlandës e të tjerë e kanë pyetur Qeverinë tonë se për ç'arsye nuk i përgjigjet ajo pozitivisht «sigurimit evropian» në një kohë kur të gjitha shtetet e Evropës kanë dhënë përgjigje pozitive. Ne ua kemi shpjeguar atyre arsyet përsë jemi kundër. Politika jonë është solidare me luftërat nacionalçlirimtare që bëjnë popujt e ndryshëm, është solidare gjer në fund

me luftën e popullit heroik vietnamez, i cili është kryesorë që lufton në shkallë të gjerë kaq trimërisht me armë në dorë. Lufta juaj vërteton se imperializmi amerikan është i thyeshëm, i mundshëm. Jeta po vërteton se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të thyhen edhe prej një populli të vogël si ai vietnamez.

Kjo është njëra anë e çështjes. Ana tjetër është se, po të mos luftojmë njëkohësisht edhe kundër revizionizmit modern, nuk mund të luftohet si duhet me sukses imperializmi amerikan. Këtë e ka thënë Lenini dhe na e vërtetojnë faktet, jeta.

Të marrim çështjen e vendeve arabe që gjoja kanë fituar lirinë. Në udhëheqje të disa prej këtyre vendeve janë borgjezë të dyshimitë ose reaksionarë si mbreti Hussein e të tjerë, të cilët, duke rënë nën influencën e revolucionistëve sovjetikë dhe të imperialistëve amerikanë, i kanë katandisur vendet e tyre në arena të përgjakshme.

Edhe një fakt tjetër. Kur popujt jugosllavë u ngri-tën në këmbë për çlirimin e vendit, Titoja hiqej si marksist-leninist dhe, si i tillë mori flamurin e luftës, ai ishte sekretar i parë i partisë. Mirépo ai u bë agjent i imperialistëve dhe arriti deri atje sa e ktheu vendin në një shtet kapitalist të degjeneruar. Ju e keni ndjekur politikën e revolucionistëve jugosllavë dhe e dini që edhe ata flasin për luftën në Vietnam, po fjalëve të tyre, sigurisht, nuk u besoni. Ata flasin edhe kundër politikës së imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme etj., po nga ana tjetër marrin, përveç nga të tjerët, edhe miliarda dollarë kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Bile edhe para tri ditësh në Jugosllavi u krijua një bankë amerikano-jugosllave.

Lufta kundër imperializmit amerikan është e domosdoshme dhe kryesorja, por ajo bëhet me sukses kur luftohet me forca të shumëfishuara edhe kundër revizionistëve modernë që janë në shërbim të kapitalizmit, dhe përdorin si maskë marksizmin për të degjeneruar kudo partitë komuniste dhe klasën punëtore, prandaj ata janë të rrezikshëm. Miq të rremë janë revizionistët sovjetikë, dhe jo vetëm këta, por edhe Titoja e të tjerë, të cilët hiqen si miq të popujve, si marksistë-leninistë, ndërsa në të vërtetë përpiken t'u bëjnë varrin.

Lufta e popullit vietnamez është në rrugë të drejtë, marksiste-leniniste, prandaj populli shqiptar është përkrah popullit tuaj. Ne jemi me ju me gjithë shpir, deri në fitoren e plotë. Popullin, Partinë dhe Qeverinë tonë ju i keni miq besnikë dhe të vërtetë që kurrë nuk ua fshehin mendimet që kanë. Po kështu dhe ne kemi te populli heroik vietnamez një mik besnik, të cilit, i urojmë të vazhdojë luftën deri në fitoren e plotë dhe në këtë drejtim ne do t'i japim atij gjithë ndihmën tonë modeste.

Prandaj, të dashur shokë, që keni ardhur në Shqipëri për të forcuar miqësinë midis dy vendeve tona, le të ngremë së bashku një dolli për miqësinë midis dy popujve tanë, për fitoren tonë të përbashkët mbi imperialistët amerikanë, për triumfin e socializmit dhe të komunizmit në të gjithë botën! U transmetoni shokëve urimet tona të përzemërtë për fitore të shpejtë dhe i siguroni ata se ne jemi me luftën e popullit vietnamez

dhe do të jemi përkrah jush gjer në fund përfitoren e përbashkët!

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 596

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 596

VËSHTIRËSITË KAPËRCEHEN DHE FITORJA ARRIHET VETËM ME NJË VIJË POLITIKE TË DREJTË E ME UNITET TË SHËNDOSHË

*Nga biseda me një delegacion të Lëvizjes për Çlirimin
Kombëtar të Palestinës «Al Fatah»*

3 gusht 1970

Jemi shumë të lumtur që ju, vëllezërit tanë palestinezë, keni ardhur për vizitë në vendin tonë. Kur u njoftuam se delegacioni juaj do të vinte në Shqipëri, u gjëzuam pa masë. Ardhja e miqve nga Palestina do ta gjëzonte patjetër popullin shqiptar, pse ai i do me gjithë shpirt popujt arabë dhe në veçanti popullin luftëtar palestinez. Them në veçanti popullin palestinez, se fati juaj është më i keq nga ai i popujve të tjerë arabë, vështirësitë dhe vuajtjet tuaja nuk kanë mbaruar, ato po vazhdojnë të jenë më të mëdha nga vuajtjet e të gjithë popujve të tjerë arabë.

Popujt arabë janë të ndershëm, zemërbardhë e të sinqertë dhe, siç na tregon historia, luftërat e tyre kanë qenë të rrepta, përgjithësisht ata kanë luftuar kurdoherë me heroizëm. Ata janë revolucionarë dhe me një të kaluar luftarake.

Popujt arabë kanë jo vetëm tradita luftarake, por edhe kulturore. Duke u njojur me veprat e kulturës së lashtë të vendeve të tjera, ata u futën në rrugën e dijes dhe të përparimit dhe pas kësaj kohe dhanë kontributin e tyre të njojur në zhvillimin e mëtejshëm të kulturës botërore. Nëpërmjet dijetarëve arabë, bota u njoht me shumë vepra filozofike, letrare dhe shkencore të lashtësisë greke e romake, me mendimet e Sokratit, Platonit, Aristotelit e të tjerë, të përkthyera në gjuhën e tyre. Nga vetë gjiri i popujve arabë kanë dalë menditarë e filozofë të mëdhenj, poetë të dëgjuar e historianë, mjekë dhe shkencëtarë të shquar. Gjithë këto tradita të mëdha luftarake dhe kulturore janë transmetuar nga brezi në brez në popujt tuaj.

Por, ashtu si ka njerëz që degjenerojnë, ka edhe qeveri e shtete të tilla. Historinë e popujve tuaj ju e njihni më mirë nga ne, prandaj dini se Perandoria Arabe, që ishte shtrirë në zotërimet e mëdha, që nga kufiri me Kinën deri në Spanjë, degjeneroi, sepse degjeneruan krerët dhe pasanikët, ndërsa populli qëndroi kurdoherë i fortë. Që nga ajo kohë shumë nga popujt arabë kanë kaluar nëpër vështirësi të mëdha, të cilat u krijuan për arsyen se tokat e tyre, pavarësisht se shumica ishin në pronësi të të pasurve, duke qenë shumë pjellore, tërhoqën lakminë e armiqve të pabesë, të cilët dora-dorës pushtuan vendet tuaja. Imperialistët, për një kohë të gjatë, arritën të skllavërojnë kështu popujt tuaj. Megjithatë, shumë nga popujt arabë, në sajë të luftërave që bënë, fituan lirinë, por halët nuk kanë mbaruar as për ata, po sidomos për ju, vëllezërit palestinezë.

Ne e kuptojmë shumë mirë gjendjen tuaj të vështi-

rë dhe shpirtërisht jemi plotësisht me ju. Ne e kemi ndjekur, do ta ndjekim e do ta përkrahim me të gjitha forcat luftën e popullit palestinez dhe e konsiderojmë sikur luftojmë krah për krah me ju. Këtë jua themi me sinqeritetin më të madh e pa asnje qëllim. Miqve asgjë dhe kurrë nuk u themi prapa krahëve.

Ju jeni përfaqësuesit e organizatës «Al Fatah», orientimin politik të së cilës, në përgjithësi, e njohim. Megjithëse jemi marksistë-leninistë dhe pavarësisht nga fakti se pikëpamjet ideologjike të njëri-tjetrit ndryshojnë, ne i përkrahim orientimet e organizatës suaj për arsyen se si detyrë themelore në programin e lëvizjes suaj keni vënë luftën e armatosur deri në fund për çlirimin e atdheut dhe të popullit palestinez, prandaj të jeni të sigurt se te marksistë-leninistët shqiptarë ju do të keni kurdoherë miq nga më të sinqertët.

Ashtu si ju edhe ne kemi njëfarë eksperience nga Lufta jonë Nacionalçirimitare. Kur nisëm luftën, kuptohet, nuk u hodhën që në fillim gjithë masat në luftë. Në gjirin e popullit, si kudo, edhe te ne kishte njerëz të varfër, të mesëm, kishte edhe të pasur. Ne vendosëm t'u jepnim zemër, t'u hapnim perspektiva dhe të mbështeteshim te shtresat e varfra të popullit, pse ato janë baza e fitores. Në Shqipëri aspirata kryesore e masës së varfër të fshatarësisë, që përbënte shumicën e popullsisë, ishte toka. Në kushtet tona kush kishte tokën në pronësi, ai drejtonte edhe fatet e atdheut, prandaj i thamë popullit se toka duhej t'i përkasë atij që e punon dhe një nga punët e para që do të bënim ne pas fitores do të ishte dhënia e tokës fshatarëve. Këta gjatë shekujve kishin luftuar për tokën, por kurrë nuk

kishin mundur ta realizonin ëndrrën e tyre. Kjo ishte arsyefa që kur ne dolëm me parullën «tokën atyre që e punojnë», në fillim fshatarëve nuk u besohej se do të bëheshin zotër të tokës.

Që në fillim të luftës na u vranë shumë shokë të mirë, por sakrifica e tyre ngjalli gradualisht besimin dhe sigurinë te fshatarët tanë se Lufta Nacionalçirimitare, që udhëhiqej nga bijtë e popullit, do t'ua siguronte me të vërtetë tokën. Dhe kështu fshatarët nisën të bashkohen me ne. Unë mendoj se edhe ju e keni shumë drejt atë që çështjen e tokës e keni vënë si një nga më kryesoret në programin e luftës suaj. Gjersa jeni ngritur dhe luftoni për çlirimin e atdheut, duhet të luftoni me vendosmëri dhe pa u lëkundur për ta çuar deri në fund edhe këtë çështje të madhe.

Kishte te ne edhe të pasur, nacionalistë të ndershëm, që ishin kundër pushtuesve. Në këto rrethana na u desh të bënim diferencimin e tyre. Ata që kishin ca pasuri dhe ishin kundër fashizmit, i ftuam të vinin me ne. Shumë prej tyre në fillim dyshuan, nuk u afroan menjëherë, por kur djem dhe vajza të tyre u bashkuan me radhët tona, më vonë edhe ata u bindën, u bënë me ne, sa deri shtëpitë e disave u bënë çerdhet tona. Aqështë e vërtetë kjo sa unë vetë, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, jam strehuar ndonjëherë edhe në shtëpi të këtyre njerëzve, megjithëse armiqtë, që më kishin dënuar me vdekje, më kërkonin nga të katër anët. Sigurisht, për shumë probleme ne nuk mund të mendonim njëlloj si ata që ishin të pasur, por një pjesë prej tyre, që kishin ndjenja patriotike dhe shikonin se komunistët shqiptarë ishin njerëz të ndershëm, se djem

dhe vajza të tyre qenë bërë me ne, nuk mund të mos e simpatizonin luftën tonë.

Nacionalistëve të ndershëm, që vinin nga shtresat e pasura të popullsisë, ne ua shpjeguam qartë qëllimet e luftës, u sqaruam se nuk ishte e mundur të rronin dot as ata me fashistët e huaj që kishin pushtuar vendin tonë, të cilët synonin dhe në fakt po e skllavëronin gjithnjë e më shumë Shqipërinë. Me patriotët e pa-organizuar në Parti, të shtresave të varfra e të mesme, të rrzymave të ndryshme antifashiste të fshatit dhe të qytetit, ne krijuam Frontin Nacionalçlirimtar. Me këtë organizatë më vonë u bashkuan edhe nationalistë që në fillim ishin kundër komunistëve, por pas një pune sqaruese me durim, shumica e tyre u bënë luftëtarë dhe aleatët tanë. Disa prej tyre arritën të zgjidhen edhe në forume drejtuese, bile deri në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, ku luftuan dhe punuan me ndershmëri të madhe dhe pas Çlirimt u bënë mbrojtës e përkrahës të Reformës Agrare e të transformimeve të tjera ekonomiko-shoqërore të vendit.

Po pati edhe të tillë nationalistë që në fakt ishin pseudopatriotë, si njëfarë Abaz Kupi, që, kur erdhi puna për të vepruar konkretisht, nuk pranuan të luftonin kundër pushtuesve. Atëherë ne mbajtëm qëndrim të prerë ndaj tyre, u thamë që nuk mund ta vazhdonim aleancën me ta, gjersa nuk luftonin krah për krah me popullin dhe me ne kundër pushtuesve gjermanë. Këtë ata as e bënë, as do ta bënин, pse në të vërtetë, siç zbuluam më vonë, ata kishin lidhje me nazistët gjermanë. Çdo qëndrim të tyre që s'pajtohej me vijën e me luftën tonë pa kompromis kundër pushtuesve italo-gjer-

manë e demaskuam gjer në fund, gjersa ata hoqën maskën e dolën kundër Frontit Nacionalçlirimtar, kundër popullit dhe u bashkuan hapur me pushtuesit gjermanë.

Nuk e di nëse te ju ka parti komuniste, por komunistë në ilegalitet mund të ketë, prandaj ata duhet të luftojnë krah për krah me ju, për arsyen se organizata e «Al Fatahut» ka një program të caktuar që përshkohet nga ideja e luftës së vendosur për çlirimin e Palestinës kundër shtetit sionist të Izraelit të kurdisur nga imperializmi. Ne nuk njihemi me ta, por, me sa kam dëgjuar, në vendin tuaj ka të tillë. Disa thonë se ata janë guevaristë. Po të jetë kështu, do të thotë se ata nuk janë marksistë. Ju të gjithë duhet të përpinqeni përtë krijuar unitetin e përbashkët me njëri-tjetrin në luftë, t'i lidhni plagët njëri-tjetrit, se vetëm në unitet të të gjitha forcave revolucionare dhe nëpërmjet luftës së armatosur do të mund të dilni nga gjendja e rëndë e vuajtjeve që ju kanë shkaktuar të tjerët.

Në një fjalim të një udhëheqësi tuaj që kam lexuar kohët e fundit, pashë se programi i organizatës suaj «Al Fatah» nuk është kundër popullit izraelit, as kundër fesë izraelite, se ju nuk jeni racistë, përkundrazi jeni njerëz përparimtarë, por me të drejtë ju nuk mund të lejoni që në vendin tuaj sionizmi ndërkombëtar të krijojë një shtet, siç është ai i Izraelit, që të shtypë popullin palestinez. Në këtë çështje ju mban qëndrim plotësisht të drejtë, prandaj edhe ne si marksistë jemi dakord, përndryshe nuk do t'ju mbështetnim. Në disa materiale kam lexuar se ka pasur edhe palestinezë që deklaronin se çifutët si popull do t'i grinin. Një pikë-

pamje e tillë nuk është aspak e drejtë. E drejtë është vija juaj, prandaj ajo gjen e duhet të gjejë kudo përkrahjen e forcave përparimtare. Aq më tepër duhet të jenë të bashkuar si vëllezër të vërtetë dhe në unitet të plotë me ju komunistët palestinezë në luftën kundër armikut të përbashkët, për çlirimin e plotë të Palestinës.

Në luftën çlirimitare kundër pushtuesve, si marksistë-leninistët, ashtu edhe nationalistët e ndershëm e gjithë luftëtarët e vendosur për çlirimin e atdheut, është e domosdoshme të kenë të qartë mirë cilët janë miqtë dhe cilët janë armiqtë kundër të cilëve duhet luftuar. Që të luftohen me sukses armiqtë, duhet të krijohet, në radhë të parë, uniteti midis vetë luftëtarëve, pastaj midis këtyre dhe masave të popullit për të cilat luftohet. Edhe këto duhet të dinë përsë luftohet, që të mund të gjykojnë nëse duhet të mbështetet apo jo lufta që bëhet. Po t'i gjykojë dhe t'i vlerësojë populli qëllimet e luftës, luftëtarët atëherë do të bëhen të pathyeshëm. Kushdo qoftë dhe çfarëdo emri t'i vërë vetes dhe të shpallë se do të bëjë këtë apo atë vepër, është populli në fund të fundit ai që do ta vlerësojë dhe jo në bazë të fjalëve, po në bazë të veprave që do të kryejë për popullin. Kur ky të shohë se dikush vepron drejt, me ndershëmëri dhe bën sakrifica për të, atëherë e mbështet pa rezerva dhe forcon unitetin me të. Prandaj uniteti brenda në lëvizje dhe uniteti i kësaj me popullin janë faktorë vendimtarë.

Duhet pasur parasysh se rëndësinë e unitetit dhe rrugën e arritjes së tij nuk e kuuptojnë të tërë njëlloj. Por uniteti nuk mund të sigurohet pa pasur një udhëheqje të fortë në krye të lëvizjes.

Uniteti brenda radhëve të organizatës suaj dhe uniteti i saj me popullin, pra, janë faktorë kryesorë dhe të domosdoshëm për arritjen e fitores, sipas mendimit tonë. Po patët këtë dhe po ruajtët të pastër vijën e drejtë politike dhe luftarake, të jeni të sigurt se do të korrni kurdoherë suksese, në të kundërtën do t'ju dalin shumë vështirësi përpara. Me vijën e drejtë dhe me një unitet të fortë çdo vështirësi do ta kapërceni.

Jashtëzakonisht i rëndësishëm është për ju, gjithashtu, uniteti juaj me popujt e tjerë vëllezër arabë. Ky unitet është jetik për çlirimin e Palestinës dhe përmposhtjen e armiqve, për arsyen se populli palestinez është pjesë përbërëse e popujve arabë, prandaj opinioni i tyre për çlirimin e popullit tuaj nuk mund të jetë një faktor i jashtëm dhe i dorës së dytë, përkundrazi, ai është një faktor i brendshëm i dorës së parë.

Uniteti i vërtetë i gjithë popujve arabë kundër armikut të përbashkët dhe për të mirën e të gjithë këtyre popujve është i domosdoshëm, por ai duhet të krijohet në luftë dhe jo me fjalë. Ne marksistët mund të bashkëpunojmë edhe me një mbret të vogël si Hyseini i Jordanisë, i dinastisë hashemite (megjithëse të gjithë e dimë sa «fitime» kanë pasur popujt nga mbretërit), në rast se ai lufton për lirinë e popujve arabë. Por në rast se Hyseini përpinqet të manovrojë me imperialistët amerikanë kundër çështjes së lirisë së popujve arabë dhe kundër lirisë së popullit palestinez në veçanti, me atë nuk mund të jemi në unitet, përkundrazi ta luftojmë derisa të pësojë fatin e Faisalit¹ që erdhi nga Medina

¹ Ish-mbret i Irakut që, së bashku me ish-kryeministrin,

dhe u vu mbi popullin irakian, si dhe të Nuri Saidit. Nga eksperiencia e vendit tonë ne mund t'ju themi se ish-mbreti ynë, Ahmet Zogu, pasi e rropi mirë e mirë popullin, kur atdheu u vu në rrezik, ai rrëmbeu florintë si kusarët dhe u largua, duke i lënë shqiptarët në mëshirën e agresorëve fashistë, prandaj ne në asnje mënyrë nuk mund të ishim në unitet me një grabitës e xhelat të popullit. Kështu pra uniteti krijohet dhe duhet të krijohet vetëm në luftë.

Për luftën e popullit tuaj dhe për arritjen e fitores kundër pushtuesve ka rëndësi të madhe edhe aleanca ndërkombëtare me punonjësit dhe me popujt e mbarë botës. Në këtë çështje është e domosdoshme që populli juaj të shfrytëzojë çdo mundësi për të njobur mirë cilët janë miqtë dhe cilët janë armiqtë tuaj të jashtëm. E them këtë se tani situatat janë mjaft të ndërlikuara në botë. Çdo popull ka nevojë t'i njobë mirë miqtë e tij, me qëllim që, duke u lidhur ngushtë me ta, të përballojë me sukses çdo vështirësi dhe kurth që mund t'i përgatitin armiqtë. Por, para se të njobësh kush është mik i vërtetë, duhet vepruar si thotë një fjalë e urtë e popullit: «Të matësh 7 herë, pa të presësh një herë», të mendosh se kjo miqësi me këtë ose me atë vend a është, në radhë të parë, në interes të popullit tënd. Ne shqiptarët kështu veprojmë, këtë parim e kemi kurdoherë parasysh në zgjedhjen e miqve. Po qe se miqësia me një vend është në interes të popullit, atëherë du-

het rënë dakord për t'u bërë miq, në qoftë se është në dëm të popullit, atëherë nuk duhet zënë miqësi me këtë ose atë vend. Dikush mund të thotë se ju jeni të vegjël dhe keni nevojë për miq, prandaj ulni kurrizin dhe bëhuni me ne. Jo, për një miqësi të tillë nënshtimi ne nuk jemi kurrë dakord. Pavarësisht se jemi të vegjël, ne nuk e ulim kurrë kurrizin. Kjo vlen si për popujt e mëdhenj, ashtu edhe për të vegjlit. Miq të vërtetë janë vetëm ata që të përkrahin, sidomos kur je ngushtë, kur je në vështirësi. Populli ynë ka një fjalë të urtë që thotë: «Miku i mirë njihet në ditë të vësh-tira». Prandaj për cilindo popull ka rëndësi të madhe njohja e miqve.

Në përgjithësi, të gjithë popujt janë miqtë tuaj, kurse klikat që sundojnë në vende të ndryshme dhe ata që vijnë në udhëheqje të shteteve nuk janë e nuk mund të janë të gjithë miqtë tuaj. Nuk mund të janë miqtë tuaj imperialistët amerikanë, anglezë, francezë etj. Por, veç këtyre, tani ka dalë edhe një imperializëm tjetër i ri, imperializmi sovjetik. Krerët revizionistë so-vjetikë, që hiqen si marksistë-leninistë, në fakt janë tradhtarë të kësaj ideologjie, e cila synon vetëm lirinë, begatinë dhe lumturinë e popujve, prandaj ata janë tradhtarë të popujve sovjetikë e njëkohësisht tradhtarë të popullit tuaj, të popullit tonë, të popujve arabë etj.

Ka disa njerëz në vendet arabe që, duke kujtuar se revizionistët sovjetikë i «ndihmojnë», i quajnë ata miq, po ne e themi hapur se ata gabojnë rëndë. Edhe diçka që mund të të jepin revizionistët sovjetikë është e përkohshme dhe synon që ajo të mashtrojë dhc të krijojë përshtypjen sikur ata gjoja mbrojnë popujt dhe

luftërat e tyre çlirimtare dhe, nga ana tjetër, marrin masa që edhe këto farë «ndihmash» të mos shkojnë në dobi të arabëve, për shembull, po në përfitim të tyre. Është gabim të mbështetesh në miqësinë e socialimperializmit sovjetik për të ashtuquajturën ndihmë të përkohshme që ata e japid me qëllime të caktuara. Askush nuk duhet të gënjehet nga «ndihmat» e premtuar nga revisionistët. Prandaj, kushdo që mendon dhe lufton për interesat e popullit të vet, duhet të mos i varë shpresat te ndihma e tyre. Këta dikujt mund t'i japid edhe armë, po duhet bërë pyetja: Përse i japid këto? Ne gjer tani nuk dimë që ata t'ju kenë dhënë armë juve, palestinezëve, pikërisht pse ju jeni të vendsur në luftën kundër armiqve të popullit tuaj dhe mendojmë se gjersa të vazhdoni të luftoni për çlirimin e plotë të atdheut tuaj, ata kurrë nuk kanë për t'ju dhënë.

Mund të thuhet se revisionistët sovjetikë i kanë dhënë disa armë Vietnamit. Në radhë të parë, duhet pasur parasysh se këto janë disa armë të vjetra që atyre s'u duhen. Përveç kësaj ata janë të detyruar ta bëjnë, pikërisht, sepse atje ekziston një situatë tjetër për ta: Qëndrimi ndaj luftës në Vietnam është një çështje jete ose vdekjeje për revisionistët sovjetikë, atje varet shumë autoriteti i tyre, pse, për të mashtruar të tjerët, e kanë hequr dhe e heqin veten si mbrojtës të Republikës Demokratike të Vietnamit. Por, krerët revisionistë sovjetikë budallenj nuk janë, prandaj me qëndrimin hipokrit ndaj Vietnamit synojnë, nga njëra anë, të mbrojnë interesat e tyre atje dhe, nga ana tjetër,

të mos diskreditohen para popujve sovjetikë e gjithë popujve të botës dhe ta frenojnë luftën e popullit vietnamez, gjë që u intereson shumë agresorëve amerikanë.

Revisionistët sovjetikë i kanë dhënë disa armë edhe Egjiptit, por këto i administrojnë vetë, i kanë në duart e tyre, kështu që asgjë nuk bëhet me to kundër pushtuesve izraelitë. Qëllimi i revisionistëve sovjetikë, që hiqen si miq të arabëve, është të shtien në dorë portet e shteteve të tyre për të siguruar nëpërmjet tyre dalje të lirë në detin Mesdhe. Edhe në vendin tonë qëllimi i tyre ishte të kishin në dorë Portin e Vlorës dhe pikërisht aty ata na u qepën si gërvhje, por ne i rrethuam me armë të gjitha nëndetëset e tyre derisa u detyruan, më në fund, të largohen. Të jemi realistë, në Lindjen e Mesme, ku kanë futur këmbët dhe janë duke forcuar pozitat, revisionistët sovjetikë tani dëshirojnë paqe e qetësi që të mos kenë telashe për vete dhe jo se mendojnë për paqen e vërtetë të popujve të kësaj zone.

Dalja e flotës së revisionistëve sovjetikë në Mcs-dhe do të krijojë shumë vështirësi. Për të përqendruar flotën e tyre në këtë zonë, ata do të përpilen të ndërtojnë tani edhe baza detare e aerodrome. Për ne është e qartë se flotën e tyre në pellgun e Mesdheut revisionistët sovjetikë nuk e kanë për të mbrojtur popujt, po për qëllimet e tyre imperialiste. Ne shqiptarët jemi të bindur për këtë nga eksperiencia jonë. Ata, duke menduar se ishim të vegjël e do të na mposhtnin, u përpogen të na futnin thikën pas shpine, po nuk ia arriten dot qëllimit, se ne u vumë pushkën nga e cila ata kanë frikë.

Revisionistët sovjetikë na quajnë «sektarë», sepse themi kurdoherë të vërtetën dhe nuk shkojmë pas qerrës së tyre. Neve, shqiptarëve nuk na e duan të mirën revisionistët që hiqen si komunistë, po që s'janë të tillë. Neve nuk na prishet aspak puna se çfarë emri na vënë armiqjtë. Qëndrimet tona të drejta parimore dhe të vërtetën tonë i kuptojnë të gjithë revolucionarët, edhe ata që nuk janë marksistë, prandaj na nderojnë, ndërsa revisionistët na përbuzin. Kjo na nderon. Kur armiku s'të mburr, do të thotë se je në rrugë të drejtë. Sovjetikët ua kanë frikën shumë edhe palestinezëve, pse janë luftëtarë dhe të vendosur, prandaj duke qenë si kurdoherë të thjeshtë, kini besim në forcën e popullit tuaj, në forcën e pushkës dhe të qëndresës së tij. Kurrë mos i dorëzoni pushkët dhe, me gjithë vështirësitë që mund t'ju krijohen, mos e humbisni kurajën.

Mundet që gabohemi, po jemi të bindur se juve do t'ju krijohen vështirësi si nga armiqjtë e hapët, ash-tu edhe nga miqtë e rremë. Refugjatët palestinezë janë shpërndarë në territorin e vendeve vëllezër arabë, ata vazhdojnë të rrojnë si muhaxhirë, pa atdhe. Në Jordani nga sa kam lexuar, xhaxhai i mbretit Hysein edhe për pak do t'ju kishte shfarosur, po të mos kishit rrokur armët. Ju i thatë ndal edhe Karamës¹ së Libanit me shokë që mbahen nga bankat e imperializmit amerikan dhe anglez. Të gjithë këta armiq të popullit tuaj dhe në përgjithësi të popujve arabë janë gati të ngrihen kundër jush dhe t'ju shtypin, prandaj, siç thashë, kurrë mos i dorëzoni armët, se ato ju kanë shpëtuar dhe

¹ Rashid Karame, kryeministër i Libanit.

përsëri ato janë i vetmi mjet që do t'ju shpëtojnë edhe në të ardhmen.

Ne mendojmë që «Plani Roxhers» është rezultat i një tradhtie të madhe nga ana e revizionistëve sovjetikë. Këta kanë rënë në ujdi me imperialistët amerikanë për të rregulluar midis tyre problemin e Lindjes së Mesme, me qëllim që të forcojnë aty pozitat e tyre sunduese ekonomiko-ushtarake dhe t'u shypin vullnetin revolucionarëve arabë, të cilët sot janë pa diskutim elementët më revolucionarë në Afrikë, prandaj armiqtë luftojnë të shypin atje çdo vatër dhe element revolucionar. Tashmë revizionistët sovjetikë janë futur në Mesdhe; ata u bënë «miq» me disa vende arabe deri edhe me Libinë, së cilës, në fakt, përpiken t'i zënë portet. Një gjendje e tillë në këtë rajon, ndërsa përbën një avantazh për socialimperializmin sovjetik, është në dëm të imperialistëve amerikanë dhe anglezë, të cilët e kishin të qartë se në këto kushte nuk mund të dilnin me një plan për nënshtimin e Lindjes së Mesme pa arritur në një marrëveshje me revizionistët sovjetikë, dhe, për t'ia arritur qëllimit, u detyruan t'u japid koncesione atyre që e heqin veten si marksistë. Këto koncesione të imperialistëve perëndimorë në favor të Bashkimit Sovjetik bëhen sepse ky nuk është më një vend marksist-leninist. Kjo do të thotë se sundimtarët e rinj të Kremlinit, në fakt, nuk e duan lirinë e vërtetë të popullit egjiptian, të popujve jordanez e palestinez, me gjithëse bëjnë propagandë mashtruese se gjoja Bashkimi Sovjetik vazhdon të jetë vendi i komunizmit dhe i mbrojtjes së lirisë së popujve.

«Plani Roxhers» është në dëm të popujve arabë

dhe veçanërisht të popullit palestinez. Ai është në favor të imperializmit amerikan dhe atij sovjetik dhe në veçanti në interes të sionizmit izraelit. Do të bëheshin patjetër përpjekje për t'u arritur ky kompromis nga ana e armiqve të popujve arabë, por «Plani Roxhers» do të hasë patjetër në shumë vështirësi e pengesa, më e madhja do të jetë lufta e palestinezëve, lufta juaj që u ka dhënë një përkrahje të ndjeshme popujve arabë dhe e ka ngritur lart emrin e tyre.

Ne na ka gëzuar shumë qëndrimi i Bumedienit kundër «Planit Roxhers» kur deklaroi botërisht se Al-gjeria është për çlirimin e gjithë tokës arabe të push-tuar nga izraelitët dhe në favor të luftës së popullit palestinez. Ky është një qëndrim i drejtë. Na pëlqyen edhe qëndrimet e Sirisë dhe të Irakut. Ne dëgjuam, gjithashtu, me vëmendje edhe fjalimin e Naserit, por kur ai bëri fjalë për kthimin e të drejtave të palestinezëve na bëri përshtypje se nuk ishte aq kategorik në thëniet e tij. Mundet që ne të mos e kemi kuptuar mirë atë, por mendojmë se ka të drejta dhe të drejta, prandaj çdo gjë duhet përcaktuar qartë dhe pa ekuivo-ke, të jetë e kuptueshme mirë nga të gjithë cilat janë konkretisht të drejtat që duhet t'u kthehen palestinezëve.

Ne, shqiptarët, kemi eksperiencën tonë të hidhur në këtë drejtim. Në historinë e popullit tonë ka plot ngjarje të tillë. Populli shqiptar ka qenë nga luftëtarët e parë që i ka rezistuar Perandorisë Otomane. Në Luftën Ballkanike ai i ka ndihmuar popujt fqinjë, grekët dhe serbët, kundër turqve osmanlinj, po, kur erdhi koha që Shqipëria të çlirohej nga robëria e «të sëmurit

të Bosforit»¹, të gjitha shtetet fqinje, të mbështetura nga fuqitë e mëdha të asaj kohe: Anglia, Gjermania, Franca, Rusia etj., u vërsulën ta copëtojnë vendin tonë. Në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër më 1913, kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë, serbët na shkëputën Kosovën, copë e madhe e shumë pjellore e truallit tonë që edhe sot vazhdojnë ta kenë nën sundimin e tyre. Mali i Zi, gjithashtu, na rrëmbeu një pjesë të tokave tona, e të tjerë. Knjaz Nikollës së Malit të Zi iu hap oreksi. Atij nuk i mjaftonin tokat shqiptare që rrëmbeu me ndihmën e imperialistëve, por, duke u ndihmuar edhe nga cari i Rusisë, u përpoq të merrte edhe Shkodrën me rrethin e saj. Por gjyshërit tanë rrokën armët, luftuan me vendosmëri dhe e shpëtuan këtë pjesë të atdheut. Lidhur me këtë ngjarje një nga diplomatët e kohës tha atëherë se cari i Rusisë dëshiron t'i vërë zjarrin Evropës për të pjekur omëletën e knjaz Nikollës.

Ne mendojmë se, siç ngjau njëherë e një kohë me Shqipërinë, ka për të ndodhur edhe me Palestinën, kur të vijë puna për zbatimin e «Planit Roxhers». Kur ministri i Jashtëm i sotëm i Kremlinit, Gromiko, duke u hequr gjoja si mbrojtës i interesave të palestinezëve, si dikur Sazanovi², do t'u lypë imperialistëve për palestinezët 5 km këtu e 7 km atje, Roxhersi do të përsëritë që Gromikoja i Rusisë dëshiron t'i vërë zjarrin botës

1 Kështu u quajt nga fundi i shekullit të 19-të dhe fillimi i shekullit të 20-të Perandoria Otomane që po perëndonte.

2 Ministri i Jashtëm i Rusisë në kohën e caklimit të kufijve të Shqipërisë, më 1913.

për të pjekur omëletën e Hyseinit e të ndonjë tjetri. Dua të them me këtë që «Plani Roxhers», për të ash-tuquajturën zgjidhje paqësore të çështjes së Lindjes së Mesme, duhet të luftohet me të gjitha forcat, se është në dëm dhe kundër interesave të popujve arabë dhe në mënyrë të veçantë të popullit palestinez.

Ne e duam popullin e vuajtur, të vogël dhe trim palestinez, pse e kemi vëlla dhe se jemi të bindur që kauza e tij është e drejtë dhe do të fitojë. Megjithëse jemi edhe vetë një popull i vogël, ne do ta ngremë fort zérin në mbrojtje të çështjes së tij dhe kundër «Planit Roxhers» që është shumë i rrezikshëm dhe në interes vetëm të dy fuqive të mëdha imperialiste.

Ajo që është vendimtare për të ardhmen e lirë të popullit tuaj, sipas mendimit tonë, është rruga dhe lufta juaj e drejtë, prandaj forconi sa të mundni unitetin, se për t'ju mashtruar dhe për t'ju penguar në rrugën tuaj nuk do të mungojnë t'ju drejtohen gjithfarë shigjetash gjoja edhe teorike nga më të ndryshmet, sidomos nga revizionistët sovjetikë, të cilët, duke bërë be e rrufe se janë «për çlirimin e popujve», janë «leninistë» etj., do të përpilen t'ju bindin të veproni si të thonë ata, në fazën e parë ju të pushoni një herë luftën, të nën-shkruani marrëveshjen me armiqtë, duke ju lënë me shpresë se çështjen e popullit palestinez ata do ta shohin në një periudhë të ardhshme. Por faza e parë e tyre do të synojë konsolidimin e pozitave të shtetit të Izraelit, gjë që më vonë do t'i vështirësojë shumë pozitat tuaja.

Nënshkrimi i një kompromisi të tillë, siç synojnë revizionistët sovjetikë të arrihet, na vjen hidhur, jua

them i hapur, se do ta vështirësojë zgjidhjen e çështjes suaj të madhe. Ai parashikon njohjen e shtetit të Izraelit për të cilin kanë luftuar qysh më 1948 dhe më përpëra klikat e Ben Gurionit, Golda Mejerit, të piratit Moshe Dajan e të tjerëve, kundër popujve arabë. Tani po bëhen përpjekje që kësaj çështjeje t'i vihet firma e të legalizohet me anën e OKB-së. Pikërisht për këtë bëjnë përpjekje dhe zotohen imperialistët amerikanë e ata sovjetikë, ndërsa populli palestinez të vazhdojë të rrojë në çadra dhe të marrë nga OKB-ja një lëmoshë prej 500 gram sheqer e 300 gram vaj në muaj, një batanije pëtre vjet e të rrojë nën «kujdesin» e një doktori për çdo 10 000 veta etj. Palestinezët, që do të tregohen të gatshëm për t'u bërë përkrahës të këtij kompromisi, që do të mbajnë ndonjë fjalim kundër interesave të popullit të tyre, si shpërblim do t'i dërgojnë për pushime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mund t'u japid ndonjë vilë të bukur në Liban ose gjetkë etj.

Edhe revisionistët sovjetikë, kujtdo që do t'i mbështetë në politikën e tyre, do t'i bëjnë elo zhe, do t'i thonë që ti je njeri i mirë, i zgjuar, i zoti etj., do t'i japid vilë e veturë në Moskë, do ta dërgojnë për pushime në Jalta etj. Kështu kanë bërë ata me Larbi Buhalinë që jetonte larg popullit algjerian dhe luftës që bëri ai, prandaj populli algjerian bëri shumë mirë që i dha duart. Ne i kemi kaluar vetë këto fazë me revisionistët hrushovianë, po u treguan vendin, prandaj populli na mbështeti. Po të mos jesh i lidhur me popullin dhe po u mbështete tek armiqjtë, more fund, re brenda. Nuk mund të janë komunistë ata që fshihen nga njerëzit e popullit. Kur situata e kërkon, ka mo-

mente që komunistët mund të qëndrojnë në ilegalitet, por me ndryshimin e gjendjes merr fund qëndrimi ilegal. Sidoqoftë dhe në cilatdo kushte lufte qofshin, komunistët duhet të lidhen dhe të ecin kurdoherë me popullin.

Ne kemi besim se, qoftë revizionistëve sovjetikë, ashtu edhe imperialistëve amerikanë, puna nuk do t'u shkojë si në gjalpjë në Lindjen e Mesme, sepse, në radhë të parë, ju palestinezët, si njerëz të zgjuar, të vendosur e me kurajë, nuk do të duroni të jetoni gjithmonë me plaçka në kurriz. Patjetër ju do të hasni vështirësi në luftën tuaj, pse mbreti Hysein, si xaxhai i tij me këshilltarin anglez Lavrensin, do të vazhdojë të thurë intriga nën nxitjen e imperialistëve dhe të revizionistëve. Sidoqoftë çështja juaj do të fitojë, askush nuk mund ta shtypë vullnetin e popullit tuaj që lufton.

Ne ju vlerësojmë ju nga qëndrimet që mbani dhe nga veprimitaria që zhvilloni. Neve na duket i drejtë veprimi i udhëheqjes suaj, pas goditjes që donte të bënte Hyseini me klikën e tij. Disa hapën fjalë që Hyseini qe rrethuar nga trupat e «Al Fatahut», por kjo organizatë mbajti një qëndrim të matur me të cilin qetësoi gjendjen dhe Hyseinit i kërkoi të largonte kryeministrin dhe kryekomandantin. Kjo ishte një nga provat e para gjatë së cilës mendojmë se «Al Fatahu» gjykoi drejt, ndryshe gjendja mund të ndërlikohej më keq. Por edhe sikur të ndërlikoheshin situatat, ne kemi besim se ju do të dinit si të vepronit. Edhe po të krijoreshin rrethana më të favorshme dhe të dukej sikur çdo gjë u arrit, ju luftëtarët palestinezë nuk do të

lidhni duart, përkundrazi vigjilencën do ta mbanit kurdoherë në nivelin e duhur. Asnjë situatë nuk do t'i gjente të papërgatitur fedainjtë palestinezë, të cilët pushkën e kanë mbajtur kurdoherë në dorë. Në këto kushte as Izraeli, as sovjetikët, askush tjetër nuk do t'ju bënin dot gjë. Fedainjtë e «Al Fatahut» me luftën e tyre të vendosur nuk do të vazhdojnë të qëndrojnë më me batanijet e OKB-së në krahë, po në unitet me popullin jordanez, do ta ngrenë lart flamurin e luftës çlirimtare të popujve arabë, do të fitojnë kundër imperialistëve dhe kundër Izraelit, do të arrijnë ta çlirojnë me luftë dhe të kenë patjetër atdheun e tyre, një atdhe të vërtetë për të jetuar dhe atëherë miqtë tuaj të shumtë në botë do ta pëershëndetin fitoren tuaj.

Ne kemi besim se ju vetë i ndiqni me vigjilencë ngjarjet, prandaj gjykojmë se as ka nevojë dhe as ia lejojmë vetes që t'ju japim mësim për t'ju treguar si fitohet liria e popullit. Ne dëshirojmë vetëm t'ju themi që, kur edhe ne ishim në të njëjtat kushte si ju sot, kishim parasysh se nga çështjet e menduara mirë e parimore nuk duhet tërhequr, po duhet vepruar me guxim për vënien e tyre në jetë.

Ne asnjëherë nuk u jemi trembur kërcënimive që na kanë bërë dhe vazhdojnë të na bëjnë armiqtë. Për dekada me radhë, pasi siguroi lirinë, populli shqiptar ka luftuar me vendosmëri, prandaj nga çdo betejë ai ka dalë më i fortë dhe kufijtë e atdheut i ka bërë të paprekshëm. Pa këtë vendosmëri të popullit, ne do të ishim përblysur nga armiqtë. Edhe sot, si kurdoherë, jemi gati të përballojmë çfarëdolloj lufte që mund të

ndërmarrë armiku kundër nesh, qoftë ky Bashkimi Sovjetik socialimperialist, Jugosllavia revizioniste, Greqia, Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo të gjithë këta së bashku. Zaten, ne kemi qenë në luftë me të tërë këta, kjo na ka kalitur e na ka forcuar më shumë, na ka bërë të paprekshëm, ndryshe do të na kishin gllabëruar prej kohësh. Armiku është i pabesë, ai mund edhe ta sulmojë Shqipërinë, po të jeni të sigurt, shokë dhe vëllezër, se s'ka për të dalë pa u përgjakur rëndë nga vendi ynë. Ai mund të sulmojë diku më lehtë, kur të jetë i bindur se objekti i tij i sulmit ka për ta ngritur flamurin e bardhë, pra do t'i nënshتروhet. Por që të bëjë diçka kundër nesh, armiku ka frikë, pse e di që nuk do ta ketë të lehtë të dalë i gjallë nga aventura që mund të ndërmarrë.

Të njëjtat taktika dhe qëllime ndjekin armiqtë edhe me ju, po e kanë të vështirë t'i realizojnë, pse llogaritin unitetin e popujve vëllezër arabë që përbën një faktor shumë të rëndësishëm. Këtë duhet ta kenë parasysh edhe mjaft krerë të vendeve arabe. Duan apo nuk duan ata, masa e arabëve të thjeshtë, kur të shohin se vëllezërit e tyre palestinezë vritten, nuk do të qëndrojnë indiferentë, ata do t'ju vijnë juve në ndihmë. Në këtë rast ata do të bëjnë pyetjen: Përse vritten vëllezërit tanë palestinezë me izraelitët, me sovjetikët apo me amerikanët? Dhe do të arrijnë patjetër në konkluzionin e drejtë se armiqtë e huaj u kanë grabitur atyre atdheun, lirinë, prodhimet e të gjitha pasuritë e tjera, i fyejnë, u marrin të drejtat nëpër këmbë etj., etj. Atëherë, me siguri, opinioni arab do të ngrihet fuqishëm dhe do të thotë: Po ne ç'bëjmë, pse

nuk ngrihemë të gjithë në luftë kundër të njëjtët armik të përbashkët? Të tillë trajtim kanë edhe një milion e ca shqiptarë në Jugosllavi, megjithëse janë në tokat e tyre. Do apo nuk do Titoja, shqiptarët që jetojnë në atdheun e tyre të lirë nuk mund të mos mendojnë për vëllezërit e tyre në Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni që padrejtësia e së kaluarës i ka lënë jashtë kufijve shtetërorë shqiptarë, nuk mund të mos ngrenë zërin për përpjekjet që bëjnë shqiptarët në Jugosllavi për të ruajtur të pastër gjuhën shqipe, për të pasur në organet e pushtetit në shumicën dérrmuese shqiptarë dhe jo serbë e të tjerë, për t'u dhënë fund persekutimeve të egra nga ana e shovinistëve serbë etj., për të ndaluar emigrimin e shqiptarëve jashtë truallit të tyre kombëtar e shumë probleme të tjera të kësaj natyre. Ne, nga ana jonë, nuk kemi qëndruar asnjëherë indiferentë përpara ngjarjeve të kurdisura në Jugosllavi në dëm të vëllezërve tanë të Kosovës, përkundrazi i kemi demaskuar ato vazhdimisht para opinionit shqiptar e botëror, saqë Titoja u detyrua më së fundi t'u japë tani disa të drejta kosovarëve, të cilëve ndjenjat kombëtare as u kanë humbur, as nuk do t'u humbasin. Po të dojë le të mos ua japë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi të drejtat që u takojnë, kjo do të jetë ca më keq për regjimin titist dhe ne këtej, nga Shqipëria e lirë socialiste, asnjëherë nuk do të heshtim, sa herë që ato do t'u mohohen vëllezërve tanë të përtejkufirit tonë shtetëror.

Ndofta fola shumë, por kjo vjen se nuk na takon të piqemi shpesh me ju.

Duke marrë fjalën, kryetari i delegacionit palestinez, midis të tjerave, tha:

Këto që dëgjuam nga ju ne i vlerësojmë si mësimë mjaft të vlefshme e të thella, që janë rezultat i një eksperience të madhe e të gjatë.

Me këtë rast u lutem shokëve shqiptarë të më lejojnë t'i përshëndes në emër të Komitetit Qendror të Lëvizjes «Al Fatah» dhe «Al Asifa» të Palestinës. Populli palestinez e ka ndjekur gjithmonë me simpati luftën e popullit shqiptar, nën udhëheqjen Tuaj largpamëse. Prandaj bisedën me Ju e konsiderojmë një shkollë të madhe që do ta ndihmojë shumë organizatën dhe udhëheqjen tonë.

Gjatë vizitës në vendin tuaj kemi gjetur te ju një popull mik të singertë që ushqen simpati dhe e përkrah pa rezerva luftën e popullit tonë. Ne pamë nü Shqipëri se udhëheqja Juaj e urtë i bën të mundur popullit shqiptar ta kuptojë drejt dhe ta përkrahë luftën që bëjmë ne. Ne jemi të bindur se mbështetja juaj për luftën e popullit palestinez është e madhe dhe, kur të kthehem, gjithçka që pamë dhe mësuam nga ju do t'ua bëjmë të ditur shokëve, megjithëse ata, edhe pa ardhur ne nü Shqipëri, ishin në dijeni për dashurinë që ushqen populli juaj për popullin tonë, por paskëtaj, mbështetjen tuaj ata do ta shikojnë si një të vërtetë të prekshme. Kemi bindjen se përkrahja juaj do të jetë e vazhdueshme. Nga ana jonë ju japim fjalën, fjalën e shokut dhe të luftëtarit se sa të jemi gjallë, nuk do të heqim dorë kurrë nga lufta e armatosur.

Në këtë çast shumë të prekshëm, shoku Enver Hoxha ngrihet në këmbë e përqafohet me krye-

tarin e delegacionit, u shtrëngon dorën fort miqve të tjerë palestinezë të pranishëm dhe pastaj vazhdoi:

Shumë drejt e keni, kjo është e vetmja rrugë e çlirimt të popujve, shokë dhe vëllezër, veçanërisht e popullit vëlla dhe heroik palestinez. Ne kemi bindjen se populli juaj do të çlirohet. Prandaj edhe unë, në emër të Partisë dhe të popullit shqiptar, ju them edhe një herë se te Shqipëria ju keni e do të keni një aleat dhe mik besnik të patundur, si në ditë të mira, ashtu edhe në ditë të vështira. Ne do ta ndihmojmë kurdoherë me gjithë zemër popullin vëlla palestinez. Ju e thatë mirë se lufta që po bën ai është e vështirë, por ka rëndësi çështja që vija e luftës suaj është e drejtë, që ajo bazohet në aspiratat e popullit tuaj për çlirimin e atdheut të vet, prandaj do të kurorëzohet patjetër me sukses. Lufta që po bëni ju është revolucionare dhe kemi besim se nëpërmjet saj ju vini gurin e patundur në themelitë e fitores së popullit palestinez, të së ardhmes së tij.

Ashtu si ju që po ccni në gjurmët e luftërave të gjyshërve dhe të prindërve tuaj për të arritur në çlirimin e përhershëm të popullit palestinez, edhe lufta që bëmë ne ishte vazhdim i luftës shekullore të popullit shqiptar, i kryengritjeve të tij të pareshtura, i përpjekjeve të patriotëve e të njerëzve përparimtarë shqiptarë që nuk ishin komunistë, po popullin e donin me gjithë shpirt, prandaj qenë të lidhur ngushtë me të dhe ushqenin një urrejtje të thellë kundër pushtuesve. Gjithë eksperiencën e madhe luftarake dhe traditat e lavdishme të përpjekjeve të tyre, brezat e kaluar na i lanë trashëgim që ne ta vazhdonim edhe pas tyre

luftën gjer në fitore. Tani detyra jonë është që fitoret e arritura t'i konsolidojmë, pse rreziqet as për ne nuk janë zhdukur dhe, pavarësisht se kemi fituar lirinë, ato vazhdojnë të janë të mëdha. Shqipëria, ku populli ynë është në fuqi, në krahasim me të kaluarën që as përfillej fare, tani me luftën e saj ka fituar respekt të madh në botë. Megjithatë ajo prapëserapë është e kërcënuar nga imperialistët, nga socialimperialistët sovjetikë dhe nga këlyshët e tyre.

Por ne, gjithashtu, nuk harrojmë kurrë se nuk jemi të izoluar, prandaj luftën dhe fitoret e popullit tonë i lidhim ngushtë me luftën dhe me përpjekjet e gjithë popujve të tjerë vëllezër që luftojnë për të njëjtat qëllime, në mes të të cilëve janë populli vietnamez, popujt afrikanë, popujt arabë e veçanërisht populli palestinez. Ne kemi besim të plotë se fitorja përfundimtare do të arrihet, por dimë, gjithashtu, se gjersa luftojmë, krahas me fitoret, ekzistojnë e do të ekzistojnë edhe disfata të përkohshme, nga të cilat revolucionarët e vërtetë nuk thyhen.

Shfrytëzuesit që sundojnë ende në botë, kudo qofshin, s'janë tjetër veçse disa klika që do të varrosen nga luftërat çlirimtare të popujve. Çdo luftë që ka përsnim çlirimin e cilitdo popull, ne e konsiderojmë si luftën tonë, çdo fitore e disfatë të tyre i konsiderojmë, gjithashtu, tonat. Kur shohim që popujt arabë luftojnë, ne këtu në Shqipëri e ndiejmë veten të fortë. Kur revisionistët sovjetikë, imperialistët amerikanë apo armiq të tjerë përpiken ta shuanë luftën e popujve arabë, ne, gjithashtu, e ndiejmë se rreziku shtohet edhe për Shqipërinë. Prandaj detyra e revolucionarëve të vërt-

tetë është t'u hapin sytë masave në Evropë e kudo gjetkë, që të mos bien kurrë në gjumë, në letargjinë e rrëme të paqes false, të bashkekzistencës false, të çarmatimit fals, të kurdisur nga dy fuqitë e mëdha për të shuar revolucionet dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve që i kërcënojnë seriozisht, prandaj edhe bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i shuar.

Aleatë të luftërave nacionalçlirimtare dhe përkrahës kryesorë të revolucioneve dhe të luftërave nacionalçlirimtare janë vendet socialiste, në radhë të parë, Shqipëria socialiste, me aq sa ka mundësi, për të gjitha arsyet që thashë më lart, duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, pa u lëkundur asnjëherë, është me të gjithë revolucionarët e vërtetë dhe me popujt që luftojnë kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Revisionistët, duke abuzuar me emrin e Leninit, me teoritë e tyre antileniniste u kanë bërë një dëm kolosal lëvizjeve nacionalçlirimtare. Ata veprën e tyre minuese e bëjnë nëpërmjet partive të quajtura «komuniste», por që i kanë degjeneruar në parti tradhtare të çështjes së popujve. Edhe në Jordani ekziston një parti e quajtur «komuniste». E them këtë se ne i njohim mirë «komunistët» jordanëzë dhe sekretarin e saj, Masarin, që vete e vjen pareshtur në Moskë. Në vitin 1960, kur Nikita Hrushovi filloi sulmin kundër nesh, sepse ne i vumë në dukje të gjitha ato që kishte bërë kundër Shqipërisë dhe luftërave nacionalçlirimtare të popujve, Masari na shau ne. Ua jepni shokëve palestinezë fjalimin e mbajtur nga delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë në Mbledhjen e 81 partive komu-

niste e punëtore¹ në Moskë më 1960, po ta duan. Unë mendoj se ky «komunist» shtyhet nga revizionistët sovjetikë për ta sabotuar luftën e popullit tuaj. Për këtë qëllim, për t'ju luftuar ju me të gjitha mënyrat, ai jo vetëm merr para, po edhe armë nga armiqjtë tuaj. Shefi i «komunistëve» jordanezë është gati të ndihmojë edhe mbretin Hysein kundër jush. Veç kësaj, kur të shikojë ai se ju do të reziston, me nxitjen e sovjetikëve do të përpinqet të krijojë edhe çeta «fedainjsh» që në dukje, për të gënjer, do të propagandojnë sikur luftojnë gjoja për çlirimin e Palestinës, po në të vërtetë do të përpinqen t'ju vënë minat juve.

MIKU PALESTINEZ: Ne e dimë që ai ka marrë armë nga Bullgaria dhe nga Bashkimi Sovjetik. Ai e mbron hapur sistemin monarkik në fuqi në Jordani dhe vendimet e partisë së tij janë të atilla që i pëlqejnë regjimit ekzistues atje. Masari ka krijuar një organizatë me emrin «Partizan» dhe lufton kundër të gjitha organizatave tona për çështjen e planit të paqes të thurur nga armiqjtë.

SHOKU ENVER HOXHA: E shikoni si veprojnë ata? Nën kushtimin e Leninit, oburra, të luftojmë së bashku me Hyseinët. Partia jonë na mëson të jemi kurdoherë të rreptë me armiqjtë, por të drejtë, të hapët e të singertë me miqtë.

...Shokë e vëllezër, siç e thatë edhe vetë, ky është kontakti i parë midis nesh. Në të ardhmen ne do të

1 Shoku Enver Hoxha u drejtohet funksionarëve të Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme të pranishëm në këtë takim.

kemi kontakte të tjera edhe më të shpeshta. Situatat aktualisht janë të vështira për ju, por do të vijë koha që të krijohen situata edhe më të mira për Palestinën.

Ju theksojmë edhe një herë, të dashur miq, se Shqipëria, me ato mundësítë e pakta që ka, nuk do të kursejë asgjë për të mbështetur luftën e popullit vëlla palestinez.

Në emër të Partisë dhe të popullit unë ju uroj suksese të mëtejshme, të vazhdoni gjer në fund rrugën e luftës që keni filluar, se është e vetmja rrugë e shpëtimit, rruga e çlirimt. Rrugë tjetër nuk ka. Kur të mos ekzistojnë më imperialistët dhe revisionistët modernë, atëherë do të vendosen në botë paqja e vërtetë dhe respekti real për një popull të vogël si juaji.

Le ta ngremë këtë gotë për shëndetin tuaj, për shëndetin e popullit vëlla palestinez!

Faleminderit shumë për bisedën. I bëni të fala nga unë udhëheqësit tuaj Jaser Arafat.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Ku-
ndër revisionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 607*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 607*

TRAKTATI SOVJETO-GJERMAN — NJË KOMPLOT I RREZIKSHIËM KUNDËR POPUJVE TË EVROPËS DHE GJITHË BOTËS

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

22 gusht 1970

Pazarllëqet e gjata midis revisionistëve sovjetikë dhe revanshistëve gjermanë mbaruan më në fund me nënshkrimin në Moskë përpara disa ditësh të një pakti të emërtuar thjesht «Traktat midis BRSS dhe Republikës Federale të Gjermanisë». Në Kremlin dhe në Bon s'po pushojnë së rëni kambanave për të kremtuar «kthesën e re» në marrëdhëniet sovjeto-gjermane dhe pér të ngritur në qiell politikën «realiste» e «shpëtimtare» të krerëve moskovitë dhe të kolegëve të tyre gjermanoperëndimorë. Udhëheqësit shtetërorë të tē dy vendeve, diplomatët, gazetarët, të gjitha mjetet e agjizacionit e të propagandës, janë vënë në lëvizje pér t'u mbushur mendjen të tjera se Traktati Sovjeto-Gjerman shënoka «ngjarjen më të madhe historike në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore», se është realizuar «pajtimi i madh» midis dy armiqve të mëdhenj, se, më në fund, kontinentit tonë plak iu hapën dyert e

«paqes së përjetshme». Ata mundohen të shfrytëzojnë rastin për t'u mbushur mendjen popujve të Evropës e të botës se gjoja dy fuqitë më të mëdha të Evropës, Bashkimi Sovjetik e Gjermania Federale, jo vetëm që njojin si të paprekshëm kufijtë ekzistues të të gjitha vendeve të Evropës dhe zotohen solemnisht të mos përdorin forcën ndaj njëri-tjetrit, por bëhen edhe super-garantë, ashtu siç u shpreh Kosigini, «për mbajtjen e stabilitetit dhe të qetësisë në kontinentin evropian».

Sigurisht, në qoftë se marrëveshja e re sovjeto-gjermane do të merrej e shkëputur nga politika e jashtme dhe e brendshme e të dy vendeve, në qoftë se do të shikoheshin vetëm germat e traktatit dhe jo fryma e tij, atëherë mund t'u besohej edhe fjalëve të bukura që tani po dëgjojmë me bollëk si nga Moska, ashtu edhe nga Boni. Por Evropa akoma nuk i ka shëruar plagët e iluzioneve të vjetra, ajo akoma vuau nga pa-sojat e premtiveve e të sigurimeve «solemne» të kaluara për ta lejuar veten që t'u nënshتروhet iluzioneve të reja, si ato të viteve 30-të, t'u besojë premtiveve e sigurimeve të reja boshe.

Hitleri pati deklaruar jo një herë se nuk do t'i sulmonte kurrë vendet e tjera, bille pati nënshkruar gati me të gjitha shtetet që invadoi pakte mossulmimi, por, kur erdhi koha, ai nuk ngurroi të fshijë Austrinë dhe të pushtojë Francën, të gllabërojë vendet e vogla evropiane dhe të sulmojë Bashkimin Sovjetik. Fuqitë e mëdha evropiane ishin zotuar botërisht me të shkruar dhe të pashkruar se do të mbronin me të gjitha mjetet «kufijtë ekzistues» të shteteve evropiane, por, kur e solli puna të vepronin, ato aprovuan anshlusin dhe përm

funduan Munihun, bënë sehir pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi e kështu me radhë.

Kushdo që në mënyrë të paanshme e realiste shqyrton situatën e sotme ndërkontaktare e, në mënyrë të veçantë, atë të Evropës, që vlerëson drejt politikën e jashtme të socialimperialistëve sovjetikë e të revanshistëve të Bonit, nuk mund të mos arrijë në konkluzionin se Traktati i ri Sovjeto-Gjerman shënon një komplot të ri e mjaft të rrezikshëm, të drejtuar jo vetëm kundër popujve evropianë, por edhe kundër popujve të të gjithë botës. I parë në tërësi, ky traktat përbën një marrëveshje midis dy fuqive të reja imperialiste, që arrihet në kuadrin e strategjisë globale sovjeto-amerikane të ruajtjes së pozitave sunduese e zonave të influencës në Evropë, në veçanti ai zbulon orvatjet e revisionistëve sovjetikë dhe revanshistëve gjermanë për nënshtrimin politik e ekonomik të vendeve evropiane.

Zgjidhja e çështjes gjermane, një nga problemet kyç dhe më të rëndësishme, e lënë trashëgim nga Lufta e Dytë Botërore dhe e lidhur ngushtë me tërë fatin e kontinentit tonë, ka preokupuar vazhdimisht popujt e Evropës. Ata kanë ndjekur me vëmendjen më të madhe të gjithë hapat pozitivë e negativë që janë bërë gjatë 25 vjetëve në këtë fushë. Në shumë aspekte problemi gjerman ka shërbyer gjatë kësaj kohe si një barometër për të matur uljen ose ngritjen e atmosferës politike në Evropë.

Tani bëhet pyetja: A i shërben traktati i përfunduar midis Moskës e Bonit zgjidhjes së drejtë të problemit gjerman dhe sigurimit të vërtetë në Evropë?

Në marrëveshjen e përfunduar në Moskë më 12 gusht, ashtu edhe në fjalimet e deklaratat e shumta të udhëheqësve sovjetikë e gjermanoperëndimorë, kush-tuar kësaj ngjarjeje, jo vetëm nuk përmendet shprehi-misht asnjëherë, por nuk bëhet as aluzioni më i vogël mbi nevojën e përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë. A është kjo një gjë e rastit? Dikur Hrushovi dhe vetë udhëheqja që është sot në fuqi në Bashkimin Sovjetik deklaronin gati përditë se Bashki-mi Sovjetik nuk mund ta zgjaste më tutje përfundimin e traktatit të paqes me të dy shtetet gjermane dhe, në rast se në Bon nuk donin, ata do ta përfundonin vetëm me RD Gjermane. Ata thoshin atëherë se për këtë punë çdo gjë ishte gati dhe nevojitej vetëm aq kohë sa të nxirrin stilografin për ta firmosur.

Përse këta zotërinj e «harruan» tani këtë çështje kaq të madhe, e cila ka qenë një nga problemet themelo-re të politikës së jashtme sovjetike? Fakt është se udhëheqësit e sotëm sovjetikë në çështjen gjermane dhe në atë të traktatit të paqes kapitulluan kokë e këmbë përpara Bonit. Ata pranuan gjendjen e faktit të kryer përpara së cilës i vunë fuqitë perëndimore dhe Gjermania Federale, domethënë njohjen e shkeljeve flagrante të vendimeve të Jaltës e të Potsdamit, mohimin e të gjitha idealeve për të cilat luftuan popujt so-vjetikë e antifashistë, zhdukjen e shpresave për t'i shkulur një herë e përgjithmonë rrënjet e militarizmit dhe të revanshizmit gjerman, burimin e përhershëm të luftës e të agresionit në Evropë.

Revisionistët sovjetikë nuk mund të mashtrojnë njeri dhe nuk mund të krijojnë iluzionin se marrëvesh-

ja që përfunduan me Bonin zëvendëson traktatin e paqes me Gjermaninë. Çështja e traktatit të paqes me Gjermaninë nuk i përket vetëm Bashkimit Sovjetik. Ky është një problem kyç i gjithë shteteve evropiane që kanë luftuar kundër nazizmit. Gjermania hitleriane u thye nga koalicioni i madh antifashist dhe, ashtu siç u veprua me Italinë, duhej të nënshkruhej edhe me Gjermaninë traktati i paqes nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse në luftën antifashiste.

Tani Gjermania e mundur po kalon në histori pa e nënshkruar traktatin e paqes dhe këtë krim që u bëhet popujve të Evropës dhe mbarë njerëzimit, që vuajtën aq shumë nga nazizmi, ata ua detyrojnë, në radhë të parë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Anglisë e Francës që shkelën vendimet e përbashkëta aleate të kohës së luftës, morën nën mbrojtje mbeturinat e nazizmit dhe ringjallën militarizmin gjerman të mishëruar sot në Republikën Federale.

Bashkimi Sovjetik me Josif Stalinin në krye nuk mund ta pranonte dhe nuk e pranoi një krim të tillë. Kurse tradhtarët revisionistë me Brezhnjev-Kosiginin në ballë, Gjermaninë Federale nga një shtet i mundur, që duhej të nënshkruante traktatin e paqes, ku natyrisht duhej të figuronin edhe klauzola restriktive, mundohen ta rehabilitojnë dhe ta çlironjë nga çdo detyrim. Për më tepër, në sajë të revisionistëve sovjetikë dhe me mbështetjen e tyre, na del që kjo Gjermani të na bëhet edhe «garante» e kufijve të shteteve të Evropës.

Kjo mënyrë «zgjidhjeje» e traktatit të paqes me Gjermaninë nuk është më e mira, siç pretendon zoti

Kosigin. Zgjidhja e vërtetë dhe e drejtë është përfundimi i traktatit me pjesëmarrjen e të gjitha shteteve të koalicionit antifashist. Atë nuk mund ta zëvendësojë asnjë marrëveshje e çdo lloji qoftë dhe e bërë nga kushdo qoftë.

Qëndrimi aktual i udhëheqësve sovjetikë ndaj problemit gjerman godet mjaft rëndë interesat e mbarë popullit gjerman, i cili ka dëshiruar të shpëtojë nga zgjedha e militarizmit dhe e revanshizmit, të hyjë në një rrugë të vërtetë demokratike e paqësore të afrimit e të bashkëpunimit me popujt e tjerë të Evropës. Traktati që revisionistët përfunduan me Bonin, jo vetëm që nuk forcon krahun antifashist e demokratik në Gjermani, por, duke u siguruar ndihmën dhe bashkëpunimin qarqeve të soime sunduese të Bonit, e për më tepër duke u dhënë atyre një «certifikatë mirësjelljeje» politike të një shkalle të tillë ndërkombëtare, i justifikon dhe i inkurajon apetitet e tyre reaksionare, revanshiste e ekspansioniste.

Krijimi i Republikës Demokratike Gjermane ka qenë një fitore e madhe për gjithë popullin gjerman, një ngjarje me rëndësi historike për të gjithë popujt e Evropës. Përpjekjet që janë bërë nga vetë gjermanët, nga gjithë njerëzit antifashistë e përparimtarë të botës, nga të gjitha forcat paqedashëse e progresiste për njojen e RDGJ-së si shtet sovran me të drejta të plota, në radhë të parë nga Republika Federale e Gjermanisë dhe nga shtetet e tjera perëndimore, kanë treguar se kjo çështje ka qenë dhe mbetet një nga bazat kryesore e esenciale të zgjidhjes së problemit gjerman. Njohja e Republikës Demokratike Gjermane me shumë të drej-

të është konsideruar si një çeshtje e lidhur ngushtë me sigurimin e vërtetë të paqes në Evropë dhe me kundërshtimin e planeve agresive të fuqive imperialiste, duke përfshirë këtu edhe ata të Bonit.

Tani krerët e Kremlinit, me marrëveshjen e përfunduar në Moskë, i futin një thikë pas shpine RDGJ-së, pozitës së saj politike, emrit dhe prestigjit të saj ndërkombetar. Në bisedimet Moskë-Bon dhe në Traktatin e fundit Gjermano-Sovjetik, Republika Demokratike Gjermane është trajtuar nga të dyja palët, jo si një shtet i pavarur e sovran, ndaj të cilit asnjë nuk ka të drejtë të ndërhyjë në punët e tij, por si një vend për të cilin fuqi e shtete të tjera mund të vendosin, t'i diktojnë dhe t'i imponojnë këtë ose atë vendim të përbashkët. Ajo është konsideruar nga revisionistët sovjetikë si një objekt pazarllëku me partnerët nga Boni, si një çiflig sovjetik, me të cilin Kremlini mund të veprojë si të dojë, ta mbajë vetë, ta shesë, ta japë me qira, t'i imponojë këtë ose atë statut politik të brendshëm e ndërkombetar, të mbyllë ose të hapë kufijtë e tij etj.

Deri tani vonë revisionistët sovjetikë e vinin njohjen e plotë nga pikëpamja ndërkombebare, të RDGJ-së nga ana e RFGJ-së, si një kusht paraprak përfundimin e çdo marrëveshjeje me Bonin. Ata betoheshin se në bisedimet sovjeto-gjermane nuk do të arrihej në asnjë rezultat në qoftë se Boni nuk do të hiqte dorë përfundimisht nga pretendimi se përfaqëson gjithë Gjermaninë, në qoftë se ai nuk do të braktiste politikën e deritanishme të «bashkimit të Gjermainisë», domethënë të gllabërimit të RDGJ-së. Në traktat s'ka

mbetur as nami as nishani nga kjo premisë. Propaganda e Moskës kërkon ta justifikojë këtë kapitullim të padronëve të saj, duke pretenduar se në marrëveshjen sovjeto-gjermane është thënë se palët e shikojnë si të paprekshëm edhe kufirin midis Republikës Federale e asaj Demokratike Gjermane.

Në të vërtetë, ky formulim i errët i traktatit nuk e fsheh dot realitetin. Mbetet fakt se Republika Federale nuk e njeh RDGJ-në, se ajo vazhdon ta heqë veten si përfaqësuesja e të gjithë kombit gjerman dhe ta konsiderojë Republikën Demokratike si një territor që përkohësisht ka mbetur jashtë kufijve të saj, por që ajo do të gjejë kohën dhe mjetet e duhura «për ta futur» në gjirin e vet. Këtë vijë politike dhe qëndrim zyrtar të qeverisë federale ndaj RDGJ-së revisionistët sovjetikë e pranuan botërisht, duke marrë në dorëzim, si dokument zyrtar dhe si aneks të traktatit, notën që Boni më 12 gusht i dërgoi qeverisë sovjetike, me anën e së cilës shprehej e ashtuquajtura «dëshirë gjermane» që «të punojë» për ribashkimin paqësor të të dyja Gjermanive. Siç njoftonte agjencia franceze e lajmeve, Gromikoja deklaroi gojarisht gjatë bisedimeve se «nacioni i paprekshmërisë së kufijve nuk e përjashton një ndryshim të mëtejshëm me anë bisedimesh». «Kjo, — vazhdon agjencia, — është e rëndësishme, mbasi fjalë të tilla, megjithëse nuk figurojnë në tekst, janë shkruar në procesverbalin e diskutimeve dhe mund të dëshmojnë për interpretimet».

Mbetet fakt se ndërsa revisionistët sovjetikë edhe më përpara, por sidomos me traktatin e tanishëm, i bënë Gjermanisë Federale koncesione të mëdha, fuqitë

e tjera imperialiste me SHBA-në në krye as denjojnë ta njohin Republikën Demokratike Gjermane dhe mbrojnë deri në fund qëndrimet dhe qëllimet e Bonit ndaj saj.

I gjithë ky allishverish i hapët dhe në prapaskenë midis Moskës e Bonit tregon se RDGJ-ja është nxjerrë nga revisionistët sovjetikë në treg. A do ta shesin atë copa-copa apo të tërë, duke i mohuar të drejtat e saj, duke e nënvleftësuar e duke e poshtëruar, kjo varet nga shumë rrethana. Por fakt është se, ndërsa ndaj «dëshirave» të revanshistëve të Bonit krerët e Kremlinit janë shumë të ndjeshëm, ndaj dëshirave të RD Gjermane dhe të gjithë popullit gjerman ata tregohen krejtësisht indiferentë.

Në Traktatin Sovjeto-Gjerman nuk përmendet, por udhëheqësit gjermanoperëndimorë kanë folur publikisht se gjatë bisedimeve të Moskës qeveria sovjetike është zotuar të njohë «të drejtat e posaçme» të Bonit mbi Berlinin Perëndimor. Bile, disa kanë deklaruar se sovjetikët kanë pranuar tanimë ta konsiderojnë atë si pjesë integrante të Republikës Federale. Për më tepër krerët sovjetikë kanë marrë përsipër ta detyrojnë RDGJ-në të bëjë lëshime të mëdha në çështjen e Berlinit që prekin drejtpërsëdrejti integritetin dhe sovranitetin e saj. Kjo është një tradhti tjetër që i bëhet popullit gjerman nga revisionistët sovjetikë dhe një inkurajim i hapët i synimeve revanshiste të Bonit. Deri pak kohë më parë udhëheqësit sovjetikë ngulnin këmbë se Berlini Perëndimor ishte një entitet territorial më vete me një statut ndërkombëtar të pavarur, ashtu si dhe çështja e marrëdhënieve midis dy pjesëve të Ber-

linit ishte në kompetencën e RDGJ-së. Si ndodhi që ata angazhohen tani përpara Bonit «për të rregulluar» problemet e Berlinit, «për të ndryshuar» situatën ekzistuese? Ku e morën këtë të drejtë? Largimi nga pozitat e mëparshme, në këtë çështje, është një provë tjetër e komplotit të ri që po thuret në kurrit të RDGJ-së midis klikës Brezhnev-Kosigin dhe qeverisë së revanshistëve të Bonit.

Kuptimi i Traktatit Sovjeto-Gjerman qëndron jo aq në atë që është arritur sot, por në pasojat e mëvonshme ndërkombëtare të tij, në rrugët që ai u hap planeve agresive të imperializmit revisionist sovjetik dhe revanshizmit gjerman. Në qendër të Evropës po krijohet një aleancë e re imperialistësh, një raport i ri forcash, i cili shpejt ose vonë do të fillojë të kërkojë «hapësira» të reja në dëm të interesave jetikë të popujve të tjerë, të paqes e të sigurisë në Evropë.

Traktati ka për qëllim të sanksionojë dhe të ruajë zonat e influencës së fuqive të mëdha në Evropë, duke u njojur atyre paraprakisht të drejtën e ndërryjes dhe të lënies së duarve të lira. Është e vërtetë se në traktat përmendet paprekshmëria e kufijve, por aty fjala është për kufijtë e zonave të influencës, mbasi për sa u përket të tjerave, ato mbeten kurdoherë nën kërcënimin e tankeve të NATO-s e të Traktatit të Varshavës. Për çfarë paprekshmërie kufijsh mund të bëhet fjalë, kur revisionistët sovjetikë ndaj vendeve satelite zbatojnë politikën e «sovranitetit të kufizuar», osc kur Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në bazë të Paktit të Atlantikut, u lejohet të ndërrhyjnë në punët e brendshme të partnerëve të tjerë sa herë ato do ta

konsiderojnë se diku është krijuar rreziku i «pavarësisë politike ose i sigurimit» të tyre? A mund të flitet për paprekshmëri kufijsh kur trupat sovjetike e amerikane janë dislokuar në shumë vende të Evropës, duke pasur të drejtën të hyjnë e të dalin kur të duan, duke mos iu nënshtruar asnjë kontrolli nga qeveritë e vendeve ku ato ndodhen? Dy vjet më parë trupat revisioniste sovjetike pushtuan Çekosllovakinë. Mos vallë ato nuk do ta përsëritin një veprim të tillë në një rast tjeter, pse do t'i ndalojnë «angazhimet» që janë marrë në Traktatin Sovjeto-Gjerman?

Përkundrazi, traktati e bën të qartë se Gjermania Federale, tani për tanë, u lë dorë të lirë revisionistëve sovjetikë të veprojnë si të duan matanë Elbës, pavarësish se revanshistët e Bonit do të mundohen, nëpërmjet evolucionit paqësor, t'i vënë minat perandorisë revisioniste.

Çdo pazarllék midis ujqve imperialistë, pra, edhe ky midis revisionistëve sovjetikë e revanshistëve gjermanë, nuk mund të përfundohet pozitivisht pa lëshime reciproke. Si kundërshpërblim për njohjen e sundimit revisionist sovjetik në Lindje, Boni siguroi nga Moska përkrahjen për ekspansionin e tij ekonomik e politik në hemisferën perëndimore të Evropës.

Shtypi borgjez perëndimor më hapët dhe deklaratat e personaliteteve politike, në mënyrë të tërthortë, e kanë shprehur qartë frikën se bashkëpunimi gjermano-sovjetik, që u sanksionua zyrtarisht dhe u forcua më shumë me traktatin e ri, do t'i japë Gjermanisë Perëndimore mundësinë e fitimit, përvëç epërsisë ekonomike, edhe të epërsisë politike në gjirin e Tregut të

Përbashkët, duke e kthyer atë gradualisht në një fuqi sunduese në këtë rajon. Ata e ndiejnë se «politika e re lindore» e Bonit dhe ndryshimi rrënjosor i qëndrimit të qeverisë të tanishme sovjetike ndaj problemit gjerman u shërbejnë forcimit të revanshizmit gjerman dhe planeve ekspansioniste të revisionistëve sovjetikë, se bashkëpunimi sovjeto-gjerman prek drejtëpërdrejt interesat e tyre kombëtarë dhe të pagues në Evropë. Por, tani për tani, më tej shfaqjes së preokupimeve dhe të rezervave, ata nuk shkojnë. Megjithëse historia jo shumë e largët ka treguar se militarizmi gjerman nuk ndalet kurrë në mes të rrugës dhe pushtimi i Çekoslllovakisë nuk lë më dyshime për planet e revisionistëve sovjetikë, qarqet sunduese borgjeze evropiane mendojnë se vrulli agresiv gjerman e ai revisionist sovjetik mund të ndalen akoma me disa manovrime politike ose duke shfrytëzuar e duke luajtur me kontradiktat ekzistuese. Kështu, për shembull, mjaft njerëz në Perëndim mendojnë se bashkëpunimi agresiv sovjeto-gjerman mund të përballohet nga ruajtja e influencës dhe e pozitave amerikane në Evropën Perëndimore, të tjerë përballimin e këtij rreziku e shohin në përfundimin e një marrëveshjeje të përgjithshme mbi «sigurimin evropian» ku shtetet do të angazhohej shin formalisht të respektojnë njëri-tjetrin. Por, sido që të bëhet, si në njërin rast ashtu edhe në tjetrin, në Evropë do të sanksionohej sundimi i dy fuqive të mëdha imperialiste në zonat e tyre të influencës dhe do t'u liheshin këtyre duart e lira për të ushtruar pression mbi vendet e vogla ose mbi ato që janë të dobëta ekonomikisht e ushtarakisht. Nga ana tjetër, asnë ma-

rrëveshje formale nuk do të ishte në gjendje, pa marrjen e masave efektive, të ndalonte ekspansionin gjerman. Çdo sigurim evropian që nuk do të drejtohej kundër imperializmit amerikan e revizionizmit sovjetik, që nuk do të kundërshtonte revanshizmin gjerman, ai nuk do të ishte sigurimi i Evropës, por skllavërimi i saj.

Revisionistët sovjetikë po bëjnë tanë një propagandë të madhe për ta paraqitur marrëveshjen e tyre me Brandin si një hap të rëndësishëm «drejt sigurimit të Evropës». Ky është një blof dhe mashtrim i madh. Me parulla të tilla ata duan të largojnë vëmendjen e popujve të Evropës nga gjendja reale e fakteve në kontinentin e tyre, të fshehin situatën e rëndë të krijuar nga sundimi i Moskës në Evropën Lindore dhe të maskojnë planet e veta agresive në rajone të tjera të botës. Me «sigurim evropian» ata kuptojnë sigurimin e vetes së tyre, sigurimin e qetësisë dhe të krahëve në Evropë për t'u përqendruar në Azi e në sektorë të tjerë ku shtrihen planet e tyre agresive.

Marrëveshja gjermano-sovjetike në shumë aspekte përputhet edhe me politikën globale të Uashingtonit. Edhe imperialistët amerikanë, ashtu si revisionistët sovjetikë, kërkojnë ruajtjen e pozitave të tyre të tanishme në Evropë, qetësinë dhe paqen me sovjetikët, për t'u transferuar në Azi ku është përqendruar aktualisht agresioni dhe ekspansioni i tyre. Zbutja ose rregullimi i problemit gjerman, duke e fiksuar, në mos më tepër, gjendjen politike aktuale, u intereson të dyja fuqive të mëdha imperialiste dhe u përshtatet interesave e strategjisë së tyre për sundimin e botës. Marrëveshja e përfunduar midis Moskës e Bonit, nuk i prek zonat e

tyre të influencës në Evropë, përkundrazi ajo i ligjëson ato. Për më tepër, ajo hap rrugën për zhdukjen e konfrontimit amerikano-sovjetik në Gjermani e në Evropë, i krijuar historikisht, por që në kushtet aktuale të aleancës sovjeto-amerikane, bëhet një barrë që pengon planet e tyre të përbashkëta agresive.

Prandaj për popujt e Evropës nuk ka vend përiluzione. Ata nuk duhet t'i lejojnë vetes të bëhen viktimë e mashtrimeve propagandistike të revisionistëve sovjetikë, të Brandit dhe miqve të tij amerikanë, ashtu sikundër nuk duhet t'u besojnë kapitulluesve dhe gjithë atyre, që përhapin shpresën e rreme se atrimi dhe marrëveshjet e reja sovjeto-gjermane do të sjellin uljen e tensionit dhe do ta largojnë rrezikun e luftës nga Evropa. Historia ka provuar tanimë, aq sa do të ishte e tepërt ta përmendim, se pajtimi me revanshizmin gjerman dhe tërheqja përpara tij kanë qenë katastrofike për popujt e Evropës. Shumë politikanë në të kaluarën, për t'i larguar agresorët nga vendet e tyre, janë munduar t'i drejtojnë ata në Lindje, duke u dhënë për këtë edhe ndihmën e përkrahjen e tyre. Por është provuar se agresorët nuk janë bërë aspak merak për «qytetërimin evropian» dhe, në radhë të parë, kanë shkatërruar Evropën. S'ka asnjë dyshim se agresorët, qofshin këta amerikanë, revisionistë sovjetikë apo të tjerë do të nënshtrojnë më parë Evropën, do t'u grabitin popujve të saj lirinë e pavarësinë, do të mbytin çdo lëvizje revolucionare e demokratike. Dhe, në fakt, i ashtuquajturi sigurim evropian është një hap që imperialistët amerikanë e sovjetikë bëjnë për robërimin dhe «qetësimin» e Evropës.

Paqja në kontinentin tonë nuk mund të shikohet kurrë e shkëputur nga situata botërore, nga ajo që ndodh përreth nesh. Si mund të ketë siguri në Evropë kur po zhvillohet agresioni në Lindjen e Mesme, kur trupat amerikane e sovjetike mbajnë me qindra baza në vende të ndryshme evropiane, kur flotat e tyre sillen si kuçedra nëpër Mesdhe, kur agresorët amerikanë i kanë shtrirë flakët e luftës në gjithë gadishullin indokinez? Vratat e zjarrit të luftës imperialiste edhe më përpara janë përhapur shumë shpejt e jo më tani kur distancat janë zhdukur dhe praktikisht izolimi është bërë i pamundshëm. E vetmja rrugë shpëtimi për popujt evropianë është të bashkohen në luftën kundër imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik dhe revanshizmit gjerman, të luftojnë pa u lodhur për t'u dhënë fund zonave të influencës dhe të gjitha formave të tjera të sundimit amerikan e të atij revisionist sovjetik mbi vendet evropiane.

Marrëveshja sovjeto-gjermane, sado që të përpilen autorët e saj për t'i zbutur kontradiktat dhe për të nxjerrë përfitime imperialiste, nuk mund t'i japë kurrë rezultatet e dëshiruara. Është e vërtetë se ajo do t'u mbyllë disa plagë revisionistëve e revanshistëve, por do t'u hapë edhe të reja, jo më të vogla dhe jo më pak të dhimbshme. Përfundimi i traktatit nuk mund të mos shtojë penetrimin gjermanoperëndimor në vendet revisioniste, gjë që nuk mund të mos dobësojë sundimin e Moskës mbi to. Deri tani udhëheqësit sovjetikë e përdornin kartën e revanshizmit gjerman si mjet për të forcuar sundimin e tyre në vendet satelite, për mbajtjen e ushtrive të tyre, për varësinë ekonomike

etj. Udhëheqësit sovjetikë a mund t'i pengojnë klikat revizioniste t'i zgjerojnë urat me Gjermaninë Perëndimore e me Perëndimin në përgjithësi në një kohë kur ata vetë e bëjnë një gjë të tillë? A nuk do ta dobësojë kjo influencën sovjetike, a nuk do të shtohen forcat centrifugale dhe a nuk do të lindin mbi këtë bazë fërkime e konflikte të reja?

Pas afrimit sovjeto-gjerman zhvillime të reja do të lindin edhe në Evropën Perëndimore. Fuqizimi i Bonit nuk mund të mos ndeshë në rezistencën e partnerëve të tjerë të tij, të gjithë atyre që i tremben supremacisë gjermane, ashtu si nuk mund të mos ngjallë shqetësime në Uashington fakti që Boni mund të fillojë të kërkojë të luajë rolin që i takon, në bazë të vendit e të forcës në Evropën Perëndimore. Rezervimet me të cilat Parisi, Londra e Uashingtoni, për të mos përmendur të tjerët, e kanë pritur marrëveshjen, janë shumë sinjifikative.

Midis imperialistëve ekzistojnë vazhdimisht kontradiktë, të cilat nuk qëndrojnë kurrë në vend, por zhvillohen e thellohen. Secila palë kërkon jo vetëm të ruajë pozitat e saj, por edhe t'i forcojë ato në dëm të tjetrës, çdo veprim i njërsë pasohet me një kundërveprim të tjetrës.

Tani përtani amerikanët pajtohen me hapjen e Gjermanisë Perëndimore në Lindje, me qëllim që të dobësojnë Bashkimin Sovjetik si nga ana politike dhe nga ana ekonomike. Por kjo, nga ana tjetër, nuk mund të mos çojë në fuqizimin e Gjermanisë Perëndimore, e cila, si partneri kryesor i SHBA-së në NATO dhe forca kryesore goditëse e këtij pakti, përfiton edhe nga Ame-

rika për të shtuar fuqinë e vet ekonomike, politike e ushtarake. Në këto kushte imperializmi gjerman nuk mund të qëndrojë gjatë duarlidhur, këto ai dikur do t'i zgjidhë e do t'i hapë, duke shtyrë dikë. Prandaj nuk ka asnjë garanci që Gjermania Federale në të ardhmen të qëndrojë indiferente e ta lërë të qetë Amerikën të dominojë sipas qejfit në Evropën Perëndimore. Do të krijohen kështu koniunktura të reja, rrugët për kundërveprime e përleshje janë të hapëta dhe ne mund të bëhem i në të ardhmen dëshmitarë të ngjarjeve të paparashikuara.

Për sa i përket popullit shqiptar, ai hedh poshtë me vendosmëri marrëveshjen e re imperialiste të përfunduar midis Bonit e Moskës dhe e denoncon atë si një komplot të drejtuar kundër të gjitha shteteve soviane të Evropës dhe të popujve të të gjithë botës. Ashtu si deri tani, si pjesëmarrës aktiv në luftën kundër nazizmit, populli ynë do të luftojë për zgjidhjen e drejtë të problemit gjerman, do të mbrojë me vendosmëri dhe nga pozita parimore interesat sovranë të RDGJ-së. Ai do të përkrahë dhe do të bashkohet me luftën e gjithë popujve evropianë për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit të vërtetë në Evropë kundër komplateve të pabesa të imperialistëve të çdo marke e të çdo ngjyre qofshin këta, amerikanë, revisionistë sovjetikë apo revanshistë gjermanë.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i popullit», nr. 200 (6864), 22 gusht 1970

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje veprash) 1968-1970», f. 630*

NE SUKSESET E PUNES ME NJEREZIT QENDRON FORCA E IDEVE TE PARTISE

Nga biseda me patriotin Idhomene Bratko

26 gusht 1970

Vizitën e parë në familje patriotësh korçarë shoku Enver Hoxha e bëri në shtëpinë e patriotit të vjetër Idhomene Bratko, i cili kishte dalë për ta pritur në rrugë, para shtëpisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Së bashku me shoqen Nexhmije kishim menduar me kohë që, kur të vinim në Korçë, të bënim një vizitë te ti, shoku Idhomene, se je një patriot i vjetër. U gëzova kur të pashë, por nuk ke bërë mirë që dole të më presësh në rrugë, sepse je i sëmurë.

SHOKU IDHOMENE BRATKO: S'ka gjë pse dola në rrugë. Unë jam shumë i gëzuar për vizitën që pomë bëni. Ju faleminderit shumë.

Pasi hynë në shtëpi dhe u përshëndet me të pranishmit, shoku Enver Hoxha zhvilloi me ta një bisedë të ngrohtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Çdo vit që kalon, si kudo në vendin tonë, edhe në Korçë sjell ndërtime të

shumta, ndryshime të mëdha. Këtu pashë se po bëhen plot pallate të reja. Korça nuk ka mbetur pas, as në terrenin industrial. Ajo është një nga qytetet që ka marrë zhvillim të madh, këtu ka industri të zhvilluar moderne.

Gratë thonë se një nga gjërat më të bukura dhe më të mëdha që kemi bërë drejt përparimit shoqëror është dhënia atyre e të drejtave që u takojnë. Dhe me të vërtetë kështu është, se pa këto të drejta e liri që u dha atyre Partia, Shqipëria nuk do të kishte ecur kaq përpara. Pa gruan nuk shkohet në socializëm. Po të mos çlirohej ajo nga të gjitha të këqijat e së kaluarës dhe po të mos merrte pjesë aktive në të gjitha frontet e ndërtimit të socializmit, në ekonomi, në ndërtim, në sektorët e kulturës e të arsimit etj., Shqipëria nuk do të ishte kjo që është sot. Të bëhet zemra mal kur i shikon gratë dhe vajzat tona që kanë marrë në dorë dhe i drejtojnë me zotësi fabrikat dhe uzinat e reja, nëpërmjet të cilave shtojmë prodhimin, rritim të ardhurat kombëtare, zbukurojmë jetën e popullit shqiptar dhe e bëjmë atdheun tonë të pathyeshëm. Kujdesi i shtetit është i tillë që në të ardhmen do të investohen akoma më shumë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës, do të merren masa për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së vendit.

Të gjitha këto të mira u arritën në sajë të punës së Partisë dhe të gjakut që derdhën djemtë e vajzat e popullit, ndryshe nuk shporreshin pushtuesit e huaj nazifashistë dhe tradhtarët e vendit dhe populli nuk do të dilte dot në dritë, sikurse doli.

Në një kohë kaq të shkurtër, në Shqipërinë tonë të

vogël, janë arritur suksese të tilla që nuk i ka parë asnjë vend tjetër i botës. Siç e ka thënë Partia, së shpejti në të gjitha fshatrat, duke përfshirë edhe ato më të largëtat, do të ketë dritë elektrike. Ekzistojnë vende kapitaliste që kanë shumë më tepër se ne energji elektrike, po atje gjenden edhe fshatra të panumërtë që nuk kanë dritë, sepse elektrifikimi është në duart e borgjezisë dhe ajo e përdor për rritjen e fitimeve të veta.

Me fabrikat e reja që do të ngrihen, me zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, që do të sjellë shtimin e prodhimit të grurit, të misrit dhe të prodhimeve të tjera buqësore, populli do të gjejë çdo ditë më shumë mallra në treg, do të shtohet edhe më tepër mesatarja e jetës së njeriut në vendin tonë. Këto synime të mëdha të Partisë do të arrihen me punën e me përpjekjet që do të bëhen për të realizuar detyrat. Puna nuk të bën asnjë të keqe, përkundrazi të fisnikëron shpirtin, pavarësisht nga tendosja e nervave, ajo nuk të dobëson, por të bën mirë edhe për shëndetin, nuk të lë të plakesh.

Gëzuar, të na rrojë Partia dhe populli!

SHOKU IDHOMENE BRATKO: Të na rrojë Partia dhe Ju, shoku Enver, me gjithë të dashurit e zemrës.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë e heq veten edhe «korçar», se këtu kam jetuar disa vjet.

Më kujtohet se si, në Korçë, kohë më parë, lumi kalonte në mes të qytetit dhe, kur vërvshonte ndonjëherë, dilte nëpër rrugë. Në dimër njerëzit mblidheshin te mulliri dhe at Vasili hidhte kryqin në lumë, disa zhyteshin në ujë për ta gjetur dhe për të marrë shpërblimin e caktuar. Çfarë kohësh të errëta ishin atëherë,

o shokë! Duhej medoemos zhvillimi kulturor i njerëzve që të hidheshin poshtë absurditetet e fesë, por para Çlirimit s'mund të kishte përparim. Ata që udhëhiqnin vendin ishin vetë xhahilë dhe sundonin vetëm për arsyen mungesës së organizimit të popullit në luftë kundër tyre, kurse tani kohët ndryshuan, edhe «njerëzit e thjeshtë» janë të zgjuar, ata, si i thonë fjalës, të futin në ujë dhe të nxjerrin pa lagur. Çupa e muratorit tani është bërë inxhiniere, kurse babai i saj është shtylla e Partisë. Janë këta njerëz të thjeshtë që kanë mësuar të drejtojnë punët e Partisë dhe të shtetit dhe që bënë të arrihen gjithë këto ndryshime. Kur shikon të rinxjtë e Shqipërisë socialiste dhe i krahason me ata të kohës së kaluar, thua se këta të sotshmit janë si luanë, më të shpejtë, më të zotë dhe më të ditur, se kanë bërë shkollë. Këto cilësi dhe këtë forcë gjykimi që kanë të rinxjtë tani, nuk i kemi pasur ne kur ishim në moshën e tyre.

SHOQJA ALEKSANDRA TRESKA¹: Këto cilësi këtyre ua ka dhënë Partia.

SHOKU ENVER HOXHA: Partia është forca e mendimit dhe e veprimit. Gjatë këtyre viteve të vrullshme ne mësojmë shumë nga koha dhe mendimet që na lindin i vëmë në veprim. Të rinxjtë, sot, si çdo njeri, janë në lëvizje, mendojnë, veprojnë dhe kritikojnë me zemër të hapët, prandaj, kur kritikojnë ata, nuk duhet t'u zemërohem. Edhe dashuria e singertë e të rinxve, duhet përkrahur. Ju korçarët keni qenë më mirë nga të tjerët për kuptimin e drejtë të kësaj ndjenje

¹ E pranishme në këtë takim.

njerëzore. Ne u themi fëmijëve tanë: Zgjidheni vetë shoqen apo shokun e jetës, por vetëm kini kujdes që të jenë njerëz të thjeshtë, të ndershëm, të duan popullin, Partinë dhe ju. Djali nuk duhet të shohë vetëm bukurinë e jashtme të vajzës që dashuron.

Ne burrave, o shoku Idhomene, tani vetëm nami na ka mbetur se gjoja vendosim në familje pa pyetur as gruan, as fëmijët. Tani ne asgjë s'vendosim vetë, se Partia u hapi sytë grave. Për të minuar pushtetin e padrejtë të burrave në familje, ne u themi grave: «Merrini paratë dhe u lini burrave vetëm sa për të blerë cigare!». Në regjimin tonë nuk është paraja që sundon, por, megjithatë, Partia i këshillon gratë kështu, për të thyer mentalitetin e burrave. Në qoftë se burri do të shkojë për të pirë një gotë birrë, s'e ndalon njeri, por mirë është të vejë së bashku me gruan. Ne njerëzit i kemi të mirë, ata i kanë kuptuar drejt mësimet e Partisë se si t'i ndërtojnë marrëdhëniet e reja në familje.

Puna ngre pallatet dhe transformon njerëzit, pas stron ndërgjegjen e tyre. Ecja jonë përpala lidhet, në radhë të parë, me formimin e njeriut të ri me ide e me mendime të reja, me ndërgjegje komuniste, se pikërisht është ky njeri ai që i bën gjithë këto të mira që shohim e prekim çdo ditë. Kur t'i duam të tjerët më tepër se veten dhe mirësinë e secilit ta shikojmë te mirësia e të gjithëve, atëherë edhe pallate, fabrika, dyqane plot e me të gjitha të mirat etj. do të kemi gjithnjë më shumë.

Puna për formimin e mendjeve dhe për fisnikërimin e zemrave të njerëzve nuk është e lehtë. Pikë-

risht, në sukseset e kësaj pune me njerëzit qëndron forca e madhe e ideve të Partisë. Partia na mëson se në këtë punë duhet durim i madh. Kur tjetri të bën padashur një të keqe, nuk duhet marrë hak, por duhet punuar me kujdes, gjersa ai të arrijë të mendojë: «More po unë bëra gjithë këto, kurse të gjithë më përgjigjen me një kujdes dashamirës, më flasin, më qortojnë, se më duan të mirën». Kështu ai do të kthehet në rrugë të drejtë. Ne kemi shumë shembuj të tillë, që vërtetojnë se edhe kjo kategori njerëzish, me punën e Partisë, është korrigjuar dhe nga radhët e tyre kanë dalë njerëz të mirë dhe të ndershëm.

Jemi shumë të gëzuar shpirtërisht që po punojmë për një çështje të madhe. Kemi armiq që duan të na bëjnë varrin, por, kur populli është i vendosur, u thotë atyre i qetë: «Mos guxoni të shkelni vendin tonë, se jua rregulloj qejfin!» dhe ata, kur të shohin të vendosur, nuk guxojnë dot të të sulmojnë.

Së shpejti në familjet tona do të futet edhe televizori. Ti, shoku Idhomene, do t'i vesh këmbët pranë zjarrit dhe do të shikosh në televizor. Kështujeta do të bëhet edhe më e gëzueshme.

Tani, mirupafshim!

Botohet për herë të parë si-pas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

LUFTA E THEMISTOKLI GĒRMENJIT FRYMËZON GJITHË BREZAT

Nga biseda me shoqen Evdhoksi Gërmjenji¹

26 gusht 1970

Gjatë qëndrimit të tij në Korçë, shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga anëtarja e Komitetit Qendror të PPSH, Nexhmije Hoxha dhe nga kuadro drejtues të rrethit, bëri një vizitë në shtëpinë e patriotit Themistokli Gërmjenji, ku zhvilloi këtë bisedë të ngrohtë:

SHOKU ENVER HOXHA: Është gjësim i madh për ne që po bëjmë një vizitë në shtëpinë e patriotit Themistokli Gërmjenji dhe po ju takojmë ju, shoqja Evdhoksi.

SHOQJA EVDHOKSI GĒRMENJI: Unë jam shumë e lumtur për vizitën që më bëni Ju, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Kënaqem shumë që mbaheni mirë me shëndet. Me gjithë moshën e kaluar, jeni shumë mirë. Me kë rrini këtu, nuk keni ndonjë nip ose mbesë?

1 Bashkëshortja e Themistokli Gërmenjit.

SHOQJA EVDHOKSI GĒRMENJI: Kam dy mbesa të martuara, po ato janë larg, nuk mund të vijnë dot të më shikojnë çdo ditë. Unë rri vetëm në shtëpi.

SHOKU ENVER HOXHA: Pranë do të keni gjithmonë Partinë. Kur të mos jeni shumë në gjendje për t'i shërbyer vetes, Partia do të kujdeset për ju që të keni një njeri për t'ju ndihmuar dhe për t'ju shërbyer.

Sa kohë ka që nuk keni ardhur në Tiranë?

SHOQJA EVDHOKSI GĒRMENJI: Kam tre-katër vjet. Kisha menduar të vija tanë, po është rrugë e largët dhe e lodhshme për mua. Desha të bisedoj si do të bëhet për librin, se kam shkruar disa kujtime të miat, rrëth 100 faqe, që do të botohen nga ana e organizatës së gruas.

SHOKU ENVER HOXHA: Ato jepua shokëve. Po të duash, me dokumentet që ke për Themistokliun mund të bëhet një libër i plotë. Këto kujtime janë për Themistokliun apo për aktivitetin tuaj?

SHOQJA EVDHOKSI GĒRMENJI: Ato janë për Themistokliun, për veten time edhe për probleme të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni letërkëmbime?

SHOQJA EVDHOKSI GĒRMENJI: Ato që kam pasur, i kam ruajtur si sytë gjatë luftës dhe ia kam dorëzuar Arkivit të Shtetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ato dokumente nuk janë thjesht personale. Themistokliu është i të gjithë popullit, prandaj letrat e tij, lufta e tij, na përkasin të gjithëve. Personaliteti i madh i tij duhet t'i frymëzojë të gjithë brezat. Kujtimet që keni për të, t'i ruani, kurse shtëpia juaj, shoqja Evdhoksi, është mirë të

vihet nën kujdesin e shtetit. Ky do të interesohet për çdo gjë, që duhet rregulluar e meremetuar, që këtu të mbetet gjithçka, siç ka qenë dhe të kujdeset për mirëmbajtjen e saj, kurse ju, të qëndroni këtu, si zonja e kësaj shtëpie, në kuptimin e komunistit patriot, se jeni bashkëshortja e tij. Ndërtesa do të qëndrojë siç është, se këtu ka lindur e ka jetuar Themistokliu, bile, në qoftë se pranoni ju, mund të konsiderohet monument kulture, kurse më vonë këtë shtëpi do ta bëjmë muze.

Këtë shtëpi ne duhet ta ruajmë, prandaj, në radhë të parë, duhet rregulluar sa të jetë e mundur më mirë që të mos lëvizë sistemi i vjetër. Ju e kuptioni sa rëndësi ka ruajtja e kësaj shtëpie, ashtu siç ka qenë.

Ju urojmë shëndet e jetë të gjatë!

Botohet për herë të parë si-pas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

PËR DOKUMENTET ME VLERË HISTORIKE ËSHTË E INTERESUAR TËRË SHOQËRIA

Nga biseda me shoqen Androniqi Grameno

26 gusht 1970

Kjo bisedë me bashkëshorten e patriotit Mihal Grameno u zhvillua në shtëpinë e saj gjatë vizitave që shoku Enver Hoxha bëri në rrithin e Korçës.

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet, shoqja Androniqi?

SHOQJA ANDRONIQI GRAMENO: Nuk jam shumë mirë, shoku Enver, për shkak të reumatizmës.

SHOKU ENVER HOXHA: A të lejojnë mjekët të vesh në llixhat e Elbasanit?

SHOQJA ANDRONIQI GRAMENO: Mjekët nuk ma këshillojnë llixhën, se nuk jam mirë nga zemra.

Sot, shoku Enver, jam shumë e gjëzuar, më duket sikur më ka ardhur Mihali. Vizita Juaj në shtëpinë tonë do të mbetet e paharruar për mua. Nuk ka gjëzim më të madh se ky i sotmi!

Unë me Mihalin kam jetuar pak. Ndonjë orendi që kemi pasur në atë kohë, e kam shitur, por shokët

e rrëthit duan të dinë se kujt ia kam shitur, mbasi duan t'i tërheqin përsëri.

SHOKU ENVER HOXHA: Shokët kanë të drejtë. Duhet të gjendet se kujt i janë shitura.

SHOQJA ANDRONIQI GRAMENO: Mihali gjithnjë më thoshte: «Shqipëria do të ndryshojë, aq sa do të na e kenë zili të tjerët. Do të rrosh e do ta shikosh». Por, mjerisht, ai vetë nuk rrojti për t'i parë me sy gjithë këto që janë bërë sot.

SHOKU ENVER HOXHA: Në atë kohë, kur e dëgjonin Mihalin ata që nuk ishin të ngritur si ai, mendonin me habi: «Çfarë thotë ky kështu?!». Por në fakt ai e kishte drejt. Mihali ka qenë njeri i zoti, ai ishte edhe shkrimtar.

SHOQJA ANDRONIQI GRAMENO: Të gjitha koleksionet e gazetës «Koha», që ka dalë atëherë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur u larguam, i lammë për ruajtje në shtëpinë e Koço Gramenos, vëllait të Mihalit. Në të vërtetë atje janë jo vetëm koleksionet e «Kohës», por edhe shumë materiale të tjera me vlerë:

SHOKU ENVER HOXHA: Të shikohet që të gjenden këto dokumente dhe, pasi të merren, t'i jepen Bibliotekës Kombëtare.

Për këtë qëllim t'i shkruhet përfaqësisë sonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara që të interesohen nëpërmjet shqiptarëve të Amerikës për të siguruar koleksionin e gazetës «Koha» të asaj periudhe, si dhe materiale të tjera që mund të ketë atje.

Të thërritet i biri i Koços, Dhimitër Gramenoja

dhe t'i thuhet që koleksionin e gazetës «Koha» dhe materiale të tjera që ka, t'i dorëzojë në Bibliotekën Kombëtare.

Me cilin ka pasur letër-këmbim Mihali?

SHOQJA ANDRONIQI GRAMENO: Mihali më shumë letër-këmbime ka pasur me Fan S. Nolin.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga dokumentet që ka pasur Fan Noli neve nuk na kanë dhënë gjë. Me cilët shqiptarë të tjerë, brenda Shqipërisë, ka pasur korrespondencë?

SHOQJA ANDRONIQI GRAMENO: Nuk e di. Ai kishte plot dorëshkrime që ndodhen në shtëpinë e Koço Gramenos. Ka pasur një shkrim shumë të bukur. Ka pasur korrespondencë edhe me disa shqiptarë në Bukuresht.

SHOKU ENVER HOXHA: Dokumentet me vlerë historike nuk janë vetëm personale, por edhe shoqërore, sepse për ato është e interesuar tërë shoqëria.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim që gjenden në AQP*

RRITJA E RENDIMENTEVE KËRKON DIJE DHE PUNË TË PALODHUR

Fjala në mitingun e organizuar në kooperativën bujqësore të bashkuar «Skënderbeu» të Devollit

27 gusht 1970

Pas takimit dhe bisedës që pati me kuadrot drejtues të kësaj kooperative, ku u njoh me punën dhe rezultatet e arritura, mes entuziazmit, duartrokositjeve e brohoritjeve të qindra kooperativistëve nga Piluri, Bitincka e Vranishti, që qenë grumbulluar në sheshin para shkollës 8-vjeçare të Vranishtit për ta pëershëndetur e për t'u takuar nga afër me të, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Të dashur vëllezër dhe motra, shokë dhe shoqe të kooperativës së bashkuar «Skënderbeu» të krahinës së Devollit,

Unë dhe shokët e mi që erdhëm sot këtu, e ndiejmë veten jashtëzakonisht të gjuar që ndodhemi mes këtij populli trim, punëtor e përparimtar që, ashtu si mbarë populli ynë, është i lidhur përjetë me Partinë.

Ju, fshatarët devollitë, qysh në kohët e kaluara keni qenë të njohur për disa cilësi të veçanta, si për

ndjenjat tuaja patriotike e përparimtare, ashtu edhe për faktin se keni qenë punëtorë të palodhur. Si gjithë fshatarësia dhe populli shqiptar, ju e keni dashur fort atdheun dhe këtë dashuri të madhe e keni treguar edhe në punimin e mirë që u keni bërë këtyre tokave të shtrenja për çlirimin e përhershëm të të cilave, gjyshërit tanë më parë dhe, më në fund, ne derdhëm shumë gjak.

Në të kaluarën fusha e Korçës përgjithësisht dhe ajo e Devollit, në veçanti, kanë qenë nga fushat e punuara më bukur e më mirë. Por, me gjithë djersën që derdhte, fshatarësia devollite, ashtu si e gjithë fshatarësia jonë, nuk ishte dhe nuk mund të ishte e lirë, e lumtur dhe e gëzuar, pse mbi popullin shqiptar rëndonte çizmja e monarkisë feudale të Ahmet Zogut, të kapitalistëve e të fajdexhinjeve të huaj dhe vendës, të cilët shfrytëzonin barbarisht mundin dhe djersën e popullit. U desh një luftë e gjatë dhe e vështirë, siç që Lufta jonë Nacionalçlirimitare, që të sillte ditë të lumtura për popullin shqiptar, për klasën punëtore dhe për fshatarësinë e varfër.

Gjatë këtij shekulli, idetë e mëdha të Karl Marksit, të Frederik Engelsit, të Vladimir Iliç Leninit dhe të nxënësit të tij besnik, Josif Visarionoviç Stalinit, u përhapën kudo në botë dhe zunë rrënëjë të thella në zemrat e proletarëve dhe të fshatarësise punonjëse, pikërisht si fara e shëndoshë që hidhet në tokat pjetlore. Këto ide të mëdha u përhapën dalngadalë edhe në vendin tonë. Këtu, në Korçën plakë, filloi të hidhet fara e parë e këtyre ideve shpëtimtare që u përqafuan më parë nga njerëzit më të ndërgjegjshëm të popullit.

Këtu nisën puna dhe lufta për përhapjen e ideve të komunizmit në vendin tonë. Natyrisht, çdo gjë filloi me pak, por, mbasi «toka» punohej me kujdes dhe «fara» e hedhur ishte e mirë, ajo mbiu e shëndoshë. Në këto ide të pastra shpreheshin qëllimet, dëshirat dhe vullneti i fshatarëve, i punëtorëve, i patriotëve, i gjithë popullit tonë. Këto ide propagandoheshin pa marrë parasysh asnje sakrificë. Për përhapjen e tyre shumë shokë internoheshin, burgoseshin, deri edhe vriteshin, por ata e kishin marrë parasysh qysh më parë që në këtë punë sa fisnike aq edhe të vështirë, mund edhe të zhdukeshin. «Një do të bjerë nga ne, — thoshin ata, — kurse njëqind e një të tjerë do të ngrihen. Shumë njerëz, në goftë se nuk na kuptojnë sot, do të na kuptojnë nesër».

Populli do t'i kuptonte medoemos ata, sepse e njihte historinë e hidhur të vuajtjeve të të parëve nga pushtuesit e huaj otomanë, italianë, grekë e serbë. Ai i shikonte vetë, me sytë e tij, vuajtjet që shkaktonin mbretërit, agallarët, bejlerët.

Me pushtimin e atdheut tonë nga Italia fashiste errësira dhe tmerri u shtuan, mirëpo edhe dëshirat e popullit për çlirim erdhën vazhdimisht duke u forcuar. Ato u përhapën gjithnjë e më shumë në masat e gjera, sidomos kur lindi Partia. Ne, anëtarët e Partisë, djemtë dhe vajzat tuaja, e filluam luftën me besim të patundur se populli do të na ndiqte. Ne nuk ua kishim frikën as bejlerëve e agallarëve, as italianëve e gjermanëve apo armëvc të tyre, pse e dinim, ishim të sigurt se, megjithëse në fillim për rrugën e Partisë nuk mund të ishte i bindur tërë populli, shpirtërisht

ai ishte me ne, do të vinte me ne dhe së bashku do t'i mundnim armiqtë. Njerëzit e varfër, duke parë luf-tën dhe sakrificat e bijve të Partisë, nuk mund të mos i bënин pyetjen vetes përse gjithë këto bija dhe bij po vriteshin, duke deklaruar se luftonin për të shporrur të huajt dhe për të përmbysur nga pushteti tradhtarët e vendit, që toka t'u jepej fshatarëve, që pasuritë e mëdha të vendit të ishin të popullit e jo të Zogut, të tregtarëve dhe të pasanikëve, të cilët, me paturpësi, thoshin se i kishin vënë vetë me djersën e tyre. Dhe populli kështu mendoi, kështu menduat ju për shokët tanë që luftonin nëpër qytete e fshatra, në male e në fusha për të përhapur fjalën e Partisë.

Ne nuk kishim armë kur nisëm luftën, kurse armiqtë ishin të armatosur, po Partia na mësonte se, në luftë e sipër, duke u përleshur fytafytas me armiqtë, do t'u merrnim atyre armët dhe do të armatosnim me to popullin. Dhe kuptohet që, po u armatos populli, ai bëhet njëqind herë më i fortë, bëhet si dragua i pamposhtur e i tregon vendin kujdo. Ngjau ashtu siç e parashikoi Partia. Fashistët italianë e gjermanë, bejlorët dhe agallarët, që hiqeshin të fortë e kapardiseshin duke mbajtur pas vetes sejmenët, që ju rrinin juve me kamxhik mbi kokë, që ju gënjenin e ju kërcënonin etj., të tmerruar nga forca e popullit, u detyruan të mblidheshin në ceflën e arrës, gjersa i shporrëm dhe çliruam vendin.

Partia jonë, menjëherë pas krijimit të saj, ndoqi politikën e bashkimit të popullit në luftë për çlirimin e vendit. Edhe pas Çlirimit, në luftë për ndërtimin e socializmit, ajo ka ndjekur të njëjtën politikë, që është

jashtëzakonisht me rëndësi. Këtë politikë të drejtë ajo do të ndjekë vazhdimisht edhe në të ardhmen.

Partia, shokë, nuk është e përjetshme. Ajo do të zhduket një ditë kur në Shqipëri dhe në gjithë botën do të jetë ndërtuar shoqëria komuniste. Në atë fazë të lartë zhvillimi të shoqërisë, njerëzit e brezave të ardhshëm do të jenë të tërë të dashur e të mësuar, ndërgjegjja e tyre do të jetë e pastër në një shkallë të lartë, niveli ekonomik do të jetë i tillë sa çdo anëtar i shoqërisë do të marrë prej saj çdo gjë sipas nevojave dhe para para dhe askujt nuk do t'i shkojë në mendje të marrë më tepër nga sa i duhet. Ata do të veprojnë kështu pse Partia, jo për dhjetë apo njëzet vjet, po për shumë dhjetëvjeçarë do t'u japë njerëzve këtë edukatë. Njerëzit, në atë kohë, nuk do të kenë më lakminë të grumbullojnë sa më shumë sende për vete, sepse shoqëria do t'ua krijojë çdo gjë me bollëk nga puna e ndërgjegjshme e secilit dhe nga rendimenti i lartë që do të sigurojë teknika e ardhshme. Ky është komunizmi që do të vijë me siguri dhe atë do ta përgatitin njerëzit që edukon Partia.

Vazhdimisht Partia do të luftojë, në radhë të parë, për bashkimin e mbarë popullit, për çelikosjen e unitetit të tij. Në kohën e luftës ka pasur njerëz që kanë gabuar, por më vonë ata janë korrigjuar ose vetë, ose i ka korrigjuar Partia dhe sot janë bërë të mirë e të ndershëm. Të ndershëm, gjithashtu, janë bërë bijtë e tyre, sepse politika e Partisë për shpëtimin e çdo njeriu ka qenë dhe është e drejtë. Ndaj kapitalistëve, bejlerëve dhe agallarëve që e shlypnin dhe e shfrytëzonin

popullin e varfër dhe përpinqeshin ta gënjenin atë me shpifjet më të ulëta ndaj Partisë, kjo u tregua e pamëshirshme, ndërsa u tregua zemërgjcrë me njerëzit e mashtruar e të pafajshëm, të cilët nuk i ngatërroi me armiqjtë. Ajo nuk u mbajti mëri motrave dhe vëllezërve të gabuar, përkundrazi punoi për t'i sqaruar dhe i bindi me durim të madh e këmbëngulje. Kështu arriti Partia t'i bashkojë rreth saj të tërë njerëzit si një grusht.

Për politikën e drejtë të Partisë për bashkimin e popullit po ju jap edhe një shembull. Djalin tim, që ndjek mësimet në Universitetin Shtetëror të Tiranës për inxhinier elektrik, Partia e dërgoi së bashku me shokët e tij për të ndihmuar në punimet për instalimet elektrike në fshatrat e zonave malore të Veriut. Një ditë atij i takoi rasti të shkonte në shtëpinë e një malësori plak. Pasi mbaroi punë, plaku e ftoi t'i ulej pranë dhe i tregoi se ai në fillim kishte qenë kundër Partisë, por shtëpinë, ku jetonte familjarisht, e kishte ndërtuar në kohën e Partisë, mobiljet kishte arritur t'i blinte në kohën e Partisë, fëmijët ia kishte dërguar në shkollë dhe ia kishte mësuar Partia, «kurse ti, djali i Enverit, mua që kam luftuar kundër Partisë, erdhe më së fundi e më vendose elektrikun në shtëpi. Unë s'kam parë si kjo Parti që nuk i mban mëri njeriu, prandaj jam gati të futem në zjarr për të», përfundoi malësori plak.

Ja, pra, se si këtë njeri, që ishte përpara kundërshtar i vijës së Partisë, drejtësia e vijës së saj e bëri të kuqtojë ku është interes i tij. Edhe më i humburi

e ka parë dhe është bindur tani se komunistët janë bijtë e popullit që luftojnë me vepra e jo me fjalë për interesat e atdheut.

Shikoni sa pjellore u bënë fushat e Shqipërisë pas kolektivizimit të bujqësisë! Shikoni ku ka arritur industria jonë, e cila para Çlirimt nuk ekzistonte fare! Në të gjithë vendin janë ngritur fabrika e kombinate të mëdha që prodhojnë për popullin. Ishte vendosur që elektrifikimi i gjithë Shqipërisë të përfundonte vitin e ardhshëm, por kjo punë mund të mbarojë që sivjet, pra një vit më parë. Ne, me të drcjtë, mund të mburremi se do të jemi një nga shtetet e pakta në botë ku të gjitha qytetet dhe fshatrat e vendit pa përjashtim do të kenë dritë elektrike. Të gjitha këto i sollën vija e drejtë e Partisë sonë dhe puna e palodhur e popullit shqiptar.

Në të tëra anët e vendit te ne ka shkolla, arsimi 8-vjeçar është i detyrueshëm për të gjithë dhe do të vijë dita kur do të bëhet e detyrueshme edhe shkolla e mesme. Të rintjtë dhe të rejat, si dhe punonjësit e rritur ndjekin shkollat në masë, me përjashtim të pleqve, por edhe këta kanë mësuar të shkruajnë dhe të lexojnë. Këta tregues në fushën e arsimit, vërtetojnë një përparim të madh të vendit, flasin për përparimin e njeriut tonë, për ndriçimin e mendjes së tij, e cila do të shpikë gjëra të mëdha për popullin, që Shqipëria të lulëzojë akoma më shumë e më shpejt se deri tash. Fabrikat dhe uzinat, që kemi ngritur, në të ardhshmen do të punojnë edhe më mirë e do të na japin të mira materiale më shumë sesa sot. Ne do të ngremë ndërmarrje të reja ekonomike më shumë dhe më shpejt nga

këto që kemi ngritur gjer tani, do të ndërtojmë të tjera hidrocentrale, rrugë e hekurudha të reja, shkolla, shtëpi kulture dhe institucion shëndetësore. Qytetarët dhe fshatarët, punëtorët dhe kooperativistët, që Partia i mëson pa dallim, do t'i japid një hov të madh zhvillimit të atdheut tonë.

E sotmja e popullit tonë është e bukur, por edhe perspektivat janë shumë të qarta. Shqipëria është bërë një vend i fortë dhe i paprekshëm nga armiqjtë, për arsyen të trimërisë së popullit e të Partisë, e cila e ka organizuar dhe e ka edukuar atë më së miri politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht. Populli ynë është mësuar të priret kurdoherë nga e mira e nga e drejta dhe të luftojë të keqen. Të gjithë ju, të mëdhenj e të veggjël, e keni tani fare mirë të qartë ç'është dhe si duhet mbrojtur atdheu, ç'është dhe si duhet mbrojtur Partia, ç'është e keqe dhe ç'është e mirë për atdheun dhe për Partinë. Kjo është arritur, pse Partia ka punuar politikisht ditë e natë që çdo njeri te ne, kur vepron, të mendojë se puna që bën çdo ditë, qëndrimi që mban në familje, trajtimi që i bën gruas apo vajzës është apo jo i mirë, i shërben apo jo çështjes së socializmit dhe të komunizmit. Në qoftë se veprimi gjykohet i drejtë, është brenda vijës dhe i shërben çështjes së Partisë dhe të popullit, atëherë të tërë hidhen në sulm, përkundrazi, kur veprimi çmohet i dëmshëm dhe nuk është në pajtim me mësimet e Partisë, njerëzit mendohen, thellohen dhe reflektojnë drejt.

Në qoftë se dikush e ka bërë cekët punimin me shatë, shokët duhet ta kritikojnë e ta sqarojnë, t'i shpjegojnë se, po të punohet toka sikur e gjërvisht, ajo

nuk shkrifet, uji nuk ka si të futet thellë gjer në rrënjët e misrit dhe, për pasojë, megjithëse atij dita e punës do t'i regjistrohet e plotë, vlera e saj, në fakt, nuk do të jetë, për shembull, për 18 lekë, po për më pak, për arsy se nuk do të merret rendimenti i planifikuar.

Mësimet e Partisë duhen zbatuar edhe në qëndrimin ndaj vajzave. Kur vajza nga qyteti dashuron një djalë, fjala vjen, nga Bitincka, prindi s'ka përsë të shqetësohet dhe të kundërshtojë gjersa djali është njeri që e do Partinë, është bujk i mirë e i ndershëm, që bën disa qindra ditë-punë në vit e të tjera. Në raste të tillë është gabim të qortohet vajza, në të kundërtën, ajo duhet ndihmuar dhe uruar që, me atë që dashuron, të trashëgohet.

Partia përpinqet, ditë e natë, t'i edukojë njerëzit që të kuptojnë e të mendojnë drejt politikisht për të gjitha problemet. Për këtë është e nevojshme që të tërë të lexojnë gazetën e të marrin vesh ngjarjet me rëndësi politike deri edhe te marrëveshja jonë ekonomike me Greqinë e të tjera. Ka patriotë që, me të drejtë, i urrejnë reaksionarët e shovinistët grekë, bile të tërë shqiptarët i urrejnë këta shovinistë të tërbuar që cirren për tokat tona të Jugut, që ata i quajnë Vorio-Epir. Por ka ndonjë, që është i paformuar si duhet politikisht, që nuk e këndon mirë gazetën dhe nuk vete te sekretari i Partisë që ky t'ia shpjegojë qartë politikën e drejtë të Partisë, prandaj edhe gabon. Po të kërkojë sqarime, secili do të bindet kur t'i thonë se ne vërtet jemi kundër reaksionarëve të atjeshëm, mirëpo nuk mund të mbyllim sytë para faktit se ka motmot e gjysmë ose dy vjet që qeveritarët e tanishëm grekë nuk po na provo-

kojnë në kufi. Natyrisht kufitarët tanë nuk flenë, po vigjilojnë ditë dhe natë, ashtu si tërë populli ynë, pse historia ne, shqiptarët, na ka mësuar ta mbajmë barutin gjithnjë të thatë, por është fakt se qeveria aktuale greke, vetë kërkoi të bëjmë tregti me leverdi të dyanshme dhe ne ishim dakord, pse politika e shtetit tonë kurdoherë ka qenë dhe është përfqinjësi të mirë. Nësër qeveritarët grekë mund të na propozojnë përfshirë lidhur edhe marrëdhënie diplomatike. Ne edhe këtë do ta pranojmë, pse kurdoherë kemi dashur të lidhim marrëdhënic diplomatike me Greqinë, por më parë do t'u themi të heqin dorë nga pretendimi absurd se janë në gjendje lufte me Shqipërinë, me arsyetimin se gjoja Shqipëria i paska sulmuar! Greqinë nuk e kemi sulmuar ne, po Italia fashiste, me të cilën ata tani janë bërë miq të ngushtë.

Ne bëjmë një politikë të drejtë edhe me Jugosllavinë. Pas sulmit të socialimperialistëve sovjetikë kundër Çekoslovakisë, edhe Jugosllavia u kërcënuar të sulmohej nga revizionistët sovjetikë, dhe është e kuptueshme se, po të sulmohej ajo, natyrisht, rrezikohej të sulmohej edhe vendi ynë. Në atë situatë Qeveria shqiptare bëri deklaratën e njohur me të cilën njoftonte se, në rast se revizionistët sovjetikë do të sulmonin popujt jugosllavë, populli ynë do të luftonte krah përfshirë krah me këta popuj. Kjo deklaratë kishte një rëndësi shumë të madhe politike, përsye se popujt jugosllavë e dëgjuan që populli shqiptar u erdhi në ndihmë në një kohë të rrezikshme përfshirë ta, prandaj qëndrimin tonë e duartrokitën dhe nuk do ta harrojnë kurrë; populli kurrrë nuk e harron të mirën që i vjen nga një popull

tjetër mik në kohë të vështirë. Në qoftë se Titos, që është armiku ynë dhe i komunizmit, i hipën në mendje që të sulmiojë Shqipërinë, ai do të gjejë kundërshtim jo vetëm nga populli ynë, po edhe nga vetë popujt jugosllavë që nuk do ta harrojnë qëndrimin tonë.

Rezisionistët sovjetikë, para një javë, nënshkruan një marrëveshje me Gjermaninë e Bonit. Kësaj ata po i bëjnë një propagandë shumë të madhe, duke u përpjekur t'u mbushin mendjen njerëzve se jo vetëm Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Federale, por sikur tërë Evropa me këtë traktat u siguria nga një luftë e mundshme, se ky paska siguruar, gjoja, kufijtë e shteteve evropiane e të tjera. Me këtë propagandë rezisionistët sikur duan t'u thonë popujve të Evropës që të flenë rehat, se paqen ua kanë siguruar ata.

Kundër kësaj propagande mashtruese u ngrit i fuqishëm vetëm zëri i Shqipërisë. Nëpërmjet artikullit të botuar para disa ditësh në gazeten «Zëri i popullit»¹, që ju e keni lexuar, bëhet e qartë se ky traktat është një komplot për të gënjer popujt e Evropës dhe të botës pse, në fakt, ky është një traktat mes dy fuqive të mëdha imperialiste, që përpiken të sundojnë popujt e Evropës dhe jo të sigurojnë paqen dhe kufijtë e tyre. Historia vërteton se e njëjta gjë ka ndodhur edhe më parë kur fashizmi gjerman pushtoi Evropën. Të gjitha këto çështje që përmenda, duhen kuptuar drejt politikisht nga njerëzit tanë.

1 «Traktati sovjeto-gjerman — një komplot i rrezikshëm kundër popujve të Evropës dhe gjithë botës», botuar në gazeten «Zëri i popullit», datë 22 gusht 1970. Shih në këtë vëllim, f. 73.

Një çështje me rëndësi të madhe për vendin tonë është puna që duhet të bëjmë për forcimin e ekonomisë sonë socialiste. Ne duhet të përpinqemi për të pasur një ekonomi të fortë. Edhe në këtë fushë janë bërë përparrime të mëdha qoftë në industri, qoftë në bujqësi dhe po shkohet vazhdimisht përpara drejt konsolidimit. Bujqësia, si degë bazë e ekonomisë, ka rëndësi të madhe për vendin tonë, prandaj për zhvillimin e pandërprerë të saj duhet të vëmë të gjitha forcat. Varet shumë nga ju, kooperativistët, dhe nga organizata-bazë e Partisë që ju udhëheq, ngritja e rendimenteve dhe rritja e mirë e bimëve bujqësore në tokat ku kushtet janë të përshtatshme; të mos kënaqeni në asnjë mënyrë duke marrë rendimente të ulëta, që e kanë burred min në moshfrytëzimin sa duhet të mundësive të mëdha që ka krijuar Partia.

Le të qëndrojmë tani në disa çështje që kanë të bëjnë me fshatrat tuaja. Shokët e kryesisë së kooperativës më raportuan për zhvillimin çdo vit e më mirë të ekonomisë suaj të madhe kolektive. Kjo na gjeson pa masë të gjithë. Gjendja ekonomike dhe arsimoro-kulturore te ju është përmirësuar vazhdimisht, për arsyet e kuptimit të drejtë politik e ideologjik të problemeve nga ju, nga organizatat-bazë të Partisë dhe nga komiteti i Partisë i rrethit. Vlera e ditës së punës, këtu, është rritur nga viti në vit, si rezultat i shtimit të rendimenteve të bimëve bujqësore. Por, sipas mendimit tim, këto rendimente ka mundësi t'i ngrini edhe më lart, pse tash tokat tuaja janë vënë nën ujë. Ju e dini mirë se uji është një nga faktorët më të rëndësishëm për rritjen e pjellorisë së tokës, veçse ai duhet shfrytë-

zuar mirë. Me gjithë eksperiencën që keni, mos mendoni se në këtë drejtim dini çdo gjë në mënyrë të përsosur. Nuk e mohon asnjeri se ju jeni nga kooperativistët më të dalluar dhe këtë të vërtetë e tregojnë përparimet e mëdha që keni arritur, por për ujitjen keni nevojë të mësoni vazhdimisht, pse ujitja është art. Në qoftë se ju nuk do t'i viheni studimit, për të ujitur sa më mirë bimët, atëherë ujin që ju solli Partia, nuk do ta shfrytëzoni si duhet dhe, për këtë shkak, toka nuk do t'ju japë rendimentet që kërkohen.

Qeveria ka sjellë sivjet një farë hibride misri që jep një rendiment shumë të lartë deri në 150 kuintalë për hektar. Nga ky lloj misri, që keni mbjellë edhe ju këtu, qysh vitin e parë mund të arrihet një prodhim prej jo më pak se 70 kuintalë për hektar. Mirëpo, që të merret rendimenti i duhur, më parë duhet njojur ç'misër është ai, çfarë shërbimesh kërkon, si e do prashitjen, rrallimin, ajrimin, plehërimin etj. Pa i ditur këto, ai mund të japë diçka më shumë, për shembull, 50 kuintalë për hektar, por me kaq prodhim nuk duhet të jemi të kënaqur. Ne duam t'i heqim nga qarkullimi të gjitha ato lloje farërash misri që kemi përdorur dhe të mbjellim farë hibride. Kudo në Shqipëri të marrim mesatarisht 70-80 kuintalë misër për hektar, gjë që do të sjellë një përmbytje të tërë në fushën e rendimenteve të deritanishme.

Lopët tuaja dhe të të gjithë Shqipërisë, prej të cilave tanë mezi marrim 900 litra qumësht në vit, kur t'i ushqejmë me kallinjtë e njomë të këtij misri, do të na japin edhe 4 000 litra qumësht në vit, bile edhe më shumë. Kështu do të kemi më tepër edhe gjalpjë e

mish. Nga prodhimi me bollëk i misrit do të kemi mundësi të ushqejmë me të edhe pulat, të cilat do t'i shtojmë çdo vit, duke përdorur inkubatorët.

Ne nuk synojmë që, duke prodhuar misër në sasi të papara ndonjëherë gjer tanë, populli të hajë bukë misri, por të sigurojmë për të më shumë qumësht, mish, gjalpjë, vezë, pula etj. Këto që po them e që do të realizohen në një perspektivë të afërt, duhet t'ju nxitin që gjithë këtyre parcelave të mbjella me misër hibrid t'u bëni shërbim të mirë. Për farë zgjidhni kallëpet më të mira dhe, pasi t'i keni shkoqur e ta keni dezinfektuar, e futni atë të pastër në thasë, e dyllosni dhe e vendosni në depo. Pas këtij procesi të përgatitet fusha për vitin e ardhshëm dhe do të shikoni që çdo vit e më shumë do të keni rezultate më të mira. Në fushat e Myzeqesë kam parë një misër të mirë, që prodhon kallnjë të mëdhenj e të shëndoshë, rendimenti i të cilit do të arrijë deri në 120 kuintalë për hektar.

Në Ndërmarrjen Bujqësore të Llakatundit të Vlorës në një parcelë me misër ku punonte një brigadë vajzash më thanë se parashikonin të merrnin 60 kuintalë për hektar. Një Hero i Punës Socialiste, i një brigade tjeter, që ishte i pranishëm, tha se ai misër hibrid do të jepte 80 kuintalë për hektar, po brigadierja druhej të jepte këtë shifër mbasi, për të qenë brenda, e kishin udhëzuar të thoshte 60 kuintalë. «Kurse unë, shoku Enver, — tha Heroi i Punës Socialiste, — do të marr 100 kuintalë për hektar në parcelën prej 15 hektarësh atje tutje. Po ju them 100 kuintalë, — vazhdoi ai, — po kjo shifër mund të kalojë edhe më lart akoma».

Në rast se kooperativistët e kuptojnë drejt problemin, pra, në rast se ata do të punojnë mirë në këtë drejtim, Partia dhe Qeveria do të sigurojnë farë hibride të vitit të parë.

Ju keni vepruar drejt që e keni mbjellë tërë sasinë e farës që ju është dhënë. Në Lushnjë, megjithëse kishin një sasi të pamjaftueshme fare, shokët e rrerhit menduan të mos e shkelnin planin e mbjelljeve dhe me gjysmën e farës vendosën të mbillnin dyfishin e tokave. Për këtë qëllim ata organizuan mbledhje me kooperativistët dhe, pas diskutimesh, vendosën që farën ta hidhnin me dorë dhe të mbillnin me të dyfishin e tokave, megjithëse, duke vepruar kështu, ose do ta pësonin, ose do të fitonin, por fituan, se misri mbiu. Atij iu bënë me kujdes, në mënyrë të organizuar, të gjitha shërbimet dhe në këtë mënyrë, sikurse thanë shokët e rrerhit, do të marrin mesatarisht 90 kuintalë misér për hektar.

Shoqë dhe shokë, motra e vëllezër, këto që thamë tregojnë se arritja e një prodhimi të mirë varet shumë nga kuptimi dhe nga zbatimi i drejtë i agroteknikës moderne. Në këtë drejtim Partia bën të gjitha përpjekjet që kooperativistët, me eksperiencë dhe pa eksperiencë, pleq e të rinj, gra edhe burra, ta shfrytëzojnë më shumë praktikën dhe eksperiencën që kanë, por të mësojnë dhe eksperiencën e re, që merret nëpër kurse. Ato duhen organizuar në mënyrë të atillë që mësimet e dhëna në to të bëhen të kuptueshme për masën e kooperativistëve, për këtë arsyе kuadrot t'i lidhin mësimet me praktikën tuaj të përditshme në fusha e në tufat e bagëtive. Po të veprohet kështu, ju mund të

kuptoni e të përvetësoni shumë lehtë edhe shkencën më të përparuar, edhe ato dijeni që duken shumë të rënda e të ndërlikuara.

Për të pasur rezultatet e duhura në prodhimet bujqësore, duhet punuar pa u lodhur e me vullnet të madh. Të gjithë të vrashin mendjen dhe të vënë tërë aftësitë dhe përpjekjet për t'u shërbyer sa më mirë bimëve, që janë një pasuri e madhe, nga të cilat ka dobi gjithë populli, në radhë të parë, ju vetë. Në qoftë se do të veprohet kështu nga të gjithë, përparimet dhe rendimentet, që kemi arritur gjer tanë, nuk janë asgjë para atyre që do të arrijmë në një të ardhme jo të largët.

Përparime të reja do të arrihen në vendin tonë, pse populli e kuption politikën e Partisë dhe është i bindur se punon e dërsin pér të ardhmen e tij. Prandaj, shoqë dhe shokë, sipas mësimave të Partisë, u vini rëndësi bimëve të arave e, në radhë të parë, drithërave, përdorni gjer në fund e në mënyrë të kulturuar mekanizimin, ujitjen, plehrat e të gjitha shërbimet e tjera! Përpinquni të mësoni mënyrën e përdorimit të plehrave kímike, pse çdo bimë kërkon një sasi të caktuar dhe atë lloj plehu pér të cilin ka nevojë.

Me një punë të studiuar mirë përpinquni që, me anën e rritjes së rendimenteve, të kurseni fondin e tokës pér mbjellje. Në qoftë se keni caktuar, ta zëmë, një sipërfaqe toke pér të prodhuar një sasi panxhari, duke i bërë atij të gjitha shërbimet e duhura do të shikoni që sasia e panxharit do të prodhohet në më pak tokë se ajo që ishte planifikuar. Duke vepruar kështu

me disa bimë, do të kursemi tokën në dobi të misrit hibrid dhe, në vend që të mbillni 100 hektarë me këtë misër, do të mbillni më shumë. Mirëpo si kudo, edhe në bujqësi çështjet janë të lidhura, pse, duke prodhuar shumë misër, do të përmirësohet ushqimi i lopëve, të cilat do të na e shpërblejnë këtë të mirë, duke na dhënë nga 3 000-4 000 litra qumësht në vit për çdo kokë, më shumë mish etj. Planin e prodhimit bujqësor duhet ta përgatitni vetë ju, kooperativistët. Natyrisht gjatë hartimit të keni parasysh zbatimin e disa kërkesave të domosdoshme të Qeverisë, pse atdheu ka nevojë për të gjitha prodhimet bujqësore: edhe për grurë, edhe për misër, edhe për panxhar etj., me qëllim që të furnizojë me ushqime nga më të ndryshmet klasën punëtore, njëkohësisht të krijojë forcën ekonomike për të ndërtuar kanale, motopompa, hidrocentrale e të tjera. Prodhimet e tjera shtesë, domethënë tej kërkesave të Qeverisë, që do të arrihen me forcat e shumëfishuara të kooperativës, do të jenë tuajat. Kështu që e keni në dorë vetë që, siç thashë më lart, në një sipërfaqe më të paktë toke të merrni atë sasi panxhari për të cilin ka nevojë shteti dhe tokën e kursyer ta përdorni për ato prodhime për të cilat ju keni nevojë më shumë.

Shokë, vëllezër e motra, konstatoj me kënaqësi se ju jeni në rrugë të drejtë e të mbarë. Kështu si ju ecën e tërë Shqipëria. Por, krahas punës që bëjmë për ndërtimin e socializmit, edhe armatosemi dhe ne duhet medoemos të armatosemi. Ato që bëjmë për mbrojtjen e fitoreve të arritura janë shumë të domosdoshme, pse, po të mos vepronim kështu, armiku do të na zinte në

befasi. Në të kundërtën, duke u përgatitur, ai nuk na zë dot kurrë në befasi. Shtetet armike janë më të mëdha se ne, ushtritë e tyre janë, gjithashtu, shumë më të mëdha, kurse Shqipëria, edhe pse është një shtet i vogël, përbën një forcë të madhe të pathyeshme, sepse popullin shqiptar e fryshtojnë idetë marksiste-leniniste, ai është i bashkuar fort si një trup i vetëm rrëth Partisë së Punës. Shumica e popujve që janë në robëri dhe popujt e tjerë të botës, që luftojnë kundër armiqve të popujve dhe të socializmit, imperializmit e revizionizmit, sytë i kanë te vendi ynë i vogël dhe së toku përbëjmë një forcë kolosale për revolucionin botëror. Ja përse armiqjtë na e kanë frikën dhe që të na e kenë akoma më shumë, ne s'duhet të na zërë gjumi në rrugën tonë. Armatimi, punimet mbrojtëse dhe stërvitjet ushtarake të popullit nuk na pengojnë që të zhvillojmë pandërprerë bujqësinë e të marrim rendimente të larta, të ndërtojmë fabrika e uzina, hekurudha e hidrocentrale, përkundrazi, na bëjnë akoma edhe më të fortë. Prandaj mësimet e Partisë, që na ndriçojnë rrugën, populli i kuption fare mirë dhe i përvetëson me zell se është rruga e tij, është rruga më e drejtë për ndërtimin e plotë të socializmit dhe për të ecur përpara drejt komunizmit, duke luftuar njëkohësisht për të mposhtur imperializmin dhe revizionizmin modern.

Të gjithëve, motra dhe vëllezër, ju uroj nga zemra shëndet, punë të mbarë edhe suksese akoma më të mëdha në punët tuaja për forcimin e për lulëzimin e kooperativës, për të mirën dhe për lumturinë tuaj dhe të mbarë atdheut. Partia është kurdoherë në mes tuaj

dhe do t'ju japë të gjitha ndihmat për çdo nevojë që
të keni!

Rroftë Partia!

Rroftë Shqipëria!

Rrofshin kooperativistët e kooperativistet e Vrani-
shtit e të fshatrave të tjera!

Rroftë rinia e kooperativës së bashkuar «Skë-
nderbeu»!

Rrofshin gratë përparimtare të kooperativës suaj!

Përpara për ndërtimin e socializmit!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

TE NDERTOJMË ATË METODE PUNE QË U PËRSHTATET MË MIRE DETYRAVE TË KOHËS

*Nga biseda në drekën e shtruar në kooperativën
bujqësore të bashkuar «Skënderbeu» të Devollit*

27 gusht 1970

SHOKU ENVER HOXHA: Kur fola në miting, përpara popullit, u zgjata pak për misrin hibrid, për të vënë në dukje kujdesin që lypset të tregohet për të siguruar prodhueshmërinë e tij më të lartë. Besoj se në rrethin tuaj ka kuadro që t'ju ndihmojnë për të zgjedhur e për të kultivuar hibridin më produktiv, por, përveç kësaj, mendoj se duhen parë edhe kushtet e klimës dhe, sidomos, shërbimet që i duhen bërë kësaj bime. Duhet kultivuar ai hibrid që u përshtatet më shumë kushteve klimatike që keni, por ka shumë rëndësi që shërbimet të bëhen nga ana juaj në bazë të të dhënavë shkencore. Ju, me anë të kultivimit të hibrive të misrit, do t'i bëni edhe përmirësime kësaj bime. Për këtë qëllim do të shërbejnë mjaft eksperimentimet, se çdo ekonomi duhet ta studiojë vetë hibridin që i përshtatet më mirë dhe që prodhon më shumë. Ju keni eksperiencë të mirë në bujqësi dhe do t'i shërbeni

shumë bujqësisë sonë me vërejtjet që mund të keni gjatë punës për kultivimin e hibrideve të misrit, për shembull, për kohën e mbjelljes, për numrin e prashitjeve e të tjera të dhëna këto që duhen studiuar dhe duhen mbajtur shënim.

Në të gjitha kooperativat tuaja është mbjellë misri hibrid?

SHOKU ZENUN SHAHOLLARI¹: Është mbjellë vetëm në 10 kooperativa bujqësore.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjersa produktiviteti i misrit hibrid është i pakrahasueshëm me atë të llojeve të zakonshme, përse ka ngurrim në mbjelljen e tij, përse të jetë ky konservatorizëm?

Ju nuk e preferoni misrin hibrid me pretekstin se tokat tuaja kanë lagështirë, se gjoja ato nuk janë aq të përshtatshme etj., por lagështira nuk ndikon negativistët në rritjen e misrit. Misri hibrid ka natyrën e tij të veçantë, se në fillim hedh rrënjet thellë në tokë, pastaj hedh shtat, pra, forcon njëherë rrënjet, më vonë, pas një periudhe, edhe trupi i tij merr një zhvillim të madh. Konsideratat, nga niseni ju, nuk më duken me vend. Si është e mundur që nga lloji «Mati» i misrit të merrni mbi 100 kuintalë për hektar dhe nga misri hibrid të mos merrni kaq?

Për hartimin e planit pesëvjeçar ka rëndësi të madhe pjesëmarrja e gjerë e masave në diskutimin e tij. Diskutimi i masave punonjëse tani karakterizohet nga debati. Cilido, pavarësisht nëse është brigadier, skua-

1 Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës.

dërkomandant apo anëtar i thjeshtë i kooperativës, ka eksperiencën e tij, ka mendimin e tij, mbi të cilët diskuton jo vetëm për rritjen e rendimenteve, por edhe për strukturën e prodhimit dhe për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me hartimin e planit.

Planifikimi për vitin 1971 duhet të bëhet duke marrë për bazë rezultatet që kanë arritur brigadat më të mira. Por, për t'i arritur edhe brigadat e tjera këto rezultate, kërkohet që edhe ato ta organizojnë punën sipas shembullit të brigadave më të dalluara. Pasi të merren zotimet përkatëse nga të gjitha brigadat, organizata e Partisë dhe gjithë kooperativistët t'i përvishen punës për zbatimin e detyrave, sidomos, për realizimin e rendimenteve dhe veçanërisht për përmirësimin e metodës dhe të stilit në punë. Udhëheqja e kooperativës, komunistët dhe tërë brigadat e kooperativës është e domosdoshme të ndërtojnë atë metodë pune që është më efikase dhe që u përshtatet detyrave të kohës. Për këtë duhet të caktoni kohën kyç të punës për çdo parcelë dhe, për çdo proces pune, kryesia e kooperativës, nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, të kontrollojë punën e sektorëve e të brigadave apo thellësinë e punimeve që realizojnë traktoristët, zgjedhjen e farës, triorimin etj. Kur konstatohet se puna nuk është kryer sipas rregullave agroteknike, të kërkohet llogari pse nuk zbatohen ato. Ky kontroll dhe kjo ndihmë të jenë të vazhdueshëm e të kualifikuar, sepse në çdo proces pune ka disa momente vendimtare, pas të cilave duhet kapur fort dhe në kohën e duhur që të mund të sigurohet prodhimi sipas planit. Po nuk u veprua kështu, nuk mund të arrihen rezultatet.

Për këto momente, që përmenda, lypset organizuar mirë dhe me shumë kujdes edhe propaganda e Partisë për prodhimin, pse ka edhe kjo rëndësi të madhe. Propaganda e prodhimit të bëhet e shkallëzuar dhe konkrete përparrë çdo procesi pune. Për shembull, para se të fillohet nga mbjellja e domates u thuhet kooperativistëve se kjo farë që keni përparrë është farë domateje e këtij lloji, që është e bukur dhe e shijshme, mbiillet kështu ose ashtu etj. Pas mbjelljes së domates vjen koha për një proces tjetër pune, për të cilin veprohet po në këtë mënyrë. Bie fjala, për ujitjen duhet t'u flitet kooperativistëve që merren me këtë punë se ç'rëndësi ka ky shërbim për bimën dhe si duhet bërë, si duhet të jenë vijat nga do të kalojë uji, çfarë duhet ujitur etj. Edhe në fund, kur mblidhen prodhimet, duhen tërhequr konkluzionet e punës me anët e saj të mira e të dobëta dhe të mbahen shënim që nga eksperiencia të nxirren mësime. Këto janë shënimë shkencore, të dala nga eksperiencia e prodhimit.

Propaganda e prodhimit bazohet në metoda shkencore. Ajo bëhet sipas nevojave që nxjerr jeta gjatë procesit të punës. Një propagandë e tillë krijon mentalitetin shkencor te kooperativistët, prandaj, siç thashë, ajo duhet bërë shkallë-shkallë për çdo proces e duhet organizuar në mënyrë të tillë që të përfshijë e të mobili zojë të gjithë njerëzit. Çështja është që me anë të propagandës së prodhimit të futim akoma më theilë në shpirtin e njerëzve tanë metodat shkencore, që kooperativistët të mos mendojnë se bimët zhvillohen në mënyrë të vetvetishme dhe spontane. Në qoftë se e zhvillojmë propagandën ashtu siç duhet, ne do t'i

bëjmë kooperativistët të kuptojnë se në disa momente të caktuara, mund t'u imponojnë bimëve atë zhvillim që duan dhe që, në mënyrë metodike, e ka vërtetuar eksperienca. Çështja është që puna me bimët bujqësore të organizohet para se atyre t'u kanoset rreziku dhe jo pasi të jenë dëmtuar, duke pritur sa të përmirësohet moti. Këto gjëra, shokë, janë të mundshme të bëhen.

Duke i dhënë përgjigje idesë që hodhi në bisedë e sipër armiku i kamufluar i Partisë e i popullit Mihallaq Ziçishti, që në rrethin e Korçës sipërfaqja e caktuar nga plani i shtetit për t'u mbjellë me luledielli të mbillej me duhan, me pretekstin se këtu kishte një përvojë të mirë në kultivimin e kësaj bime dhe se siguroheshin më shumë të ardhura, shoku Enver Hoxha tha:

Siq e dini, ne kemi deficite në prodhimin e yndyrave, të cilat i plotësojmë duke importuar nga jashtë sasi të konsiderueshme. Ne duhet të bëjmë përpjekje jo vetëm për ta eliminuar këtë deficit, po në të njëjtën kohë të përpinqemi ta shtojmë konsumin e yndyrave për popullatën. Rruja e vetme më e mirë për zgjidhjen e këtij problemi është shtimi i prodhimit të lulediellit, prandaj është dhënë direktiva që të mbillet kjo bimë. Duhani vërtet ka të ardhura më të mëdha për kooperativistët, por ai nuk na zgjidh problemin e vajit dhe të gjalpit. Ne nuk jemi kundër mbjelljes së duhanit, po duhet të sigurojmë edhe yndyrat, prandaj shteti dhe kooperativat bujqësore t'i bëjnë llogaritë mirë e me kujdes në këtë drejtim.

Ju, që keni fuqi punëtore të mjaftë, shpirt revolucionar, mundësi për ujitje, për mekanizime dhe për

bujqësi të përparuar, duhet të merrni patjetër rendimente të larta, rendimentet e ulëta nuk ju lejohen.

Shoku Gjikë T., kur punonte në aparatin e Komitetit Qendror, na informonte se në Devoll kishte shumë krahë pune, kurse zona e Oparit po boshatisej, se po e braktisnin fshatarët, prandaj, propozonte ai, duhet të merren masa nga ana e Partisë. Tani, që Gjika ka ardhur këtu, nuk i thotë më këto fjalë.

Ne duhet të bëjmë një propagandë të shëndoshë për të populluar malësinë dhe të kujdesemi që t'u sigurojmë disa kushte të përshtatshme materiale familjeve të reja që krijohen me anën e martesave në zonat malore, si dhe atyre që shkojnë prej këndejej për të punuar e për të jetuar në ato zona të bukura. Njerëzit shkojnë atje, se e duan malësinë, se edhe atje kanë drithën elektrike. Në malësi do t'u dërgojmë edhe radio e televizor.

Ta ngremë këtë gotë për shëndetin tuaj, shokë! Ju uroj që të korrni gjithmonë suksese më të mëdha! Të na rrojë Partia që na udhëheq në rrugë të lavdishme!

Plani i ardhshëm pesëvjeçar do të jetë shumë i ngjeshur, por i realizueshëm në të gjitha drejtimet, si në industri, ashtu edhe në bujqësi, në ndërtim etj. Hidrocentralin e Vaut të Dejës do ta mbarojmë në afatin e duhur, por do të ndërtojmë dhe të tjera edhe më të mëdha, që do të kenë perspektivë shumë të madhe.

Edhe për naftën e gzin perspektivat janë, gjithash, të mëdha, se vendi ynë është zonë naftëmbajtëse dhe gazmbajtëse. Ka të dhëna që mund të nxjerrim gaz dhe nga zonat në thellësi të detit, gjë që do t'i hapë perspektiva të mëdha ekonomisë së vendit tonë.

Nga perspektiva e përpunimit të gazit dhe të naftës, do të vijë dita që ne të mos e eksportojmë më naftën brut, por të përpunuuar. Sa më shumë të punojmë, aq më shumë do të sigurojmë rezerva gazi, gjë që do të na japë mundësi për sigurimin e lëndës së parë, për kthimin e gazit në prodhime të ndryshme. Por, për këtë qëllim, gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm do të ngrihen fabrika që lypin shumë investime. Realizimi i të gjitha këtyre parashikimeve reale e të mundshme do të na hapë perspektiva të mëdha.

Rëndësi të madhe për ekonominë tonë, kanë edhe zhvillimi dhe përpunimi i mëtejshëm i mineraleve se pa këto nuk bëhet dot asgjë. Veprat industriale që janë ndërtuar deri më sot janë më të vogla nga ato që do të ngrihen në pesëvjeçarin e ardhshëm, dhe në pesëvjeçarët e tjerë ne do të ecim akoma më përpara në zhvillimin e industrisë së vendit. Për këtë do të shfrytëzojmë mirë burimet minerare të vendit, se, po të mendojmë që t'i sjellim nga jashtë mineralet që na nevojiten, do të vareshim nga të tjerët.

Shqipëria ka burime të mëdha kromi dhe mineralesh të tjera me vlerë, të cilat kërkohen kudo. Ne kemi vendosur të zhvillojmë më tej industrinë minerare, por, sot për sot, është e zorshme t'i shfrytëzojmë plotësisht të gjitha burimet. Partia përpinqet që, tani për tanit, të sigurojmë vetëm sasitë industriale dhe pastaj zhvillimin në perspektivë. Ajo do të kujdeset që të gjitha ato fabrika e uzina që na nevojiten, t'i parashikojë drejt në plan dhe, pa iu rritur mendja, të marrë masa për ndërtimin e tyre në mënyrë frontale, jo me specialistë të huaj, por me punëtorët dhe inxhinierët tanë.

Sukseset që kemi arritur deri më sot në industri dhe në bujqësi, janë inkurajuese për të punuar e për të prodhuar jo vetëm me këtë nivel që kemi arritur e që duhet ta çmojmë, por në një nivel akoma më të lartë. Lypset ta ngremë më shumë rendimentin e misrit. Tani kemi krijuar kushtet për të investuar akoma më tepër në bujqësi, me qëllim që kjo degë e rëndësishme e ekonomisë sonë të ecë shpejt e të bëhet me të vërtetë e përparuar. Po, për ta zhvilluar atë, duhet të ngremë akoma më lart nivelin agroteknik, të ujtim sa më shumë që të jetë e mundur sipërfaqe të mbjella, të shtojmë sasinë e plehut etj., me qëllim që të shtojmë prodhimin bujqësor. Të kemi parasysh që të përdorim më tepër plehun organik të lopëve, mbajtja e të cilave ka shumë leverdi, se përveç qumështit, gjalpit dhe mishit ato na japin edhe plehun. Por, që të mbahet lopa, duhet prodhuar misër me bollëk. Edhe në grurë të synojmë të marrim mesatarisht nga 25-27 kuintalë për hektar dhe të arrijmë kështu shpejt nivelin e vendeve më të përparuara¹.

Tani do të ndërtojmë më shumë edhe shtëpi banimi, me qëllim që të strehojmë një pjesë të mirë të popullit, pastaj do të vazhdojmë të ndërtojmë çdo vit normalisht për të përballuar edhe nevojat e shtimit natyror të popullsisë.

Nuk imagjinohej që elektrifikimi i gjithë vendit të mbaronte brenda një kohe kaq të shkurtër prej 4 vjetësh. Tani do të krijohen mundësi më të mëdha edhe

1 Në vitin 1983 rendimenti i grurit në shkallë republike ishte 30,8 kuintalë për hektar.

për ndërtimin e fshatrave, prandaj të bëjmë përpjekje që të prodrojmë më shumë çimento. Për këtë do të na duhet të ngremë të tjera fabrika çimentoje, si dhe të dyfishtojmë prodhimin e fabrikave ekzistuese të çimentos në Fushë-Krujë e në Elbasan. Ne kemi në plan të ndërtojmë edhe Portin e Vlorës.

Të gjitha këto që përmenda do të bëhen, por ne do të gjejmë kohë për t'u marrë edhe me bujqësinë, edhe me ushtrinë. Veç duhet ta kemi të qartë se, pa u hedhur në sulm dhe pa marrë zjarr hovi i masave punonjëse, këto punë të mëdha nuk bëhen.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TY TË KEMI KOMUNIST VETERAN

Nga biseda me shokun Miha Lako¹

27 gusht 1970

SHOKU ENVER HOXHA: Si je me shëndet shoku Miha? Ke kohë që nuk na ke ardhur nga Tirana. Përse nuk vjen? Ty të kemi komunist veteran dhe gëzohem shumë që je mirë, megjithatë të këshilloj të mbash regjim.

SHOKU MIHA LAKO: Mirë jam, shoku Enver. Për Partinë do të bëj ç'është e mundur, deri në fund.

SHOKU ENVER HOXHA: Sot, paradigm vajta për vizitë në Kooperativën Bujqësore në Vranisht. Kryetari dhe sekretari i organizatës-bazë aty më raportuan për gjendjen dhe për sukseset që kanë arritur. Në takim merrnin pjesë edhe kryetarët e kooperativave bujqësore të zonës së Devollit dhe mësova se të tërë kanë suksese. Devolli është vend pjellor. Tani janë krijuar mundësi të mëdha edhe për ujitjen, për të cilën kjo zonë ka qenë keq. Edhe çështja e plehut ishte marrë në dorë mirë

¹ Gjatë ditëve që ishte në Korçë, shoku Enver Hoxha i bëri një vizitë në shtëpi shokut Miha Lako.

nga të gjitha kooperativat. Kudo në çdo fushë të jetës po bëhen përparime. Korça është zbuluar mjaft, kudo të shikon syri pallate shumë të bukura.

Sa gjuhë të huaja di ti, shoku Miha? Bibliotekën e paske plot me libra, paske edhe volumet e veprave të Leninit.

SHOKU MIHA LAKO: Di gjashtë gjuhë të huaja. Unë kam pasur dëshirë që të mësoj sa më shumë gjuhë dhe jam përpjekur që edhe fëmijët e mi të mësojnë gjuhë të huaja, vazhdimisht u kam thënë se gjuhët e huaja janë të nevojshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu duhet. Ne përpinqemi që fëmijët tanë të mësojnë shumë, por të jenë edhe të thjeshtë e popullorë.

Kur Miha ishte ambasador në Rumani, më thoshte mua: «Rumunët nuk janë komunistë, nuk janë marksistë-leninistë». Unë i thosha: «Po dale, more Miha!», por ky përsëri ngulte këmbë.

SHOKU MIHA LAKO: Këto, natyrisht, Jua thosha Juve. Unë kisha konstatuar që ata ishin shumë të lëkundur. Atje mua të gjithë më quanin stalinist.

SHOKU ENVER HOXHA: Stalini duhej mbrojtur para tyre. Në kohën e Stalinit Bashkimi Sovjetik ishte në gjendje shumë më të mirë ekonomike nga ç'është tani. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë janë të gjithë borgjezë dhe kapitalistë. Sa vdiq Stalini, të gjithë nxorën fytyrën e tyre të vërtetë.

SHOKU MIHA LAKO: Ne, megjithëse vend i vogël, qëndruam të patundur.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne ua punuam fare mirë dhe ata nuk patën çfarë të na bëjnë. Ne jemi të fortë.

Ata e dinë këtë, prandaj na e kanë frikën. Megjithatë duhet të forcohem që do ditë që të mbrojmë vijën tonë të drejtë.

Ç'libra lexon tani?

SHOKU MIHA LAKO: Kam lexuar të gjithë librat ideopolitikë që kanë dalë. Me lexime merrem sidomos në periudhën e dimrit, se tani, në verë, edhe çoku dal nga pak. Si romane lexoj ato të Viktor Hygoit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po romanin e Alqi Kristos¹ e ke lexuar? Atë mund ta lexosh, që të ndihmosh me ndonjë vërejtje.

SHOKU MIHA LAKO: Po, në atë roman ka disa gjëra që bien në sy, për shembull, rasti ku bëhet fjalë për pjesëmarrjen e rinisë në mbledhje. Mua më kujtohet se në atë mbledhje, që përshkruhet në roman, ka marrë pjesë thuajse gjithë rinia korçare.

SHOKU ENVER HOXHA: Pjesëmarrja e rinisë ka qenë kryesore në lëvizjen tonë komuniste dhe punëtore; të rinxjtë kanë bërë një punë të madhe aty.

Vërejtjet që do të kesh për këtë roman, mundësisht i dërgo në aparatin e Komitetit Qendror ose në ndërmarrjen e botimeve «Naim Frashëri» me qëllim që, kur të ribotohet ky libër, të kihen parasysh edhe ato. Ti mund të bësh vërejtje jo vetëm për ç'janë shkruar në roman, po edhe për të parashtruar fakte të reja për zgjerimin e tij.

SHOKU MIHA LAKO: Vërejtje kam edhe për maketin e historikut të qarkut të Korçës. Nuk më duket e drejtë që qysh në fillim të këtij maketi të thuhet se

1 Romani «Shkëndijat».

në formimin e Partisë ka pasur shumë vështirësi nga fryma e grupit, që sundonte veçanërisht në Grupin Komunist të Korçës dhe se tradhtia e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos ka lidhje me gabimet e këtij grupei.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë lufte ke bërë ti dhe anëtarët e tjerë të Grupit Komunist të Korçës kundër Niko Xoxes e Sotir Vullkanit, ti e di më mirë se unë.

Grupi i «Të Rinjve» që filloi të formohej si fraksion në gjirin e Grupit Komunist të Korçës, ashtu edhe grupet e tjera, kishin elementë me prirje të theksuara trockiste dhe anarkiste. Me gjithë pengesat që u hasën për çështjen e unititetit të komunistëve, krijimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë, ishte një domosdoshmëri historike, ndërsa arsyetimi sipas të cilit Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, si korçarë, qenkan frysmezuar në tradhtinë e tyre nga Grupi Komunist i Korçës, nuk është i drejtë.

Grupi Komunist i Korçës ka pasur shokë të mirë, komunistë të vendosur e të sakrificës edhe në kohët më të rrezikshme. Ti na pate mësuar të tillë, shoku Miha, se ne ty të kishim si të parë¹, prandaj duhet të ecnim atëherë në rrugën tënde.

SHOKU MIHA LAKO: Duhej të bëheshim shembull në sakrifica, shoku Enver.

1 Në librin «Kur lindi Partia (Kujtime)», f. 40, shoku Enver Hoxha shkruan: «Te Miha, bolshevik i patundur e i guximshëm, dyqani i të cilit qëndronte kurdoherë hapur, shkonim këshilloheshim e shkëmbenim mendime edhe për vepër prime që duhej të bënim në shkolla me nxënësit, me mësuesit, me profesorët, me të cilët unë isha caktuar veçanërisht të punoja».

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ata që nuk ishin komunistë të vërtetë, historia i ka hedhur tej.

SHOKU MIHA LAKO: Në atë kohë, ne që luftonim kundër armikut, na quanin anarkistë. Niko Xoxe dhe Zef Mala thoshnin se, sikur edhe «Vetë Stalini të vijë, nuk do të pranojmë që tani fillimin e luftës kundër armikut».

SHOKU ENVER HOXHA: Partia u formua dhe u rrit, por krijimi i saj nuk u arrit pa përpjekje, pa luftë dhe pa sakrifica. Duke pasur parasysh këtë luftë, duhet të punojmë e të ecim akoma edhe më përpëra me devotshmëri, me trimëri e me guxim.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

NGA ZEMRA JEMI E DO TË JEMI PËRHERË PROLETARE

Nga biseda me shokun Nesti Gambeta¹

27 gusht 1970

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se ju gjejmë. Si je me shëndet, shoku Nesti, familjen si e keni?

SHOKU NESTI GAMBETA: Mirë se erdhët. Të gjithë jemi mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nesti është një nga shokët komunistë më të vjetër, që në kohën kur bënim përpjekje për formimin e Partisë.

Mundimet dhe sakrificat e komunistëve dhe të patriotëve për çlirimin e atdheut nuk vajtën kot, se në zjarrin e luftës, u krijuua Partia Komuniste e Shqipërisë. Pas Çlirimit të vendit, u hodhën themellet e ndërtimit të socializmit, që sot ecën përpara me vrull. Dikur ne kemi qenë të varfër, s'kishim asgjë, kurse tani kemi çdo gjë, por nga zemra, vazhdojmë të jemi e do të jemi përherë proletarë.

¹ Kjo bisedë u zhvillua në shtëpinë e komunistit të vjetër Nesti Gambeta, të cilit shoku Enver Hoxha i vajti për vizitë.

SHOKU NESTI GAMBETA: Shokët që shkruajnë historikun e Korçës më kërkuan t'u tregoja ndonjë kujtim personal për Ju, shoku Enver. Unë u thashë se më kujtohet se si njëherë më erdhi në dyqan një profesor i ri i Liceut të Korçës që kishte nevojë për këpucë. Kur ma prezantuan, më thanë që e kemi shokun tonë, se është komunist.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur bëra këpucët, mbaj mend që më pyete se mos i doja «tango». Të tjera kohë qenë atëherë kur ishim djem të rinj, të mbushur plot entuziazëm.

SHOKU NESTI GAMBETA: Që në atë kohë Ju, shoku Enver, ishit me gjykim të thellë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ky është djali juaj? Ku je me punë ti?

SHOKU VLADIMIR GAMBETA: Jam inxhinier në Ndërmarrjen e Peshkimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Për ne ka vlerë të madhe profesioni i peshkatarit. Në Korçë dhe në Gjirokastër peshku njihet mirë. Në Gjirokastër, për shembull, lumi i Drinos shfrytëzohet. Edhe në Korçë ekziston kjo traditë. Ju kujtohet kur znim peshk në Dunavec?

Çështja është që të popullojmë me peshk edhe ligonet e rezervuarët e kooperativave bujqësore. Atje ku ka rezervuarë, të punojmë që të krijojmë pellgje me peshk. Kooperativistët, për të plotësuar nevojat e tyre, të merren vetë me shtimin dhe me gjuetinë e peshkut.

Duhet ta zhvillojmë shumë sektorin e peshkimit, se peshku ka rëndësi të madhe për ushqimin e popullit. Për perspektivën e peshkimit në të ardhmen ne duhet të investojmë, por, më parë, të përpinqemi të për-

gatitim kuadro dhe vaporë-frigoriferë të mëdhenj, që, në perspektivë, të peshkojmë cdhe në oqeane.

Unë i thashë Nexhmijes se dëshiroj t'u bëj një vizitë në shtëpi shokëve të vjetër që t'i takoj dhe të gëzohem bashkë me ta.

SHOQJA AFROVITI GAMBETA: S'ka gjësim më të madh për ne nga ky i sotmi. Kishim kohë që nuk Ju kishim takuar shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Shtëpinë e paskeni rregulluar.

Është kënaqësi e madhe kur shikon këto pallate, apartamente dhe dyqane të bucura që janë ndërtuar e po ndërtohen këtu, në Korçë. Korça është bërë një qytet i madh, me një industri dhe bujqësi të përparuar, që do të zhvillohet e do të zbulurohet akoma më shumë. Kjo nuk do të thotë që rrugicat e vjetra të prishen, ose të ndryshohen, sepse njerëzit kanë shumë kujtime, të embla dhe të hidhura, që lidhen me to dhe, natyrisht, do t'u pëlqejë të shëtitin si më parë nëpër to. Më kujtohet kur ditëve të diela dilnim këtyre rrugëve për shëtitje.

Disa ndërtesa mendoj se duhen ruajtur në gjendjen që kanë qenë. Për meremetimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të caktojmë fonde. Pallate të reja do të bëhen plot, por edhe disa ndërtesa të vjetra duhet t'i mbajmë ashtu siç janë që, kur të vijnë nipërit tanë, ta zëmë në vitin 2170, të thonë: Shih sa bukuri kanë këto ndërtesa! Partia ka bërë shumë mirë që i ka ruajtur të paprekura këto vlera.

Kur vijnë në vendin tonë të huaj, mahnitën me bukurinë arkitekturore të Beratit dhe të Gjirokastrës.

Si këto dy qytete është pak a shumë edhe Korça, me bukuritë e të mirat e saj.

Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimave të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

KURRË TË MOS CENOHET DIKTATURA E PROLETARIATIT

Nga biseda me shokun Abdurrahim Bilbili¹

27 gusht 1970

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se të gjetëm, shoku Abdurrahim! Kënaqem që gjëzon shëndet të plotë.

Ti ke qëndruar burrë trim dhe punëtor edhe në kohët më të vështira, kur Partia luftonte me armiqtë dhe tradhtarët. Armiqtë kurrë nuk të mposhtën.

SHOKU ABDURRAHIM BILBILI: Kemi Partinë që na udhëheq. Të rroni sa malet tonë, shoku Enver! Asnjëherë nuk kam qenë kaq i lumtur sa sot që më erdhët Ju për vizitë.

SHOKU ENVER HOXHA: Partia jonë është parti e komunistëve, e punëtorëve dhe e fshatarëve, është parti e tipit të Leninit dhe të Stalinit.

SHOKU ABDURRAHIM BILBILI: I gjithë populli ynë ka besim të madh te Partia, se ato që ka thënë, ajo i ka bërë realitet. Kam katër vjet që kam mbushur

¹ Veteran i Luftës Nacionalçlirimtare, në atë kohë kryetar i këshillit populor të Lagjes nr. 5 të Korçës.

moshën për të dalë në pension, me gjithatë përsëri do të punoj. Këto forca m'i jep besimi i madh që kam te Partia.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, Partinë dhe popullin i kemi të fortë.

Në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të bëjmë shumë gjëra të tjera, do të kemi një industri akoma më të fuqishme se sot, do të zgjerohet industria e naftës dhe e gazit. Ne do të ndërtojmë hidrocentrale të tjera, më të mëdha, që do të prodhojnë shumë energji elektrike, do të ngremë fabrika të tjera të reja. Përparime do të kemi edhe në fushën e bujqësisë e të industrisë së minierave. Të gjitha këto vepra të mëdha, do t'i bëjmë me duart dhe me djersën tonë.

Çdo gjë bëhet me kohë dhe me durim. Ka edhe njerëz që, pa e menduar gjendjen ku ishim, i duan të tëra të mirat përnjëherë.

Si i keni punët këtej? Keni ndonjë ankesë apo kërkesë për të parashtruar? Ka popullatë të madhe lagjja juaj?

SHOKU ABDURRAHIM BILBILI: Lagjja jonë ka popullatë të madhe dhe shumica përbëhet nga kurbatë, të cilët martesat i bëjnë vetëm midis njëri-tjetrit dhe kanë shumë fëmijë. Ne, si këshill i lagjes, përpinqemi shumë për t'i bindur që të futen në punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Partia duhet të bëjë një punë të madhe dhe sistematike për edukimin e tyre, se edhe ata janë një pjesë e popullatës.

Edhe në Gjirokastër ka pasur kurbatë, ata ishin njerëz shumë të mirë, punëtorë, të ndershëm dhe shumë të pastër. Një pjesë prej tyre kanë qenë edhe në

luftë. Kurbatët atje punojnë si në bujqësi, edhe në punët e tjera, për shembull, në Fabrikën e Duhanit, të Lëkurëve etj. Këta, të këtushmit, janë arixhinj endacakë, që merrnin ariun e zbutur dhe shkonin bashkë me të në Devoll ose në zona të tjera, ku shisnin shporta, kanistra etj. Kudo që venin, këta ngrinin çadra dhe nuk janë mësuar të qëndrojnë në apartamente. Prandaj ka rëndësi puna bindëse për vendosjen e tyre nëpër apartamente dhe për futjen e tyre në punë, veçse duhet pasur parasysh që të trajtohen mirë e me kujdes. Këta të konsiderohen njëloj si të bardhët.

Në vendosjen e kuadrove të rinj në punë, duhet ta shikojmë shumë origjinën e tyre, se ky problem ka të bëjë me sigurimin dhe me të ardhmen e pushtetit tonë popullor. Kështu duhet t'i vlerësojmë njerëzit që e ardhmja e atdheut të jetë në duar të sigurta. Atij që është me origjinë të mirë dhe punon në rrugën e Partisë, t'i besojmë. Ata që janë shokë të luftës, kanë meritat e veta që, natyrisht, nuk mund të mos ndikojnë edhe në të ardhmen e fëmijëve të tyre. Nuk përjashton ndonjë rast që edhe një djalë i një babai të mirë të çoroditet e të ndërrojë rrugë. Në qoftë se ndodh kështu, atëherë Partia të përpinqet ta sjellë në rrugë të mirë. Bijtë e shokëve komunistë, të ndershëm dhe patriotë, duhet t'i vëmë në vendin që u takon në Parti dhe në pushtet, se ata, si dhe shumë të tjerë, janë besnikë për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë.

Në qoftë se një i ri, është bir ballisti, por qëndron mirë, merr pjesë aktive në aksionet e rinisë dhe vërteton me punë se nuk është në rrugën e babait, Partia e inkurajon që të vazhdojë rrugën e drejtë. Këtij djali

i duhet thënë hapur se ti je i mirë, por komunist ose, ta zëmë, oficer nuk mund të jesh, sepse, që të bëhesh i tillë, duhet të kesh garanci politike partie. Një të riu të tillë edhe në mbledhje, po t'i thuhet se je i biri i një babai të keq, ai do të ngrihet e do të thotë se vërtet është bir ballisti, por politikisht qëndron kundër babait, atëherëjeta dhe biografia e këtij njeriu duhet të karakterizohen nga puna e ndershme për ndërtimin e atdheut socialist.

Edukimi politik i të rinjve me origjinë të mirë shoqërore është më i lehtë se edukimi i të rinjve, ballarët e të cilëve ishin armiq. Është më shumë zor të edukohen bijtë e armiqve, por megjithëkëtë edhe edukimi i tyre nuk është i pamundur. Njerëzit kanë të meta, por ne duhet të punojmë që t'i ndreqim. Por, kur vjen ndonjë që nuk ka të drejtë dhe kërkon të përfitojë nga demokracia e pushtetit tonë, le t'i kujtojmë se demokracia jonë është formë e diktaturës së proletariatit. Ndaj këtyre njerëzve nuk duhet të jemi liberalë. Çdo gjë duhet të bëhet me takt dhe me durim, por kurrë të mos cenohet diktatura e proletariatit. Ne u plakëm, Abdurrahim, por Partia përtërihet. Partia i rrit dhe i edukon me kujdes të rinjtë dhe, për cilësitë e mira që kanë, i pranon në gjirin e saj.

SHOKU ABDURRAHIM BILBILI: Po shikojmë me gjësim që fëmijët tanë janë bërë të mirë, saqë mund t'ua lëmë stafetën në dorë plot besim. Ata duhet të mësojnë prej eksperiencës sonë që të shkojnë akoma më përpara.

SHOKU ENVER HOXHA: Të mësojnë nga eksperiencia e popullit dhe gradualisht t'u japim atyre besim,

duke i ngarkuar në detyra me përgjegjësi që t'i mësojmë e t'i përgatitim si kuadro të Partisë dhe të shtetit. Zëvendësimi i kuadrove të vjetër me të rinj duhet bërë vazhdimisht. Për ripërtëritjen e kuadrit njerëzit lypset të mos jenë ambiciozë, ndryshe nuk do të ketë vazhdimësi në Parti e në pushtet.

SHOKU ABDURRAHIM BILBILI: Në pushtet ne kemi vënë edhe të rinj, edhe të kaluar nga mosha. T'i vëmë të rintjtë në krye dhe ne t'i mësojmë. Po të na pyesin dhe po të na kërkojnë ndihmë, ne pleqtë do t'u përgjigjemi dhe do t'i ndihmojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo vetëm po të na pyesin, por e kemi për detyrë t'i mësojmë vazhdimisht. Pushteti ynë popullor është organizuar në mënyrë të atillë që asnjëri, qoftë person i emëruar apo i zgjedhur, gjer në instancat më të larta, nuk i shpëton kritikës dhe dhënies llogari para popullit. Në qoftë se një i ri, për shembull, zgjidhet nga populli deputet në Kuvendin Popullor dhe nuk pyet e nuk konsultohet me një aktivist të organizatës së Frontit ose me një komunist të vjetër për hallet që ka populli, shoku i vjetër që ka eksperiencë, t'i thotë: «Pa hajde pak këtu e na thuaj se çfarë mendon ti për zgjidhjen e këtij problemi». Me këtë rast i riu do t'i japë mendimin e tij. Në qoftë se ka mendim të drejtë, atëherë të dy të bien dakord, në të kundërtën, t'i shpjegohet arsyaja pse nuk del mirë kështu; në këtë mënyrë fillon debati, gjersatë bien dakord për zgjidhjen e drejtë të problemit. Në rast se nuk merren vesh midis tyre, atëherë është Partia ajo që do ta zgjidhë problemin, se aktivisti i Frontit ose komunisti i vjetër ka të drejtë të shkojë

edhe te sekretari i Komitetit të Partisë, bile t'i shkruajë edhe Komitetit Qendror, në qoftë se mendon që rrathi nuk e ka drejt. Komiteti Qendror, pasi të dëgjojë të dyja palët, e zgjidh çështjen drejt e përfundimisht, si-pas vijës së Partisë dhe interesave të popullit.

SHOKU ABDURRAHIM BILBILI: Të na rroni mijëra vjet shoku Enver! Si Ju nuk ka njeri!

SHOKU ENVER HOXHA: Unë jam një ushtar i Partisë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQF

KËTU MËSUAM SHUMË GJERA TË MIRA

*Nga biseda me kuadrot drejtues të Ndërmarrjes
Bujqësore të Dvoranit në rrëthin e Korçës*

28 gusht 1970

*Pasi u takua dhe u përshëndet me të pranishmit,
e mori fjalën shoku Enver Hoxha.*

Si e keni zgjidhur problemin e banimit të punonjësve tuaj, duke ndërtuar banesa këtu në ndërmarrje, apo ata çdo ditë venë e vijnë nga qyteti në fshat?

SHOKU PALO THEMELI¹: Pjesa më e madhe e punonjësve nuk banojnë këtu, ata janë nga qyteti, por nga Korça e gjer këtu udhëtojnë me autobusë urbanë. Për nënrat me fëmijë kemi ngritur edhe çerdhc ku të çojnë fëmijët.

SHOKU ENVER HOXHA: Besoj se ka shumë gra që venë e vijnë nga qyteti.

SHOKU SPIRO GURI²: 40 për qind e punëtorëve te ne janë gra. Autobusi urban na i sjell me vonesë

1 Në atë kohë drejtor i ndërmarrjes bujqësore.

2 Në atë kohë sekretar i organizatës-bazë të Partisë.

punëtorët, aty nga ora 8⁰⁰ ose 8^{:30}, gjë që i detyron ata ta fillojnë punën me vonesë.

SHOKU PALO THEMELI: Ne vazhdimisht kemi ndërhyrë për këtë problem, por nuk e kemi zgjidhur dot përfundimisht. Kur ngremë zérin, na vijnë disa ditë me kohë, pastaj vijnë përsëri me vonesë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë problem duhet ta zgjidhni, se nuk është mirë që punëtori të nisë nga puna kur fillon të nxehtit. Ai duhet ta fillojë herët punën, në vapë puna nuk ka rendiment.

Mirë do të ishte, shoku Palo, sikur të na informoje pak për gjendjen e ndërmarrjes.

Pas këtij informacioni, shoku Enver Hoxha u interesua të dinte për një sërë problemesh.

SHOKU ENVER HOXHA: Mollën «Golden deliciosa» në cilin sektor e keni mbjellë? Keni koleksion të ri dhe keni filluar të shton edhe në bllokun poshtë?

SHOKU PALO THEMELI: Në bllokun poshtë kemi llojin «Jonafani» që ka leverdi ekonomike. Ka disa lloje që nuk antifekondohen.

SHOKU ENVER HOXHA: Blloqet i keni ndarë sipas varieteteve, apo i keni të përziera?

SHOKU PALO THEMELI: Çdo bllok e kemi të ndarë sipas varieteteve, por afër njëri-tjetrit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku e keni gjetur këtë lloj molle të kuqe?

SHOKU PALO THEMELI: Kjo ka qenë në vend, po pak e përhapur. Ne do ta përhapim më shumë, se tani kemi mjaft ckzemplarë.

Veç mollëve kemi, si pemë të dytë, kumbullën

dhe si lloj më kryesor kumbullën «Tropojane». Këtu janë edhe disa lloje të mira qershish.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga cilat lloje, nga qershitë e mëdha kokërrzeza?

SHOKU PALO THEMELI: Jo, ne kemi një lloj qershie tjetër që është e kuqe, kokërrmadhe, e fortë dhe shumë e shijshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Përpara në Gjirokastër nuk kishte qershi, ato vinin atje nga Leskoviku dhe na dukeshin të jashtëzakonshme, megjithatë ato ishin vërtet shumë të mira, kokërrzeza, piqeshin shpejt dhe me to bëhej reçel i mirë.

SHOKU PALO THEMELI: Për reçel kemi një lloj tjetër qershie shumë të mirë.

SHOKU PETI SHAMBLLI¹: Po qershitë pranë Fabrikës së Birrës si ju duken? Atje ka disa varietete të mira që janë të forta dhe të mëdha.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'sasi frutash eksportoni dhe a mund të bëhet më shumë në këtë drejtim?

SHOKU PALO THEMELI: Në të vërtetë nga viti në vit ne e kemi rritur sasinë e frutave për eksport, po këto kërkojnë të zgjidhim më mirë disa probleme, siç janë: niveli kulturor i punëtorëve, studimi i përhapjes së sëmundjeve të ndryshme të pemëve që të mund t'i luftojmë në kohë, të shtojmë akoma edhe mjetet e mekanizuara gjatë spërkatjes së pemëve etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Po në fushë nuk keni më sipërfaqe toke ku të mbillni pemë të tjera?

SHOKU PALO THEMELI: Territori i ndërmarrjes

1 I pranishëm në këtë takim.

sonë është i përzier me tokat e kooperativës së Dvoranit, ku janë rreth 50-60 familje. Mirë do të ishte që ata të futeshin në ndërmarrje, megjithëse do të na dalë pastaj problemi i çerdhes, i kopshtit dhe i shkollës.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa ditë-punë bëjnë kooperativistët këtu dhe nga sa marrin për ditë-punë?

SHOKU PALO THEMELI: Tani për tani ata marrin nga 8-9 lekë për ditë-punë, prandaj nuk kanë asnjë kundërshtim që të futen në ndërmarrje.

Ne kemi edhe fidanishten që na furnizon, e cila është e pavarur nga ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse, nuk varet nga ndërmarrja juaj fidanishtja?

SHOKU PALO THEMELI: Ajo me urdhër nga lart është menduar të jetë ndërmarrje më vete, megjithëse ne ishim të mendimit të bënte pjesë si një sektor yni.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk është aspak e drejtë të ndajmë fidanishten e mollëve nga ndërmarrja që ka si kulturë kryesore këtë pemë dhe aq më tepër kur që të dyja janë pranë njëra-tjetrës. Fidanishtes, duke qëndruar më vete, i duhet të ketë më vete depot, zyrat, planovikët, punëtorët etj. Po përse t'i kenë të gjitha këto të vëçanta, kur mund t'i keni të përbashkëta? Është e domosdoshme të shikohet kjo çështje. Kush e bën planin e kësaj ndërmarrjeje?

SHOKU PALO THEMELI: Planin fidanishtja e bën vetë, ajo konsultohet edhe me ne, por më në fund vendos vetë për çdo gjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Pak më parë ju na folët për nevojat që keni për shtesë të mekanikës. Na-

tyrisht, ju i dini nevojat, po edhe mundësitë që kemi, prandaj, duke qenë modestë, mund të na thoni çfarë shtesash ju duhen.

SHOKU PALO THEMELI: Më tepër na duhen traktorë të lehtë dhe motopompa.

SHOKU ENVER HOXHA: Po prashitjen si e bëni?

SHOKU PALO THEMELI: Punimet kryesore prashitëse i bëjmë me traktorë me zinxhir, kurse punimet rreth kurorës, me krahë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga ndërmarrja e fidanishtes furnizoheni ju me fidanë?

SHOKU PALO THEMELI: Po, nga ajo.

Krasitjen dhe plehërimin e pemëve ne i kemi bërë në vjeshtë. Këtë proces pune e kemi eksperimentuar 3-4 vjet rresht dhe kemi krijuar bindjen se në vjeshtë, duke e kombinuar edhe me plehërimin, ajo na jep rezultate më të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Si e zbatoni këtë eksperiment në mollën e llojit «Starking» që është kapriçioze?

SHOKU PALO THEMELI: Çdo brigadë dhe skuadër ka bllokun e vet të rendimentit të lartë. Punën e kemi organizuar duke e kombinuar me gara midis punëtorëve. Punëtorët merren me ujitjen dhe me kryerjen e të gjitha shërbimeve të tjera që u duhen bërë pemëve që kanë në patronazh.

SHOKU ENVER HOXHA: Figurojnë këto të dhëna në planifikimin e ri?

SHOKU PALO THEMELI: Po. Në bazë të të dhënavë që kemi arritur, ne kemi bërë dhe parashikimet për planin e ri.

SHOKU ENVER HOXHA: Duke u bazuar në të dhënët që keni arritur, sa keni parashikuar ta rritni mesataren e prodhimit në pesëvjeçarin e ardhshëm, në krahasim me të tanishmin?

SHOKU PALO THEMELI: Kemi parashikuar që në vitin 1971 të marrim një rendiment mesatar prej 32 kg fruta për rrënje, megjithëse kemi blloqe ku marrim nga 150-170 kg për çdo pemë. Në vitin 1969 kemi marrë mesatarisht 27 kg për rrënje, duke përfshirë në këtë shifër edhe pemët e reja, që në fillim, natyrisht, nuk japidin prodhimin maksimal.

SHOKU ENVER HOXHA: Po shokët e Ministrisë së Tregtisë që merren me eksportin, në ç'mënyrë i mbajnë lidhjet me ju? Vijnë ata këtu të interesohen dhe të bisedojnë me ju? Ç'perspektivë ju hapin ata për mollët? Mos kanë më tepër leverdi të eksportohen të freskëta, apo më mirë të përpunuara, si reçel dhe komposto dhe në ç'kohë është më mirë të eksportohen? Ju kanë dhënë të tilla mendime, me qëllim që edhe ju të mendoni për industrializimin e tyre?

SHOKU PALO THEMELI: Shokët e eksportit interesohen më shumë për mollët «Starking» dhe «Jonafani», sesa për llojet e tjera, të cilat nuk kërkohen. Kur vjen koha e pjekjes, këto dy varietete na i marrin menjëherë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kush e bën seleksionimin e frutave para se të kalojnë në eksport?

SHOKU PALO THEMELI: E bëjmë vetë ne, duke iu përmbajtur rreptësisht standardeve që na janë caktuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk ka dy çmime për to?

SHOKU PALO THEMELI: Jo, ka vetëm një çmim.

SHOKU ENVER HOXHA: Në prodhimin e parë mendoj të ketë 2 dhe 3 standarde. Në qoftë se ne arrijmë të furnizojmë të parët tregjet e jashtme, domethënë i nxjerrim mollët kur në vendet e tjera nuk janë pjekur akoma, ato mund t'i shesim 2-3 standarde.

Sa krerë lopë ka Dvorani?

SHOKU PALO THEMELI: Ka rreth 80 krerë, 40 i kemi ne këtu, që bëhen gjithsej 120 krerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa kuadro të lartë keni këtu?

SHOKU PALO THEMELI: Kemi 3 agronomë të lartë dhe 6 kuadro të mesëm, ndërsa të tjerët janë të paspecializuar. Shumica e brigadicerëve janë të rinj, po me shkollë të mesme teknike.

SHOKU ENVER HOXHA: Po transportin tuajin e keni apo jo?

SHOKU PALO THEMELI: Për transport nuk na ka lindur shumë nevojë, sepse prodhimin, si për eksport, ashtu edhe pér konsum të brendshëm, vijnë na e marrin këtu.

SHOKU PETI SHAMBLLI: Para pjekjes dhe derisa vilen, shumë mollë bien përdhe. Në qoftë se i mblidhni edhe këto, ka shumë leverdi, se përpunohen.

SHOKU PALO THEMELI: Ne që pardje kemi fillouar t'i mbledhim, por mollët e rëna para vjeljes, i çojmë në konservim, mbasi ato nuk janë të mira pér treg. Ne kujdesemi që t'i vjelim ato në kohën e duhur, se, po ta vonojmë këtë proces pune, prodhimi pëson dëm të madh. Prandaj në kohën e vjeljes mobilizojmë edhe pensionistët. Këtë problem mendoj se e kemi zgjidhur mirë. Pas vjeljes fillojmë të merremi me se-

Ieksionimin e mollëve. Për të shmangur dëmet eventuale, frutat i futim në transhe dhe i mbulojmë me kashtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga sa dimë, në Francë bëjnë një lloj pijeje të mirë nga mollët, që quhet sidër, bile në provincën e Bretanjës mollët i përdorin vetëm pér këtë qëllim. Përse të mos e bëjmë edhe ne atë pije? Mos duhet parë çështja që edhe kokrrat që bien para se të piqen, të përpunohen e të bëhen sidër? Ne duhet të bëjmë përpjekje të gjejmë procedurën teknologjike të sidrës dhe ta prodhojmë.

SHOKU PALO THEMELI: Kur fillojnë të prishen mollët, nc vëmë punëtorët pér t'i pastruar, por kjo pu-në vonon. Po ta kishim punishten këtu pranë, do të kishim leverdi më të madhe, se mund të bënim edhe sidër, edhe lëng frutash.

SHOKU ENVER HOXHA: Sot ne mësuam këtu shumë gjëra të mira.

Po ti, shoku Nesti mund të na thuash ndonjë gjë pér gjuetinë, se e di që e ke pasion atë.

SHOKU NESTI TËRPO¹: Gjahu i shkurtës është pakësuar shumë, shoku Enver, tani ato po vijnë çdo vit e shumë pak, se janë shfarosur. Lepuri në përgjithësi paraqitet mirë. Zonat e gjuetisë janë të pasura me lepuj dhe gjahtarët tregojnë kujdes, duke e gjuajtur këtë kafshë vetëm në kohën që lejohet.

SHOKU ENVER HOXHA: I kanë kuptuar drejt gjahtarët masat kufizuese që janë vënë pér mbrojtjen e gjahut?

SHOKU NESTI TËRPO: Në përgjithësi gjahtarët

1 Në atë kohë përgjegjës sektori.

e kanë kuptuar se gjahu është një pasuri e madhe që duhet mbrojtur. Thëllëza e malit është edhe kjo një pasuri për vendin. Nga kontrolllet që janë bërë, del se ato tani kanë filluar të shtohen, për arsyen se vrasja e tyre është kufizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Si zbatohen dhe si kontrollohet zbatimi i rregullave për ndalimin e gjue-tisë në periudhat e caktuara?

SHOKU NESTI TËRPO: Kjo varet, në radhë të parë, nga ndërgjegjja e vetë gjahtarëve, sepse organet pyjore që ushtrojnë kontrollin, nuk mund të ndjekin pas çdo njeri që del për të gjuajtur. Megjithatë nuk mund të mohohet se mbrojtja e gjahut varet shumë edhe nga organizimi i mirë i këtij shërbimi nga organet pyjore.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur rojtari dëgjon krismën e armës dhe vete në vend për të shikuar, e di ai që më parë nëse gjahtari e ka apo jo autorizimin përkatës për të gjuajtur?

SHOKU NESTI TËRPO: Autorizimet i lëshon drejtoria e pyjeve, e cila i njofton që më parë rojtarët për ditën dhe vendin ku do të venë të gjuajnë ky ose ai gjahtar ose grup gjahtarësh të pajisur me autorizimin përkatës.

SHOKU PETI SHAMBLLI: Kontrolli bëhet edhe në formë masive.

SHOKU NESTI TËRPO: Në rrëthin tonë ka edhe 50 inspektorë vullnetarë, të cilët na informojnë vazhdimisht për këtë problem.

SHOKU ENVER HOXHA: Po derri ka filluar të shtohet?

SHOKU NESTI TËRPO: Ky ka qenë shumë i rrallë në disa zona, kurse tani në zonën e Goricës ka filuar të shtohet mirë. Por atë c vrasin shumë në jug, se, kur bie dëborë këtej nga ne, duke qenë atje më ngrohtë, derrat venë andej. Edhe sorkadhja paraqitet mjaft mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju uroj suksese në punën tuaj!

*Botohet për herë të parë me
shkurtim sipas shënimave të
mbajtura në këtë takim
që gjenden në AQP*

BASHKË ME DETYRËN SI MAMI TË JENI EDHE AGJITATORE TË ZJARRTA TË PARTISË

Letër drejtuar 40 vajzave të rrethit të Elbasanit që mbaruan të parat shkollën trevjeçare të mamive

12 shtator 1970

Të dashura shoqe,

Këndova me kënaqësi të veçantë letrën që më dërguat, në të cilën pashë atë dashuri të zjarrtë që vlon në zemrat tuaja të reja për Partinë tonë të shtrenjtë, qartësinë e sinqueritetin tuaj për vijën e saj të drejtë, optimizmin revolucionar për jetën tonë socialiste dhe pasionin e madh për profesionin tuaj të nderuar.

Fjalët që më çuat në letër sollën tek unë një tog lajmesh të mira, që më gjëzuan shumë.

Në radhë të parë dëshiroj t'ju përgëzoj me gjithë zemër për gatishmërinë që treguat duke shkuar të shërbeni atje ku e kërkojnë interesat e atdheut. Ky është një shembull i lartë i atij patriotizmi të shkëlqyer që karakterizon mbarë rininë e vendit tonë, në flamurin e kuq të së cilës është shkruar si një betim «Atdheu mbi të gjitha!». Ju, të dashura shoqe, që jeni brumosur me mësimet e Partisë, keni zbatuar pikërisht

këtë betim, duke vënë mbi gjithçka interesat e përgjithshëm të popullit, pasi e dini që atje gjen garancinë e plotë edhe lumburia personale. Prandaj janë përtu lavdëruar gatishmëria dhe vendosmëria juaj, që shkuat t'i shërbeni popullit me ndërgjegje të lartë revolucionare gjer në skajet më të largëta të rrethit.

Në letër më njoftoni, gjithashtu, se çdo kooperativë bujqësore në Elbasan, për ndër të zgjedhjeve të reja të pushtetit dhe të gjykatave popullore, ndërtoi me forcat e veta shtëpinë e lindjes. Kjo është një punë tjetër e bukur, një fitore e re në vargun e gjatë të fitoreve që ka arritur populli patriot i atij rrethi. Shumë njerëz të kaluar nga mosha, kur shohin këtë kujdes të Partisë për nënën, nuk mund të mos kujtojnë ato kohë të vështira kur gruaja lindte në shtëpi pa asnje ndihmë mjekësore nga ana e shtetit dhe foshnja binte në prehrin e ndonjë gjysheje analfabete, e cila edhe kërthizën ia priste me ndonjë gërshërë të ndryshkur. Ç'të bënte e shkreta gjyshe! Ajo, duke mos pasur mundësi të tjera, aq sa dinte, aq edhe bënte. Në ato kushte të prapambetura, për faj të regjimeve antipopullore, të cilave nuk u bëhej aspak vonë se si do të lindnin gratë e popullit, shëndeti i lehonës dhe i fëmijës së saj të shtrenjtë ishte vazhdimisht në rrezik.

Por tani kohët kanë ndryshuar. Partia, duke e quajtur njeriun kapitalin më të çmuar, ka punuar, përveç të tjerave, për të lehtësuar sa më shumë jetën e gruas dhe tani arritëm që deri në çdo fshat të kesni shtëpinë e lindjes. E ku ka më mirë për një grua shtatzënë sesa të shkojë për të lindur gjënë më të dashur të saj, fëmijën, në maternitet? Atje është

mamia, jeni ju, vajzat e mia të dashura, që mësuat për këtë qëllim, duke kryer tre vjet shkollë. Por bashkë me detyrën që keni si mami, ju duhet të jeni njëkohësisht edhe agjitatore të zjarrta të Partisë. Me punën tuaj të palodhur ju do t'i mësoni gratë me normat higjieno-sanitare që duhet të zbatojnë para, gjatë dhe pas lindjes, do t'i udhëzoni si ato të vijnë herë pas here të këshillohen me ju apo në konsultore, si të kujdesen për shëndetin e fëmijës, për ushqimin e regjimin e tij dhe ajo që ka rëndësi është se do të punoni për ta bindur çdo grua shtatzënë që të vijë të lindë në maternitet, pikërisht aty ku shërbeni ju.

Sa shumë më gjenuat me lajmin se ju pritet fëmijët e parë dhe, bashkë me të qarat e tyre, patë edhe buzëqeshjen e nënave! Ju keni të drejtë të ngazëlloheni e të krenoheni për këtë, pasi në shtëpitë e lindjes përtërihetjeta e njeriut. Aty lindin filizat e rinj, të cilët do të rriten e do të lulëzojnë në trungun e gjallë të jetës sonë, lindin ata që nesër do të punojnë e do të drejtojnë në atdheun e tyre të shtrenjtë dhe do ta shpien përpara revolucionin tonë fitimtar, që udhëheq me lavdi Partia jonë e dashur.

Duke përfunduar, ju uroj shëndet e suksese në detyrën tuaj të re aq shumë fisnike!

Ju përqafoj si vajzat e mia
Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»
nr. 220 (6884), 15 shtator 1970*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Mbi problemin
e gruas», f. 405. Tiranë, 1973*

NË UNITETIN E PLOTË PARTI-POPULL-PUSHTET QËNDRON FORCA JONË

Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës elektorale
Nr. 219

18 shtator 1970

Të dashur shokë dhe shoqe,
Vëllezër dhe motra,
Të rinj dhe të reja,

Çdo takim me popullin është për mua një gjëzim shumë i madh, një shkollë e vërtetë revolucionare, pasi te populli ne gjejmë gjithmonë mësimë të mëdha, mendimin e tij krijues, gjejmë energji të pashtershme, që na jatin forca të reja për të luftuar e për të punuar. Në mënyrë të veçantë unë jam shumë i gjzuar kur vij në këtë zonë elektorale e takohem me zgjedhësit e mi, sepse këtu vij jo vetëm si biri juaj, si vëllai juaj, si shoku juaj, por edhe si kandidati dhe përfaqësuesi juaj në organin më të lartë të pushtetit tonë popullor.

E çmoj shumë nderin e madh që më bëtë duke më propozuar kandidat për deputet në Kuvendin Popullor

në këtë lagje të kryeqytetit, me të cilën më lidhin përjetë kujtime të paharruara. Në këtë lagje u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë, kjo nënë e madhe dhe e urtë që na rilindi, na dha dorën dhe na tregoi rrugën si të luftojmë e si të fitojmë mbi armiqjtë. Partia u formua nën mbrojtjen tuaj, përpala syve tuaj vigjilentë, që na ruanin nga ndjekjet e spiunëve, të milicëve e të fashistëve. Shtëpitë tuaja ishin për ne gjithmonë të hapura. Në dhomat tuaja të thjeshta hynin, vepronin dhe dilnin, sikur të ishin në shtëpitë e tyre, revolucionarë të pavdekshëm, si: Gogo Nushi, Qemal Stafa, Misto Mame, Vasil Shanto, Vojo Kushi e shumë e shumë të tjerë, me të cilët unë kam bashkëluftuar në këtë lagje e në qytetin e Tiranës.

Më lejoni, të dashur shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra, t'ju falënderoj nga zemra dhe t'ju shpreh mirënjohjen e thellë për besimin që treguat duke më propozuar kandidat për deputet në Kuvendin Popullor. Kjo dashuri e zjarrtë dhe e singertë është dashuri për Partinë e lavdishme të Punës, për zemrën dhe trurin e popullit tonë, e cila, edhe mua, ashtu si ju, më rriti, më edukoi e më mësoi si të luftoj, si të mendoj e si të punoj si revolucionar i pandarë nga populli ynë trim, punëtor e liridashës.

Me këtë rast dua t'ju siguroj se, nën udhëheqjen e Partisë, do të vë të gjitha forcat e mia për të merituar plotësisht besimin tuaj, do të jem kurdoherë ushtar i vendosur i Partisë, shërbëtor besnik i popullit për lumburinë e atdheut tonë të dashur, për çështjen e socializmit e të komunizmit, për çështjen e marksizëm-leninizmit e të revolucionit.

Është e shtata herë që populli ynë zgjedh në mënyrën më demokratike përfaqësuesit e tij të vërtetë në organin më të lartë, në Kuvendin Popullor. Karakteristikë e përbashkët e të gjitha fushatave elektorale në vendin tonë ka qenë uniteti i çeliktë i popullit rrëth Partisë. Si një trup i vetëm ai ka votuar për kandidatët e Frontit Demokratik, pasi ai e di që këta janë bijat dhe bijtë e tij nga më të mirët dhe, duke votuar përtat, ka votuar për ndërtimin e socializmit, përlirinë dhe përvavarësinë e atdheut, përbegatinë dhe lulëzimin e tij, përvijën marksiste-leniniste të Partisë sonë. Partia është e sigurt se ky unitet i çeliktë do të shkëlqejë akoma më shumë edhe në zgjedhjet e 20 shtatorit, kur populli ynë, me ndërgjegje të lartë politike revolucionare, me pjekurinë dhe urtësinë që e karakterizon, do të japë votën për pushtetin e tij, që lindi nga gryka e pushkës së popullit dhe përfaqëson vullnetin, dëshirat dhe aspiratat e tij dhe përtë cilin ne japim, siç thotë populli, «jo vetëm votën, por, po ta lypë nevoja, edhe kokën».

Shokë dhe shoqe,

Më 20 shtator të gjithë njerëzit e Shqipërisë sociale që kanë arritur moshën e votimit, gra e burra, të rinj e të reja, pa asnjë përjashtim e në mënyrë direkte, do të venë të votojnë për njerëzit që duan të dërgojnë në këshillat popullorë, në gjykatat popullore dhe në Kuvendin Popullor.

Kjo, në esencë dhe në procedurë, nga pikëpamja

e të drejtave dhe e detyrave të njeriut në një shoqëri të avancuar dhe progresiste, përfaqëson formën më demokratike të zgjedhjeve. Kjo mund të ngjasë, ngjet e zhvillohet vetëm në një vend socialist si yni, në një vend të diktaturës së proletariatit, ku populli është në fuqi dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste siç është Partia e Punës e Shqipërisë.

Fushata e zgjedhjeve te ne merr çdoherë e më mirë përpjesëtime të mëdha politike dhe shprehje gjëzimi dhe entuziazmi të madh popullor. Veçanërisht kësaj radhe që zgjedhjet për të gjitha instancat e pushtetit, si të bazës ashtu edhe të Kuvendit Popullor, duke përfshirë edhe ato të gjykatave popullore, koïncidojnë në një kohë, ato përbëjnë një ngjarje të madhe kombëtare për shumë arsyë.

Fushata e zgjedhjeve përfaqëson një pjesë të aktivitetit të vrullshëm revolucionar politik, ekonomik e kulturor të mbarë popullit, të Partisë së tij që e udhëheq, të Frontit Demokratik, të pushtetit të tij popullor, të organeve të diktaturës dhe të të gjithë njerëzve që janë zgjedhur në to në format më demokratike nga populli.

Edhe gjatë fushatës së zgjedhjeve populli punonjës bën bilancin e punës së tij krijuese, vë në dukje anët e mira dhe anët negative të punës dhe të njerëzve, të institucioneve, të formave e të metodave të punës, kritikon dobësitë e të metat, adopton, përkrah përparimin, shtyn përpara, dërgon në pushtet njerëzit e progresit e të revolucionit të pandërprerë. Këtë populli e bën në mbledhje të gjera, të hapëta, të lira, pa as më të voglën pengesë e druatje. Ai ka fituar tanimë të drejtën dhe

pjekurinë politike për të kritikuar të gjithë ata që gabojnë, për t'i dënuar të gjithë ata që bëjnë faje dhe për të lavdëruar e për të inkurajuar ata që punojnë mirë dhe është i ndërgjegjshëm për forcën e vërtetë të demokracisë së shumicës, të demokracisë sonë proletare.

Fushata e zgjedhjeve sivjet koincidon me mbarimin e planit të katërt pesëvjeçar që vendosi Kongresi i 5-të i Partisë. Parti e popull në unitet dalin ballëlart, pasi detyrat që vuri Kongresi u realizuan me sukses dhe në këtë fitore të madhe janë shkrirë edhe djerësa, pjekuria e sakrificat e të zgjedhurve të popullit në instancat e ndryshme të pushtetit.

Rezultatet e zgjedhjeve, që pa dyshim do të jenë të shkëlqyeshme, do të mbushin radhët e pushtetit tonë popullor e të gjykatave popullore me njerëz të vjetër në këtë punë dhe me të rindë, të cilët do ta fillojnë për herë të parë punën me detyra të reja madhështore të planit të pestë pesëvjeçar, që do të përcaktojë Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili do të mbahet në vitin 1971¹.

Karakteri thellësisht demokratik i zgjedhjeve në vedin tonë është një tipar dallues i regjimit tonë socialist. Ndryshe, krejt ndryshe ndodh në regjimet kapitaliste, ku flitet shumë për demokraci e bëhen votime. Ka vende kapitaliste që quhen «të përparuara» dhe që pretendojnë se në to bëhen votime «demokratike». Por në disa prej tyre gratë vetëm dje mezi e fituan të drejtën e votës, në disa të tjera ato nuk kanë akoma të drejtë të votojnë; ka vende kapitaliste ku kjo e drej-

1 Ky Kongres i zhvilloi punimet nga data 1-7 nëntor 1971.

të kufizohet tek ata që kanë një të ardhur të caktuar në vit, gjë që do të thotë se atje votojnë vetëm borgjezët, ata që kanë të ardhura të mëdha; në disa të tjera nuk votojnë ushtarët, të gjallët, kurse në listat e votimit përfshihen edhe të vdekurit; ka edhe nga ato ku, siç bëhej te ne në kohën e Zogut, votohet me zgjedhës të dytë. Ekzistojnë edhe vende ku mekanizmi i votimeve është rregulluar në një mënyrë të atillë që nuk fiton kandidati që ka marrë shumicën e votave të zgjedhësve, por fitojnë kandidatët e partive që përfaqësojnë kapitalin monopolist.

Me këto metoda pseudodemokratike kapitali monopolist synon mbajtjen në skillavëri të plotë të popullit, varfërimin e masave punonjëse, mbajtjen në injorancë dhe shfrytëzimin e tyre sa më të thellë e barbar, me këto metoda kapitali synon të krijojë dhe të forcojë çdo ditë e më shumë mjete dhe forma të ndryshme për të shtypur, për të çoroditur e për të shpartalluar rezistencën dhe luftën e masave punonjëse kundër shfrytëzimit kapitalist.

Drejtimi i shtetit, i ekonomisë, i kulturës dhe i ushtrisë në vendet kapitaliste ka vetëm etiketat e jashtme «demokratike», pasi në fakt atje sundon thundra e egër e kapitalit, ligji i tij i xhunglës. Atje ka «demokraci» për të pasurit, po jo për të varfrit. Këta duhet t'u nënshtrohen ligjeve të kësaj lloj «demokracie», e cila, natyrisht, përpinqet të krijojë ndër ta përshtypjen se «demokracia» e tyre e votës «popullore» që zgjedh, për shembull, senatorët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është «demokracia më e përsosur në botë». Por realiteti në këtë vend të madh kapitalist

është krejt ndryshe: asnë nga senatorët amerikanë, qofshin këta të partisë së «elefantit» apo të «gomarit», domethënë të partive «demokrate» apo «republikane», jo vetëm nuk janë nga gjiri i shtresave punonjëse, por ata s'janë as edhe nga çdo lloj fraksioni të borgjezisë. Ata dalin nga ato fraksione të shtresave të larta të borgjezisë monopoliste që përgatiten posaçërisht në universitete të veçanta për të ardhur në vendet kyç drejtuese të shtetit kapitalist amerikan. Kjo është ajka, aristokracia e kapitalit, *de jure* dhe *de facto*. Ministrat dhe senatorët amerikanë që vijnë në organet e larta të shtetit, janë njëkohësisht udhëheqës ose anëtarë në kë-shillat e konsorciumeve dhe të bankave të mëdha të vendit. Deri tani statistikat amerikane nuk tregojnë për asnë rast që ndonjë senator o ministër ta ketë prejardhjen e vet jo më nga klasa punëtore që nuk mund të bëhet fjalë, por as nga shtresat e mesme të borgjezisë. Në këtë mënyrë është ndërtuar atje i gjithë trupi i piramidës shoqërore, në të gjitha drejtimet e saj. Kuptohet lehtë për çfarë regjimi e për çfarë «demokracie» e votimesh «të lira» mund të bëhet fjalë në këtë vend.

Në vendet e tjera kapitaliste format e jashtme mund të mos janë plotësisht të njëllojta me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por në brendi, në esencë dhe në praktikën e gjërave janë njëlloj.

Në parlamentin anglez ka edhe laburistë, të cilët janë përfaqësues të tredunioneve. Ata hiqen si përfaqësues të klasës punëtore angleze, por në realitet bëjnë pjesë në aristokracinë punëtore, që është në shërbim të plotë të kapitalit dhe të imperializmit an-

glez. Kjo parti, «Lejbër parti», gjoja në opozitë, vjen edhe në pushtet, por në realitet nuk është aspak klasa punëtore që vjen në pushtet, pasi në pushtet atje është kurdoherë kapitali anglez, ndërsa laburistët janë administratorët servilë të kapitalit dhe të imperializmit anglez, ata janë një «shtresë e teknokracisë politike» në shërbim të kapitalit monopolist.

Në Francë dhe në Itali është e njëjta gjë, por në këto dy vende gjoja demokracia merr forma më të theksuara. Në parlamentet italiane e franceze vijnë edhe «komunistë», në qeveri marrin pjesë edhe «socialistë», formohen shpesh qeveri të përziera me lloj-lloj partish me plot etiketa «demokratike», por në realitet të gjitha janë kapitaliste, borgjeze. Tani revisionistët francezë dhe italianë, që predikojnë marrjen e pushtetit nëpërmjet procedurave parlamentare, në mënyrë paqësore dhe në koalicion me borgjezinë kapitaliste, përpinqen të futen edhe ata në qeveritë e ardhshme për t'i shërbyer kapitalit. Por me gjithë këto ndryshime, ashtu sikurse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe në këto vende sundon kapitali monopolist, prandaj këto lloj ndryshimesh, të cilat për naivët jepin përshtypjen e njëfarë «demokracie», në qoftë se klasa punëtore dhe masat punonjëse të këtyre vendeve nuk i analizojnë, nuk i thellojnë dhe nuk i luftojnë me vendosmëri, atëherë ato mbeten vetëm iluzione të kota që, duke u hedhur njerëzve hi syve, krijojnë mundësinë dhe lejojnë deri në njëfarë shkalle e në disa momente kyç t'i zgjatetjeta sundimit të kapitalit.

Është e qartë se një hendek i madh ndan botën tonë socialiste nga bota kapitaliste. Populli shqiptar,

me Luftën e tij heroike Nacionalçirimitare, të udhëhequr nga Partia, kundër pushtuesve nazifashistë dhe feudalëve vendës, e kapërceu humnerën kapitaliste dhe doli në shoqërinë socialiste, të cilën e ndërtoi dhe vazhdon ta ndërtojë plotësisht e me sukses, përsëri me luftë e me përpjekje, me punë të palodhur e me hov revolucionar të pandalshëm, me pjekuri e në mënyrë shkencore, duke u kalitur çdo ditë politikisht dhe ideologjikisht me mësimet e Partisë dhe të ideologjisë sonë fitimtare, marksizëm-leninizmit.

Kur i hedhim një sy së kaluarës, ne mburremi dhe krenohemi me popullin tonë heroik, me Partinë tonë të lavdishme, që kapërcyen kaq shumë luftëra e beteja, vuajtje e mjerime, vështirësi e pengesa të papërshkrueshme dhe dolën mbanë fitimtarë, pa u ligshtuar, pa u dekurajuar në asnjë moment, por me një forcë shpirtërore dhe fizike vigane, mbi gjërmadhat e shoqërisë me klasa antagonistë, ngritën shoqërinë e lulëzuar socialiste, Shqipërinë e re të popullit.

Shumë nga ju, të rinj e të reja, fëmijë tanë, që do të shkojmë së bashku krah për krah të votojmë për forcimin e republikës dhe të pushtetit tonë populor, nuk kishit lindur akoma kur lindi republika jonë. Sot jo vetëm ju që votoni për herë të parë, por edhe ata të cilëve akoma nuk u ka ardhur radha, janë vërsulur si një lumë i madh, i papërbajtur në shkollë e në punë, në ara e në fabrika dhe ndërtojnë hekurudha, kombinate e hidrocentrale, shtrojnë rrjetin e elektrikut anembanë Shqipërisë, ndërtojnë shkolla e çajnë male. Mbarë populli ynë krenohet me ju, brezi i ri i vendit tonë, pasi duke u rritur, ju gjithnjë e më mirë

mendoni, punoni dhe luftoni si revolucionarë të vërte-të, ju jeni siguria e një zhvillimi më të begatshëm të atdheut, sepse këtë begati ju po e krijoni vetë me punë, me djersë, me dituri, sepse çështja e madhe e mbarë popullit është juaja, sepse në asnjë vend të botës nuk është kuptuar dhe nuk është zgjidhur kaq dreqjt çështja e rinasë, siç është kuptuar dhe zgjidhur nga populli shqiptar dhe nga Partia e lavdishme e tij e Punës.

Por unë dëshiroj t'ju them një gjë, që fëmijët tuaj, nipërit dhe stërnipërit tanë, do të jenë edhe më të zotë, edhe më të mësuar e më punëtorë se ne edhe se ju, pasi Partia jonë është dhe do të jetë kurdoherë një Parti e çeliktë revolucionare, që do t'i edukojë brezat njërin pas tjetrit me një karakter të hekurt, me një kulturë të madhe përparimtare, do t'i kalitë ata me ideologjinë marksiste-leniniste, do t'i bëjë punëtorë të palodhur e me një zemër krejt të pastër e bujare, do t'i çlirojë nga shumë mbeturina që vuajmë ne sot, do t'i bëjë kurdoherë ushtarë të paepur të revolucionit, do t'u mprehë në kulm vigjilencën dhe luftën kundër armiqve të klasës, qofshin këta brenda, qofshin jashtë. Jeta e bukur dhe e begatshme që do të lulëzojë vazhdimisht anembanë Shqipërisë, do të jetë për ta një nxitje dhe një kënaqësi për të ecur kurdoherë përpara dhe jo për të fjetur mbi dafina. Vepra e madhe e popullit duhet të vazhdohet, të përjetësohet. Atë na e lanë amanet heronjtë dhe brezat që kaluan. Ne e kemi për detyrë të parë ta ngremë lart e më lart këtë amanet dhe t'ua kalojmë dorë më dorë dhe zemër më zemër brezave që vijnë. Për këtë punon i gjithë populli me Partinë e Punës në krye.

Shokë dhe shoqe,

Katër vjet më parë, me rastin e zgjedhjeve të deputetëve për Kuvendin Popullor, Partia dhe Fronti Demokratik shpallën platformën e tyre elektorale, ku qenë përmbledhur objektivat kryesorë të planit të katërt pjesëvjeçar, direktivat e të cilit i aprovoi Kongresi i 5-të i Partisë. Ato ishin detyra mjaft të forta, të ngjeshura mirë, sepse masat punonjëse, siç jeni në dijeni të gjithë, të frymëzuara nga thirrja e Komitetit Qendror të Partisë, luftuan dhe ia arritin të hartonin një plan me të vërtetë real, mobilizues e revolucionar.

Dhe ja sot, në prag të zgjedhjeve të reja dhe në prag të mbylljes së pesëvjeçarit të katërt, në emër të Partisë e të Frontit Demokratik dhe si përfaqësuesi juaj në Kuvendin Popullor, duke raportuar për punën e kryer, deklaroj se në tërsi detyrat e pesëvjeçarit të katërt për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës janë plotësuar para kohe, ose janë duke u plotësuar me sukses: plani i katërt pesëvjeçar për prodhimin e përgjithshëm industrial dhe për investimet u plotësua në 4 vjet e 7 muaj; në 4 vjet e 4 muaj u plotësua plani i ndërtim-montimeve. Prodhimi i drithërave të bukës, detyra kryesore që shtruam para bujqësisë dhe ekonomisë në përgjithësi, gjatë 4 vjetëve, 1966-1969 u realizua sipas planit pesëvjeçar; u tejkalan detyrat për hapjen e tokave të reja, për arsimin etj.

Të gjitha këto tregojnë se hovi revolucionar i maseve, mobilizimi i tyre i ndërgjegjshëm bëjnë të tejkalohet çdo parashikim yni, sado i guximshëm që të duket.

Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë dhe timin personal, për të gjitha këto fitore historike u shpreh mirënjojjen e pakufishme klasës punëtore heroike të vendit tonë, fshatarësise kooperativiste dhe inteligjencies popullore. Në mënyrë të veçantë unë përgëzoj gjithë punëtorët, fshatarët dhe inteligjencien e qytetit e të rrëthit të Tiranës, të cilët, si kurdoherë, edhe gjatë pesëvjeçarit të katërt u mobilizuan pa rezerva dhe me një frymë të lartë revolucionare plotësuan me nder e para afatit detyrat kryesore që u ngarkonte ky plan.

S'ka dyshim se shumë vështirësi e pengesa u hasën në rrugën për plotësimin e këtyre detyrave. Vështirësi e pengesa hasen edhe në punë më të vogla e më të thjeshta e jo më në një vepër të tillë madhështore siç është lufta për realizimin e planit pesëvjeçar. Por ato u kapërcyen me sukses në sajë të frymës së lartë revolucionare, të entuziazmit e të vrullit në punë, të aftësive të mëdha të njerëzve tanë të mrekullueshëm, në sajë të zbatimit me konsekuençë të vijës së masave dhe të mbështetjes, në radhë të parë, në mundësitë e në forcat tona të pashtershme. Një rol jo të vogël luajti në këtë drejtim edhe fakti që klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse, nën drejtimin e Partisë, u njo'hën më thellë me kërkeshat e ligjeve objektive të socializmit dhe me proceset shkencore që kanë të bëjnë me zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës. Kjo ndihmoi që ato të bëhen më të ndërgjegjshme për politikën e Partisë dhe për detyrat e tyre dhe t'i shtojnë përpjekjet për të rritur efektivitetin e punës, për të forcuar më tej organizimin, disiplinën, për të ngritur rendi-

mentin, për të përmirësuar cilësinë e produkteve etj.

Prandaj edhe në të ardhshmen neve na duhet ta forcojmë akoma më shumë punën për zgjerimin e mëtejshëm të njojurive mbi shkencat shoqërore e teknike, sepse nuk mund të mendohet zgjidhja e asnje detyre dhe problemi të rëndësishëm të ndërtimit socialist pa i bërë të ndërgjegjshme masat për domosdoshmërinë objektive dhe përrugët shkencore të realizimit e të zgjidhjes së tyre.

Krahas kësaj, është e domosdoshme të ngremë e të forcojmë akoma më shumë rolin drejtues e kontrollues të klasës punëtore në të gjithë jetën e vendit, si një nga parimet e patundura marksiste-leniniste për ta çuar përpara revolucionin tonë.

Në tërë zhvillimin kompleks, të harmonishëm e me ritme të shpejta të ekonomisë, si kurdoherë, rolin kryesor e ka luajtur industria. Potenciali prodhues i kësaj dege, i ngritur gjatë viteve të ndërtimit socialist me punën dhe me djersën e klasës punëtore e të të gjithë punonjësve, është zgjeruar e është modernizuar më tej. Ritmi mesatar vjetor i rritjes së prodhimit industrial gjatë këtij pesëvjeçari ka qenë mbi 14 për qind, ose dy herë e ca më i madh se ai i legjislaturës së mëparshme dhe shumë më i lartë se ai i cdo vendi kapitalist e revisionist të Evropës.

Gjatë legjislaturës së gjashtë në strukturën e industriisë sonë nisi të bëhet një ndryshim i rëndësishëm cilësor. U ndërtuan miniera të reja, u hodhën hapat e parë për krijimin e industrisë kimike moderne e të metalurgjisë. Baza e lëndëve djegëse u forcua dhe prodhimi i energjisë elektrike u rrit 2,4 herë në kra-

hasim me vitin 1965. Industria mekanike po vihet në rrugën që ajo të bëhet një faktor i fuqishëm për zhvillimin e gjithë ekonomisë. Tani këto degë që përmenda, të marra së toku, jepin 1/3 e krejt vëllimit të përgjithshëm të prodhimit industrial.

Si pasojë e çuarjes përpara të industrializimit socialist, pasuri të reja të nëntokës, vendburime të reja mineralesh, nafte, gazi e qymyrguri, që rrinin të fjetura, janë zbuluar. Një pjesë nga këto ka filluar të shfrytëzohet, duke rritur edhe shkallën e vlerësimit të tyre ekonomik me anën e përpunimit në vend. Të tjetra presin të shfrytëzohen dhe të tërhiqen në qarkullimin e përgjithshëm ekonomik gjatë pesëvjeçarit të ri.

Rezultatet e arritura në prodhimin e energjisë elektrike po i shpejtojnë tej parashikimeve të mëparshme ritmet e elektrifikimit të vendit. Me nivelin e sotëmi të energjisë elektrike, ne kemi krijuar atë bazë të domosdoshme fillestare, e cila do të lejojë që në të ardhshmen të kalohet me ritme më të shpejta e në front më të gjerë në një prodhim modern e intensiv në të gjitha degët e ekonomisë popullore. Gjithnjë e më shumë do të përdoret energjia elektrike për të lehtësuar punën dhe për të rritur rendimentin e saj, përveç industrisë, edhe në bujqësi, në ndërtim e në transport, si dhe për të plotësuar nevojat e reja që do të lindin nga ngritja e nivelit dhe e kulturës së jetesës së popullsisë.

Ne e dimë se ka në botë jo pak vende (kapitaliste e revizioniste) që prodrojnë energji elektrike përfrymë shumë më tepër se Republika Popullore e Shqipërisë e, megjithatë, asnje prej tyre nuk e ka bërë elek-

trifikimin e të gjitha fshatrave, që te ne do të përfundojë së afërmë, jo në nëntor 1971, që është afati i caktuar, por, siç duket, një vit më parë, në nëntor të këtij viti¹. Zgjidhja e kësaj detyre aspak të lehtë dhe në një kohë kaq të shkurtër është një fitore e madhe, me të vërtetë historike. Ja ç'do të thotë epërsi e rendit socialist mbi atë kapitalist! Ja, kështu, me vepra, e tregojnë Partia dhe klasa punëtore atë vlerësim të lartë që ato u bëjnë punës e rolit të fshatarësisë sonë revolucionare, kontributit aq të madh e të pakursyer që ajo ka dhënë, jep e është gati të japë kurdoherë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, për forcimin e alcancës me klasën punëtore dhe të diktaturës së proletariatit.

Për rritjen e shkallës së mekanizimit të punës, përvienien në jetë të shumë iniciativave krijuar e revolucionare të masave punonjëse, lidhur me ngritjen e fabrikave, reparteve e linjave të reja të prodhimit me forcat e brendshme, një rol të posaçëm ka luajtur industria jonë mekanike. Punëtorët, teknikët dhe inxhinierët tanë të talentuar kanë projektuar e kanë ndërtuar shumë makina e pajisje të thjeshta e të ndërlikuara, unikale e në seri. Thellimi i mëtejshëm i revolucionit tekniko-shkencor kërkon medoemos që kjo degë e industrisë të forcohet e të zhvillohet pareshtur. Partia s'e ka parë atë kurrë vetëm si një bazë ripari-

1 Ky aksion i guximshëm revolucionar përfundoi më 25 tetor 1970, 13 muaj para afatit të caktuar në vendimin e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të PPSH dhe 15 vjet para afatit që parashikohej në planin perspektiv.

mesh apo prodhimi të veglave të ndërrimit, por edhe si një bazë nisjeje që, gradualisht, lypset të shndërrohet në një industri të ndërtimit të makinave. Për këtë degë kjo është një perspektivë objektive dhe plotësisht e realizueshme, atë Partia po e përgatit me durim dhe këmbëngulje.

Ndonëse forcat dhe mjetet kryesore janë përdorur për zhvillimin e industrisë së rëndë, Partia s'ka lënë asnjëherë pas dore edhe industrinë e lehtë e ushqimore. Ndërtimi i fabrikave të reja dhe rikonstruksioni i një pjese prej atyre ekzistuese kanë bërë të mundur të shtohen prodhimi dhe assortimenti i mallrave të përdorimit të gjerë. Tani është arritur në një stad të tillë kur, pa dobësuar për asnjë çast luftën për sasi, duhen bërë përpjekje gjithnjë e më shumë që mallrat e produara për popullin të jenë më të forta, të thjeshta, më të bukura e më të lira.

Fitore të shquara ideopolitike, ekonomike e shoqërore janë shënuar në këto katër vitet e fundit edhe në zhvillimin socialist të fshatit. Kolektivizimi i bujqësisë përfundoi me sukses në zonat e thella malore. Edhe për fshatarësinë e këtyre zonave socializmi u bë tani një rend shoqëror dhe ekonomik i drejtpërdrejtë në jetën dhe në punën e përditshme. Rrethanat u krijuan të tilla që fshatarësia në këto zona përmbysi njëherësh e me guxim revolucionar shumë gjëra nga bota e vjetër ekonomike, shoqërore e shpirtërore: u nda nga prona e nga puna private, nga psikologjia individuale dhe mbyllja në vetvete, shqelmoi shumë zakone e besime të vjetra skillavëruese, u ndriçua me dritë elektrike etj. Duke u mbledhur të gjitha këto në një

kohë, ajo shkuli me të vërtetë diçka me rrënje nga vetja e saj, që e kishte munduar, shtypur e ndrydhur për shekuj të tërë. Për këtë arsyec ajo, si edhe e gjithë fshatarësia shqiptare, i është përjetë mirënjojëse Partisë, sepse nën udhëheqjen e saj doli në rrugën e gjerë e të ndritur të socializmit, në rrugën e begatisë e të jetës së lumtur.

Të mëdha, si asnjëherë tjeter, janë suksceset e arritura në bujqësi për sa u përket rritjes së rendimenteve, shtimit të prodhimit të drithërave, hapjes së tokave të reja, zgjerimit të sipërfaqes së ujitshme, mekanizimit e përdorimit të plehrave kimike. Në vitin 1969 u prodhuan 187 000 tonë drithëra buke më shumë se në vitin 1965. Me këto ritme të larta e të qëndrueshme që është ecur në këto vitet e fundit në prodhimin e drithit, po krijojen mundësitë për të zgjidhur përfundimisht problemin e sigurimit të bukës në vend.

Në jemi të ndërgjegjshëm se në lëmin e bujqësisë ka edhe ndonjë detyrë të caktuar në planin e katërt pesëvjeçar që nuk do të mund të plotësohet. Si rrjedhim, ka pasur edhe ndonjë vështirësi të përkohshme për sigurimin e industrisë me lëndë të parë bujqësore, siç është rasti me pambukun, por që është kapërcyer me masat e marra nga Partia dhe nga Qeveria.

Tërë kushtet materiale janë krijuar e po forcohen dita-ditës që bujqësia jonë të ecë e sigurt në rrugën e zhvillimit të saj intensiv. Krahas tyre, një rol vendimtar ka tanë veprimi i faktorit subjektiv: përsosja e organizimit dhe e drejimit, ngritja e nivelit kulturor e agroteknik të fshatarësisë dhe të të gjithë punonjësve të bujqësisë. Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor

dhe i procesit për specializimin e kooperimin, bashkimi i punës së palodhur të kooperativistëve me përdorimin e dijeve shkencore, janë bërë ai kusht i domosdoshëm pa të cilin prodhimi bujqësor nuk mund të çohet përpara me ritmet e shpejta që kërkon ndërtimi ynë socialist.

Për t'i peshuar e për t'i vlerësuar drejt rezultatit e zhvillimit të ekonomisë, Partia ka përdorur një kriter themelor e të pandryshueshëm: Sa dhe si prodhimi shoqëror ka shërbyer për të plotësuar nevojat gjithnjë në rritje materiale e kulturore të popullit, sot e në-perspektivë. Jetesa e përditshme e çdo familjeje qytetare e fshatare dhe e çdo punonjësi, treguesit ekonomikë, shoqërorë e kulturorë vërtetojnë se jeta e popullit është në ndryshim, se ajo përmirësohet pa pushim.

Ngushtimi pa precedent i diferencave në pagat, heqja e çfarëdolloj takse për popullsinë, përfundimi i arsimit të detyrueshëm 8-vjeçar në të gjithë vendin, rritja e peshës së moshave të reja në numrin e përgjithshëm të popullsisë, në kushtet e rritjes së shpejtë të saj, ngritja e një rrjeti të gjerë të shërbimeve social-kulturore thuajse në të gjitha fshatrat, janë disa nga ato suksese të shquara që kanë karakterizuar ngritjen e mirëqenies së popullit në këto vitet e fundit.

Që të krijohet një ide akoma më e plotë mbi këtë çështje, po përmend edhe disa të dhëna. Gjatë viteve 1966-1969 të ardhurat kombëtare janë rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 9,3 për qind. Një ritëm i tillë nuk është shënuar gjatë kësaj kohe në asnjë vend tjetër të Evropës. Mbi këtë bazë janë rritur të ardhurat reale të punëtorëve, të nëpunësve dhe të koopera-

tivistëve. Në vitin 1969 popullsisë i janë shitur mallra për fryshtën 23 për qind më shumë se më 1965.

Një kthesë ka filluar të bëhet në ndërtimin e shtëpisive të banimit. Iniciativa e madhe revolucionare, që ka shpërthyer gati në çdo qytet, për të ngritur ndërtesa banimi me kontribut vullnetar, është një nga ata faktorë të rëndësishëm që ka çelur perspektiva të reja lidhur me kohën e zgjidhjes së plotë të këtij problemi të mprehtë për jetesën e punonjësve. Është detyrë e organave të Partisë e të pushtetit, e organizatave të masave dhe e të gjithë punonjësve që përvoja më e mirë, e grumbulluar në shkallë republike, të studiohet e të përgjithësohet, me qëllim që të përhapet në të gjithë vendin.

Pjesë e pandarë e rritjes së nivelit kulturor të popullsisë janë edhe përfundimet e arritura gjatë këtij pesëvjeçari në arsim, kulturë, art e letërsi. Në këtë vit arsimor në të gjitha llojet e shkollave mësojnë 622 000 nxënës e studentë. Në çdo 10 000 banorë te ne 125 veta ndjekin arsimin e lartë. Me këta tregues vendi ynë ka dalë në radhët e para të shteteve evropiane, duke lënë prapa shumë prej tyre në këtë fushë. Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të Partisë i dha popullit një program të qartë veprimi në lëmin e arsimit. Ky program është shumë i gjerë e me afat të gjatë, prandaj edhe vënia e tij në jetë nuk është çështje e një apo dy viteve. Rëndësi ka që të merren në dorë hallka të veçanta të tij, të zgjidhen detyrat më të ngutshme, siç i nxjerrjeta dhe sipas radhës që lejojnë mundësitetë materiale. Iniciativa, fryma kritike, mendimi krijues i masave do të na mësojnë, si kurdoherë, t'i kapërcejmë vështirë-

sitë, ta nxjerrim në krye me ndër edhe këtë vepër të Partisë me rëndësi të pallogaritshme për fatet e socializmit në vendin tonë.

Në vendet kapitaliste dhe kudo ku sundojnë revisionistët modernë tabloja paraqitet diametralisht e kundërt. Në përgjithësi këtu masat punonjëse hasin vështirësi në plotësimin e nevojave materiale e kulturore. Herë në një vend e herë në një tjetër, atje ka greva e protesta për rritjen e pagave të punëtorëve dhe për ndalimin e ngritjes së çmimeve, për përmirësimin e kushteve të punës, për zgjerimin e sigurimeve shoqërore, për liri e të drejta politike, për përhapjen e arsimit dhe demokratizimin e tij etj., etj. Edhe në ato raste kur shënohet ndonjë përmirësim, ky vjen kurdoherë pas një lufte të gjatë që janë të shtërnguar të bëjnë punonjësit dhc shoqërohet gjithnjë me rritjen e mëtejshme të shfrytëzimit të tyre.

Rezultatet e arritura në të gjitha fushat e veprimtarisë përbëjnë atë bazë të fuqishme mbi të cilën do të mbështetet i gjithë zhvillimi ynë në pesëvjeçarin e ardhshëm. Siç është në dijeni i gjithë populli, në bazë të orientimeve të përgjithshme që kanë caktuar Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria, në të tënë vendin po punohet tani për hartimin e planit të ri pesëvjeçar. Në sektorin e bujqësisë ai është bërë tanimë objekt i një diskutimi të gjerë popullor. Së shpejti e njëjtë gjë do të bëhet edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë dhe të kulturës.

Porosia e Partisë është që, me këtë rast, të tërhoqet efektivisht mendimi krijues i masave të gjera punonjëse, i gjithë klasës punëtore, i fshatarësisë koopera-

tiviste, i specialistëve e i teknikëve, i njerëzve të bazës e i kuadrove; të merren parasysh e të shfrytëzohen tërë ato mundësi kolosale të krijuara në fushën ideopolitike dhe ekonomike nga rritja numerike e kuadrove dhe e përvojës së tyre, nga iniciativat revolucionare të masave, nga aksionet e tyre të pandërprera, nga hovi i revolucionit teknik e shkencor; të shfrytëzohet tërë ajo eksperiencë e pasur, e grumbulluar nga ekonomitë e përparuara dhe nga elementët e pararojës në të gjitha fushat.

Në qendër të zhvillimit të ekonomisë sonë, edhe për pesëvjeçarin e ardhshëm, do të mbetet industrializimi socialist. Synimi kryesor i këtij pesëvjeçari në këtë fushë është të ndërtohen të tilla objekte, sidomos të industrisë së rëndë, që nga pikëpamja e nivelit teknik, e proceseve teknologjike dhe e përpjesëtimit të prodhimit ta ngrenë industrinë tonë në një stad të ri, më të lartë dhe modern. Kombinati metalurgjik i hekur-nikelit, uzina komplekse për përpunimin e thellë të naftës, hapja e minierave të mëdha të hekur-nikelit, kromit, fosforiteve e qymyrgurit, përfundimi i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, fillimi i punimeve në hidrocentralin e Fierzës, si dhe shumë vepra të tjera që do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, do të luajnë një rol vendimtar për shndërrimin e Republikës Popullore të Shqipërisë në një vend industrialo-agrar të përparuar.

Klasa punëtore, specialistët dhe teknikët, gjithë drejtuesit e prodhimit duhet t'i përqendrojnë forcat e tyre, në radhë të parë, për të përsosur organizimin e punës, për të shfrytëzuar në maksimum të gjitha ka-

pacitetet prodhuese, për të ngritur me ritme më të shpejta rendimentin e punës dhe për të përmirësuar më tej cilësinë e prodhimeve.

Edhe në bujqësi detyrat që mendohen për pesëvjeçarin e ri janë mjaft të mëdha e fryshtuese. Afërsisht do të dyfishohet prodhimi i drithërave të bukës, do të shtohet shumë prodhimi i bimëve industriale, i prodhimeve blegtore, do të dyfishohen pemët frutore etj. Synimi üshtë që edhe këtu, në bimët e arave dhe në blegtori, të arrihen të tilla rendimente që të flasin për një nivel të lartë organizimi e pune, për një bujqësi me të vërtetë moderne e të përparuar. Rritja e pandërrerë e rendimenteve dhe zhvillimi i harmonizuar drejt i bimëve të arave me blegtorenë përbëjnë atë rrugë nëpër të cilën duhet të ecë edhe në të ardhshmen bujqësia jonë që të arrijë sa më parë plotësimin në nivel të kënaqshëm të nevojave të popullit për prodhimet ushqimore më të rëndësishme dhe të industrisë përlendë të parë.

Shteti, si edhe deri sot, do të vazhdojë të investojë shuma të mëdha për mekanizimin e mëtejshëm të punimeve bujqësore, për shtimin e plehrave kimike, për sigurimin e farërave me rendiment të lartë, për bonifikimin, ujitjen etj. Por edhe fshatarësia, nga ana e saj, duke ecur sipas shembullit të brigadave dhe ekonomive të përparuara, që kanë arritur qysh sot shumë nga treguesit e parashikuar për pesëvjeçarin e ardhshëm, duhet të shtojë pjesëmarrjen në punë, të kryejë me kohë tërë shërbimet që kërkon shkenca bujqësore dhe të shfrytëzojë në maksimum mundësitë e shumta që krijon shteti dhe epërsitë që i jep rendi kooperativist.

I gjithë ky zhvillim e këto transformime të mëdha që do të kryhen gjatë pesëvjeçarit të pestë në ekonominë tonë, si gjithnjë, do të sjellin me siguri ngritjen e mëtejshme të mirëqenies materiale dhe kulturore të punonjësve të qytetit dhe të fshatit, do të rritin të ardhurat reale të popullsisë, do të ngushtojnë dallimet midis fshatit e qytetit, do të shtojnë numrin e populsisë të zënë me punë. Jeta e popullit do të bëhet më e lumtur, më e gëzuar dhe më e kulturuar.

Siq shihet, detyra të mëdha po marrim përsipër për pesëvjeçarin e ardhshëm. Por revolucionarët nuk u janë trembur ndonjëherë detyrave të mëdha. Ata prandaj edhe janë të tillë, sepse kryejnë detyra të rënda, të vështira, por heroike e të lavdishme. Populli ynë, i mësuar të çajë me gjoks përpara, pa pyetur përpengesa e vështirësi, duke i shtuar vrullit revolucionar edhe dijenitë shkencore, i udhëhequr nga Partia, do t'i plotësojë, si kurdoherë, me nder detyrat madhështore që i shtron plani i pestë pesëvjeçar; ai do të dalë me siguri fitimtar edhe në këtë betejë të lavdishme, që do t'i ngrejë akoma më lart emrin dhe fuqinë e atdheut tonë të dashur socialist.

Të gjitha këto suksese që kemi arritur, janë sigruar në sajë të vijës kurdoherë të drejtë e konsekiente marksiste-leniniste të Partisë.

Që ditën që Shqipëria u vu në rrugën e socializmit, për Partinë ishte e qartë se rendi i ri shoqëror mund të ndërtohej vetëm nga një popull i ndërgjegjshëm, i vendosur dhe i ngritur politikisht, nga një popull që tërë detyrat që shtronte revolucioni t'i shihe nga prizmi i qartë i një politike marksiste-leniniste, si

detyra që u shërbenin interesave të socializmit, ndërtimit të jetës së tij të begatshme, të kulturuar, të lirë, demokratike e sovrane. Në të njëjtën kohë Partia ishte e vetëdijshme se lufta për ndërtimin e socializmit kërkonte që masat punonjëse të armatoseshin me dijenitë më të domosdoshme shkencore, me përvojën më të mirë të grumbulluar nga njerëzimi gjatë shekujve në luftët për zotërimin dhe për transformimin e natyrës.

Që politika e drejtë marksiste-leniniste e Partisë në të tëra aspektet e saj të zbatohej në jetë nga masat punonjëse, në mënyrë krijuese e jo dogmatike, ishte e domosdoshme që ajo të kuptohej thellë prej tyre, të thithet, të përshkonte tejendanë mendimin dhe veprimin e tyre. Dhe pikërisht sepse u punua kështu nga Partia, komunistët dhe njerëzit e paorganizuar në Partite ne, kuadrot dhe punonjësit e thjeshtë, edhe kur nuk kanë ditur «teorinë e madhe», detyrat e caktuara i kanë parë kurdoherë me syrin e mprehtë politik. Kjo rrethanë ka bërë që ata të jenë luftëtarë të vendosur të vijës së Partisë dhe që lufta e tyre për zbatimin e kësaj vije të kurorëzohet me sukses. Detyra jonë është që këtë vendosmëri dhe gatishmëri politike të masave ta mbajmë vazhdimisht të gjallë, ta forcojmë më tej, ta kthejmë gjithnjë e më shumë në bindje të brendshme ideologjike, në një karakteristikë themelore të jetës sonë shoqërore.

Përvoja e derisotme na ka mësuar se plotësimi i kësaj detyre arrihet nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të Partisë, të Frontit, të masave të gjera, dhe sidomos të brezit të ri, me idetë e marksizëm-leninizmit. Kështu duhet të kuptohet dhe këtij qëllimi duhet t'i

shërbejë edhe orientimi i Partisë që i tërë mësimi dhe edukimi në shkollë të përshkohen nga marksizëm-leni-nizmi, që shkolla jonë të përgatitë jo vetëm specialistë të aftë, por edhe revolucionarë të vendosur. Një edukim i tillë politik nuk mund të kryhet me fushata dhe as vetëm nëpërmjet formave të organizuara, ai duhet t'i shoqërojë punonjësit e t'u ndriçojë rrugën në çdo hap të jetës së tyre, në punë e në shtëpi, si kolektiv e si individë, duke i hedhur masat në aksione revolucionare dhe duke përdorur gjithë mjetet e tjera të formimit të opinionit shoqëror.

Krahas kësaj, për ndërtimin me sukses të socializmit Partia dhe shteti duhej të zhduknin injorancën në popull, prapambetjen e madhe arsimore e kulturore që ai trashëgoi nga e kaluara. Ata ishin të ndërgjegjshëm se zgjidhja e kësaj detyre mund të arrihej vetëm duke i bërë të masave arsimin dhe kulturën, duke përhapur gjerësisht në to diturinë dhc njohuritë shkencore. Këtu nuk ishte çështja për një ndërmarrje të karakterit thjesht iluminist, por që ngritja e nivelit arsimor e kulturor të punonjësve të lidhej ngushtë me detyrat e ndërtimit të socializmit, me çështjet aktuale dhe perspektive të këtij ndërtimi. Prandaj, tok me ngritjen e industrisë, me zhvillimin e bujqësisë dhe të sektorëve të tjerë ekonomiko-shoqërorë, Partia mori masa të rëndësishme për përgatitjen e kuadrove, për aftësimin e tyre të vazhdueshëm, të cilët, tok me punëtorët e fshatarët, të shkrirë me ta, punojnë, luftojnë e çojnë përparrë ekonominë tonë, arsimin, kulturën, gjithë jetën e vendit. Kështu Partia mbushi atë boshllëk të madh që u trashëgua nga e kaluara.

Në përpjekjet për përhapjen e kulturës në masat u vlerësuan të gjitha ato tradita e vlera shpirtërore të shëndosha, përparimtare e demokratike që populli ynë kishte krijuar gjatë shekujve. Studimi shkencor i historisë së popullit, krijimi në baza të shëndosha mark-siste-leniniste i shkencës albanologjike, që u arrit në sajë të shumë studimeve serioze dhe zbulimeve të rëndësishme arkeologjike e dokumentare arkivale, nxori më në dritë kulturën e madhe të popullit tonë qysh në kohët e lashta, e mbuluar kjo me një heshtje varri nga dijetarë shovinistë e reaksionarë të Evropës.

Por vetëm trashëgimia kulturore e së kaluarës nuk mund t'i kënaqte kërkesat e ndërtuesve të shoqërisë socialiste. U desh që kjo të plotësohej dhe të ngrihej më lart me zhvillimin e kulturës së re popullore. Si rrjedhim, një hov të paparë morën në këto vite arti ynë i realizmit socialist, teatri e muzika, piktura e skulptura, letërsia e të gjitha gjinive. Një krijimtari e pasur, e larmishme dhe e një niveli të lartë ideo-estetik ka karakterizuar punën e shkrimitarëve dhe të gjithë artistëve tanë të talentuar. Veprat e tyre, që janë frymëzuar nga ideologjia e Partisë dhe ushqyer nga gurra e pashtershme e krijimtarisë popullore, kanë dhënë një kontribut të çmuar për edukimin e rinisë dhe të gjithë punonjësve me idealet e mëdha të atdheut, të socializmit e të komunizmit.

Transformimi i madh, i shumanshëm dhe i ndërlikuar i gjithë jetës së shoqërisë mbi baza socialiste nuk mund të bëhej në mënyrë spontane e të shthurur apo sipas praktikës së mikroborgjezit «ç'të nxjerrë ditë». Duhej që Partia t'i mësonte njerëzit si të punonin

në mënyrë të re, si ta organizonin e ta drejtonin punën që ajo të jepte rezultate sa më të mëdha. Prandaj, çështja e organizimit të madh e të vogël të punës ka qëndruar dhe vazhdon të qëndrojë në rend të ditës përkryerjen e çdo detyre dhe për plotësimin e çdo plani që kanë marrë e do të marrin përsipër punonjësit. Organizimi, që ka ardhur gjithnjë duke u forcuar, ngre edhe vlerën e punës politike, ideologjike, të shkollës dhe të diturive të përhapura në popull. Kombinimi i organizimit të punës me këta faktorë ka qenë dhe mbetet edhe për të ardhmen kushti vendimtar i të gjitha sukseseve. Atje ku mungon ose dobësohet organizimi, lindin anarkia dhe rrëmuja, atje nuk mund të zërë vend as puna politike.

Për t'u hapur rrugë të gjerë e të lirë punës dhe mendimit krijues të punonjësve, ishte e domosdoshme të luftohej e të zhdukej mjegulla e së kaluarës në botëkuptimin e njerëzve: pikëpamjet idealiste, besimet fetare, patriarkalizmi, zakonet dhe doket prapanike, ndjenja individuale mikroborgjeze, interesi i ngushtë vetjak etj., etj. Të gjitha këto përbënин një pengesë të madhe në zhvillimin tonë ekonomiko-shoqëror, sepse mbanin të ndrydhura forca të gjalla e efektive të shoqërisë sonë, sidomos rininë e gruan. Prandaj ato duhet të shkuleshin nga rrënjet. Natyrisht, kjo nuk ishte diçka e lehtë, për arsy se kishte të bënte me botën e brendshme të çdo punonjësi, me mendimet dhe me gjendjen e tij shpirtërore, me tradita dhe norma të kultivuara në shekuj. Por Partia ia hyri kësaj pune me durim e takt dhe sukseset janë kolosale.

Ajo që është arritur tanimë në këtë fushë dhe që

njihet nga të gjithë çshtë një përmbyssje e vërtetë. Shumë nga fijet më të padukshme, të cilat i mbanin mjaft punonjës të lidhur me botën e vjetër, u këputën një herë e përgjithmonë. Në gjithë këtë luftë faktori kryesor që siguroi suksesin që hedhja e masave në revolucion. Aksionet dhe lëvizjet revolucionare, që shpërthyen me një vrull të paparë, tronditën mbeturinat më të theksuara të botës së vjetër dhe çuan në emancipimin e mëtejshëm të forcave të tilla dinamike e luftarakë siç janë rinia dhe gruaja shqiptare. Nxjerrja në dritë dhe hedhja tërësisht në revolucion e këtyre forcave ishte një detyrë historike për Partinë dhe për klassën punëtore, të cilën ato e përbushën më nder. Të udhëhequra nga Partia, këto dy forca u bënë nga faktorët vendimtarë për përparimin e Shqipërisë së re, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Forcimi dhe kalitja e vazhdueshme e ndërgjegjes socialiste të njeriut tonë të ri, çlirimi i gjithanshëm shpirtëror i tij nga mbeturinat dhe nga ndikimi i botës së vjetër, mbeten edhe për të ardhmen një detyrë kapitale e Partisë, me rëndësi jetike për fatet e revolucionit e të socializmit.

Ndërtimin e socializmit Partia nuk e ka ndarë kurë nga detyra e shenjtë për mbrojtjen e atdheut tonë socialist. Ajo ka punuar dhe ia ka arritur që çështjen e mbrojtjes ta marrin në dorë vetë masat e gjera të popullit. Në tërë këtë punë ne jemi udhëhequr nga mësimi i Leninit të madh, sipas të cilës qëdo qytetar i mirë të jetë edhe një ushtar i mirë dhe qëdo ushtar i mirë të jetë njëkohësisht një qytetar i mirë. Në këtë rrugë

po ecën sot i gjithë populli ynë, i madh e i vogël, burra e gra. Ne nuk e mbajmë të fshehtë, por e themi botërisht, dhe për këtë jemi krenarë, se çdo qytetar i Republikës Popullore të Shqipërisë mëson të përdorë çdo lloj arme, të pajiset me artin ushtarak, të njohë pëllëmbë për pëllëmbë truallin amtar, ta dashurojë, ta zbulurojë dhe ta mbrojë atë kundër çdo armiku e në çfarëdo rrethane që të krijohet. Te ne ushtri e popull janë një, të lidhur si mishi me kockën rreth Partisë. Ushtria jonë është ushtri e revolucionit, ajo karakterizohet nga një demokraci e vërtetë proletare, nga një disiplinë e hekurt dhe patriotizëm i flaktë. Të tillë ta ruajmë dhe ta forcojmë gjithnjë Ushtrinë tonë Popullore, t'i ngremë pareshtur vigjilencën dhe gatishmërinë luftarake të të gjithë popullit, garanci të sigurta këto për mbrojtjen e të gjitha fitoreve që ka arritur e do të arrijë populli ynë.

Kalitja, pra, e njeriut të ri, të qartë e të vendosur politikisht, të gatshëm të japë edhe pikën e fundit të gjakut, po ta lypin interesat e Partisë dhe të popullit, me veti të larta të moralit komunist dhe me ndërgjegje të pastruar nga shumë njolla të botës së vjetër, ja, kjo përbën fitoren më të madhe të Partisë në këto vite lufte e pune kolosale. Këtu e ka burimin ai vrull i madh revolucionar i popullit tonë, që ka shpërthyer si një ortek i pandalshëm dhe që karakterizon gjithë jetën e vendit.

Rruga në të cilën kemi ecur ne është e lavdishme. Eksperienca që kemi grumbulluar përbën një thesar të paçmueshëm. Të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë edhe

në të ardhmen, ta pasurojmë dhe ta ngremë në shkallë përherë e më të lartë gjithë përvojën e grumbulluar.

Shokë e shoqe,

Shqipëria socialiste jo vetëm që ndjek me vigjilencë zhvillimin e ngjarjeve në arenën ndërkombëtare, por edhe lufton aktivisht në mënyrë revolucionare dhe influencon në to.

Duan apo nuk duan borgjezët, ajo bën punën e vet dhe influencon pozitivisht në zhvillimin e ngjarjeve në botë, jo nga madhësia e saj tokësore, as nga numri i popullsisë apo nga armët atomike, por nga identë marksiste-leniniste që e frymëzojnë, që i zbaton, i mbron dhe i përhap në të gjithë botën. Nga kjo pikë-pamje forca e Shqipërisë është e pamatshme. Bota kapitaliste bën sikur nuk e ka në hesap, por atë ajo është e detyruar ta llogaritë, pasi marksizëm-leninizmi është ideologja dhe rrugërrëfyesja për aksion dhe përluftë për gjithë proletariatin botëror dhe popujt e shtypur.

Kapitalizmi botëror arriti një sukses të madh, por të përkohshëm, kur klika hruščoviane tradhtoi marksizëm-leninizmin në Bashkimin Sovjetik dhe u ndoq në këtë rrugë edhe nga klika të tjera revizioniste që janë në fuqi në disa vende e në disa parti pseudokomuniste. Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë qëndruan dhe qëndrojnë të patundura përpëra presionit imperialist e revizionist. Si imperialistët ashtu edhe revizionistët modernë ç'nuk bënë që të na përkulnin!

Por të gjitha orvatjet e tyre u thyen. Ky fakt i madh, lufta e vendosur e Partisë sonë, nuk mund të mos influenconin në arenën ndërkombearc, në marksistë-lininistët e botës, në popujt e vegjël e të robëruar që luftonin për liri e pavarësi.

Kur borgjezia kapitaliste dhe revisionistët modernë e panë se s'ia dolën dot mbanë Shqipërisë socialiste, ndërruan taktikat, por jo qëllimet. Ata filluan të na buzëqeshin, të thonë se duan të kenë lidhje diplomatike me shtetin tonë, të zgjerojnë tregtinë dhe të bëjnë «bc e rrufe» se nuk kanë asnje qëllim të keq ndaj vendit tonë. Ka ca kohë që ata propagandojnë se në Shqipëri po fryn, gjoja, era e liberalizimit dhe çdo akt normal diplomatik të shtetit tonë e propagandojnë sikur ne po bëjmë kthesa politike. Kthesat e tyre taktike ndaj nesh ata i regjistrojnë si tonat ndaj tyre.

Ne nuk bëmë asnje kthesë në politikën tonë në rast se dje lidhëm marrëdhënie diplomatike me vendet skandinave ose me Zvicrën, nesër ne jemi gati të lidhim të tilla marrëdhënie edhe me republikat e Amerikës Latine. Kjo dëshirë nga ana e Qeverisë sonë ka qenë që kur u çlirua Shqipëria dhe populli ynë erdhi në fuqi. Të tjerët nuk donin, pasi ndodheshin nën presionin ose ishin lidhur pas qerres së atyre fuqive të mëdha, të cilat kishin shpresa që, me anë komplotesh, nga brenda dhe nga jashtë, popullit tonë t'ia rrëmbenin pushtetin nga duart dhe të risillnin në fuqi klikat borgjeze. Mirëpo kësaj jo vetëm s'ia arritën dot, por në jetë u vërtetua se asnje fuqi e madhe nuk mundi t'i impononte vullnetin e saj Shqipërisë socialiste. Me Republikën tonë Popullore të gjithë duhej të ishin

korrektë, t'i respektonin dhe t'i respektojnë të drejtat e saj të plota dhe të pacenueshme nga kurkush. Shqipëria as nuk bëri, as nuk do të bëjë lëshime në parimet e politikës së saj të drejtë, të brendshme dhe të jashtme. Në këto çështje shtetet kapitaliste dhe revizioniste në realitet nuk kanë asnjë iluzion, por, edhe po të kenë, shteti ynë i fuqishëm i diktaturës së proletariatit dhe Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë janë në këmbë, për t'i dekurajuar në këtë drejtim.

Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë se dëshirojmë të kemi marrëdhëniet të mira dhe korrekte edhe me shtete që kanë regjime të kundërta nga yni, por me kusht që ato të respektojnë lirinë e pavarësinë e atdheut tonë, sovranitetin, integritetin tokësor dhe gjithë fitoret e revolucionit tonë popullor.

Kurse të gjitha ato shtete imperialiste dhe revizioniste që kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrime armiqësore ndaj Shqipërisë socialiste, kanë marrë dhe do të marrin kurdoherë përgjigjen e merituar nga ne. Ato Shqipërisë, i kanë borxhe të niëdha politike dhe ekonomike që nuk lahen me fjalë boshe dhe me demagogji. Revolucioni i pashmangshëm në këto vende do t'i vërë në vend krimet që i janë bërë dhe po i bëhen nga ana e tyre jo vetëm Republikës Popullore të Shqipërisë, por gjithë popujve të botës.

Pikërisht që të triumfojë ky revolucion luftojnë Republika Popullore e Shqipërisë, populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës dhe pikërisht për këto arsyet Shqipëria socialiste gjëzon një simpati të madhe në popujt e botës që përfaqësojnë një forcë të madhe, të cilën fuqitë imperialisto-revizioniste duhet ta llogaritin.

Të kuptohemi, Shqipëria socialiste nuk është kërthiza e botës, aksi i botës është marksizëm-leninizmi, është doktrina jonë revolucionare... Janë miliona proletarë e popuj të tërë në botë që luftojnë për lirinë e tyre, për bukën, për tokën, për fabrikën, për dinjitetin njerëzor. Atëherë vihet pyetja: Kush bën lëshime, ne apo kundërshtarët tanë?

Ne nuk bëjmë lëshime. Për ne, për revolucionin, gjendja zhvillohet në mënyrë të favorshme. Ju i mbani mend fare mirë ç'situata të vështira kemi kaluar e, me gjithatë, Shqipëria socialiste asnjëherë s'u përkul atëherë e jo më të përkulet sot. Tani armiqtë e komunizmit e të marksizëm-leninizmit, imperializmi amerikan, revizionizmi sovjetik dhe gjithë satelitët e tyre, janë dobësuar, janë në një krizë të madhe. Për të rimarrë frymë, për t'u përforcuar për luftëra të reja, ata janë të detyruar të bëjnë disa lëshime. Këtë të mos e harrojmë. Luftërat grabitqare të padrejta që bëjnë ata, janë të pandara nga regjimet e tyre kapitaliste, nga politika dhe nga ideologjia e tyre e pronës kapitaliste.

Historia e popujve të Evropës njeh një sërë pushtimesh, që janë cilësuar si invadime të barbarëve. Këto pushtime, si ato të hunëve e të tjerë, në kohën e tyre, shkatërruan shtete dhe perandori, dëmtuan qytetërimin që kishte arritur njerëzimi deri atëherë. Atij iu desh një periudhë e gjatë të merrte frymë dhe të rimëkëmbej. Edhe tani imperializmi amerikan dhe bota kapitaliste përpilen të pushtojnë vende e kontinente, të shtypin popujt e t'u bastardojnë kulturën, të përhapin degjenerimin dhe mënyrën e jetesës amerikane etj. Këtë ata e bëjnë me anë të dollarit, të korruptionit

dhe të armëve. Por nuk mungojnë të përdorin edhe armatën e lloj-lloj «turistëve» e «vizitorëve».

Tradhtia e revizionistëve sovjetikë dhe e shokëve të tyre, të cilët Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera ku sundojnë, i kanë bërë hanc me dy porta për kapitalet e huaja dhe për jetën e shthurur kapitaliste, për spiu-nët e të degjeneruarit, i ka hapur një oreks të madh borgjezisë reaksionare kapitaliste të vendeve të ndryshme nëpërmjet vërvshimit turistik që ka marrë në vendet revizioniste përpjesëtimin e invadimeve të vjetra barbare. Deviza e huaj është bërë flamuri i revizionistëve modernë, të cilët përgjërohen për të. Në të ardhurat nga turizmi ata mbështetin shpresat e mëdha për buxhetet e tyre të lëkundura, hiqen si të modës, si të qytetëruar, si përkrahës të demokracisë e të liberalizmit demokratik, pavarësisht se shesin atdheun dhe ulin dinjitetin e popullit. Ata përhapin degjenerimin në rini, nxitin spekulimin dhe krimin që sjell me vete kjo turmë heterogjene turistësh, së cilës i hapen lirisht të gjithë kufijtë, deri edhe në çështjet intime të familjeve.

Një shtet që respekton vjetveten dhe popullin e vel, që lufton për përparimin dhe progresin, që nuk lejon të rrezikohen liria, pavarësia dhe sovraniteti i atdheut, që dëshiron t'i ruajë e t'i zhvillojë të pastra virtytet e larta të njeriut, nuk mund të ndjekë kurrë rrugët dhe praktikat e qelbura revizioniste kapitaliste. Kështu vepron shteti ynë i demokracisë populllore.

Republikën Popullore të Shqipërisë armiqtë e quajnë vend të mbyllur për të huajt. Në këtë ka diçka

të vërtetë, por, e marrë në një kuptim të gjerë, është një shpifje. Po, Republika Popullore e Shqipërisë është e myllur për armiqtë, për spiunët, për turistët hipë e vagabondë të tjerë, kurse për miqtë e saj, marksistë dhe jomarksistë, për revolucionarët dhe demokratët përparimtarë, për turistët e ndershëm, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre politike, por që duan të vijnë në vendin tonë për të pushuar në natyrën e bukur të tij dhe në mes të popullit tonë trim, bujar e punëtor, pa u përpjekur të ndërhyjnë në punët tona të brendshme dhe për të bërë punë diversioniste, Republika Popullore e Shqipërisë është e hapur. Dhe të tillë njerëz vijnë me shumicë çdo vit në vendin tonë dhe kthehen të kënaqur në vendet e tyre, ku flasin me simpati për realitetin në Shqipëri. Ne ushqejmë respekt për gazetarët demokratë përparimtarë francezë dhe të tjerë që vijnë në vendin tonë, shkojnë kudo dhe pastaj shkruajnë miqësisht dhe realisht, me aq sa u lejon shikimi i botëkuimit të tyre. Ne kemi respekt për shkencëtarët gjermanë, francezë, austriakë e të tjerë, për agronomin shkencëtar italian, që politikisht nuk mendojnë si ne, por që, pasi njihen me realitetin tonë, shkruajnë për të në mënyrë miqësore e të sinqertë.

Më treguan një ditë se në vendin tonë para disa kohësh kishin ardhur dy industrialistë të huaj, nga të cilët kishim blerë disa makineri. Këta njerëz vizituan disa qytete dhe, para se të largoheshin, u thanë shokëve tanë në mes të tjerash: «Gazetat reaksionare jastë bëjnë një propagandë shpifëse për vendin tuaj, të cilin ne e gjetëm të bukur e të përparuar, krejt ndry-

she nga ç'na thuhet. Por ne po ju themi se me ardhjen këtu dëshironim të vërtetonim me sytë tanë tri gjëra, prandaj brodhëm pér këtë qëllim me kujdes rrugët e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit, ditën dhe natën. E para, jashtë shkruhet se në Shqipëri ka ushtri kinez. Ne kërkuam e kërkuam të shihnim, por nuk pamë asnjë ushtar kinez. E dyta, u përpoqëm dhe kërkuam të shihnim një person të dehur në rrugë ose në kafe dhe nuk mundëm të gjenim qoftë edhe një. E treta, jashtë thonë se ju vuani nga uria. Ne kudo që shkuam nëpër Shqipëri, ditën dhe natën, donim të shihnim një lypës të kërkonte lëmoshë, por as lypës nuk gjetëm. Na besoni se këto që themi i pamë me sytë tanë».

Shqipëria socialiste nuk mund të bëhet kurrë fusha e degjenerimit kapitalisto-borgjez. Atë as nuk e verbon, as nuk ia merr mendtë dhe logjikën dollari ose rubla. Ajo rritet e zhvillohet e shëndoshë në rrugën e ndritur që i ka caktuar Partia e saj marksiste-leniniste. Dhe në këtë rrugë të drejtë, të ndershme, plot dinjitet, ajo ka kudo në botë miq të panumërt e të sinqertë. Republika Popullore e Shqipërisë dhe populli i saj kanë shokë besnikë, në politikë dhe në ideologji, por kanë edhe miq të atillë që i duan dhe i respektojnë pér trimërinë, pér pjekurinë, pér respektin që rrezatojnë me punën e tyre, pér drejtësinë dhe kurajën e tyre civile në arenën ndërkombëtare.

Tradhtia e hruščovianëve ishte një e keqe e madhe pér komunizmin, një rrezik kërcënues i ri që u shtohej njerëzimit dhe botës. Të gjithë nuk ishin të ndërgjegjshëm dhe nuk e kuptionin, bile disa nuk e kuptionin akoma si duhet këtë rrezikshmëri. Në histo-

rinë e lëvizjes komuniste ndërkombejtare Partia e Punës e Shqipërisë ka meritën që e kuptoi këtë rrezik dhe i hapi luftë të pamëshirshme, pa asnje kompromis, pa marrë parasysh asnje sakrificë. Në botën e komplikuar dhe në kaosin politiko-ideologjik që u krijuat me tradhtinë e hrushovianëve, disa e quajtën të drejtë e parimore qëndresën e Partisë sonë të Punës, të tjerë aventureske e donkishoteske. S'munguan edhe ata që na akuzonin të shitur tek imperialistët. Por përveç miqve dhe shokëve që na aprovonin dhe na mbronin në rrugën tonë të drejtë e me plot sakrifica, edhe vetë koalicioni armik imperialisto-revizonist që na luftonte, e dinte se ne nuk ishim të shitur. Disa, si imperialistë që janë, e nënvleftësonin forcën tonë dhe numëronin me javë jetën e regjimit socialist në Shqipëri pasi, duke iu referuar biblës së tyre, thoshin «lufton Davidi me Goliatin». Kurse revizonistët sovjetikë, në ditët e para, kur gjëzonin frytin e tradhtisë së tyre, thanë se, me presionet e para të mëdha që do t'u bënин komunistëve shqiptarë, këta do të gjunjëzoheshin përpara tyre.

Faktet historike vërtetojnë se ishin ata që u thyen dhe po thyhen përpara Partisë së çeliktë të Punës të Shqipërisë dhe shtetit shqiptar, duke kërkuar të pushohej polemika, duke kërkuar të rivendoseshin marrëdhënie tregtare, të rilidheshin marrëdhëniet diplomatike etj. Tradhtarët revizonistë sovjetikë që s'na e kafshuan dot dorën, tanj duan të na e puthin, por grushti i popullit dhe i komunistëve shqiptarë është i mbyllur, ai i ka goditur dhe do t'i godasë gjithnjë e më me forcë.

Ata e dinë fare mirë se populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore e Shqipërisë janë armiqtë e tyre të betuar, monolitë e të pamposhtur. Te ne nuk kalojnë as kërcënimet me armë e invadim të klikës tradhtare Brezhnev-Kosigin dhe as demagogjitetë e saj me degën e ullirit. Aventurave të tyre ushtarake fashiste ne nuk u trembemi dhe jemi plotësisht të përgatitur t'u bëjmë ballë me sukses, kurse lajkat, demagogjitetë, diversionet e kreditë ne nuk i hamë, s'na gënjejnë dot me to. Kalanë tonë ata nuk e marrin dot as nga brenda, as nga jashtë. Na mbetet vetëm rruga të luftojmë dhe ne do të luftojmë kundër tyre deri në fitoren e plotë të socializmit dhe të komunizmit.

Ju kujtohen, shokë dhe shoqe, etapat e luftës së lavdishme të Partisë sonë kundër revizionizmit modern. Sot, në dritën e fakteve dhe të rrjedhimit të historisë, vërtetohet drejtësia e vijës së saj marksiste-leniniste, e parashikimeve të drejta dhe e vendimeve të saj konsekiente.

Revizionistët hruščovianë u përpoqën me të gjitha forcat të shuanin polemikën në mes partive marksiste-leniniste dhe atyre partive që e kishin tradhtuar marksizëm-leninizmin, në mes marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë. Partia e Punës e Shqipërisë nuk e pranoi për asnjë moment këtë manovër antimarksiste të revizionistëve, që kishte për qëllim jo vetëm të mbulohej tradhtia e renegatëve, por edhe të mbështeteshin e të ndihmoheshin këta në veprimet e tyre taktike dhe strategjike. Revizionistët, me «pushimin e polemikës», kërkonin të legalizonin luftën

kundër komunizmit nga vetë komunistët, t'i detyronin këta të fundit të pranonin shmangjet e tyre antimarksiste si një «thesar të ri» dhe q'thesar (!) që i sillej marksizëm-leninizmit në kohët aktuale.

Natyrisht lufta parimore dhe e guximshme e Partisë sonë u solli dëme të mëdha revolucionistëve modernë dhe nuk i lejoi t'ia arrinin qëllimit të tyre kryesor. Ata u demaskuan keqas, hap pas hapi dhe në çdo veprim të tyre, të brendshëm dhe ndërkombëtar. Ky ishte një sukses i madh për marksizëm-leninizmin mbi revolucionizmin modern.

Polemika dhe lufta e rreptë e partive marksiste-leniniste dhe e komunistëve revolucionarë në botë bënë jo vetëm që paraja kallp të demaskohej, por nuk i lanë revolucionistë hrushovianë të kalonin në histori si marksistë-leninistë dhe të mundnin të vendosnin hegjemoninë e tyre në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. U bë çarja e marksistë-leninistëve dhe e revolucionistëve, proces ky që po vazhdon me sukses. Ky është një sukses tjetër i madh për marksizëm-leninizmin mbi revolucionizmin modern.

Të shpartalluar në këtë luftë të madhe ideologjike, revolucionistët hrushovianë u përpdqën dhe vazhdojnë të bëjnë përpjekje të dominojnë në klanet revolucioniste botërore. Por edhe këtu policentrizmi, kontradiktat dhe lufta në mes klikave revolucioniste në fuqi, në shtetet dhe në partitë revolucioniste ku ata sundojnë, po e minojnë rëndë këtë orvatje të dëshpëruar të borgjezisë së re shoviniste sovjetike. Klikat revolucioniste që janë në fuqi, janë në grindje dhe kanë kontradikta me revolucionistë sovjetikë, kurse klikat udhëheqëse në par-

titë revizioniste në vendet kapitaliste çdo ditë e më shumë e identifikojnë veten me fraksionet dhe me korrentet e ndryshme politike të borgjezisë reaksionare vendëse. Ky është, gjithashtu, një sukses tjetër i marksizëm-leninizmit, pasi armiku i maskuar ideologjik demaskohet, shpartallohet.

Disa pseudomarksistë, që janë në fuqi, përpilen të grupojnë fraksionet e huaja disidente të revizionistëve sovjetikë, t'i rehabilitojnë dhe t'i kalojnë në një platformë «marksiste» si ajo e tyrja. Kjo është një orvatje e pashpresë dhe marksistë-leninistët nuk mashtrohen kurrë nga këto akrobaci të falimentuara.

Imperializmi, stadi suprem i kapitalizmit, është i dënuar nga historia të zhduket, por zhdukja e tij duhet të shpejtohet. Sot në arenën ndërkombëtare po ndeshen forcat revolucionare progresive me forca kundërrevolucionare regresive, po ndeshen kapitalistët, imperialistët, borgjezia kapitaliste reaksionare me klassën punëtore, me fshatarësinë punonjëse, me inteligjençien revolucionare. Forcat në ndeshje nuk janë të ndara me mure dhe qartësia politiko-ideologjike nuk është e njëjtë kudo. Revolucioni që po ngrihet nuk ka dhe nuk mund të ketë kudo as prirje dhe as intensitet të njëlllojtë. Natyrisht, këtu ndërhyjnë shumë faktorë, përleshën faktorë pozitivë dhe negativë, por lufta, përpjekjet, sakrificat sqarojnë, eliminojnë anët e këqija, forcojnë anët pozitive. Politika, ideologjia, zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës, bëjnë punën e tyre pozitive ose negative, sipas kushteve reale të forcave në ndeshje. Në këtë përleshje të madhe revolucionare detyra

e partive marksiste-leniniste është t'i sqarojnë masat e popujve politikisht dhe ideologjikisht, t'u tregojnë atyre cili është armiku, ku është, si fshihet e organizohet, si na shfrytëzon dhe si duhet luftuar pa mëshirë ai dhe aleatët e tij, si duhet të organizohemi kundër tij dhe si ta godasim me të gjitha mjetet.

Imperializmi amerikan është armiku kryesor dhe më i egër i popujve. Kjo nuk duhet të konsiderohet dhe të thuhet si një slogan, prandaj në të katër anët e botës është e domosdoshme të organizohet nga të gjithë popujt një luftë e rreptë kundër kësaj kuçedre. Por imperializmi amerikan nuk është i vetmi armik i popujve. Ai ka mbështetjen e shumë miqve të tij kapitalistë në botë, të cilët, me veprime të koordinuara ndërkombëtare, me presione të shumëlllojta apo me shtypje kombëtare për të ruajtur sundimin e tyre mbi popujt që shfrytëzojnë, janë në aleancë politike, ideologjike, ushtarake me imperializmin amerikan, pavarësisht nga mosmarrëveshjet ose kontradiktat e natyrshme që kanë në mes tyre. Të thuash se luftoj imperializmin amerikan dhe, nga ana tjetër, të mos luftosh e të mos punosh për të dobësuar mikun dhe aleatin e tij, që e ke mu brenda në shtëpi, të mos luftosh me ashpërsi njëkohësisht edhe revisionistët modernë, atëherë lufta kundër imperializmit amerikan mbetet një slogan. Imperializmi amerikan dëshiron të sundojë botën, ai thith gjakun dhe pasuritë e popujve të tjerë, mban baza ushtarake dhe ndërhyn me armë kudo ku miqtë e tij kapitalistë rrezikojnë pozitat e tyre. Pra, ai ndërhyn me armë, jo për të shpëtuar

vetëm lëkurën e një Lon Noli, por, në radhë të parë, për të mbrojtur interesat e tij politikë, ekonomikë dhe strategjiko-ushtarakë.

Por le të kalojmë te një tjetër armik që nuk është më pak i rrezikshëm, më pak i egër dhe më pak dinak nga imperialistët amerikanë. Këta janë revisionistët modernë, me revisionistët sovjetikë në krye, klika tradhtare e Brezhnev-Kosiginit.

T'i demaskosh dhe t'i luftosh këta armiq, me këtë u ke bërë shërbimin më të madh popullit dhe partisë tënde, marksizëm-leninizmit, socializmit, revolucionit. Gjithashtu, duhet thënë dhe ritheksuar edhe një herë me forcë se me këtë u ke bërë shërbimin më të madh internacionalist edhe popujve të Bashkimit Sovjetik dhe revolucionarëve të vërtetë marksistë-leninistë sovjetikë, të cilët ne nuk i konfondojmë me revisionistët.

«Bashkekzistenca paqësore» ashtu siç e kuption klika hrushoviane, e cila kërkon paqe me këdo dhe me çdo kusht dhe që bën thirrje histerike «të harrojmë ç'na ndan», «të shohim ç'na bashkon», i ka kënaqur imperialistët. Tani imperialisto-revisionistët po përpinqen bashkërisht të krijojnë një mjegull në kokën e njerëzve, se gjoja kush mendon dhe vepron jashtë parullave të tyre, na qenka një luftënxitës, anakronik dhe një politikan jo i modës. Dhe prandaj ndonjë «i zgjuar» jashtë mund të thotë: «Po bashkekzistenca paqësore që e pranoni edhe ju komunistët shqiptarë, ku hyn, si kuptohet, si zbatohet nga ju?». E kemi përdetyrë t'ua shpjegojmë këtë të gjithëve.

Për Partinë e Punës të Shqipërisë ka dy lloj bashkekzistence, ajo leniniste dhe bashkekzistenca pa-

qësore revizioniste hruhoviane. Ne jemi me të parën dhe kundër së dytës. Në bazë të bashkekzistencës leniniste, që zbaton me konsekuençë Partia jonë, ne jemi dhe luftojmë aktivisht për revolucionin, nuk heqim kurrë dorë nga lufta politike dhe ideologjike për të mbrojtur fitoret tona dhe marksizëm-leninizmin, në platformën kombëtare dhe ndërkombe. Ne jemi kundër luftërave grabitqare shtypëse imperialiste, por jemi për luftërat e drejta dhe i ndihmojmë aktivisht popujt që luftojnë kundër robërisë fizike, politike, ekonomike etj., jemi kundër imperializmit, me imperializmin amerikan në krye dhe kundër revizionizmit modern, me revizionizmin sovjetik në krye, jemi për revolucionin botëror dhe luftojmë aktivisht për të. Ne përkrahim politikisht dhe ideologjikisht të gjitha lëvizjet përparimtare, jemi dhe dëshirojmë të kemi marrëdhënie të mira, korrekte, shkëmbime tregtare e kulturore edhe me vende e shtete që kanë regjime të ndryshme nga yni, por me kusht që këto marrëdhënie të qëndrojnë në normat e pranueshme nga të dyja palët, pa ndërhyrje, pa presione politike, pa shantazhe e kërcënimë për njëri-tjetrin. Ne nuk jemi as kundër një paqeje të drejtë dhe të vërtetë në botë, as edhe kundër një çarmatimi të vërtetë, të plotë e të përgjithshëm.

Ja cila është bashkekzistenca leniniste që zbaton Partia e Punës e Shqipërisë. Kujt i pëlqen, shumë mirë, kujt nuk i pëlqen, aq punë na prish.

Partia e Punës dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë janë fare mirë në gjendje të gjykojnë dhe të vlerësojnë rrezikshmërinë e koniunkturave

ndërkombëtare, të vlerësojnë miqtë dhe armiqtë dhe asnjëherë nuk do ta futin atdheun e tyre në kombinacione të shtrembra, të përgatitura ose të pompuara nga politikanë të falimentuar që mendojnë të luajnë kartën e tyre me dy faqe.

Bashkekzistencë paqësore revizioniste hrushoviane është në kundërshtim flagrant me leninizmin. Ajo i përshtatet dhe pasqyron gjithë kursin ideologjik, politik, ekonomik, organizativ e ushtarak të tradhtarëve të marksizëm-leninizmit. Bashkekzistencë paqësore për revisionistët do të thotë, në fakt, pajtim ideologjik me armiqtë e revolucionit dhe të socializmit, pajtim që u arrit pas shumë peripecish e akrobacish të klounit Hrushov. Ky pajtim ideologjik dhe politik me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare botërore u arrit pasi u shkallmuva Partia Bolshevikë e Bashkimit Sovjetik, u shkallmuva ndërtimi i socializmit, u diskredituan lufta patriotike dhe Stalini, u degjenerua komsomoli, u minuan industria dhe socializmi në fshat, u shtua terrori brenda në vend dhe u mëkëmb e u forcua kundërrevolucioni në fuqi. Të gjitha këto «suksesë të komunizmit» në Bashkimin Sovjetik ishin aq të mëdha saqë bashkekzistencë paqësore hrushoviane lulëzoi: imperializmi amerikan, nga armiku i komunizmit dhe i revolucionit, u bë aleati dhe partneri më i mirë i Bashkimit Sovjetik. Kapitalet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste vërshuan në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera «socialiste». Kapitalistët, me fjalë të tjera, financojnë «ndërtimin e komunizmit» në Bashkimin Sovjetik. Tani, siç dihet, grupimet titiste, revisionistët

sovjetikë dhe të gjithë pjesëmarrësit e Traktatit të Varshavës zbatojnë teoritë trockisto-buhariniste për integrimin në socializëm të kapitalizmit amerikan, revanshizmit të Bonit dhe militarizmit japonez.

Revizionizmi modern, si një korrent i fortë borgjez antimarksist e antileninist, duke ardhur në fuqi në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera socialiste, do të kryente në to transformimin e shoqërisë socialiste në atë borgjeze, do t'i jepte prova të kapshme kapitalizmit botëror se ky transformim është real dhe mund të bisedohej me të, mund të merreshin vesh, mund të merrnin vendime të përbashkëta në interesin e përbashkët kundër socializmit dhe revolucionit. Format dhe maskat që përdornin ishin të nevojshme, bëheshin dhe bëhen përpjekje që çdo gjë të mbulohet me emrin e Leninit. Reformat kapitaliste në Bashkimin Sovjetik, sipas revizionistëve hrushovianë, janë «leniniste», «partia e të gjithë popullit» është «leniniste», ajo që thanë përpara se Stalini është një «kriminel» është «leniniste». Të nxirret Bashkimi Sovjetik në ankand dhe pasuritë e tij të shiten te kapitalistët është «leniniste»; të sulmohet dhe të pushtohet një vend «socialist» si Çekoslovakia është «leniniste»; të pushtohen vendet socialiste nga ushtritë sovjetike, edhe pse kanë kaluar 26 vjet nga mbarimi i luftës, kjo është përsëri «leniniste»; të sulmohet Shqipëria socialiste është «leniniste», siç janë «leniniste» alcancat e revizionistëve sovjetikë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe marrëveshjet me revanshistët e Bonit e me militaristët japonezë. Kështu ne mund të vazhdojmë të numërojmë pa mbarim.

Revizionistët modernë hrushovianë sovjetikë janë tradhtarët më të mëdhenj që ka njohur deri tani komunizmi ndërkombe tar pasi ata, duke tradhtuar marksizëm-leninizmin, vunë kundër revolucionit, kundër proletariatit botëror, kundër çlirimit të popujve, Bashkimin Sovjetik, prestigjin e tij të madh, të arritur në sajë të heroizmave të popujve sovjetikë, forcën e tij ekonomike dhe ushtarake. Nga një bazë për revolucionin, ata e ktheyen Bashkimin Sovjetik në një mbështetje për kapitalizmin botëror. Prandaj t'i mbështetësh këta tradhtarë është tradhti ndaj revolucionit dhe popujve.

Bashkekzistenca paqësore hrushoviane, që Partia e Punës e Shqipërisë e demaskoi me të gjitha forcat, është një platformë politike reaksionare, kundërrevolucionare, që synon shkatërrimin e socializmit, që ndihmon luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe përkrah e mbështet kapitalizmin botëror, i cili ka hyrë në kriza të mëdha. Me një fjalë, ajo ka për qëllim shuarjen e revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

Pagen, që e duan dhe për të cilën luftojnë popujt e botës, nuk e duan imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë, kapitalizmi botëror. Këta janë armiq të pages. Me page këta kuptojnë sundimin e tyre mbi botën, mbi popujt. Që të sundosh, të pasurohesh, të zgjerosh sferat e sundimit e të grabitjes duhet të shtypësh rezistencën e popujve dhe të hysh në konflikte e luftëra grabitqare me të tjerët që kanë të njëjtat synime. Imperializmi, socialimperializmi dhe i gjithë kapitalizmi botëror vazhdojnë të rrojnë në sajë të kësaj politike, prandaj në çdo kohë, qoftë në atë të një

«paqeje relative», qoftë kur imperialistët e ndryshëm shpërthejnë «konflikte lokale», ata përgatiten për luftëra lokale, të pjesshme apo botërore. Gjatë këtyre përgatitjeve ata kërkojnë nga popujt qetësi, të rrinë urtë, të aprovojnë dhe të duartrokasin veprimet e tyre. Ata që i kundërshtojnë në qëllimet e tyre të errëta, cilësohen prej tyre luftënxitës, kundër paqes, kundër uljes së tensionit. Në rast se ngrihen me armë kundër tyre, për lirinë dhe pavarësinë e vendit të vet, atëherë avionët, kryqëzorët, tanket vërsulen për të shtypur «rebelët». Të gjithë köta barbarizma bëhen në emër të «paqes», në emër të «bashkekzistencës paqësore», në emër të «qytetërimit të kulturuar» borgjez kapitalist.

Luftërat në botë i kanë shpërthyer kapitalizmi dhe fuqitë e mëdha imperialiste. Ata po i përgatitin dhe do t'i shpërthejnë edhe paskëtaj, në qoftë se këtë mundësi nuk ua heq revolucioni. Këto veprime, këto luftëra grabitqare i veshin me formula, me demagogji. Afër kërbaçit dhe bombës ata kanë ngritur kudo edhe një rrjet të gjerë propagande, një rrjet partish me lloj-lloj etiketash pseudodemokrate, pseudosocialiste e revisioniste për të gënjen e për të helmatisur opinionin, për të përçarë unitetin e popujve në luftë e në revolucion kundër sundimit kapitalist. Prandaj, kushdo që lufton për çështjen e revolucionit e të popullit nuk mund të qëndrojë duarlidhur përparrë këtij kursi imperialisto-revisionist, përparrë qëllimeve dhe manovrave të tyre. Të reagosh, të luftosh kundër të gjitha të këqijave dhe mashtrimeve të këtij kursi, do të thotë t'i shërbesh çështjes së popullit.

Populli shqiptar, Qeveria e tij dhe Partia e Punës e Shqipërisë që i udhëheq, u kanë shpallur luftë të hapur këtij kursi dhe protagonistëve të tij, imperialistëve amerikanë, socialimperialistëve sovjetikë dhe borgjezisë reaksionare. Vuajtje dhe mjerime të mëdha ka pësuar Shqipëria nga këta. Me popujt e tyre populli ynë ka qenë dhe është mik. Por në qoftë se Shqipëria nuk u zhduk nga faqja e Evropës, kjo i takon luftës heroike të popullit të vet. Kjo të jetë e qartë për të gjithë jashtë. Faktori i brendshëm ka qenë vendimtar, pa të nuk do të kishte Shqipëri të lirë; faktori i jashëtëm, ai i Ushtrisë heroike Sovjetike të Stalinit, ishte i dyti. Kështu vazhdon të jetë edhe sot kjo çështje, kështu do të jetë edhe nesër. Shqipëria socialiste rron dhe do të rrojë e lirë, e pavarur, sovrane, sepse është e fortë, sepse është një vend i vërtetë socialist.

Politika e Republikës Popullore të Shqipërisë është e qartë dhe e vendosur në mbrojtjen e interesave të saj të ligjshëm dhe në interes të lirisë së popujve e të revolucionit. Kjo politikë gjëzon simpatinë dhe ka mbështetjen e popujve përparimtarë dhe revolucionarë. Ajo urrehet dhe luftohet vetëm nga armiqtë tanë, ndërsa respektohet nga njerëzit e logjikshëm, pavarësisht se nuk janë dakord me ne. Ky është realiteti dhe ai është shumë pozitiv.

Ne fjalët nuk i ndajmë kurrë nga veprat, mendimet nuk i fshehim, por i themi haptazi, etiketat borgjeze nuk i njohim dhe nuk mund t'i zbatojmë as me shtetet borgjeze me të cilat kemi marrëdhënje. Ne jemi korrektë në marrëdhëniet shtetërore dhe kërkojmë të njëjtën gjë edhe nga të tjerët ndaj vendit tonë.

Ne as ia kemi nderur, as do t'iia nderim dorën kurrikujt për lëmoshë. Revizionistë nuk jemi. Për nejeta e çdo qytetari është e shtrenjtë. Atdheun dhe liritë e fituara me gjak nuk i shesim për lecka. Tregti të leverdishme, po, bëjmë e do të bëjmë dhe me të gjitha ato vende kapitaliste që dëshirojnë dhe sillen korrekte me Republikën Popullore të Shqipërisë ne mund edhe t'i shlojmë marrëdhëni tregtare.

Revizionistët sovjetikë do të thonë, sikurse bëjnë çdo ditë: «Ç'marksistë jeni ju që bëni tregti me vendet kapitaliste dhe nuk bëni me ne?!.» Ne u themi atyre: «Ju jeni renegatë, ju jeni nga kapitalistët më të këqij. Por edhe nga ana shtetërore për të bërë tregti me ju mos harroni se i keni borxhe të mëdha Shqipërisë, borxhe politike, borxhe ideologjike, borxhe ekonomike, të cilat edhe pasi t'i lani krejtësisht, e botërisht, përsëri Republika Popullore e Shqipërisë do të mendohet nëse e meritoni të shkëmbejë disa plaqka tregtare me ju. Dhe ky qëndrim yni është plotësisht marksist, pasi, duke ju demaskuar ju, fitojnë revolucioni dhe komunizmi. Ju kërkon që ne t'ju hapim qoftë edhe një dritare të vogël për ta pasur atë si kapital shfajësimi për tradhtinë tuaj të madhe, por dijeni mirë se ne asnje pikë uji nuk ju japim edhe në shtratin e vdekjes.

Qëndrimet tona ndaj jush janë të peshuara, të drejta, të marra në dritën e marksizëm-leninizmit. Dokumentet e Partisë sonë e vërtetojnë këtë, ato vërtetojnë durimin tonë marksist dhe egërsinë tuaj fashiste, pjekurinë tonë politike dhe aventurizmin tuaj. Ju na goditët, ne ju dhamë breshërinë; ju kujtuat se do të

na likuidonit, ne i dërrmuam planet tuaja, ju demas-kuam dhe bota njozu fyttyrën tuaj të vërtetë».

Shokë dhe shoqe,

Lufta e Dytë Botërore ka 25 vjet që ka marrë fund. Megjithatë, me përjashtim të disa shteteve, të gjitha shtetet e tjera të Evropës, të ashtuquajtura të lira, të pavarura, sovrane, janë të pushtuara nga ushtri të huaja, nga ushtritë sovjetike dhe amerikane. Ironia qëndron në atë që të dy këto shtete imperialiste, ndërsa nuk pushojnë së foluri për paqen dhe për lirinë e popujve, për demokracinë dhe për sovranitetin kombëtar, për çarmatin e plotë e të përgjithshëm, për ndalimin e armëve atomike, në realitet politika e tyre imperialiste po puqet, ato po miqësohen me njëra-tjetër, kanë nënshkruar një sërë traktatesh, kanë ndarë zonat e influencës dhe kudo në botë duken veprimet e tyre të akorduara. Ushtritë e këtyre dy fuqive mbajnë të pushtuara Evropën, ato janë armatosur deri në dhëmbë dhe po vazhdojnë të armatosen, njëra palë me sloganin «për mbrojtjen e botës së lirë», tjetra me sloganin e rremë «për mbrojtjen e botës socialiste». Ato kanë grumbulluar e perfekcionuar plot armë atomike dhe bëjnë çmos që të ruajnë monopolin e tyre. Natyrisht, Franca, që po zhvillon fuqinë e vet atomike në mënyrë të pavarur dhe u prish kështu qetësinë dhe planet e tyre hegemoniste në Evropë, është për to një «rebele».

Republika Popullore e Shqipërisë ka të thotë fjalën e saj në të gjitha këto probleme dhe ajo e ka thënë

atë kurdoherë dhe ka vepruar. Kështu do të bëjë nga-herë. Ajo ka besim në drejtësinë dhe në mbështetjen e popujve.

Traktati i NATO-s është një aleancë agresive dhe në të sundojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Republika Federalë e Gjermanisë. Ai ka për qëllim të luftojë kundër komunizmit dhe të mbajë nën thundrën dhe diktatin e imperializmit amerikan të gjitha vendet që bëjnë pjesë në këtë traktat. Forcat agresive të NATO-s u kanë zënë frymën popujve të Evropës dhe u diktojnë politikën hegemoniste amerikane. E ashtu-quajtura politikë e pavarur e brendshme dhe e jashtme e shteteve anëtare efektive të NATO-s është po aq e lirë dhe e pavarur nga diktati amerikan sa është e lirë dhe e pavarur politika e brendshme dhe e jashtme e pjesëtarëve të Traktatit të Varshavës nga diktati i Kremlinit.

Me tradhtinë e revisionistëve sovjetikë Traktati i Varshavës u shndërrua në një mjet robërues për popujt e vendeve që bëjnë pjesë në të. Ai është një traktat agresiv, gjë që e vërtetuan pushtimi i Çekoslovakisë dhe kërcënimet për invadim që i bëhen Rumanisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Shqipëria socialiste doli nga ky traktat dhe revisionistët hrushovianë na quajtën tradhtarë të socializmit, kurse shteteve kapitaliste u erdhi mirë për këtë dhe shpresuan që ne të afrohemishim me ta. Por të dyja palët mbetën me gisht në gojë. Ne ndoqëm të vetmen rrugë të drejtë marksiste-leniniste, ndihmuam socializmin dhe nuk ishim nga ata që lidhen me shtetet kapitaliste.

Partia e Punës e Shqipërisë demaskoi, tok me re-

vizonistët e Moskës, edhe veprimtarinë e agjenturave të tyre që ishin në fuqi në vendet satelite. Kur ne demaskonim klikën e Novotnit dhe, më vonë, atë të Dubçekut, Brezhnjevi dhe Kosigini putheshin me ta. E dimë si përfunduan këta dhe Çekoslovakia. Bile është për t'u theksuar se revisionistët sovjetikë, për të arsyetuar pushtimin e Çekoslovakisë, nuk munguan të thoshin se klika e Dubçekut bashkëpunonte me qeverinë revanshiste gjermane të Bonit. Tani Çekoslovakia, që quhet «vend socialist, i pavarur e sovran», rron nën thundrën e pushtuesit, nën terrorin e tij dhe të kuislingëve vendës, ndërsa klika e Kremlinit nënshkroi traktatin e miqësisë me revanshistët e Bonit.

Revisionistët modernë sovjetikë thonë se ka rënë tensioni në Evropë, por ushtritë e Traktatit të Varshavës çdo muaj bëjnë manovra ushtarake më shumë nga sa të diela ka muaji. Kjo thuhet se bëhet për të qenë në gatishmëri kundër armikut, por revanshistët gjermanë, dje komplotistë, sot na u bënë «burra të mirë»! U nënshkrua Traktati Moskë-Bon dhe po trumbetohet sikur u sigurua paqja në Evropë, sikur imperializmi gjerman dhe socialimperializmi sovjetik i pas-kan siguruar kufijtë e shteteve të Evropës. Askush nuk u pyet për këtë traktat, por pretendimet janë se që të gjithë duhet ta pranojnë dhe ta duartrokasin. Mirëpo në Evropë ndodhet një republikë e vogël socialiste, Shqipëria, që jo vetëm nuk e pranon dhe nuk duartroket për të, por përkundrazi ajo e denoncon atë botërisht dhe e denoncon jo për shpirt kontradikzioni, por pasi ka arsyë të shëndosha. Ne mendojmë se ka edhe shtete të tjera në Evropë që nuk duhet të janë

dakord me këtë traktat, por tani vetëm zëri i Shqipërisë dëgjohet në kundërshtim me të gjithë ata që e aprovojnë.

Përse jemi ne kundër këtij traktati?

Gjermania doli nga lufta si një fuqi e mundur që i shkaktoi njerëzimit mjerime të mëdha. Ajo duhej të nënshkruante traktatin e paqes me të gjitha ato vende që luftuan kundër saj dhe fituan. Klauzolat e këtij traktati duhet të ishin të atilla që revanshizmi gjerman të mos e hedhë dot më botën në një kasaphanë të re. Bashkimi Sovjetik, duke nënshkruar Traktatin Moskë-Bon, kapitulloi përpara fuqive imperialiste, përpara revanshizmit gjerman dhe shkeli të drejtat e ligjshme të të gjithë popujve që derdhën gjak. Bashkimi Sovjetik revisionist u tregua edhe në këtë rast një shtet që mbron interesat e vet, të një shteti të madh shovinist imperialist në dëm të popujve të tjerë.

Traktati i paqes me Gjermaninë duhej të konfirmonte botërisht dhe në mënyrë ndërkombëtare të dyja Gjermanitë. Traktati Moskë-Bon e la mënjanë këtë, shkeli të drejtat sovrane të Republikës Demokratike Gjermane, pranoi statukuonë e Berlinit, mundet edhe koncesione të mëtejshme në interes të revanshistëve gjermanë dhe e vuri Republikën Demokratike Gjermane në mëshirën e vullnetit të koordinuar të Kremlinit e të Bonit.

Revisionistët sovjetikë e bënë Republikën Federale të Gjermanisë një partnere të tyre të barabartë, ia ngritën shumë kreditinë në Evropë dhe në botë, kurse vendet kapitaliste, aleatët e Gjermanisë së Bonit, as që e njojin Republikën Demokratike Gjermane, bile, as

emrin s'duan t'ia përmendin, por e quajnë gjithnjë «everia e Pankovit¹».

Traktati Moskë-Bon e konsideroi Poloninë si një partnere jo të denjë për të bërë pjesë në traktat dhe çështja e kufirit Oder-Najse lihet të zgjidhet në rrugë të tërthorta ose ndër kulisa, që, natyrisht, lënë shteg për nënshtrimin e vazhdueshëm të Polonisë ndaj shantazhit revizionist sovjetik. Kjo lidhet, natyrisht, edhe me dëshirat e Bonit për të mos njojur kufijtë e Republikës Demokratike Gjermane.

Marrëveshja Moskë-Bon është ndërtuar në mënyrë që revizionistët sovjetikë të përfitojnë pjesën e luanit nga kreditë e Bonit, ndërsa satelitëve të tyre, të cilët duhet t'i binden diktatit të Moskës, t'u vënë thërrimet. Për këtë qëllim gjenden edhe ushtritë e Traktatit të Varshavës nëpër vendet e tjera revizioniste që të frenojnë dëshirat e lakenjve.

Për Traktatin e Munihut as që bëhet fjalë fare dhe kjo tregon se klika e sotme e Çekoslovakisë është një kukull e bindur e sovjetikëve.

Zhurma se Traktati Moskë-Bon është një faktor që ul tensionin në Evropë, është një mashtrim, pasi vetë në Evropë ky traktat famëkeq do t'i acarojë kontradiktat në mes vendeve kapitaliste të Evropës dhe të tre beneficiarëve kryesorë të tij — Shteteve të Bashkuara të Amerikës, revizionistëve sovjetikë dhe revanshistëve të Bonit.

Gjithashtu, është fare e qartë se ky traktat ka qëllim të krijojë njëfarë qetësie në Evropë, për t'u

1 Pankov — një lagje e Berlinit.

lënë dorë të lirë imperialistëve amerikanë dhe social-imperialistëve sovjetikë ta zgjidhin në favorin e tyre, domethënë, të shuajnë luftërat çlirimtare të Vietnamit dhe të popujve të Indokinës, të popujve arabë dhe atij palestinez, të popujve të Afrikës dhe të përgatitin luf-tët agresive të madhe kundër Kinës.

Pa u tharë mirë boja e nënshkrimit të Traktatit Moskë-Bon, renegati Brezhnev nxitoi të shkojë në Kazakistan, Taxhikistan e Kirgizi dhe mareshali Greç-ko në Mongoli, rajone këto kufitare me Kinën, ku janë përqenduar forca të mëdha ushtarake sovjetike. Karakterin antikinez të qëllimeve të këtyre vizitave nuk mund ta mbulojë asnje pretekst propagandistik.

Për këto arsyе dhe shumë të tjera, si mundet që Republika Popullore e Shqipërisë ta gjejë të drejtë një traktat të tillë të përfunduar midis dy fuqive imperialiste, një fuqie imperialisto-fashiste të mundur, të pandëshkuar dhe jo të frenuar nga një traktat paqeje, dhe një fuqie tjetër imperialisto-ekspansioniste që komplotojnë dhe kërcënojnë lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë? Edhe nga pikëpamja evropiane, po ta shikojmë këtë traktat, ai është nënshkruar midis dy fuqive imperialiste që duan të bëjnë ligjin në Evropë. Hegjemonia revizionisto-sovjetike dhe revanshisto-gjermane, sidomos që aktualisht ka bekimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe «buzëqeshjen e verdhë» të Anglisë, e sidomos të Francës, derisa të piqet konfla-gracioni i ri ndërkombëtar, synon t'u vërë bërrylin të tjerëve. Gjermania e Bonit është si veshka në mes të dhjamicit, ajo është partnere e parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO, ndërsa në Tregun e

Përbashkët është fuqia ekonomike e parë, tani ajo u bë partnere e Bashkimit Sovjetik. Vaimari filloi me Vili Brandët¹, mbaroi me Hitlerin. Ky polarizim i ri i forcave agresive imperialiste evropiane dhe botërore përpinqet t'i zërë frymën Francës. Veprime të tilla këta përpinqen t'i kurorëzojnë me aktin tjetër agresiv botëror, «sigurimin evropian», që nuk do të thotë tjetër veçse nënshtrimin e shteteve evropiane ndaj diktatit të Shtetëve të Bashkuara të Amerikës, socialimperialistëve sovjetikë dhe revanshistëve gjermanë. Ky është një pakt i ri i tipit Briand-Kellog², që e dimë kush e bëri dhe si mbaroi.

Duhet të jesh naiv në politikë që të mos diktosh qëllimet e këtyre komploteve imperialiste, duhet të injorosh ose të tradhtosh çështjen e popujve në rast se nuk i lufton këto komplot, tregohesh dritëshkurtër në rast se i sheh, por shpreson se koniunkturat do të ndryshojnë vetveti. Vepra e hitlerianëve është akoma e gjallë në kujtesën e njerëzve. Evropës nuk ia vunë zjarrin as Shqipëria, as vendet skandinave, por Gjermania hitleriane.

Republika Popullore e Shqipërisë është kundër këtij të ashtuquajturi sigurim evropian, pasi ajo e konsi-

1 Këtu ka kuptimin: me socialdemokratët.

2 Pakti Briand-Kellog, i cili mori emrin nga ministrat e atöhershëm të Jashtëm të Francës dhe Shtetëve të Bashkuara të Amerikës, u përfundua në Paris më 27 gusht 1928, nga një varg shtetesh kapitaliste. Nën parullat false të heqjes dorë nga lufta si mjet për rregullimin e grindjeve ndërkombëtare etj., fshiheshin dëshirat e SHBA-së për hegemoninë botërore dhe përgatitjet e fugive të mëdha për agresion.

deron atë robërim evropian, shtypje të lirisë, të demokracisë e të pavarësisë së popujve evropianë nga fuqitë e mëdha imperialiste dhe nga të gjitha ato gru-pime kapitaliste që janë në fuqi në vendet e tjera të Evropës dhe që ndjekin qorrazi këtë veprimitari kriminale.

Disa thonë: «Ju shqiptarët jeni të marrë, shkoni kundër gjithë botës». Kjo s'është e vërtetë. Ne s'jemi të marrë, po përkundrazi, shkojmë me të gjithë botën kundër një pakice. Ne jemi shumica, armiqtë tanë janë pakica dhe jemi ne që do t'i mundim ata.

E vërteta është se të gjitha këto ujdi imperialiste po kurdisen nga kjo pakicë, por ato kurdisen në ethe, në pasiguri të madhe për klikat. Popujt e Evropës lë-vizin, lëvizin gjallërisht punëtorët, lëviz rinia, zjarri i revolucionit po ngrihet. Këtu qëndron forca jonë, e cila nuk mund të mposhtet kurrë. Ajo do t'i përvëlojë armiqtë dhe ujditë e tyre.

I ashtuquajturi sigurim evropian që përpigjet të arrihet nën patronazhin e dy fuqive të mëdha imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe revisionistëve sovjetikë, ashtu siç synon ta vërë nën këmbët e veta Evropën, natyrisht, ka për qëllim kryesor që këto dy fuqi agresive t'i kenë duart e lira për të sunduar botën.

Imperializmi gjakatar amerikan nuk mund ta ketë jetën të gjatë në rast se popujt e botës, që po i shtyp me zjarr dhe po i shfrytëzon pa mëshirë, ia bëjnë jetën të pamundur duke u ngritur në luftë çlirimtare kundër tij dhe satelitëve që e mbështetin. Forca ekonomike e imperializmit amerikan qëndron në grabitjen e pasu-

rive materiale dhe mendore të popujve. Ai, për ta mbajtur në eficiencë këtë grabitje, ka një arsenal të madh atomik, që e shton vazhdimisht, ai ka baza ushtarake anembanë botës dhe atje ku nuk veprojnë dot në favor të tij dollari, intriga dhe diversioni, ndërhyjnë forcat e tij të armatosura.

Por rrjedha historike e ngjarjeve në botë tregon se imperializmi amerikan po tronditet nga themellet, forca e tij goditëse është dobësuar shumë. Brendapër-brenda perandorisë së tij dhe në gjirin e aleancave agresive që ka thurur po kalon nëpërmjet krizash të rënda, është duke u brejtur nga kontradikta që jo vetëm nuk zgjidhen, por shtohen e thellohen vazhdimisht.

E gjithë kjo krizë e madhe që kalon kapitalizmi botëror, me imperializmin amerikan në krye, u detyrohet ngritjes së hovit të revolucionit në botë, luftës revolucionare të proletariatit botëror, luftës nacionalçirimi-tare të popujve në të gjitha kontinentet. Krizat ekonomike, disfatat ushtarake që po pësojnë në përpjekjet e armatosura me popujt, grevat madhështore të punëtorëve në të gjitha vendet kapitaliste, pushtimi me armë i vendeve të lira, terrori fashist që ushtrohet kudo për të shtypur zezakët, studentët e të tjerë, që hidhen në sulm, nuk tregon gjë tjetër veçse ngritjen e luftës revolucionare dhe dobësimin e imperialistëve të ndryshëm dhe të revisionistëve sovjetikë. Të gjithë këta janë zënë për gryke nga popujt, prandaj, për t'i mbajtur këmbët në buzë të greminës ku janë duke shkarë, ata flasin shumë për «paqe», për «statuko»,

për triumfin e «bashkekzistencës paqësore», për zgjidhjen e konflikteve «në mënyrë paqësore», për «rolin e madh të OKB-së», ku sundojnë sovjeto-amerikanët dhe ku bëhen pallavra të kota, për rolin «paqësor» të njëfarë Jaringu¹ etj.

Socialimperializmi sovjetik, tok me imperializmin amerikan, luan edhe ky rolin kryesor në shtypjen e revoltave populllore. Revisionistët sovjetikë janë bërë partnerët kryesorë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në çdo gjë. Si bazë, si parim të politikës së tyre ata kanë miqësinë dhe diplomacinë e fshehtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo u intereson të dyja palëve, sidomos, sovjetikëve, për të mos u demaskuar. Fjalët «antiimperialiste» të revisionistëve sovjetikë në publik janë krejt demagogji, atyre tanimë asnjeri nuk u beson dhe as Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe asnje shtet tjetër kapitalist nuk u zemërohet. Këta shikojnë punën e vet, pasi politika e revisionistëve të Moskës është në ndihmë të tyre, ata mbajnë dhe zhvillojnë në mes tyre diplomacinë e fshehtë.

Revisionistët sovjetikë bëjnë agresion dhe shtypin vende të lira, krijojnë baza ushtarake dhe tregje ekonomike për të thithur pasuritë e popujve të tjerë, zgjerojnë perandorinë e tyre dhe shfrytëzojnë naivitetin ose vështirësitet e të tjerëve. Ata shuajnë hovin e revo-

1 Gunar Jaring — ish-ambasador i Suedisë në Bashkimin Sovjetik, u ngarkua nga OKB-ja për të zbatuar rezolutën numër 242 të Këshillit të Sigurimit për Lindjen e Mesme.

lucionit, shuajnë luftërat nacionalçirimitare të popujve, bien në ujdi dhe tradhtojnë tek amerikanët çështjen e popujve që luftojnë për liri, pavarësi e përparim shqëror, përpiken të rrethojnë dhe të goditin me zjarr, tok me imperializmin amerikan dhe me militarizmin japonez, Kinën. Dhe të gjitha këto ata i bëjnë nën «emrin e Leninit dhe të leninizmit».

Por e gjithë kjo tradhti do të dërrmohet nga luftërat revolucionare të popujve. Nuk mund të gënjen, në fund të fundit, popujt e lavdishëm e revolucionarë arabë nga miqësia false e socialimperializmit sovjetik, që përfitoi nga vështirësitë e tyre të përkohshme për t'u pushtuar portet, detet, për të shuar luftën e tyre të drejtë çlirimtare kundër fashistëve sionistë dhe imperializmit amerikan. Të dyja fuqitë agresive imperialiste kanë interes të zënë rrënje të thella në Lindjen e Afërt, të kenë në vendet e kësaj zone baza ekonomike, politike dhe ushtarake, të shtypin popujt e këtyré vendeve, t'i nanurisin me pallavra, t'i demoralizojnë e t'i korruptojnë dhe pastaj, nga këto baza të hidhen më tej për të pushtuar Afrikën, Azinë e vende të tjera, të ndezin luftërat koloniale e grabitqare imperialiste në kontinente të ndryshme.

Populli shqiptar i do popujt arabë pasi i ka vëllezër dhe miq në ditë të mira dhe në ditë të vështira. Në këto kohë luftërash revolucionare e çlirimtare ne jemi në çdo moment afër tyre, i kemi ndihmuar dhe do t'i ndihmojmë me çdo mjet. Ne kemi besim në triumfin e çështjes së drejtë të luftës së tyre, por fitorja sa më e shpejtë mbi armikun e përbashkët

kërkon unitetin e çeliktë të të gjithë popujve arabë në luftë të armatosur. Sionistët, imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë përpiqen t'i përcajnjë popujt arabë, t'i çarmatosin, t'u diktojnë një paqe që s'mund të jetë e tyrja, por e armiqve. Armët që u janë dhënë kontrollohen nga sovjetikët, ato nuk hyjnë në veprim për çështjen e shenjtë arabe, ato u përdorën pikërisht për t'i gënjer ata, për t'u lidhur duart e për t'i çuar si dashi te kasapi. Plani famëkeq «Roxhers», për të qenë ekzakt, mund të quhet plani «Roxhers-Gromiko». Vëllezërit arabë, sigurisht, nuk do të bien kurrë në kurthin e tmerrshëm të tij. Ushtritë sovjetike dhe amerikane me dredhi mund të vendosen në të dyja anët e kanalit të Suezit dhe atëherë popujve arabë u rrofshin hekurat që u dhanë sovjetikët. Ata nuk e dëbuat me heroizëm një imperialist nga kanali që tani ta pushtojnë dy të tjerë.

Klithmat e Dajanit janë të rakorduara me veprimet e fshehta të revisionistëve sovjetikë, por pushka heroike e vëllezërve arabë palestinezë është përgjigjja më e lavdishme, që do ta shpartallojë këtë komplot të madh të armiqve. Prandaj duhet të ndihmohet me mish e me shpirt lufta e drejtë partizane palestinezë, që është aktualisht në pararojë të luftës së shumanshme e të përgjithshme, që duhet të zhvillojnë anembanë popujt arabë. Vëllezërit arabë do të dinë ta ngrenë lart flamurin e luftës çlirimtare kundër imperialistëve dhe sionistëve, do të dinë t'i dërrmojnë planet e revisionistëve sovjetikë dhe të gjitha provokacionet e organizuara nga agjenturat e CIA-s, që nuk ia

duan të mirën luftës çlirimtare të popullit palestinez dhe të të gjithë popujve arabë.

Për vite me radhë imperializmi amerikan po pëson disfata kolosale në Vietnam, pasi populli vietnamez lufton me heroizëm, pa lëkundje dhe në unitet të plotë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndodhen tani përpara katastrofës në Vietnam: katastrofë politike, ushtarake, strategjike. Revisionistët sovjetikë kanë edhe ata vite të tëra që ndihmojnë imperializmin amerikan në Vietnam me përpjekjet që bëjnë për të shuar luftën, duke nxitur një paqe kompromisi, ata predikojnë fsheherazi dy Vietnamese, siç pranojnë haptazi dy Kina, dy Kamboxhia me njohjen e qeverisë tradhtare të Lon Nolit etj. Por revisionistët sovjetikë nuk kanë pasur dhe nuk do të kenë suksese me intrigat e tyre. Populli i Vietnamit lufton heroikisht dhe do t'i hedhë në det imperialistët amerikanë... Populli shqiptar ka qenë dhe do të jetë kurdoherë me mish e me shpirt me popullin heroik vietnamez dhe me luftën e tij të madhe kundër imperializmit amerikan dhe kukullave të Sajgonit. Ne jemi larg gjeografikisht me atë popull vëlla, por zemrat tona rrahin së toku, vuajtjet dhe fitoret janë të përbashkëta. Fitorja e popullit të Vietnamit është c sigurt, armiku amerikan do të hidhet në det tok me kukullat e tij, si nga Vietnami i Jugut, si nga Kamboxhia ashtu edhe nga gjithë Indokina...

Të tilla janë ngjarjet, të tilla janë faktet. Partia, Qeveria dhe populli ynë janë të njojur me to, çdo ditë i analizojnë, nxjerrin konkluzione dhe, në unitet të plotë, veprojnë Parti-popull-pushtet. Këtu qëndron

forca jonë, këtu qëndron forca e analizave marksiste-leniniste të ngjarjeve në botë dhe të vendimeve që merren e që zbatohen me kaq sukses në vendin tonë.

Ja pse politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë është e drejtë, e guximshme, parimore, ja pse ajo kuptohet, mbrohet dhe zbatohet nga populli ynë, ja pse shokët dhc miqtë jashtë i duan dhe i respektojnë Republikën Popullore të Shqipërisë, popullin shqiptar dhe Partinë e Punës të Shqipërisë dhe ja cilat janë arsyet që armiqtë, të cilëve ne s'ua kemi frikën, na urrejnjë dhe na luftojnë.

Të dashur shokë e shoqe,

Gjendja e tanishme e atdheut tonë është e shkëlqyeshme, e ardhmja është e sigurt. Për këtë punojnë pa u lodhur ditë e natë Partia dhe populli ynë i mrekullueshëm. Perspektivat e ndritura, që qëndrojnë përpara nesh, na e forcojnë edhe më tepër besimin në forcat tona dhe na frymëzojnë për vepra edhe më të mëdha e më të guximshme, për ta bërë Shqipërinë socialiste edhe më të fortë, edhe më të bukur, jetën e popullit tonë më të begatshme e më të lumtur.

Me zgjedhjet e reja të 20 shtatorit, duke marrë pjesë të gjithë në votime dhe duke votuar të gjithë për kandidatët e Frontit Demokratik, populli ynë do të tregojë pjekurinë e tij të lartë politike që e karakterizon, do të manifestojë edhe një herë unitetin e tij të çeliktë rreth Partisë e pushtetit të tij populor, do të korrë një fitore tjetër të shkëlqyeshme, e cila do t'i

forcojë e do t'i konsolidojë edhe më shumë bazat e patundura të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Rroftë populli ynë heroik dhe u forcoftë gjithnjë e më shumë uniteti i tij në Frontin Demokratik!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës!

Rroftë e u forcoftë pushteti ynë popullor!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 224 (6888), 19 shtator 1970*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas librit: Enver Hoxha.
«Raporte e fjalime 1970-1971»,
f. 5. Tiranë, 1972*

PROBLEMEVE TË PESHKIMIT T'U HYJMË THELLË E SHKENCËRISHT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shtator 1970

Mendoj të ngre edhe unë disa probleme rreth çështjes në diskutim, të cilat do të jetë mirë të na shërbejnë, në radhë të parë, si orientime për hartimin e planit të pestë pesëvjeçar dhe jo si vendime. Shqyrtimi i këtij problemi në Byronë Politike ka vlerën e vet, sepse si raporti, edhe diskutimet e shokëve, na vënë përpara përgjegjësive e detyrave të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të punës për zërien e peshkut, qoftë në det të hapët, qoftë në ujërat e brendshme. Siç shihet, deri tani, ky problem nuk është vlerësuar sa duhet, prandaj mendoj të ndalemi për ta analizuar më thellë gjendjen aktuale të peshkimit, të punojmë më mirë dhe të parashikojmë më drejt detyrat që na dalin për të ardhmen.

1 Në këtë mbledhje u mor në shqyrtim raporti i paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e indistrisë së peshkut në det të hapët, në ujërat e brendshme dhe në rezervuarët».

Mua më duket se, për këtë problem, kemi trashë-guar nga e kaluara një punë të paorganizuar si duhet, të pathelluar dhe aspak shkencore. Prandaj është e domosdoshme që këtej e tutje t'i jepet fund një qëndrimi të tillë. Të gjitha të metat e punës, që janë vërtetuar gjer tanë në këtë sektor, është mirë të nxitin për të nxjerrë mësimë dhe, duke u bazuar në rezultatet e arritura, si dhe në faktin se peshku është një ushqim i rëndësishëm për popullin, problemet kyç, që kanë të bëjnë me peshkimin, është e domosdoshme t'i analizojmë thellë e një nga një dhe të merren masa me të vërtetë të shëndosha për ta zgjidhur drejt këtë problem të rëndësishëm. Fakt është se mund të ishte bërë më shumë në këtë drejtim, gjë që e vërtetojnë edhe diskutimet e shokëve. Pavarësisht se nuk i kemi pasur të gjitha mundësitë, për arsyen se ka munguar baza materiale dhe kuadro kemi pasur pak, pakujdesitë që janë vërtetuar, mungesa e organizimit dhe e drejtimit të punës nga ana jonë dhe nga ana e organeve të Partisë dhe të pushtetit në rrethe e në bazë, nuk mund të na shfajësojnë.

Prandaj mendoj t'i rikthehem i edhe një herë studimit të këtij problemi, sepse, po të mbështetemi në shifrat që na janë dhënë, ato më duket nuk janë të drejta dhe reale për hartimin e planit pesëvjeçar për peshkun. Të parashikosh blerjen jashtë të motobarkave me kapacitet vjetor peshkimi më të madh, duke harxhuar për këtë qëllim disa milionë lekë valutë dhe të planifikosh zënien vetëm të 80 tonëve peshk për çdo motobarkë, kurse ne qysh sot sigurojmë 60 tonë me mjetet që kemi, nuk do të ishte aspak e drejtë,

përkundrazi shumë gabim. Vihet pyetja: Përse mbahet gjithë kjo rezervë? Ne e kemi jetuar të gjithë situatën, aq të vështirë në të kaluarën në sektorin e peshkimit. Ju e mbani mend mirë se ç'përpjekje të mëdha janë bërë nga Partia për t'i edukuar e për t'i mësuar punonjësit e peshkimit, kurse sot gjendja është krejt ndryshe. Atëherë përse të planifikojmë të zëmë më pak peshk nö det nga ç'është kapaciteti i çdo motobarke dhe të parashikojmë kështu një rritje krejt të pamjaf-tueshme të planit me törë këto mjete? Ky planifikim, më duket mua, nuk është aspak i drejtë.

Problematike për ne është edhe çështja e peshkimit në ujërat e brendshme. Ne këtu nuk japim dot një shifër ekzakte se sa do të jetë sasia e gjahut që mund të kapet në këto ujëra. Këtë e kanë për detyrë ta studiojnë njerëzit e mësuar që merren me rritjen e me zhvillimin e peshkut, por mendoj se sasia që mund të kapet në ujërat e brendshme nuk varet vetëm nga numri i hektarëve ku do të bëjmë popullimin me peshq, por edhe nga llojet e tyre, nga intensiteti i popullimit të rasateve, nga mosha e madhësia që duhet të ketë rasati para se të hidhet në lumenj, në liqene, apo në rezervuarë për t'u rritur e për t'u zhvilluar, nga ushqimi që do t'u sigurojmë jo vetëm brenda qendrave ku do të zhvillohen, por edhe atje ku do t'i hedhim, nga vendi e nga mënyra e rritjes në liqene të hapëta, në basene, në lumenj, nga përcaktimi shkencor i kohës së lejueshme për peshkim në këto ujëra etj. Ka, pra, një sërë problemesh shkencore që duhen studiuar e duhen zgjidhur me kujdes. Problemin e peshkimit në këto ujëra na bie barra ta studiojmë një çikë më

thellë e më seriozisht, ta vlerësojmë si duhet dhe të nxjerrim detyrat që na bien të kryejmë pér të ardhmen në bazë të përvojës së arritur deri më sot, në bazë të praktikës së peshkatarëve tanë, po edhe në bazë të tē dhënavë të shkencës së përparuar.

Unë e kuptoju çështjen e studimit të peshkut si një gjë me shumë rëndësi. Ne e studiojmë blegtorinë në mënyrë të imët dhe pér këtë kemi grupe të tēra njerëzish, si: veterinerë, zooteknikë e specialistë të tjera, kemi qendra zooteknike etj. Këtë që thua ti¹, që pér peshkun kemi studime me 3 e 4 veta, të cilët breshin sa andej-këndej, unë nuk i quaj studime. Kësaj çështjeje duhet t'i shkohet gjer në fund. Peshku është një krijesë e gjallë, i cili lind, zhvillohet, jeton, ushqehet e vdes. Që peshku të popullohet, ka disa kërkesa pér t'u ushqyer, ka mënyrën e tij të tē jetuarit që lidhet me klimën, me ujërat etj., pra janë një sërë faktorësh që kërkojnë një studim të thellë. Që tē bëhet kjo duhen njerëz të specializuar. Kështu duhet ta shtrojmë çështjen pér zhvillimin e peshkut, siç e kemi pér blegtorinë, ndryshe nuk mund tē ecim përparrë në këtë sektor me rëndësi. Qendra e kërkimeve shkencore të ihtiologjisë është medoemos e nevojshme, mirëpo ajo është prishur²; atëherë si mund tē bëhet kjo punë në mënyrë shkencore?

¹ I drejtohet Koço Theodhosit, në atë kohë ministër i Industrisë dhe i Minicrave.

² Stacioni i Kërkimeve Shkencore të Peshkimit, që ishte ngritur më 1958 në Durrës, u shkri në vitin 1965. Ai u rikrijua më 1972.

Praktika e gjuetisë së peshkut te ne s'ka dyshim që është e vjetër, por, pavarësisht nga mundësitet e shumta që kanë ekzistuar, me një bregdet relativisht të gjatë, me plot lumenj e liqene të mëdha e të vogla, kjo gjueti është zhvilluar në një masë pak a shumë të kufizuar. Zona më e përshtatshme dhe më e pasur për peshkim në Shqipëri ka qenë dhe, natyrisht, është bregdeti, megjithatë banorët e kësaj zone gati e kanë harruar këtë profesion. Në qoftë se kanë peshkuar përpara, këtë e kanë bërë peshkatarët në Shkodër e në Nartë, prandaj edhe në terrenin praktik ne kemi pak përvojë në fushën e peshkimit. Peshkatarët tanë, me gjithë vështirësitet e profesionit, të cilave ata nuk u shmangen dhe janë të gatshëm t'i shërbejnë popullit me të gjitha forcat e tyre, nuk e kanë eksperiencën shekullore të barinjve, të cilët njojin mirë, nga përvoja e gjatë, shumë të fshehta të zanatit të tyre dhe eksperiencën, që kanë fituar tradicionalisht në mënyrë empirike, kanë arritur ta konkretizojnë e ta kthejnë në shkencë, megjithëse të pashkruar. Prandaj është e nevojshme të bëhen përpjekje më të mëdha që në peshkim planin në të ardhmen ta hartojmë duke u bazuuar në të gjitha këto të dhëna që thashë dhe, mbi këtë bazë, të nxjerrim detyrat, të cilat të bëjmë përpjekje t'i kryejmë medoemos dhe gjer në fund.

Për ta realizuar gjithë sasinë e peshkut që parashikojmë të zëmi, çështja, pra nuk varet vetëm te mjetet që duhet të kemi. Kryesorja është më shuni të zotërimi i shkencës përkatëse, që merret me problemet e peshkut, nga punonjësit tanë të peshkimit. Po t'i hedhim një sy vetëm eksperiencës që kemi për gjuetinë

e sardeles, që është një nga llojet e peshqve, për të cilën kemi njojuri më shumë, shohim se akoma edhe sot nuk njohim shumë të dhëna të domosdoshme shkencore për një punë me rezultate të frytshme, siç janë: emigrimet e sardeles, drejtimet dhe koha kur ajo lëviz, kur shumëzohet e shumë gjëra të tjera, mosnjojja e të cilave bën që të mos ecim me ritmet që dëshirojmë në realizimin e planeve të zënies së peshkut.

Është e domosdoshme, së pari, të zbulojmë e të njohim ku janë përqendrimet, çfarë lloj peshqish kemi, të bëhet rikonjicioni i emigrimit të llojeve të ndryshme të tyre në stinë të ndryshme, si shumëzohen e shumë karakteristika të tjera, pastaj të nisemi të gjuajmë e jo kuturu. Ky për ne është një libër pothuajse i mbyllur. Ne duhet ta hapim patjetër këtë libër, por për këtë qëllim është e nevojshme të kemi edhe kuadro, edhe atë që e përmendi këtu shoku Petro Dode¹, mjetet e duhura për studim.

Ne duhet të mendojmë, gjithashtu, edhe për mbrojtjen e peshqve në ujërat tona dhe të mos lejojmë peshkimin në çdo kohë e pa kriter, gjë që çon në shfarrsjen e të vegjelvë në kohën e shumëzimit, ndryshtet punët nuk do të na ecin mirë në këtë sektor. Duhet parashikuar që flota jonë të pajiset edhe me mjetet e duhura për ruajtjen e gjahut, pse shoh që këtu shtrohet të kapim disa mijëra tonë peshk në vit, mirëpo gjithë kjo sasi ose duhet të shpërndahet me shpejtësi deri te konsumatori, punë që nuk është aspak e lehtë, ose

1 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.

të kemi frigoriferë, ku peshku të ruhet dhe të shpërndahet pastaj gradualisht në rrjetin e tregtisë. Prandaj, medoemos, krahas rritjes së planit të kapjes, del nevoja të parashikohet sigurimi i mjeteve të transportit dhc të ruajtjes së peshkut.

Këto probleme duhen studiuar të gjitha me kujdes, thellë e në mënyrë të gjithanshme, ndryshe do të na ngjasë si puna e midhjeve që u bë çështje deri në Byronë Politike se, për faj të drejtuesve të Ministrisë së Tregtisë, rrezikohen të na shkojnë dëm 500 kuintalë. Si mundet t'i lejojmë ne këta njerëz të urdhërojnë me anë të një telegrami të shkatërrojnë ekonominë? Unë në asnjë mënyrë nuk jam dakord me këtë mënyrë drejtimi dhe mendoj se ata duhen dënuar rëndë për këtë shkelje. Kur ministria bën telegrame se nuk mund të eksportohen midhjet, atëherë ç'do të bëhet, përse nuk merr masa dhe të urdhërojë që këto të shiten në vend?! Edhe ti Koço [Theodhos] duhet të luftosh për këto gjëra, se je në krye të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave. Në qoftë se ju imponon Ministria e Tregtisë ligjet për prodhimin, atëherë ju nuk e kryeni si duhet detyrën. Prandaj këtë problem duhet medoemos ta atakojmë drejtpërsëdrejti dhe të marrim të gjitha masat për ta zgjidhur gjer në fund. Masat që duhen marrë për peshkimin, si një nga problemet më të rëndësishme për t'u zgjidhur gjatë pesëvjeçarit që vjen, janë të shumta, më duket mua. Nuk është çështja vetëm të përcaktojmë disa detyra të përgjithshme, por problemit t'i hyjmë thellë e konkretisht. Për këtë qëllim mendoj se edhe baza, shokët e rretheve (që, siç i dëgjuam kur diskutuan, kanë shumë idera) t'i thellojnë

më tej këto çështje dhe të na ndihmojnë më shumë. Ka edhe ide mjaft të mira, po që, për një arsy ose për një tjetër, nuk vihen dot menjëherë në jetë, pa një studim të mirë të detajuar. Ja këtu u fol për grykat e dajlanëve që janë mbushur me rërë e lym, po që, për mungesë mjetesh, nuk i kemi thelluar dot. Me se t'i hapim këto shtigje nëpër dajlanë, siç u kërkua këtu nga shokët e rretheve? Në rast se nuk i hapim dot se s'kemi draga, të mendojmë ç'rrugë të tjera të ndjekim, me qëllim që të peshkojmë më shumë. Por sa gjëra të këtilla ka që duhen parë??!

Këtu u bënë shumë propozime, të cilat, gjatë ko-hës që do të përpunojmë planin ekonomik të pesëvjeçarit të pestë për industrinë, është e domosdoshme t'i studiojmë dhe problemin e peshkimit ta thellojmë në të gjitha anët që nga çështja e kuadrove, sigurimi i mjeteve dhe përmirësimi i metodave të drejtimit, njëlloj sikurse çdo fushë tjetër të ekonomisë sonë popullore. Prandaj t'i kemi parasysh të gjitha këto që u ngriten këtu që të na shërbejnë si orientime kur të rishikojmë përsëri shifrat e paraqitura.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NAFTA DHE GAZI NDODHEN NËN TOKE, POR GABIMET NË PUNË DUKEN SHESHIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shtator 1970

Jam dakord me ato që tha shoku Adil Çarçani, por kisha për të shtuar diçka lidhur me detyrat që u dalin shokëve të sektorit të naftës e të gazit, duke fillouar që nga punëtorët e gjer te specialistët e lartë.

Punimet e kërkimit të gazit të mos i konsideroni sikur i filloni për herë të parë. Arsyetimi, sipas të cilit punimet e shpimit të puseve të gazit janë një fushë e panjohur për ne, nuk është i drejtë. Këto punime vërtet kanë veçoritë e tyre specifike, por naftëtarët tanë, që kanë 25 vjet që po kërkojnë, po shpojnë dhe po shfrytëzojnë fusha naftëmbajtëse e gazmbajtëse, e njobin tashmë përbërjen e tokave tona, disponojnë

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua edhe relacioni i Ministrisë së Industrisë e të Minierave «Mbi përfundimet e gjertanishme të punimeve të kërkimit për gaz dhe masat që duhen marrë për intensifikimin e mëtejshëm të tyre».

mjaft të dhëna të tjera të nevojshme dhe kanë një eksperiençë jo të vogël në këta sektorë.

Punimet e kërkimit për gaz, megjithëse nuk janë të njëllota me ato të kërkimit për naftë, kanë prapë-serapë elemente të përbashkëta midis tyre. Dijenitë e fituara për shtresat dhe strukturat e tokës që përmbyjnë naftë, sipas mendimit tim, ndikojnë e duhet të ndihmojnë edhe në zbulimin e rezervave të gazit. Prandaj, nuk ka arsy, mendoj unë, që gjeologët tanë, të cilët s'janë aq të rinj në këtë fushë, t'i bëjnë gabim një pjesë të mirë të parashikimeve të tyre për gazin. Ata kanë tashmë një eksperiençë të madhe, prandaj gabimet që po na ndodhin në përcaktimin e pikave të shpimit është e domosdoshme të reduktohen në një përqindje jashtëzakonisht të vogël. Nuk u lejohet kuadrove me eksperiençë të gjatë pune në këtë sektor, të parashikojnë pika shpimi të pastudiuara mirë, pse shtresat dhe strukturat e tokës gazmbajtëse nuk janë shumë të ndryshme nga ato të naftës. Veç kësaj, gjeologu, kur studion për naftën, studion njëkohësisht edhe për gazin.

Kujdes të veçantë duhet të bëjnë, gjithashtu, edhe punonjësit që shpojnë e shfrytëzojnë, pse as këta nuk janë të rinj në këtë proces pune. Puna për shpimin e puseve të gazit, me gjithë «vështirësitë dhe ndërlikimet gjeologjike», që na vë në dukje relacioni i paraqitur, nuk duhet të jetë aq e ndryshme nga puna për shpimin e puseve të naftës. Tjetër është çështja e përvetësimit të gazit. Ky mund të jetë i ndryshëm nga përvetësimi i naftës, por, siç thashë edhe më parë, nuk është e pranueshme dhe e rregullt që edhe sot, pas

kaq vjet eksperience, të na nxirren përpara si justifikim pengesat që kemi pasur në vitet e para për naftën, kur ne nuk kishim as specialistë gjeologë, as teknikë e punëtorë me eksperiencë, as kuadro dhe mjete të mjaftueshme. Tani nuk lejohet të ndiqet për gazin e njëjta rrugë që kemi ndjekur për naftën. Këtë të gjithë ta keni mirë të qartë.

Ne duhet të jemi realistë dhe të kemi kurdoherë parasysh se shteti ynë ka bërë shpenzime kolosale për naftën, për gazin dhe për përgatitjen e kuadrove për këta sektorë, mjaft nga të cilët kanë një stazh jo të vogël pune dhe, në fakt, kanë dhënë për republikën. Pikërisht për këtë arsyе edhe rendimenti i tyre në punën për zbulimin dhe nxjerrjen e naftës e të gazit tani kërkohet të jetë më i madh, me qëllim që këto prodhime t'i realizojmë me kosto gjithnjë e më të ulët, dhe të tregohet shumë më tepër kujdes gjatë punimeve për të pasur sa më pak avari dhe jo të rënda. Kjo kërkon që mjetet që vë shteti në dispozicion në këtë sektor të rëndësishëm, të përdoren drejt, të mirëmbahan, të shfrytëzohen me eficiencë, por edhe me një frysë më lartë kursimi.

Nuk duhet të udhëhiqemi në asnjë mënyrë nga mendimi jo i drejtë se në vendet kapitaliste naftën ose gazin e zbulojnë dhe e shfrytëzojnë me mjete të tjera të fuqishme, të perfektionuara etj., etj. Kapitalisti llogarit mirë çdo mjet që përdor. Ai nuk i harxhon paratë dosido, çdo mjet që vë në punë llogarit t'i japë fitim sa më të madh. Por, edhe në qoftë se ndonjë, ta zëmë, i harxhon paratë pa kursim e llogari, ai mund ta bëjë këtë, se është majmur në kurriz të masave, kur-

se neve nuk na lejohet në asnjë mënyrë dhe për asnjë rast të jemi dorëlëshuar me djersën e popullit. Mirë është të kemi mjete më të përsosura e më të shumta për të shpuar më shpejt, më mirë dhe më lehtë. Në këtë drejtim, në planifikimin që do të bëjë, shteti do të përpinqet të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e katër mjeteve e t'i shtojë ato në numër, siç ka bërë përpjekje e i ka përmirësuar gradualisht gjer tanë. Por të shkohet me mendimin që punët në sektorin e naftës dhe të gazit do të përmirësohen qind për qind vetëm në sajë të shtimit të mjeteve e të fondeve që do të vërvë shteti në dispozicion dhe të justifikohen me këto, pa të drejtë, të metat c' dobësitet e punës së njerëzve tanë, nuk është aspak e pranueshmë.

Kur bëhen analizat (dhe analiza ju keni bërë shumë), konstatohet që ka me të vërtetë nevojë akoma për mjete, por, në të njëjtën kohë ama, shikojmë se shumë nga ato që janë, nuk shfrytëzohen si duhet, me kapacitet të plotë. Në sektorët e naftës dhe të gazit, siç e dini, na kanë ndodhur shumë avari, të cilat Qeveria i analizoi kohët c' fundit, prandaj nuk dëshiroj të zgjatem për t'i përmendur edhe një herë. Këshilli i Ministrave i kritikoi dhe i ndihmoi punonjësit e naftës, prandaj ju në ministri, pör të mos u vërtetuar më ato të meta e dobësi, është e domosdoshme të udhëhiqeni vazhdimisht nga mësimet e mëdha që dha Partia.

Ndihmën nga shteti do ta keni, por ju keni detyrë të bëni përcaktime të sakta të vendeve të shpimit. Kjo nuk do të thotë që të ngadalësohen studimet për këtë qëllim, veç, para se të veprohet, siç thotë fjala e urtë popullore, «mendon 18 herë, pastaj preni një herë».

Nuk lejohet të jepen pika shpimi të papërcaktuara drejt, duke menduar «fundi ne jemi specialistë dhe ne e dimë si zbulohen këto pasuri, por, meqenëse këto ndodhen nën tokë dhe nuk duken, edhe mund të gabojmë». Është e vërtetë se nafta dhe gazi ndodhen fshehur nën tokë, por, kur bëhen arsyetime shkencore dhe logjike, gabimet e shkaktuara për pakujdesinë e njërit apo të tjetrit, duken sheshit. Pyetjeve të logjikshme që lindin për të svaruar gjendjen e sendeve mbi këtë ose atë veprim të pastudiuar mirë, të përciptë e jo të matur, nuk mund t'u përgjigjen arsyetimet formale, qoftë edhe të paraqitura «bukur» në formë letorraine. Pyetjeve që lindin rreth pakujdhesive në punë, secili duhet t'u përgjigjet me përgjegjësi partie dhe me ndërgjegje komuniste. Te punonjësit e Institutit të Naftës dhe të Gazit, të atij të Gjeofizikës duhet të krijohet një frysma e lartë partishmërie, të zgjohet tek ata një interes i jashtëzakonshëm për studime të bazuara, me qëllim që, në një kohë sa më të shkurtër, të sigurohen në fusha të gjera sasi sa më të mëdha nafte e gazi për të siguruar në të ardhmen lëndë djegëse të bollshme për të mirën e atdheut.

Këto rekomandime që po jua përsërit Byroja Politike ju i kuptioni drejt, prandaj kemi besim të plotë te ju, sepse jeni punëtorë të vendosur partie, punoni me partishmëri dhe ndërgjegje. Gabime në punë, siç bëjnë të tërë, keni bërë edhe ju dhe pikërisht për ato ju kemi kritikuar, kurse për punën e mirë kurdoherë ju kemi lavdëruar. Prandaj edhe këto që u thanë në këtë mbledhje, i kini parasysh në punën tuaj të ar-

dhshme, me qëllim që gabimet e vërtetuara gjer më
sot të mos përsëriten.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUDO TË NGRIHET VIGJILENCA, GATISHMËRIA TË JETË E PLOTË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shtator 1970

...Kryesorja dhe vendimtarja për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe kuadrot e saj ka qenë dhe mbetet lufta e pamëshirshme kundër armiqve të klassës, të Partisë, të republikës, si brenda, ashtu edhe jashtë.

Natyrisht, në gjithë këtë punë ka edhe të meta e gabime, shumë herë ka vend edhe për të kritikuar, edhe për të qortuar. Të dyja anët e medaljes ne duhet t'i vëmë në dukje, ndryshe gabojmë, flemë mbi dafina, lëmë gabimet të trashen, të cilat, siç e kam theksuar dhe herë të tjera, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, veçanërisht, po të mos ndreqen menjëherë, bëhen të rrezikshme...

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi disa çështje të metodës së punës në organet e punëve të brendshme», paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Si kudo, edhe për kuadrot e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për organet e instancat e ndryshme të saj, Partia rekomandon vazhdimisht vetëveprimin dhe iniciativën në punë, duke u bazuar në platformën e vendosur, në ligjet e shtetit që duhet të njihen mirë nga punonjësit dhe duhen interpretuar e zbatuar pastaj drejt në baza reale, në rrethana objektive, në kushte politiko-shoqërore jo kurdoherë të njëlllojta për çdo vend, për çdo individ, ose grup individësh.

Vetëveprimi për atë që bën, presupozon të marrësh përgjegjësi përpara udhëheqjes kolegiale, përpara instancave më të larta, përpara politikës së Partisë dhe ligjeve të shtetit.

Vetëveprimi presupozon të jesh i guximshëm, por veç marksist i guximshëm dhe jo një kokëkrisur i patelluar e i pamatur në veprime, fodull e arrogant në kryerjen e detyrës dhe të funksioneve që të janë ngarkuar.

Vetëveprimi nuk harron dhe nuk mund të harrojë demokracinë e vërtetë proletare, domethënë të drejtën që të kritikosh, por edhe të kritikojnë veprimtarinë tënde jo të drejtë, kritikë që nuk duhet të ta ndalë vetëveprimin dhe iniciativën, por që të armatos për të vendosur drejt.

Vetëveprimi presupozon edhe guximin si në mendime e në veprime individuale, por ai përmbledh sidomos guximin kolektiv dhe vendimin kolektiv. Të dy janë të lidhur ngushtë së toku. Po të çalojë njëri, vetëveprimi dobësohet, pengohet ose bën që të zhvillohet anarkia.

Nuk mund të ketë vetëveprim të shëndoshë, në rast se nuk mbahet parasysh direktiva, në rast se nuk

zbatohet disiplina proletare. Pra, në çdo punë, në çdo veprim ose vetëveprim, në çdo iniciativë, njerëzit e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet t'i kenë kurdoherë parasysh direktivën, normat, centralizmin demokratik. Vetëm atëherë çdo taktikë e tyre do të jetë në përgjithësi e pagabuar.

Zgjerimi i kompetencave të organeve të bazës që varen nga Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu si në sektorët e tjera, është i domosdoshëm, por, pa penguar këtë zgjerim dhe iniciativën e bazës, centralizimi i drejimit në ministri nuk duhet të dobësohet, përkundrazi të jetë rigoroz dhe vigjilent për vetë natyrën e luftës kundër armikut të klasës brenda dhe jashtë. Ministria duhet të jetë plotësisht e informuar dhe e informuar shpejt e saktë për çdo veprim të armikut. Ajo vepron në permanencë si një shtab madhor që drejton luftën kundër armiqve të republikës. Ky është një problem me rëndësi për Ministrinë e Punëve të Brendshme që, duke e pasur të qartë parimin, ta pashojë dhe ta perfekcionojë atë me praktikën dhe me luftën e përditshme, luftë që duhet të konsistojë në kuptimin sa më thellë politikisht dhe ideologjikisht të problemit dhe në perfekcionimin organizativo-teknik të raporteve qendër-bazë.

Për ta kryer si duhet detyrën, kuadrot e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet, në radhë të parë, të jenë të qartë politikisht dhe të ngritur ideologjikisht me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të Partisë. Ana e tyre profesionale duhet të jetë derivate dhe e lidhur ngushtë me politikën e Partisë dhe me ligjet e shtetit të diktaturës së proletariatit.

Me gjithë përparimet që kemi në këtë drejtim, nuk lejohet cektësi në përvetësimin dhe në zbatimin në jetë të materialeve të Partisë. Kjo cektësi vjen, sigurisht, për arsyen se ka cektësi në studimin e doktrinës sonë dhe të materialeve me rëndësi të Partisë, gjë që i bën disa kuadro të mos orientohen drejt në koniunkturat që krijohen, të tregohen shumë herë oportunistë e të bëjnë lëshime, disa herë të tregohen shumë sektarë e konservatorë. Kjo do të thotë të mos orientohesh drejt nga rr Ethanat, të mos kesh parasysh eksperiencën e madhe të fituar nga Partia, për arsyen se atë nuk po e studion seriozisht ose thua me lehtësi «e di se e kam jetuar», pa u menduar se duhet ta azhurnosh e vazhdimisht ta freskosh këtë njohuri.

Eksperiencia e madhe e fituar, që është një thesar, duhet gërshtuar me eksperiencën e re, pse Partia me një zhvillim dialektik, dinamik e të pandërprerë krijoi kushte të reja. Këtë zhvillim, pra, është e domosdoshme ta studiosh që të mund të orientohesh si duhet.

Direktivat e Partisë për organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë qenë gjithnjë rrugërrëfye se dhe që kurdoherë lypin të zbërthehen e puna pastaj të organizohet në mënyrë të përsosur, që të mundim të parashikojmë dhe të paraveprojmë më mirë e më shpejt nga armiku.

Që të parashikosh dhe të parandalosh veprimin e armikut, lypset bërë një analizë e origjinës shoqërore të së keqes, të ambientit imediat material dhe politik që e prodhon atë, të dobësive politiko-ideologjike të punës sonë dhe të masave politike, organizative dhe administrative që duhen marrë. Kuptohet që një punë

e pastër në këtë drejtim nuk mund të bëhet, në rast se kuadrot nuk i vihen akoma më me zell ngritjes ideo-politike, në qoftë se nuk lidhen akoma më shumë nga sa janë lidhur me masat dhe në rast se vazhdimisht e kurdoherë nuk e vënë gjithë veprimtarinë e tyre nën drejtimin e Partisë.

Unë kam bindjen se gabimet e të metat që janë vërtetuar në punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme do të korrigohen.

Unë i sintetizova disa probleme që preokupojnë organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme për të mos përsëritur vërejtjet e vlefshme të shokëve dhe për të mos u përsëritur po ashtu mjaft çështje që i kam përmendur dhe herë të tjera.

Vetëm mendoj se është e domosdoshme të ritheksoj shkurtimisht disa gjëra:

1) Sido që nuk ka shkelje flagrante të platformës, mejgjithatë, shokët që punojnë në këta sektorë duhet të jenë rigorozë në zbatimin e saj. Dhe për të qenë kështu, ata duhet ta njohin në kuptimin e thellë politik dhe ligjor dhe të jenë të matur, të drejtë dhe gjakftohëtë në zbatimin e saj.

2) Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në gjithë repartet e saj vartëse nuk lejohet familjaritet në punë e në detyrë, nuk lejohet oportunizëm dhe butësi ndaj armikut të klasës; fodullëku dhe arroganca duhet të luftohen politikisht dhe ideologjikisht nga punonjësit e organeve të punëve të brendshme.

3) Kudo duhet të ngrihet vigjilencia, në çdo moment gatishmëria të jetë e plotë, të ndiqet me kujdesin më të madh politika e Partisë në konjunkturat që

krijohen, t'u shpjegohen me durim e qartësi të gjithëve, deri tek ushtari i kufirit, ç'do të thotë vigjilencë e përhershme, ç'do të thotë koniunkturë e momentit që ai të bëjë kështu rojë me mend në kokë dhe as të mos bjerë në provokacionin e armikut.

4) Dëshiroj me këtë rast të them disa fjalë për kuptimin e drejtë të politikës së Partisë në lidhje me kuadrin.

S'ka asnjë dyshim se ju, shokë punonjës të Sigurimit të Shtetit dhe të të gjitha organeve të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si të gjithë punonjësit e vendit tonë jeni dashruar me punën, me zanatin. Kështu duhet. Por puna juaj është veçanërisht e lodhshme, sidomos nga tensioni i përhershëm dhe i madh nervor. Partia dhe Qeveria kujdesen shumë dhe vazhdimisht do të kujdesen për shëndetin tuaj. Por ka momente që nga lodhja e madhe dhe nga një punë shumë e gjatë disa shokë këshillohen të mos punojnë absolutisht në atë sektor ose duhet të punojnë me orë shumë të reduktuara. Partia në këtë rast do të zgjedhë ruajtjen e shëndetit dhe zgjatjen e jetës së shokut. Ka disa që nuk e kuptojnë drejt këtë masë dhe në kokën e tyre mendojnë lloj-lloj gjérash të paqena. Kjo e ka burimin në sedrën e sëmurë, në kuptimin e cekët politik, në frikën ç'do të thotë opinioni për të që doli në lirim ose shkoi në një sektor tjetër. Dhe të gjitha këto paqartësi e errësojnë atë çmim të lartë që ka Partia për të, për heroizmin dhe besnikërinë e tij. Por, ashtu si në sektorët e tjere të Partisë dhe të shtetit, edhe në organet e punëve të brendshme vjen një kohë që, për të mirën e punës, i moshuari duhet t'i hapë rrugën të riut. Si kudo,

edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka disa shokë konservatorë në çështjen e ngritjes së kuadrit të ri. Këta duhet të thellohen, ta kuptojnë drejt punën e Partisë për kuadrin dhe ta zbatojnë, duke luftuar egoizmin në këtë çështje kaq të madhe.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si edhe në sektorë të tjerë, ka nganjëherë njerëz që nuk japid, që nuk e kryejnë detyrën dhe nuk bëjnë përpjekje në këtë drejtim. Atëherë është e natyrshme që, pasi bëhen të gjitha përpjekjet, ata transferohen në sektorë të tjerë punc. Prandaj masa që merret ndaj tyre duhet të kuptohet drejt.

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas tekstit të nxjerrë nga
procesverbali i mbledhjes së
Byrosë Politike të KQ të
PPSH që gjendet në AQP*

SHFAQJEVE TË INTELEKTUALIZMIT DHE TË TEKNOKRATIZMIT T'U BËHET NJË LUFTË E VAZHDUESHME

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 shtator 1970

Për këtë problem është folur edhe më përpara dhe në të ardhmen ne përsëri do të vazhdojmë të flasim e të punojmë më thellë në të tri drejtimet: ideologjikisht, politikisht dhe organizativisht. Nuk është aspak e mjaftueshme të diskutojmë vetëm politikisht për intelektualizmin dhe teknokratizmin ose të shpjegojmë thjesht rrezikshmërinë e tyre gjatë veprimitarisë sonë për ndërtimin e socializmit, por të marrim njëkohësisht edhe masa organizative për t'u prerë hovin dhe për t'u mbyllur shtigjet tendencave e pikëpamjeve in-

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Për zbatimin e detyrave të Plenomit të 6-të të Komitetit Qendror të PPSH për luftën kundër shfaqjeve të intelektualizmit» paraqitur nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës, si dhe raporti i paraqitur nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës «Për luftën kundër shfaqjeve të teknokratizmit».

telektualiste e teknokrate që shfaqen e do të shfaqen te njerëzit tanë. Natyrisht, kjo nuk është një punë e lehtë dhe nuk ka pse të mendohet që mund të zhduken lehtë nga mendja e njerëzve sëmundjet e intelektualizmit dhe të teknokratizmit, por ne i kemi mundësitë për të arritur rezultate më të mëdha se deri tani, në qoftë se këtë çështje e marrim seriozisht dhe mendimet e njerëzve i lidhim konkretisht me zhvillimin e prodhimit dhe me përsosjen e drejtimit, me iniciativën e tyre dhe me realizimin e planeve.

Me direktivat, me këshillat, me punën e vazhdueshme politike dhe ideologjike, që po bëjnë Partia dhe shteti, mund të themi se lufta kundër shfaqjeve të intelektualizmit e të teknokratizmit është vënë në rru-gë të drejtë, megjithatë ka akoma shumë pengesa. Këtë na e vërteton gjithë praktika e gjertanishme e punës, si dhe raportet e komiteteve të Partisë të rretheve të Tiranës dhe të Korçës, që vënë mirë në dukje si përparimet e bëra, ashtu edhe pengesat që hasen akoma në këtë drejtim dhe në përgjithësi nga kush hasen.

Nuk është e mundur që ne të bëjmë një klasifikim se cilët janë të larë nga këto shfaqje të dëmshme dhe cilët nuk janë spastruar akoma prej tyre. E vërteta është që përpjekje bëhen kudo, po, në një mënyrë ose në një tjetër dhe në shkallë të ndryshme, tendencat e intelektualizmit, të teknokratizmit dhe të burokratizmit shfaqen, ku më shumë e ku më pak, te të gjithë. Por mua më duket, dhe këtë e vërtetojnë edhe raportet dhe e gjithë praktika jonë, se këtu, në qendër, vëçanërisht në dikasteret, këto të meta ekzistojnë më të

theksuara, kurse në udhëheqjet e ndërmarrjeve më pak. Prandaj, pa ulur aspak kujdesin, kudo, përpjekjet më të mëdha për luftimin e këtyre tendencave duhen bërë nga punonjësit e institucioneve qendrore, në radhë të parë, të cilët duhet ta kuptojnë thellë rrezikshmërinë e këtyre shfaqjeve. Por këta të mos kufizohen vetëm në të kuptuarit politikisht të rrezikut të tyre, rëndësi të posaçme merr pastaj sidomos lufta që u duhet bërë atyre shfaqjeve në praktikë. Në këtë drejtim, më duket mua, qëndron edhe e meta e kësaj pune.

Këtu u vu në dukje se shokët tanë dhe njerëzit në përgjithësi nuk është se s'duan t'i luftojnë këto shfaqje, (megjithëse ka disa që nuk e kuptojnë rrezikshmërinë e tyre, ose disa të tjerë që s'e bëjnë këtë për arsyen të mendjemadhësissë, të prepotencës, të nënveftësimit të rolit të masave e të kuadrove më të ulët, të mbivlerësimit të zotësisë së tyre intelektuale etj.), por edhe për arsyen të përdorimit të shumë formave e metodave të drejtimit të punës që janë të vjetruara, që nuk u përgjigjen koniunkturave e momenteve aktuale revolucionare. Shumë shokë me përgjegjësi, që punojnë në dikasteret qendrore ose edhe nga ata që zënë poste udhëheqëse në bazë, megjithëse e kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht rrezikshmërinë e intelektualizmit e të teknokratizmit, kur vjen puna në praktikë nuk i luftojnë ata, për arsyen se janë futur në një punë drejtimi rutinë dhe sepse ekzistojnë formulime, ekzistojnë rregulla, ekziston një disiplinë plani, ndërlidhje e varësi financiare etj., etj., të cilat në praktikë i bëjnë ata të mos ecin me hovin e masës dhe, pa dashje, të pengojnë vrullin revolucionar të tyre. Këtu qëndron një

kontradiktë e madhe, që ne dhe gjithë Partia duhet të bëjmë shumë përpjekje për ta zgjidhur.

Tani problemet janë, si të thuash, të qarta për të gjithë. Por, pavarësisht nga mendimet ekstravagante etj., etj., që mund të ekzistojnë te disa, në punë ne marrim kurdoherë parasysh mendimet racionale të masave, të punonjësve, të inxhinierëve, të drejtoreve, të ministrave, të cilët jo vetëm hapin horizonte të mëdha pune, por edhe realizojnë gjëra të mëdha, kapërcejnë e thyejnë kornizat e planeve, të metodave, rregullave, lidhjcve, varësive e ndërvarësive etj. Partia, populli, shteti janë të kënaqur për të gjitha këto përpjekje që bëhen dhe thonë se kjo është rruga nëpër të cilën duhet të ecim. Prandaj nëpër këtë rrugë që jemi duke çarë dhe kemi rezultate, dëshira e zjarrtë e të gjithëve është që t'i luftojmë e t'i zhdukim edhe ato shfaqje negative që përmendëm, t'i kapërcejmë këto pengesa, të rifillojmë një punë me metoda të reja, të përpinqemi për të gjetur organizimin më të përshtatshëm për t'iu përgjigjur këtij hovi e kësaj pjekurie të masave, sugjerimeve të shumta e gatishmërisë së tyre të madhe dhe në këtë drejtim po ecet. Megjithatë, në ritmin e gjithë këtij vrulli të madh, përsëri ndihet rënkimi i frenave të burokratizmit e të teknokratizmit, që shumë mirë e shpjegoi shoku Manush.

Disiplinën e planit, që është një gjë me rëndësi të madhe, burokrati e kupton si diçka shumë të ngurtë, bile jashtëzakonisht të ngurtë. Mirëpo nga ana e tyre masat e thyejnë këtë ngurtësi dhe shteti, Partia (në përmjet buxhetit, planit), në fakt, i janë përgjigjur kësaj thyerjeje, në një kohë që burokrati dhe teknok-

rati i vënë pengesa, duke i qëndruar në mënyrë shabllone e me fanatizëm gjoja disiplinës së planit. «S'ka, — thotë burokрати, — kaq kam, s'jap më shumë». «Nuk bëhet kjo, — vazhdon teknokrati, — këtë nuk e parashikojnë normat....». Këta njerëz hiqen si shumë të mësuar, dhe mund të janë të mësuar, por për mua mësimi i tyre nuk vlen asgjë. Ata mund të kenë edhe shumë eksperiencë, por eksperienca e tyre për mua, gjithashtu, nuk vlen, për arsyet se ajo pengon ecjen përpara. Burokrati dhe teknokrati janë njerëz pa perspektivë, pa iniciativë e pa guxim, kurse masat, që mendojnë, veprojnë dhe thyejnë kornizat e planit, kanë një besim dhe guxim të madh në veprimtarinë e tyre dhe janë të bindura se i shërbejnë kauzës së tyre, kauzës së atdheut. Burokrati dhe teknokrati kujtojnë se prishet Shqipëria, po të bëhet ndonjë ndryshim në plan, ata nuk marrin guximin të venë te drejtori i ndërmarrjes, te këshilli teknik, te ministri, ose në Qeveri dhe me kurajë të argumentojnë domosdoshmérinë e ndryshimit që i duhet bërë planit. Pra, në vend që diturinë e tyre ta vënë në lëvizje, ata e mbajnë ngurtësisht në gjendje statike. Burokrati dhe teknokrati, pra, nuk janë të vlefshëm, përkundrazi ata pengojnë zhvillimin me hov revolucionar.

Duhet kuptuar drejt dhe të mos interpretohet kjo çështje sikur ne kërkojmë të nderim këmbët aq sa nuk e kemi jorganin. Jo, ne asnjëherë nuk i kemi nderur këmbët tej jorganit, megjithatë kemi realizuar më shumë nga sa i kemi pasur planet. Këto realizime i ka siguruar forca e madhe revolucionare krijuese e mësave. Me këto nuk kam parasysh vetëm popullin e

thjeshtë, po edhe kuadrot, komunistët, teknikët, pra, të gjithë ata që punojnë për zbatimin e vijës së Partisë, me përjashtim të njerëzve që janë të cekët dhe të prekur nga këto shfaqje të dënueshme për të cilat po diskutojmë, të atyre që, siç tha shoku Manush, i mundojnë mendjemadhësia e intelektualit, frika dhe ambicia personale. Prandaj në këto drejtime ne duhet të bëjmë një luftë të vazhdueshme.

Shoku Manush e ka trajtuar gjerë në raport çështjen e intelektualizmit, aty ai na jep edhe një tablo mbi masat që ka marrë Komiteti i Partisë në Tiranë për ta luftuar këtë shfaqje të sëmurë. Mua më duket se drejt ka menduar Komiteti i Partisë për rrethin e Tiranës se si të veprojë në këtë çështje dhe si të punojë për lidhjen e anës shkencore me atë praktike të prodhimit. Nëpër fabrika, nëpër shkolla, në institute, me inxhinierët, me punëtorët, me kooperativistët, me njerëzit e prodhimit etj. Unë mendoj se duhet ndjekur kjo rrugë: Eksperienca e fituar të thellohet e të ndiqet më tej dhe të përpinqemi të nxjerrim sa më shumë fryte prej saj.

Në aparatet qendrore, në dikasteret, intelektualizmi është më i theksuar dhe nuk luftohet si duhet as në teori e sidomos as në praktikë. Ai manifestohet në shumë drejtime, si: në metodën e vjetër të planifikimit, në besimin joreal te baza, por te bilancet e materialeve, në sigurimin e materialeve e të mallrave të ndryshme nga importi në bazë të kërkesave që bëjnë dikasteret nga lart. Shfaqjen e intelektualizmit e shohim edhe te ngurrimet e punonjësve të aparateve qendrore për t'i dhënë kompetenca bazës, te tendenca për

të grumbulluar shumë gjëra në aparatet qendrore, gjë që e ka burimin te mendjemandhësia e tyre dhe te besimi i tepruar në fuqinë e urdhrale. Edhe shikimi vetëm i anëve negative e jo edhe i anëve pozitive të organeve dhe kuadrove të bazës, mania intelektuale, më shumë për të shitur mend dhe jo për të vënë në dukje si duhet forcën krijuese të masave, është aspekt i kësaj shfaqjeje.

Shumë probleme ka nxjerrë lufta kundër intelektualizmit dhe teknokratizmit në drejtim të iniciativave të mëdha të masave punonjëse. Shumë gjëra të mëdha po bëhen e mund të bëhen akoma, por çështja është se në këtë drejtim pengon akoma teknokratizmi i dikastereve, ku këto shfaqje, siç e thashë, janë më të theksuara. Vihet re se ministrive u mungon në shumë raste iniciativa, ato e kanë kuptuar shpesh gabim disiplinën e planit, gjë që i bën të jenë shumë të ngurta, të mos pranojnë sugjerime, novacione, të mos bëjnë shtesa që i kërkon zhvillimi. Kjo është një punë shterpë nga ana e tyre, një punë frenuese¹. Faktet e ini-

1 Një qëndrim të tillë mbante edhe Koço Theodhosi, të cilin shoku Enver Hoxha e kritikoi rreptë në nibledhje: «Ju thoni se Elbasani nuk ka mundësi të ndërtojë një ose dy objekte për zgjerimin e prodhimit, kur bën qindra apartamente në një kohë rekord. Unë këtë nuk e kuptoj. Si është e mundur të thuhet që Elbasani nuk ka kapacitet ndërtimi për ngritjen e këtyre objekteve? Jam i bindur se edhe ato Elbasani i bën përnjëherësh.

Kur flasim për teknokratizëm ky ekziston edhe te ti, Koço, dhe teknokratizmin duhet ta luftojmë jo vetëm në teori, por edhe në praktikë...».

ciativave të shumta dhe të realizimeve të mëdha të masave i kanë vërtetuar këto konstatime.

Aksionet me goditje të përqendruar janë një grusht i rëndë për teknokratët, për llogaritësit gjoja të përpiktë të normave, të materialeve, të kohës, të rendimenteve etj. Masat punonjëse në këto aksione, me vrullin e tyre revolucionar, i thyen normat dhe planet e bëra nga zyra, nga burokratët e teknokratët. Këto aksione dhe shumë të tjera kanë ndihmuar që të krijojen e të zënë vend ide dhe koncepte të reja revolucionare te njerëzit tanë, duke i bërë ata të mendojnë politikisht drejt, të matin drejt dhe të krijojnë për popullin në shkallë të gjerë; ato u kanë dhënë një grusht skeptikëve teknokratë dhe kanë ndihmuar në zgjimin e mendimit punëtor. Vënia e politikës në plan të parë nga punonjësit tanë, e kuptuar kjo drejt prej tyre, ka luftuar e po lufton vazhdimisht burokratizmin, teknokratizmin, ekonomizmin dhe politikanizmin abstrakt.

Është e drejtë që shumë kujdes e më shumë përpjekje duhet të bëhen kundër koncepteve intelektualiste edhe në shkolla, në mësues e në pedagogë, për të luftuar te punonjësit e arsimit fryshtë e sëmurë intelektualiste, shfaqjet e ndryshme të saj, duke përdorur për spastrimin e tyre një larmi formash e metodash pune nga më të efektshmet.

Në raport ngrihet edhe çështja e qarkullimit të kuadrit. Mua më duket se ky problem nuk kuptohet në çdo rast mirë dhe drejt, por në mënyrë automatike. Vetë, shumë shokë përgjegjës nuk e kuptojnë thellë nevojën e qarkullimit të kuadrit. Për mendimin tim,

mjaft kuadro të ministrive duhet të venë në bazë dhe ata të bazës të vijnë nëpër ministritë. Nuk jemi më tanë si në kohët e para, kur nuk kishim kuadro, pse në të gjithë sektorët janë me mijëra ata që kanë minimum nga 5 ose 6 vjet në prodhim, pra kanë një stazh të mirë në punët praktike e që njohin mirë edhe anën teorike të punëve edhe atë të drejimit të prodhimit. Të gjitha këto i dinë shumë bukur njerëzit e bazës, se janë rrahur me luftën e jetës. Shumë nga ata kanë ardhur kushedi sa herë edhe në ministri, ku shpesh kanë bërë propozime, disa nga të cilat u janë pranuar, disa nuk janë pranuar, një pjesë janë lënë mënjanë, duke u thënë se për këto s'kemi mundësi materiale etj., etj. Ju sollët këtu shembullin e një funksionari, i cili nuk dha një sasi çimentoje për ndërtimin e shtëpive me punë vullnetare, pse kjo nuk qenkej parashikuar në plan. Sipas tij duhej pritur fundi i vitit për të parë sa çimento do të realizohej jashtë planit, pastaj të studiohej ç'sasi çimentoje mund të disponohej për këtë qëllim nga kjo sasi jashtë planit. Ja një pengesë burokratike. Pa zëvendësoje këtë funksionar menjëherë me një kuadër të bazës dhe çoje të punojë poshtë, vëre atje nën saçin e masave punonjëse dhe të shikosh se sa shpejt do të bëhet një inxhinier i zoti e i kualifikuar, pse atje ai do të marrë hovin dhe frymën e bazës, do t'i njohë nga afër kërkesat dhe nevojat e bazës, do të pajiset me shpirtin revolucionar të bazës, kështu që edhe kur të qëllojë të vijë në ministri për të bërë ndonjë kërkesë, nuk do të pengohet, siç pengon ai vetë të tjerët, në rastin konkret me çimenton, pse do të gjejë një shok që ka punuar në bazë dhe i njeh mirë

nevojat e bazës, prandaj do ta kuptojë shumë mirë kërkesën dhe do të marrë menjëherë masa për ta plotësuar. Ky njeri edhe kërkesat që do të bëjë, kur të jetë në bazë, do t'i paraqitë të arsyeshme, sepse punën në bazë do ta shikojë ndryshe, ndërsa shoku i tij i ardhur nga baza në ministri, duke qenë i kalitur me frymën e bazës, do t'ia zgjidhë nevojat shumë më shpejt nga ç'ia zgjidh sot ai. Do të ketë kështu, me një fjalë, një harmonizim të plotë dhe një unitet veprimi dinamik revolucionar midis ministrisë dhe bazës. Kjo do të ndihmojë edhe për rritjen e autoritetit të organeve gendrore.

Qarkullimi i kuadrove është i domosdoshëm edhe për arsyen që të forcohet besimi i dikasterit te baza, meqenëse kuadri, që dikasteri e konsideron të mirë, do të shkojë pikërisht atje ku duhet dhe ku puna duhet të dalë e mirë. Kështu, tok me konceptin intelektualist të «kolltukut», ne luftojmë edhe ndjenjën intelektualiste në punë, në drejtim, në administrim.

Mirëpo si jemi aktualisht me çështjen e qarkullimit, në ç'drejtim po ecet? Të gjithë e kemi të qartë se duhet të shkohet në bazë, pse të gjitha problemet janë në bazë. Fabrikat, uzinat, bujqësia, ndërtimet, shëndetësia, shkollat, arti dhe kultura, të gjitha janë në bazë. Atëherë, derisa është kështu, ne duhet të dërgojmë atje njerëzit tanë me eksperiencë të madhe drejtimi, të cilët është e domosdoshme të pleksen me baltën, të jetojnë me popullin, të pajisen me frymën e bazës dhe të bëhen luftëtarë të vendosur, për të zhdukur të gjitha fijet e mbeturinave intelektualiste, burokratike e teknokrate nga vetja e tyre. Në vend të tyre të sje-

llim në aparatet qendrore punonjës të dalluar të bazës. Kështu ne do të kemi gjallëruar edhe bazën edhe ministritë.

Mirëpo sa vë dorën te ndonjë nga punonjësit e aparatave qendrore për ta larguar, fillojnë kundërshtimet, duke u gjetur plot «arsye». Kur propozohet ta zëmë një punonjës i vjetër i Komisionit të Planit për ta çuar në bazë, na thuhet përnjëherësh: «Këtë nuk e lëmë», «Pa të nuk bën dot Komisioni i Planit» etj. Unë jam i mendimit se nuk është e domosdoshme të kemi në këtë dikaster specialistë me stazh 20-25 vjet, sado që ndonjëri mund të ngulë këmbë se ai di tërë historinë e planit për profilin ku është specializuar, që nga viti 1945. Një gjë e tillë nuk na hyn aspak në punë, pse, po të na lindë nevoja për shifra, atje i kemi punonjësit e statistikës që mund të na i nxjerrin ato kur të duam. Për naftën, për shembull, në plan kemi nevojë për një njeri që të ketë njohuri për të, që ta ndjekë si duhet këtë sektor dhe të jetë në gjendje t'i sugjerojë Qeverisë problemet që duhen zgjidhur. Aktualisht në Komisionin e Planit të Shtetit kemi grumbulluar plot njerëz të zotë e me eksperiencë të gjatë, po që kanë një psikologji zyre, letrash, studimesh të shkëputur nga jeta e gjallë, nga masat dhe puna në bazë, larg praktikës dhe që tërë veprimtarinë e tyre e mbështetin në këto letra e studime.

Përse të mos sjellim ne qoftë në Komisionin e Planit, ashtu dhe nëpër dikasteret e tjera, punonjës të bazës, të rrahur me vështirësitet e jetës dhe të aftë për të punuar në degët përkatëse në organet qendrore? Ne sot kemi plot inxhinierë, teknikë, ekonomistë të vjetër

e të tjerë, që kanë tërë jetën në bazë, atëherë me këta njerëz nuk mund të bashkëpunojë ministria përkatëse? Përse të mos bashkëpunojë Ministria e Shëndetësisë, fjala vjen, me një mjek që ka 10-15 ose 20 vjet stazh pune në bazë? Përse mban ministri në dikaster po ata njerëz pér një kohë të gjatë, duke krijuar mundësitë pér të përgatitur atje një situatë të sëmurë, të kuptohemi, nga ana burokratike? Një gjendje e tillë e mban udhëheqjen e dikasterit të shkëputur nga baza, e bën atë të ketë më shumë besim te njerëzit që ka përqark, sesa tek ata që punojnë poshtë, dhe të japë kështu urdhra jo të bazuar, siç ka ndodhur me dikasterin e Tregtisë që, pa i peshuar mirë çështjet, jep në disa raste porosi të padrejta, bile edhe telegrafisht. Kështu ndodhi me midhjet, që nuk u morën masa pér t'u konsumuar nga populli, ose kërkohet që konfekcionet të bëhen siç duan këta të ministrisë, ndryshe, u njoftua, nuk i tërheqin etj.¹. Një njeriu të tillë me përgjegjësi në Ministrinë e Tregtisë, jo të lidhur me bazën dhe me nevojat e masave, që propozon të bëhet një shpërndarje mallrash jashtë nevojave dhe kërkessave të masave, i bën shumë mirë ta dërgosh drejtor të një ndërmarrjeje tregtare në rrith që të njohë realitetin, të shikosh pastaj se si do të vijë ai në Tiranë të kundërshtojë ato direktiva jo të studiuara që i dërgon eprori i tij nga zyra në ministri. Ai do ta njoftojë qendrën

¹ Siç u vërtetua më vonë këto veprime e të tjera si këto i bënte ish-ministri i Tregtisë në atë kohë Kiço Ngjela, në kuadrin e tërë punës armiqësore që zhvilloi ai në këtë sektor të ekonomisë sonë.

se atje poshtë gjendja është krejt ndryshe, se dërgohen nga lart dhe mallra pa u kërkuar nga baza përtë cilat nuk ka nevojë populli i rrëthit. Kurse krejt ndryshe mendon tani ky njeri që punon në ministri.

Pastaj disa nga këta kuadro kanë krijuar pikëpamjen e gabuar sikur janë të pazëvendësueshëm. Po pse qenkan të pazëvendësueshëm? Është e vërtetë se shumë prej tyre janë të vjetër në punë e të kaluar nga mosha dhe për këtë duhet të kemi respekt. Veç kësaj ata janë edhe të zotë. Përpara ka qenë ca e vështirë t'i lëvizje, sidomos nga ana ekonomike, por vështirësi në bazë ka aq sa edhe për të tjerët që punojnë e jetojnë atje. «Po si do të iki nga Tirana?» pyet ndonjëri. Edhe nga Tirana do të ketë kuadro që do të largohen përnë bazë, shokë, po veç jo t'i lëmë pa shtëpi. Ai që do të vijë këtu nga rrëthi duhet t'ia lirojë menjëherë shtëpinë atij që do të largohet prej këtej. Kur ky i Tiranës të shkojë me punë në bazë, është e domosdoshme të gjejë strehim atje ku do të punojë, që të marrë familjen. Por kur tjetrit i gjen apartamentin, ndërsa gruan me fëmijët i lë këtu i prirë nga mendimi se do të vijë prapë në Tiranë, ai me siguri do të qëndrojë në punë si mbi gjemba. Një mendim e qëndrim i tillë s'është aspak i drejtë. Ai që transferohet nga Tirana në një rrëth, përsë të mendojë se do të kthehet prapë këtu? Komunisti dhe patrioti i ndërgjegjshëm nuk duhet të kërkojnë që të largohen nga baza ku i kanë caktuar, as të punojnë atje me mendje të ngritur. Tjetër punë se për ndonjërin Partia mund të ketë nevojë ta marrë përsëri në qendër, po vetë ai nuk duhet të kërkojë të largohet nga baza, përkundrazi të luftojë që të

lidhet si mishi me thoin me masat dhe me punën ku është caktuar, pse ka disa që, akoma pa zënë vend mirë aty ku janë transferuar, kërkojnë të vijnë përsëri në Tiranë. Po përse, për ç'arsye?

Problemi i qarkullimit të kuadrove duhet ndjekur me kujdes dhe vazhdimisht të punohet që të kuptohet drejt nga të gjithë, ideologjikisht e politikisht. Në këtë çështje Partia duhet të bëjë një politikë të drejtë. Sidomos në ato vende kyç, ku ka mundësi të lindin e të zhvillohen tendencat e rrezikshme të burokratizmit, të intelektualizmit e të teknokratizmit, ne duhet të sjellim pikërisht kuadro që në praktikë kanë dhënë prova dhe janë treguar luftëtarë të vendosur kundër këtyre shfaqjeve. Këta kuadro duhen ndjekur e duhen njobur në luftën për zbatimin e vijës së Partisë në këtë çështje. Kështu, kur të lindë nevoja për të qarkulluar një kuadër nga aparatet qendrore, të kemi mirë parasysh që të mos e zëvendësojmë atë pa kriter, duke sjellë në vend të tij një tjetër që mund të jetë i krimbur, si ata që përmenda që, kur u dërguan poshtë, nuk i morën familjet, duke pritur që të kthehen përsëri në qendër, ose që edhe pse janë dërguar, nuk i kryejnë mirë detyrat e ngarkuara. Të sjellim një njeri vërtet të mësuar, me horizont, në radhë të parë luftëtar të paepur të vijës së Partisë, të zotin e që nuk ka aspak frikë të thotë hapur mendimin, që ka iniciativë e nuk pyet ngaherë e për çdo gjë titullarin. Një kuadër i tillë, ta zëmë në sektorin e industrisë, mund të vejë t'i shtrëngojë dhëmbët një elementi burokrat të tregtisë, kur nuk është në rregull, dhe pa qenë nevoja për ndërhyrje nga lart, ta detyrojë që, për interes të eko-

nomisë dhe të popullit, të veprojë siç është e drejta.

Ne duhet të bëjmë një politikë të përshtatshme qarkullimi në bazë të vijës revolucionare të Partisë. Tani kemi me mijëra njerëz në bazë që mund t'i sjellim në aparatet qendrore, kurse të tjerët që kanë një kohë të gjatë që punojnë në organet eprore e që janë edhe ata revolucionarë, të zotë e me eksperiencë, t'i çojmë në bazë që të drejtojnë dhe ta forcojnë atë, të drejtojnë atje forcat ekonomike që tani janë mjaft të mëdha, të çojnë atje zotësinë dhe eksperiencën e tyre të gjerë, të marrin njëkohësisht edhe frymën e bazës për të cilën kanë shumë nevojë. Kuadrot tanë revolucionarë duhet të jenë kurdoherë të gatshëm të venë pa hezitim në bazë, kudo që të lindë nevoja e më shumë nga sa kanë shkuar deri tani dhe atje të mos e ndiejnë asnjëherë veten si provizorë.

Kjo është një luftë që kemi filluar e që duhet vazhduar. Parimet i kemi të qarta dhe në këtë drejtim është bërë një punë e mirë dhe e shëndoshë që po vazhdon, por ka e do të ketë akoma pengesa, do të ketë edhe luftë për t'i kapërcyer ato. Rëndësi ka fakti që ndonjë rrezikshmëri në këtë çështje nuk po shikojmë. Sigurisht shfaqje jo të shëndosha tek-tuk ekzistojnë e do të ekzistojnë edhe më vonë, prandaj pikërisht kundër tyre ne duhet të bëjmë një luftë të vazhdueshme për t'i zhdukur.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1970-1971»,
f. 80. Tiranë, 1972*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1970-1971», f. 80.
Tiranë, 1972*

PARTISË I DUHET UNITET I VËRTETË, JO UNITET FALS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 shtator 1970

Kur lexova raportin e shokëve të kontrollit të shtetit, si dhe atë të ekipeve të Komitetit Qendror, lidhur me gjendjen në Kooperativën e Bashkuar të Picarit, me të vërtetë u revoltova për gjithë ato gjëra për të cilat bëhej fjalë aty. Personalisht nuk e gjykova të drejtë qëndrimin që kishte mbajtur Komiteti i Partisë i Rrethit të Gjirokastrës ndaj kryetarit të kësaj kooperative. Mendimi im është se ndaj gabimeve të tij është mbajtur qëndrim i butë...

Në kooperativat tona bujqësore nuk duhet të mbretërojë mentaliteti i vjetër i kryetarëve dhe gabimet e tyre të mos dënohen repektë, «për hir të unitetit». Jo, shokë, ky nuk është një unitet i vërtetë, po unitet fals.

1 Në këtë mbledhje ishte thirrur në raport Komiteti i Partisë i Rrethit të Gjirokastrës për çrrregullimet që kishin ndodhur në kooperativën e bashkuar «Partizani» të Picarit dhe prishjen e unitetit në organizatën e Partisë të kësaj kooperative.

Raporti i shokëve të Komitetit Qendror, që e konstaton këtë unitet fals, është shumë i drejtë. Ky «unitet» buron nga mentaliteti, sipas të cilit «të mos u prishim qejfin të mëdhenjve», «t'i vëmë kapakun kësaj gjëje», sepse «ky kryetar mund të ketë lidhje me shokët e udhëheqjes», «mund të ketë aprovimin e tyre» e ku e di unë se çfarë, prandaj «të mjaftohemi me disa kritika të përgjithshme dhe asgjë tjetër».

Mua më duket se Komiteti i Partisë i Gjirokastrës nuk i ka dhënë zgjidhjen e duhur kësaj çështjeje. Si pasojë, jo vetëm fajtori nuk ndreqet, por as situata në kooperativë nuk përmirësohet. Ne duhet t'u themi të gjithëve atyre që e mbrojnë njeriun që gabon, se Partia nuk është e një mendimi me ta dhe për këtë t'u tregojmë arsyet për të cilat ai duhet ndëshkuar më rëndë. Kështu, pasi të sqarohen e të binden, do të vijnë në rrugën e drejtë të Partisë edhe ata që janë dakord me atë që gabon. Po të mos veprojmë në këtë mënyrë, nuk i edukojmë mirë shokët, përkundrazi, i lëmë të vazhdojnë të ecin në rrugën e dëmshme të tarafeve.

Njerëzve që kanë krijuar tarafe në kooperativë duhet t'u hiqen të gjitha mundësitë për ta vazhduar më tej veprimtarinë e tyre. Në radhë të parë, është e domosdoshme që këta njerëz të largohen nga vendet me përgjegjësi. Po të shohim se ndonjë do të spekulojë e do të mburret, duke thënë se «doli fjala ime», t'i themi se masat që u morën nuk kanë të bëjnë aspak me ato që thotë ai, por me drejtësinë e vijës së Partisë. Edhe ndonjë tjetri, që mund të mendojë se «e humba davanë», t'i themi, gjithashtu, se jo vetëm që nuk ka humbur gjë, po të nxjerrë mësime nga gabi-

met që ka bërë dhe të ecë në rrugë të drejtë. Është e domosdoshme dhe në interes të Partisë e të popullit që të zhduken gabimet e padrejtësitë e të vihet në vend uniteti. Të gjithëve t'u bëhet e qartë se, po të vazhdojnë ndryshe, duke bërë të tilla gabime, nuk janë në rrugën e Partisë, përkundrazi, një veprimitari si kjo është e dëmshme, sepse na fut në praktikën e zakoneve të së kaluarës. Partia sot nuk lejon të ecet në këtë rrugë.

Çështjet, shokë, nuk duhet t'i shikojmë në mënyrë sentimentale dhe të përkrahim njërin apo tjetrin kur nuk vepron drejt. Kur na kanë ngjarë raste të tilla, ndaj shkaktarëve janë marrë masa të rrepta. Një shembull të kësaj natyre kemi pasur edhe në Cakran. Në këtë kooperativë nuk kishte ndodhur ndonjë vjedhje dhe ai që drejtonte atje ishte kuadër i mirë. Megjithatë, për gabimet që bëri, nuk ia preu njeri kokën, po u shkarkua si kryetar dhe u vu të punojë gjetkë. Me këtë masë që u mor kundër tij, Partia e ndihmoi atë.

Ne nuk i mohojmë aspak sukseset që ka pasur kooperativa e Picarit, për të cilat na u fol aq gjatë. Rezultatet kjo kooperativë i ka arritur, sepse kanë pnuar mirë anëtarët e saj e, në radhë të parë, organiza-ta-bazë e Partisë dhe komunistët.

Për t'u kuptuar drejt këto çështje, mendoj se mund të bisedohet edhe një herë me popullin. Të lexohet përpara tij edhe një herë raporti e të sqarohen kooperativistët se veprimet e kryera nga kryetari i kësaj kooperative janë të dënueshme nga ana e statutit të kooperativës, si dhe nga ana politike dhe ekonomike. Të bëhet e qartë se te këto veprime e kanë bu-

rimin edhe fjalët që disa njerëz i kanë shprehur hap-tazi, kurse disa të tjerë i kanë ngritur me letra ano-nime. T'i thuhet popullit se çështje të tillë Partia i zgjidh kurdoherë drejt se edhe kryetarë të tjerë koo-perativash, kur kanë bërë të tillë veprime si ky, pasi janë kritikuar, janë shkarkuar nga detyra. Jam i bindur se populli do t'i gjejë patjetër me vend dhe të drejta masat që propozohen të merren. Pas kësaj, është mirë të mendohet për t'u dërguar atje, si kryetar, një nga shokët më të mirë, tek i cili fshati të ketë besim të plotë. Mendoj se, po të veprohet në këtë mënyrë, gjendja do të ndreqet, gjë që do të jetë më mirë sesa ta lëmë të vazhdojë siç ishte dhe njerëzit të jenë të paqartë, të ziejnë poshtë e lart diskutimet dhe të na krijohen përsëri situata të rënda.

Masat e tjera që janë marrë më duken shumë të drejta, bile të shumanshmë. Ato janë të pjekura, të shikuara në një shkallë të gjerë partie dhe shtetërore, politike dhe ideologjike. Jemi të bindur se ju, shokët e Komitetit të Partisë të Gjirokastrës, do t'i zbatoni drejt këto orientime, me qëllim që ngjarje të tillë, të mos ndodhin më. Edhe këto që ngjanë, është e domos-doshme të vihen menjëherë në vend.

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali
i mbledhjes së Sekretariatit
të KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

GJEST PATRIOTIK QË E ÇMON SHUMË JO VETËM POPULLI I RRETHIT TË SHKODRËS, POR EDHE I GJITHË SHQIPËRISË

Letër drejtuar fotografit Gegë Marubi

29 shtator 1970

I dashur shoku Gegë Marubi,

Me letrën që më dërgove dhe nga shkrimi i Fadil Krajës, botuar në gazeten «Zëri i popullit»¹, mësova se ju i dhuruat shtetit fototekën 85-vjeçare, që pasqyron një histori të tërë të popullit tonë, për të cilën ati juaj, i nderuari Kel Marubi, gjatë tërë jetës së tij, i udhëhequr nga ndjenja patriotizmi, punoi me aq kujdes, pasion e durim. Ti, i dashur Gegë, djali i tij, ndoqë me vëmendje, ruajte, zhvillove dhe e pasurove më tej veprën e babait, derisa e bëre fototekën 85-vjeçare, të cilën ia fale më së fundi pushtetit popullor. Ju përgëzoj për këtë gjest patriotik, që e çmon shumë jo vetëm populli i rrethit të Shkodrës, por edhe i gjithë Shqipërisë dhe që do të frymëzojë edhe patriotë të tjerrë që ruajnë vlera të kësaj natyre për të mirën e atdheut e të popullit tonë.

¹ Ky shkrim mban titullin «Fotografi Gegë Marubi dhuon fototekën e tij 85-vjeçare». Shih: «Zëri i popullit», nr. 228 (6892), 24 shtator 1970.

Tani organet e pushtetit dhe të Partisë kanë për detyrë që, në bashkëpunim me ju, ta ruajnë të paprekur këtë pasuri. Kjo kërkon, në radhë të parë, të bëhet inventari shkencor i të gjitha materialeve, me qëllim që as gjëja më e vogël të mos humbasë, por gjithçka që ekziston në këtë fototekë të vlefshme të shfrytëzohet në interes të popullit në mënyrë rigorozë, të organizuar mirë dhe plot përgjegjësi.

Sigurisht, ju vetë është mirë të vazhdoni të jeni në krye të fototekës, së bashku me vajzën tuaj, e cila, pavarësisht se tani është bërë inxhinire e kryen edhe funksione të tjera shtetërore, kam bindjen se do të gjejë kohë për t'u interesuar edhe për fototekën. Megjithatë, në qoftë se për kryerjen e kësaj pune do të jetë e nevojshme të shtohet edhe ndonjë ndihmës i kualifikuar, me pëlqimin tuaj, pushteti në rreth mund të vendosë, duke u kujdesur njëkohësisht për të përcaktuar rregulla të plota rreptësisht të zbatueshme ashtu si për çdo arkiv tjetër të rëndësishëm shtetëror.

Unë kam porositur organet e Partisë dhe të pushtetit në rreth që të kujdesen për të marrë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse nga çdo rrezik që mund të dëmtojë fototekën.

Ju uroj shëndet dhe gjithë të mirat juve, vajzës dhe gjithë familjes!

Juaji

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazeten «Zeri i popullit», nr. 232 (6896), 29 shtator 1970

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Mbi letërsinë dhe artin», f. 311. Tiranë, 1977

C'KËRKON NIKSONI NË EVROPE?

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

30 shtator 1970

Kurdoherë dhe kudo që pozitat e imperializmit amerikan tronditen apo rrezikohen, sipas rastit, herë presidenti, herë nënpresidenti i Shteteve të Bashkuara dalin nga strofka e tyre. Këtë herë, me një suitë impresionuese, vjen në Evropë vetë presidenti Nikson.

Sado që shtypi amerikan dhe mikpritësit e mysafirit të shquar të përtejatlantikut përpinqen t'i japin vizitës së Niksonit një pamje paqësore, situata, rajoni dhe koha e zgjedhur për këtë vizitë dëshmojnë se qëllimet janë të tjera.

Vetë objektet e vizitës së tij, Italia, Jugosllavia, Spanja, Flota e 6-të në Mesdhe, takimi në Napoli me ambasadorët amerikanë në këtë pellg dhe, më në fund, vizita në Angli, lënë qartë të supozohen hallet dhe objektivat e Niksonit.

Imperialistët amerikanë kanë tanë në Mesdhe mjaft baza për anijet e aeroplanët e luftës, me anën e të cilave ushtrojnë një presion të vazhdueshëm mbi popujt e këtij rajoni. Një erë e vogël ndryshimesh të

fryjë në vendet ku ndodhen bazat amerikane, shkakton një furtunë të madhe shqetësimësh në Pentagon.

Niksoni vjen tani në brigjet e Mesdheut për të kontrolluar dhe për të forcuar gatishmërinë e njësive detare e ajrore amerikane në Mesdhe, të cilat përfaqësojnë mbështetjen kryesore të politikës dhe të diplomacisë agresive amerikane në këtë rajon. Fakti që Niksoni e nis vizitën e tij me një demonstrim pompoz të forcës së Flotës së 6-të, e cila këto ditë është shtuar posaçërisht, tregon se cilat janë preokupacioni dhe synimi i tij. Të tri vendet që do të vizitojë ai, Spanja, Italia dhe Jugosllavia, shikojnë nga Mesdheu e Afrika Veriore, ku planet e SHBA-së shkojnë shumë larg.

Niksoni do të takohet e do të bisedojë me Saragatin, Titon dhe Frankon, miq dhe aleatë besnikë të imperializmit amerikan, pasi pozitat strategjike, ekonomike dhe ushtarake amerikane në këto vende në koniunkturat aktuale janë të tronditura dhe atyre u duhet dhënë një «impuls presidencial».

Italia është aeroplanmbajtësja kryesore amerikane në Mesdhe. Ajo është mbushur me baza të saj dhe Amerika dikton atje ligjin, nënkuptoitet në rrugë dhe në forma të stërholluara «demokratike». Por kjo e famshme «demokraci» në Itali me vite të tëra është në krizë të rëndë.

Me vite dhe çdo ditë të vitit bëhen greva të punëtorëve dhe përleshje me policinë. Pozitat e atlantizmit të pakondicionuar sa vjen e po dobësohen. Ekuilibri i tanishëm i forcave politike është i lëkundshëm. Partitë borgjeze e revisioniste, të gjitha të shitura, janë të përqara dhe në luftë me njëra-tjetrën për

pushtet. Rrugët për të gjitha drejtimet në të ardhmen janë të hapëta. Dhe në Itali janë të njohura qarqet që të famshmen «demokraci» duan ta transformojnë në diktaturë fashiste. Këtë e subvencionon Amerika, këtë po vjen tani ta fuqizojë, ta inkurajojë Niksoni.

Niksoni nuk mund të kënaqet më me sigurime verbale. Nga bashkëbiseduesit italianë, që nga Saragati e deri te papa, ai kërkon masa serioze që të mos lejojnë të rrezikohen interesat amerikanë, natyrisht, nënkuptohet «të botës së lirë». Shtetet e Bashkuara duan që në vendet ku ndodhen bazat ushtarake amerikane të sundojnë në mënyrë të sigurt, të patundur, njerëzit e tyre besnikë, ata që mbështetin pa hezitime Amerikën në Evropë dhe në politikën e saj globale.

Me vizitën në Itali Niksoni kërkon të inkurajojë dhe me të të ndihmojë miqtë, agjenturën e amerikanëve, që të mbajnë fort pushtetin dhe, në rast rreziku, «De Lorencot» të jenë gati. Gjithashtu, ai nuk do t'i lërë mënjanë përpjekjet për t'i mbajtur nën kontroll tendencat e gjalla të nostaljisë për boshtin «Romë-Berlin», aktualisht Romë-Bon, për të mbajtur nën dush të ftohtë shpresat e revisionistëve për një puthje me aleatin e tyre moskovit.

Përveç këtyre, interesat ekonomikë amerikanë në Itali janë të mëdhenj. Ata duhen mbrojtur me çdo kusht, me anë të politikës, me anë të bursës, me anën e qeveritarëve italianë të lidhur me bankat dhe finançët e lartë amerikane, me anë të forcës.

Spanja është një vend ku mbretëron fashizmi i hapët, atje nuk ekziston as demokraci e maskuar. Por Frankoja nuk është i pavdekshëm dhe pas tij nuk

është e thënë që qarqet politike do të jenë të predispozuara t'i nënshtrohen diktatit amerikan që në fjalën e parë. Spanja, ashtu si edhe Italia, është në krizë, populli, punëtorët luftojnë. Ajo rron me kreditë e amerikanëve, por tani në këtë vend po futet mirë edhe Boni, ndërsa revizionisti sovjetik ka filluar të flirtojë me të. Niksoni, natyrisht, është i shqetësuar për këtë vend plot me baza dhe me aerodrome amerikane, plot me interesa politikë dhe ekonomikë. Imperializmi amerikan ka interes të madh që fashisti Franko dhe diktatura e tij të jenë plotësisht në duart e amerikanëve, pasi Spanja është Mesdheu, është presioni mbi Francën, është siguria e Flotës së 6-të dhe paralizimi i flotës franceze, është një nga pionet më të rëndësishme të NATO-s në këtë zonë.

Në traditën e politikës së jashtme imperialiste amerikane është përdorimi njëkohësisht i demagogjisë së papërmabjtur dhe vringëllimi i armëve. Por në vizitën e tij të tanishme në Mesdhe, Niksoni e ka lënë mënjanë degën e ullirit dhe po tregon vetëm shigjetat.

Edhe biseda e Niksonit me ambasadorët e tij në vendet e Mesdheut nuk synon shëndetin e tyre, por shëndetin e vendeve ku ata janë akredituar, për t'u rekomanduar atyre se s'janë momentet për të qenë optimistë as për fuqinë politike, as për fuqinë e intrigave, as për atë të dollarit. Popujt janë ngritur dhe luftojnë kundër tyre. Prandaj Niksoni u thekson se lodra e tyre diplomatike duhet të jetë e shtrënguar, se për amerikanët nuk ka pasur dhe nuk do të ketë kurrë vlerë fjala latine «Heshtin topat, se këndon mu-

za». Diplomacia amerikane do t'i nënshtrohet forcës ushtarake të Flotës së 6-të.

Veçanërisht qartë kjo duket në gjendjen e Lindjes së Mesme, ku lufta nacionalçirimitare e popujve arabë, me gjithë vështirësitë e peripecitë e saj, ka qenë një goditje e rëndë për imperializmin amerikan dhe për sundimin e tij në Lindjen e Mesme e në Mesdhe. Rezistenca arabe dhe, në mënyrë të veçantë zgjerimi e intensifikimi i luftës çlirimtare të popullit palestinez, zgjoi anembanë opinionin publik ndërkombëtar, i cili, në pjesën dërrmuese, u radhit me arabët dhe kundërshton politikën skllavëruese të imperialistëve amerikanë. Të çara në lidhje me Lindjen e Mesme lindën edhe në gjirin e aleatëve të SHBA-së në Evropë dhe në vendet e tjera.

Në bashkëpunim me revizionistët sovjetikë qeveria amerikane përpunoi «Planin Roxhers», por ai ngeci në vend. Tani Niksoni kërkon të përdorë shpatën. Flotën e 6-të dhe grumbullimin e forcave të tjera në Mesdhe ai do t'i paraqesë si provë të gatishmërisë për ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake.

Inspektimi i Niksonit mbi këtë flotë agresive nuk do të jetë për të kaluar në paradë mërinsët, po për t'i nxitur ata për luftë kundër popujve, për të qenë të gatshëm të ndërhyjnë dhe të goditin popujt dhe luftrat nacionalçirimitare, të jenë gati të mbrojnë pasuritë e Amerikës dhe agjentët e saj në fuqi, nënkuptoher, nën parullën për të mbrojtur «botën e lirë». Niksoni do t'u tërheqë vëmendjen marinarëve amerikanë se përbri tyre ndodhet edhe një flotë tjetër, ajo

e revizionistëve sovjetikë, e cila, për ta, më mirë të mos ishte, por ja që erdhi.

Rivalitetin e flotës sovjetike në Mesdhe imperialistët amerikanë nuk e durojnë me qejf dhe ata e thonë shpesh se do të bëjnë çmos që ta neutralizojnë dhe, më në fund, kur të vijë koha, t'ia punojnë si në Trafalgar apo Abukir, sigurisht, për të mbrojtur «botën e lirë» që ajo kërkon ta pushtojë. Niksoni, me vizitat e tij, kërkon të shtojë fuqizimin e NATO-s në Mesdhe për të blokuar flotën sovjetike, për të nxitur dhe për të siguruar mbështetjen e aleatëve të tij mesdhetarë për penetrimin amerikan në kontinentin afrikan dhe për dobësimin e neutralizimin e penetracionit sovjetik.

Që ekziston një konkurrencë midis imperialistëve amerikanë dhe atyre revizionistë sovjetikë në luftën për ekspansion dhe hegjemoni në Mesdhe dhe që po rritet vazhdimisht, kjo është e vërtetë. Shfaqjet e saj dhe lindja mbi këtë bazë e kontradiktave midis tyre është e dukshme. Por është po kaq e dukshme dhe po kaq e vërtetë se interesat dhe qëllimet e përbashkëta të imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë tanë për tanë janë shumë më të mëdha se kontradiktat e veçanta dhe jo një, por me qindra e mijëra fakte tregojnë se, në ka gjë që të dyja palët i ruhen më tepër, është evitimi i fërkimeve dhe i acarimit të kontradiktave reciproke.

Në qoftë se demonstrimi i forcës që e shoqëron turneun mesdhetar të Niksonit ka edhe një drejtim tjetër të veçantë, ky synon, në radhë të parë, ata aleatë të pabindur evropianë të SHBA-së të cilët herë pas here u nxjerrin vështirësi në zbatimin e strategjisë

globale të sundimit të botës. Në shtypin e huaj ka kohë që flitet për shqetësimet që i ka shkaktuar Amerikës politika e Francës në përpjekjet për rritjen e influencës së saj në disa rajone të Mesdheut, të cilat imperializmi amerikan i konsideron si domene të përjetshme të tij. Me sjelljen e tanishme, kur viziton të ashtuquajturin krah jugor të NATO-s e nuk kalon fare nga Parisi, Niksoni do të tregojë se disponon akoma shumë mjete e shumë leva për t'i qortuar partnerët josolidarë.

Në turneun e tij evropian as Jugosllavinë, as Titon nuk mund t'i harronte Niksoni. Në Jugosllavi imperializmi amerikan nuk ka baza ushtarake, por atje kapitali amerikan është instaluar këmbëkryq dhe interesat ekonomikë e politikë të Amerikës në këtë vend janë të mëdhenj. Kjo i detyrohet titizmit, që e shndërrroi Jugosllavinë, nga një vend ku kishte filluar të ndërtohej socializmi, në një vend kapitalist.

Borxhet kolosale që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë dhënë dhe po i jepin, e kanë mbytur ekonominë e saj dhe e kanë bërë Jugosllavinë një apendiks kaotik të imperializmit amerikan. Kjo e ka bërë Jugosllavinë që të rrojë në kriza të mëdha, ekonomike dhe politike, të pashërueshme. Me politikën dhe me ideologjinë e tyre antimarksiste, revisionistët jugosllavë jo vetëm që po e shkatërrojnë vendin e tyre dhe po rrezikojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Jugosllavisë, por i bënë dhe po i bëjnë shërbime të mëdha imperializmit amerikan, i cili iu gjend përkrah kur ata braktisën marksizëm-leninizmin. Tani, Amerika i gjendet përsëri në krah Titos, kur Jugosllavia është

në rrëmujë dhe në vigjiljen e tërheqjes së tij nga posti i presidentit të republikës jugosllave dhe do të merret me «punë të tjera», siç pohoi vetë.

Niksoni mban gjithnjë parasysh rolin e Jugosllavisë në interes të amerikanëve në të ashtuquajturën botë e tretë, në vendet arabe, në marrëdhëniet Lindje-Perëndim etj. Jugoslavia është një vend fqinj me postet pararojë të NATO-s dhe ai do që atë ta ketë në anën e tij. Por populli jugosllav është armik i NATO-s e i Traktatit të Varshavës dhe ne kemi bindjen e plotë se ai do të luftojë kundër të gjithë atyre imperialistëve që do të guxojnë t'i cenojnë lirinë e pavarësinë. Populli liridashës e patriot jugosllav nuk do të shkojë kurrë as në anën e imperializmit amerikan, as në anën e socialimperializmit sovjetik.

Fundi i udhëtimit të Niksonit është Anglia, aleatja tradicionale, e afërtë e zemrës, por së cilës i kanë rënë pendët. Megjithëkëtë ajo është thirrur, si kurdoherë, të luajë një rol në Evropë dhe, sidomos, në momente krize të rënda, për të balancuar forcat në prezencë, për të vënë në lëvizje diplomacinë e fshehtë të Intelixhens Servisit. Edhe kjo aleate e Amerikës rron në kriza, influenca e saj në kontinentin evropian ka rënë, pesha e saj në botë nuk ndihet.

C'rol do t'i caktohet Anglisë për Francën, si do t'i zhduket frika nga Boni e sovjetikët, si duhet ta mprehë vigjilencën? Të gjitha këto të dy kushérinjtë, amerikani dhe anglezi, do t'i rrahin e do t'i bisedojnë, por, sigurisht si unghi i pasur me nipin e varfër.

Niksoni vjen në Evropë, e posaçërisht në Mesdhe, duke treguar grushtin dhe me besim te klientët e tij

evropianë. Por popujt e Italisë, Jugosllavisë e Spanjës nuk janë të gatshëm t'i shtrojnë qilimin e kuq presidentit të përtejoqeanit, ashtu si dhe popujt e tjerë mesdhetarë nuk do t'u nënshtrohen kurrë arrogancës së tij dhe topave të Flotës së 6-të.

Koha e politikës së kanonierave, koha e diktatit dhe e arbitraritetit imperialist, qoftë ky kapitalist apo revizionist, ka perënduar dhe nuk kthehet më prapa.

Të gjithë njerëzit demokratë e përparimtarë, të gjithë popujt liridashës e paqedashës nuk mund të mos ngrihen kundër vizitës së Niksonit dhe të mos demaskojnë komplotet që ai kërkon të kurdisë kundër popujve të Mesdheut dhe të Evropës, nuk mund të mos mprehin vigjilencën e tyre ndaj planeve që imperializmi dhe aleatët e tij përgatitin kundër paqes dhe sigurimit në Evropë e në botë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 233 (6897), 30 shtator 1970

Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», nr. 233 (6897), 30 shtator 1970

RRITJA E PRODHIMIT BUJQËSOR KËRKON NJË GJENDJE TË MIRE TË TRANSPORTIT

Nga biseda me shokun Rrapi Gjermenit¹

2 tetor 1970

Shoku Rrapi Gjermenit kërkoi të takohej me Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror të Partisë për të biseduar lidhur me mundësinë e sigurimit të mjeteve të transportit për tërheqjen e shpejtë të prodhimeve bujqësore nga fusha. Porsa u njoftua, shoku Enver Hoxha e priti në zyrën e tij dhe zhvilloi këtë bisedë:

SHOKU ENVER HOXHA: Ku i kaluat pushimet, shoku Rrapi? Si e ndieni veten tanë?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Në Pogradec dhe e ndiej veten mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në përgjithësi, të gjithë shokët, edhe kur janë të sëmurë, kështu thonë «e ndiejmë veten mirë», po kjo nuk është e drejtë as për shëndetin e tyre, as për Partinë, sepse nga gjërat e

¹ Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

vogla lindin të mëdhatë, sëmundja përparon, gjendja shëndetësore e shokëve, në radhë të parë, dhe aftësia e tyre për punë bien, kështu pengohet edhe puna e Partisë. Prandaj është e domosdoshme që lejen vjetore ta bëjmë çdo vit rregullisht, sepse, duke pushuar, marrim energji e forca të reja, të cilat pastaj i shfrytëzojmë në punën tonë të përditshme. Nuk duhet punuar pa pushim dhe pastaj të sëmuremi. Të kemi më shumë kujdes për shëndetin, se njeriu është kapitali më i çmuar.

SHOKU RRAPI GJERMENI: Të më falni që po ju shqetësoj, shoku Enver, por kam ardhur këtu për një problem që preokupon organizatën e Partisë të rrëthit tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të vini tek unë kurdoherë që të doni, sa herë që t'ju paraqitet rasti dhe t'ju duket e nevojshme për punën.

Shoku Rrapi Gjermenit e vuri në dijeni shokun Enver Hoxha lidhur me punën e bërë për misrin në rrëthin e Lushnjës, si dhe për vështirësitë e krijuara nga mungesa e automjeteve, e cila pengonte transporimin e prodhimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Mjetet e transportit që kërkon, kush duhet t'jua japë?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Qeveria me Ministrinë e Komunikacionit. Unë u interesova edhe me anën e Ministrissë së Bujqësisë dhe me shokët instrukturë të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë. Këta më janë përgjigjur se kanë biseduar për këtë çështje, megjithatë, deri sot problemi nuk na është zgjidhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Brenda ditës do të rre-

gullohet kjo punë. Nga ana juaj, në rreth, të tregohet kujdes i madh që të organizohet puna në mënyrë të tillë që makinat, të cilat do t'ju jepen gjatë tetorit, të mos mbeten asnjë ditë pa punë.

Si duket pambuku?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Pambuku sivjet është i mirë, megjithatë prodhimi i tij do të varet nga koha që do të bëjë tani e tutje. Kemi një sasi bimësh pambuku, që, po filluan shirat, nuk do t'i hapin gonxhet.

SHOKU ENVER HOXHA: Ekziston rreziku i vjetshëm për pambukun?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Jo, nuk ekziston. Prodhimin më të madh, domethënë pikun e pambukut, ne e kemi arritur në vitin 1965. Sivjet plani vjetor parashikon 10 000 kuintalë më shumë se atëherë, kurse brenda shtatorit kemi vjelë vetëm 9 000 kuintalë. Gjer tani mund të themi se kemi prodhim të mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Atë vit që ka qenë pikun në pambuk, si ka mbajtur koha gjatë muajit tetor?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Ka mbajtur mirë. Tani që po fillojnë shirat, po marrim disa masa për kullimin e ujit në tokat e pambukut, sepse lagështira në këtë fazë e dëmton prodhimin dhe ia forcon gongxhet bimës.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjatë shtrimit të planit pesëvjeçar pati mendime e propozime lidhur me rritjen e rendimenteve?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Projektplani u shtrua për diskutim në masë në kooperativat bujqësore. Shokët e Partisë dhe të pushtetit në rreth kanë marrë pjesë të gjithë në mbledhjet për shtrimin e planit, edhe

në brigada dhe, gjer tani, puna ka shkuar mirë. Rendimentin e grurit për vitin e ardhshëm e kemi parashikuar 22,5 kuintalë për hektar.

SHOKU ENVER HOXHA: Kurse për vitin 1975 kemi caktuar detyrën që të arrijmë 25 kuintalë për hektar¹.

SHOKU RRAPI GJERMENI: Një çështje tjetër që na preokupon në bujqësi është ajo e rajonizimit të llojeve të bimëve bujqësore. Jo të gjitha kooperativat janë duke bërë rajonizimin e tokave për të gjitha llojet e bimëve. Mendoj se tani ka ardhur koha për të bërë edhe ndonjë bashkim kooperativash, me qëllim që të rritet më shumë sipërfaqja e tokës së punueshme të kooperativave bujqësore.

SHOKU ENVER HOXHA: Rajonizimi i tokave për llojet e bimëve bujqësore është problem edhe për rrethet e tjera. Ato e kanë ngritur këtë problem, se e shikojnë që ka frenim, prandaj bashkimi i kooperativave është gjë e mirë dhe do të ndihmojë për zhvillimin e specializimit të llojeve të bimëve. Pikërisht, kur të bëhet kjo, të kërkojmë të mbjellim nga të gjithë këto lloje bimësh.

Viti i ardhshëm duhet të na gjejë më ndryshe, sepse tashmë shumë vështirësi teknike pothuajse janë eliminuar, numri i kuadrove është rritur, gjithash tu, ka një ngritje politike më të madhe të njerëzve tanë dhe çështja e ditëve të punës nuk diskutohet.

Si shfaqen tendencat e konservatorizmit në plani-

¹ Në vitin 1975 rrethi i Lushnjës mori mesatarisht 32,2 kuintalë grurë për hektar.

fikimin e rritjes së rendimentit në brigadat e përparruara dhe si justifikohen ato?

SHOKU RRAPI GJERMENI: Shfaqje të konserverorizmit duken, në radhë të parë, në atë që, për një kohë të gjatë nuk janë marrë prodhime me rendimente të larta, së dyti, në transportimin e plehrave organike, sepse, në fakt, sasia e plehut ekziston, po nuk çohet në fushë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sot për sot transporti është një problem i madh kyç, për shkak të vështirësive që ka në këtë sektor. Ai nuk është në gjendje të përballojë që tani punën për lëvizjen e prodhimeve të shumta bujqësore, për shkak të rendimenteve të larta që kemi filluar të marrim. Prandaj është e domosdoshme të futet më shumë traktori për transport në fusha, sepse ai mund të tërheqë edhe rimorkio dhe të zëvendësojë shumë mirë punën e kamionit, i cili e ka të vështirë të futet brenda në tokat e mbjella sidomos kur fillojnë shirat. Çështja e transportit nuk mund të zgjidhet duke sjellë gjithnjë mjete nga jashtë. Prandaj duhet të mendojmë për të filluar nga prodhimi në vend i traktorëve për transportet në bujqësi. Për këtë qëllim duhet menduar që tani për përgatitjen e makinerive për prodhimin e traktorëve të tillë, në mënyrë që, pas disa vjetësh, të arrijmë të prodhojmë traktorë për transport dhe të dalim një herë e mirë nga gjendja në të cilën jemi sot.

Ne përpinqemi të rritim vazhdimisht rendimentet e bimëve bujqësore. Kështu, për shembull, kërkojmë të marrim 50 kuintalë misër për hektar, por me se do ta transportojmë gjithë këtë prodhim?

Ne mund të ekonomizojmë deri diku diçka, në transport, nga sektorët e tjerë, për t'i dhënë më shumë të tilla mjete bujqësisë, por kjo nuk na e zgjidh problemin. Qerrja nuk e zëvendëson dot tani punën e traktorit, pastaj transporti me qe nuk ka leverdi. Pra, rritja e rendimenteve në bujqësi kërkon një gjendje të mirë të transportit.

Për sa i përket ujitjes, mendoj se ka rrethe që akoma nuk dinë ta bëjnë atë si duhet. Tokat në disa raste janë të pasistemuara. Është e nevojshme të kuptohet mirë që në bujqësi gjëja kryesore është toka, prandaj asaj i duhet kushtuar rëndësi e veçantë. Për këtë qëllim ia vlen të bëhet analiza e tokës, të merren masa për ta pajisur atë, ashtu sikurse bëjmë kur futili në një shtëpi të re, që ka vetëm muret dhe atëherë përpinqemi ta mobilojmë me krevat, me skamni, me tavolina etj. Kështu, pra, kërkohet të veprojmë edhe me tokën. Asaj i duhet bërë analiza dhe, kur konstatojmë që është e kripur ose ranore, të përcaktojmë llojin e plehut që do të përdorim për përmirësimin e saj, mënyrën e shkriftimit etj. Ne duhet ta mësojmë bujkun që, kur toka është ranore, t'i shtojë edhe pak humus, të cilin kooperativa ose ndërmarrja bujqësore mund ta sigurojë vetë. Këtu e kam fjalën për domosdoshmërinë e sistemimit dhe të plehërimit të tokave. Kështu, për shembull, kur toka ka nevojë për ta përmirësuar strukturën e saj, duhen marrë menjëherë masat, por disa njerëz, megjithëse i dinë këto gjëra, nuk e mbajnë parasysh strukturën ekzistuese dhe neglizhojnë. S'mjafton vetëm të bëhet ujitja e tokës, ajo duhet të sistemohet, të rrafshohet, ndryshe as ujitja

nuk bëhet si kërkon agroteknika, si rrjedhim edhe rendimenti nuk është ai që duhet të jetë.

Rrafshimi, plehërimi, ujitja etj., përbëjnë procese të tëra, që kërkojnë edhe njohuri shkencore, të cilat fshatarit duhet t'ia mësojmë dhe ai t'i pasurojë pastaj me praktikën e punës së përditshme. Dibranët dinë të ujin mirë e, për këtë punë, ata i ka mësuar jeta. Megjithëse nuk e njojin shkencërisht strukturën e tokës, praktika i ka mësuar ata ta njojin këtë strukturë edhe pa bërë analiza pedologjike.

Rrafshimi i tokës është problem si për kooperativistët, ashtu edhe për traktoristët. Fshatari duhet të kuptojë nevojën e futjes së traktorit në arë, si dhe të punimit të tokës me gradacione të ndryshme 15, 25, 40 centimetra etj., sipas strukturës së saj dhe sipas nevojave të çdo lloji bime. Për shembull, kur toka është ranore, punimi duhet të jetë i thellë, me qëllim që të bëhet ajrimi i mirë i saj, ndërsa kur është torfoze, s'ka nevojë që plugimi të jetë 45 centimetra i thellë, sepse kjo do të shkaktonte shpenzime të kota, punimi i tokës do të bëhej i kushtueshëm. Është e nevojshme t'i shpjegohen këto gjëra edhe traktoristit, që ai t'i kuptojë dhe të bindet përse duhen bërë, sepse, ndonëse është punëtor, ai ka nevojë të ketë edhe një edukatë teknike.

I përmenda këto për të vlerësuar drejt shërbimet që duhet t'i bëjmë tokës, se vetëm kështu do të mundim të marrim prej saj rendimente të larta. Në sajë të punës së Partisë, si republikë ne kemi marrë deri tani mbi 20 kuintalë misër dhe mbi 15 kuintalë grurë për hektar. Këto janë rezultate të mira, por, si-

kur të arrijmë ta bëjmë kodin agroteknik real e konkret dhe ta njohin mirë të gjithë punonjësit e bujqësisë, atëherë do të arrijmë rezultate më të mëdha.

Me gjithë rezultatet që kemi arritur, ne synojmë të marrim 50 kuintalë misër dhe 25 kuintalë grurë për hektar, po, që t'ia arrijmë këtij qëllimi, duhen kryer mirë të gjitha shërbimet që përmenda.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TI JE NJË PATRIOT I NDERUAR, PAÇ PLEQËRI TË BARDHË!

*Nga biseda me patriotin Mehmet Myslimi
dhe me djalin e tij Ilmi Myslimi¹.*

8 tetor 1970

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se më erdhe, xha Mehmet, si të kam me shëndet? Po sa vjeç u bëre kështu, more xha Mehmet?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: 100 vjeç u bëra. Jam i datëlindjes 1882.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë nuk je bërë akoma 100 vjeç, je më pak, domethënë 88 vjeç, po ti do të vesh patjetër 100 vjeç, do t'i mbushësh e do t'i kalosh të 100 vjetët. Na mori malli, more xha Mehmet! Po si e le kështu Helmësin dhe paske shkuar me djemtë? Jeni mirë atje?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Shumë mirë jemi nga të gjitha, që nga banimi e çdo gjë tjetër.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani ne kemi çdo gjë,

¹ Kjo bisedë u zhvillua në selinë e KQ të PPSH.

bile, edhe fishekë, sepse na duhen. Atëherë, kur e ditë, me gjithë nevojën shumë të madhe për ta, fishekët i kishim të paktë. Të kujtohet si i gjenim? Vrissnim pushtuesit italianë, gjermanë e ballistët dhe ua merrnim, kurse tani, kemi plot nga të gjitha llojet e armëve, pse na prodhojnë sa të duam, djemtë dhe vajzat tonë.

Po në Helmës kush ka mbetur tani?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Në Helmës kanë mbetur vetëm disa shtëpi, të tjerat janë prishur.

SHOKU ENVER HOXHA: Shtëpia ku banonit ju, ka rënë apo është?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Ka rënë¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Po shtëpia e Asllanit dhe e Haxhiut² është? Kush rri në këtë shtëpi?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Rri Asllani. Haxhiu vdiq, por një djalë e ka në Shkollën e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Cilat shtëpi kanë mbetur tani atje?

1 Më vonë kjo shtëpi u rindërtua dhe u bë shtëpi-muze, e cila u përruua ditën e 40-vjetorit të Kongresit të Rinisë të Helmësit.

2 Dy vëllezër nga Helmësi, fshat për të cilin, në librin «Kur u hodhën themelët e Shqipërisë së re» (f. 373), shoku Enver Hoxha, ndër të tjera, shkruan: «... u vendosëm në Helmës, një fshat i vogël me 10-12 shtëpi e me plot bahçe me mollë dhe këtu, mes mollëve, hapëm edhe çadrat ku u strehuja një pjesë e shokëve, rojat partizane etj, kurse ne u vendosëm në dy shtëpi dykatëshe, në të vetmet të tilla në këtë fshat». Këto dy shtëpi dykatëshe ishin të Mehmet Myslimit e të vëllezërve Asllan dhe Haxhi Asllani.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Ka mbetur shtëpia përkundrejt furrës, atje ku rrinin sovjetikët.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mensa ka rënë?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Po, ka rënë.

SHOKU ILMI MYSLIMI: Ne, shoku Enver, u kë-naqëm shumë që u takuam me Ju. Babait, që e kishte merak t'Ju takonte, iu bë shumë qejfi që Ju pa dhe një herë, prandaj mendoj të largohemi tani, që të mos Ju shqetësojmë, se keni punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, kam dëshirë të rri edhe ca me ju. Sa më gjenuat që erdhët! E mbaj mend mirë shtëpinë tuaj, si poshtë, ashtu edhe sipër, ku flinim. Të kujtohet gjermani që na mori të keqen, se donte të hynte në dhomën e doktor Omerit? Po partizani që ishte atje, ia ngriti këmbët përpjetë, e vau.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Unë isha te çezma kur më thanë për Qazimin¹ se vau gjermanin.

SHOKU ENVER HOXHA: Qazimi ka dalë në pension tani, përpara rrinte me mua.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Ishte djalë i fortë ai.

SHOKU ENVER HOXHA: E ke të mirë babanë, ti Ilmi, ai ka qenë njeri i vendosur, patriot, besnik, ka punuar si gjatë luftës edhe pas Çlirimt, tërë kohën. Merr pension babai?

SHOKU ILMI MYSLIMI: Po, merr.

SHOKU ENVER HOXHA: Je i fortë, xha Mehmet, do t'i mbushësh të 100 vjetët.

E ke parë ndonjëherë Riza Kodhelin? Kohët e

1 Qazim Malaj.

fundit ai ka rënë shumë nga shëndeti. Kur kam qenë njëherë në Korçë, e pashë dhe e thirra të më takonte. Ai m'u paraqit si oficer.

Po e di ti, si e pësuam me të? Kur kishte dalë në pension, ia kishin hequr rrobat e oficerit. Një ditë që u takuam bashkë në një mbledhje, xha Rizai, i cili rrinte pas meje, m'u afrua dhe më tha në vesh: «Enver, m'i hoqën rrobat». Unë u ktheva e i thashë se edhe mua m'i kishin hequr rrobat, se të dyve na i kishte hequr Partia. «Ah, ç'ma hodhe bukur!», — më tha. Ndenji një çikë dhe më kërkoi një mushkë. Porosita që t'i jepnin një mushkë xha Rizait, se donte të shkonte kaluar. Shokët ia dhanë dhe ai u kënaq.

Ti, xha Mehmet, me sa shoh, nuk e pi duhanin dhe më duket bën shumë mirë.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Duhanin nuk e pi, ma ka ndaluar doktori, kurse raki më tha të pi nga një kupë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga një apo nga dy?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Doktori më tha: «Duhanin mos e pi, mos pi cigare, po në darkë dhe në mëngjes mund të pish nga një gotë me raki».

SHOKU ENVER HOXHA: Tani, plak je ti, mund të pish nga një gotë, bile nusja e djalit të të bëjë edhe një çikë meze.

Sa fëmijë ke?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Kam katër fëmijë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku janë me punë djetmë, në Poliçan? Po vajzat venë në shkollë?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Jemi shumë mirë, shoku Enver, një djalë e kam drejtor.

SHOKU ILCMI MYSLIMI: Vjet, kur u bë festa e Helmësit, dëgjuam sikur do të vinit dhe Ju, prandaj u nis e vajti edhe babai, po atje u takua me shokun Ramiz, të cilit i tha se bëri gjithë atë rrugë me shpresë që të takohej e të çmallej me shokun Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku të kam, xha Mehmet, ku të kam; sa trim ke qenë!

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Më duket vetja hiçgjë tani.

SHOKU ENVER HOXHA: Si hiçgjë, ti je një patriot i nderuar. Mirë se erdhët, të rrosh sa malet, të rrojë Partia, të të rrojnë djemtë e vajzat, nipat e mbesat, paç pleqëri të bardhë!

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Të na rrosh, me jetë të gjatë sa malet tonë! E lulëzove Shqipërinë, e bëre lulishte.

SHOKU ILCMI MYSLIMI: Të rroni, shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Në pesëvjeçarin e ardhshëm do të bëhen gjëra akoma më të mëdha, do të ngrihen fabrika e uzina të reja, më të mëdha e më moderne, do të vijnë akoma të tjërë traktorë edhe në Skraparin tënd, do të ngrihen aty fabrika të tjera, do të mbillen gjithfarëlloj pemësh. Punime do të bëhen edhe për shtimin e sipërfaqeve të ujitshme. Kemi një plan të tërë për ujitjen e Skraparit, që të bëhet kështu misër e grurë shumë e më shumë nga sa bëhet tani, kurse përparrë thuatje s'bëhej fare.

Tani po vete kudo edhe drita e Partisë. E mban mend, xha Mehmet, si rrnim me kandil, bile fare në errësirë, kur nuk na vinte vajguri nga Staravecka?

I mban mend anglezët? Nuk e di në të kujtohet,

po na erdhi njëherë një anglez, ishte nënkolonel¹. Ai ishte hedhur me parashutë. E prita në shtëpinë tuaj ku ishte Shtabi i Përgjithshëm, në atë dhomën në krahun e djathtë. «Mirë se erdhe!», — i thashë. «Do të na hidhni gjëkafshë armë, apo jo?» — e pyeta pastaj, gjatë bisedës. «Po, do t'ju japid, — më tha, — po tani kemi ardhur t'ju shikojmë një herë». «Mirë, shikonani, por vetëm armë na hidhni», — ia preva.

«Kam një kërkesë për ju, — tha ai. — Dua të takohem me zotin Tefik Cfiri». «Atëherë, keni ardhur për te nc, partizanët, apo për te ballistët?» — e pyeta. «Kam ardhur te të dyja palët», — u përgjigj ai. «Po të jetë kështu, — e sqarova unë, — atëherë më mirë të shkonit tek ata, se këtu te ne nuk mund të qëndroni dot me këto qëllime. Po vajtët atje, — i thashë, — do të thotë se bëheni armiku ynë. Dhe ta dini, po dolët nga territoret tona të çliruara, nuk mund të hyni më kurrë këtu te ne». Anglezi, i shtangur nga kjo përgjigje që s'e priste, më përshëndeti i skuqur, zbriti shkallët, i përcjellë nga ti dhe një partizan, kaloi nëpër bokërimën, nën shtëpinë tuaj dhe vajti në Staraveckë. Ishte koha kur ne po bëheshim gati të shkonim në Përmët. Anglezi ashtu bëri, po nuk iku. Të nesërmen më dërgoi lajm se do të vinin aeroplanët. «Shikoni, — u thashë shokëve, — ky njeri ka ardhur për te ballistët, prandaj neve asgjë nuk do të na jepet». Kur vajtëm atje ku ishte vendosur dhe e pyetëm anglezin se kur do të vinin aeroplanët, ai na u përgjigj: «Pas dy orësh». U duk

¹ Shih: Enver Hoxha. «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë (Kujtime)», f. 205-208.

qartë që ishte i poshtër, pse me të vërtetë aeroplanët kaluan, por ata shkuan poshtë Potomit dhe u hodhën në Greqi. I kërkova shpjegim ku vajtën ashtu gjithë ata aeroplanë dhe m'u përgjigj se gjoja duhej t'i kishin diktuar gjermanët, prandaj kishin shkuar andej.

Një natë erdhi një aeroplan dhe hodhi një radio, por ajo s'ishte për ne, po për ballistët. «Me ta lëshuar anglezët, — i porositëm partizanët, — të veni ta merrni radion menjëherë». Kështu i lamë ballistët pa radio.

Para se të shkonim në Përmet, i dërgova nënkolonelit ftesë, me një partizan, që të vinte edhe ai me ne, se e kishim aleat, por na u përgjigj që nuk do të vinte. Ditën e fundit të Kongresit, kur me një numër delegatësh po hanim bukë, më lajmëruan se kishte ardhur nënkoloneli anglez. «Hajde, urdhëro të hamë», — e ftova, po m'u përgjigj se kishte ngrënë, pse qe nisur përrugë, do të vente gjer në Polican (e kishte fjalën për Policanin e Gjirokastrës), do të dilte në Himarë e në Sarandë, pastaj do t'i hipte nëndetëses e do të hidhej në Itali. I dhashë me vete dy shoqërues, pse nuk donte gjë tjetër. Mirëpo, kur vajti në Sheper të Zagorisë, në një shesh hapi çadrën e bardhë dhe, kur kaloi në atë kohë një aeroplan gjerman, e diktoi çadrën, e qëlloi dhe e la të vrarë anglezin.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Tani si ne, nuk rron njeri. Ja jemi ne mirë sot, ja nuk është njeri tjetër. Bota kanë qindra vjet dhe nuk janë rregulluar akoma, ndryshtë është këtu, te ne, dhe ky është rregullim me gjoks, këtë e ka bërë Partia.

SHOKU ENVER HOXHA: Ke nevojë për gjëkafshë, xha Mehmet? Më fol si djalit tënd.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Nuk kam nevojë për asgjë, mjafton që të pashë edhe një herë sy për sy, pa le të vdes.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, s'duam të vdesësh, po të rrrosh shumë. Me se ke ardhur këtu?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Kam ardhur me makinë dhe me tren dhe nesër mendojmë të shkojmë në Polican.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë nesër do t'ju çojnë shokët e mi me automobil në Polican.

SHOKU ILMI MYSLIMI: Nuk është nevoja, shoku Enver, ka mjete sot, ne mund të shkojmë me makinë e me tren pa ju penguar.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, se lodhet plaku. Mos ke nevojë për ndonjë gjë tjetër? Sikur t'ia shkojmë një herë sytë te mjeku, këtu, në Tiranë! Le ta çojnë shokët e mi të vizitohet¹ dhe nesër, pastaj, ju çojnë në Polican me automobil.

Qofsh mirë, xha Mehmet! Ti më erdhe këtu sot dhe më bëre një nder të madh, po edhe unë, kur të vij në Polican, do të të vizitoj në shtëpi² dhe përgatitna të pimë nga një gotë, se këta, këtu, nuk më lënë të pi më shumë. Të kam ardhur në kohën e luftës në Hëllmës, po do të të vij në shtëpi edhe në Polican. Të faleminderit shumë edhe një herë për nderin që më bëre.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Faleminderit shumë

1 Xha Mehmetin e vizituan mjekët dhe, me kujdesin e shokut Enver Hoxha, ata e kishin nën kontroll dhe i shkonin për vizitë edhe në shtëpi.

2 Këtë vizitë në shtëpinë e xha Mehmetit, shoku Enver Hoxha e bëri më 30 nëntor 1971.

Juve, të më vish në shtëpi dhe të pimë raki, të jap unë sa të duash, vetëm të vish. Edhe fëmijët e tu më kanë ardhur kur isha në Lushnjë. Të faleminderit shumë!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQF

ATDHEU YNË, NË KRAHASIM ME TË KALUAREN, KA NDRYSHUAR SI DITA ME NATËN

Nga biseda me Liri e Violeta Kavon¹

12 tetor 1970

Mysafiret i bënë shokut Enver Hoxha një vizitë në shtëpinë e tij. Pasi u përshëndetën përzemërsisht ai zhvilloi me to një bisedë shumë të ngrohtë.

SHOKU ENVER HOXHA: U gëzuam shumë që na erdhët për vizitë.

SHOQJA LIRI KAVO: Edhe ne u kënaqëm shumë që e pamë Shqipërinë të gëzuar e të lulëzuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa herë që venë e vijnë shokët tanë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i pyes për Hulon, se është njeri i mirë. Megjithëse ka një kohë të gjatë larg atdheut, ai i ka ruajtur të pastrat ndjenjat e patriotizmit e të dashurisë për Shqipërinë; midis atyre që e mbrojtën çështjen e popullit shqiptar jashtë atdheut ishte nga personat kryesorë. Ne e kemi të qartë se është vështirë të mbrosh çështjen e Shqipë-

1 Përkatësisht bashkëshortja dhe vajza e patriotit Hulusi Kavo, me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

risë socialiste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga që te ne udhëheq Partia e komunistëve, por megjithëkëtë, Huloja na ka mbrojtur me ndershmërinë, me guximin dhe me personalitetin e tij.

Huloja ishte me Luftën Nacionalçlirimtare që bëri populli shqiptar. Ai ka luajtur një rol të veçantë që në atë kohë, pas luftës dhe tanë, prandaj e quajmë si një nga patriotët më të shquar midis shqiptarëve që jetojnë në Amerikë.

Ti, vajzë¹, duhet të jesh e lumtur që babanë dhe nënën i ke njerëz të mirë.

SHOQJA VIOLETA KAVO: Unë u kënaqa shumë që erdha në Shqipëri, bile, meqenëse kisha vetëm një muaj leje, e shtova atë edhe për dy javë të tjera. Do të kisha qejf të rrija më shumë, por s'kam mundësi. Nuk e di si do të largohem, kjo do të më sëmbojë në zemër.

SHOKU ENVER HOXHA: Si ju duk Gjirokastra?

SHOQJA LIRI KAVO: Shumë e mirë. Vajza vizitoi atje çdo gjë, kurse unë nuk i pashë dot, po do të shkoj prapë dhe do t'i shikoj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne bëjmë çmos të mos i prishim, përkundrazi, përpinqemi t'i ruajmë karakteristikat e qyteteve të tilla, siç është edhe Gjirokastra.

SHOQJA LIRI KAVO: Për ne është gëzim i madh që erdhëm në vendin tonë dhe tanë themi gjithnjë midis nesh: «Si do të largohemi nga Shqipëria dhe nga njerëzit tanë të dashur?». Mendjen dhe zemrën do t'i kemi gjithnjë këtu.

1 I drejtohet Violeta Kavos.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa keq që po rrini kaq pak! Të kishit ndenjur më shumë! Kur të vini herë tjetër, së bashku me Hulon, t'i bini Shqipërisë rrëth e rrotull. Ju do të shikoni që atdheu ynë, në krahasim me të kaluarën, ka ndryshuar si dita me natën. Përpara Çlirimt te ne nuk ka pasur bujqësi të zhvilluar, nuk ka pasur traktorë, nuk ka pasur as industri, as ndriçim elektrik, me përjashtim të disa qyteteve. Muajin që vjen, në gjithë Shqipërinë, gjer te malet më të larta, do të ketë ndriçim elektrik. Shumë pak vende në botë janë elektrifikuar tërësisht si Shqipëria. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shembull, nuk janë elektrifikuar në gjithë vendin.

Te ne rinia bën një punë të madhe, hekurudhën Rrogozhinë-Fier ajo e ndërtoi. Edhe vajza ime ka punuar si aksioniste në hekurudhë. Ajo shkoi në aksion edhe kur ra tërmeti në Dibër që të punonte atje me vëlle-zërit e saj.

SHOQJA VIOLETA KAVO: Më ka treguar babai për punën e rinisë shqiptare në aksione dhe më ka pyetur: «Do të punosh dot edhe ti atje?». «Nuk trembem unë, — i thashë, — do të punoj, se jam e fortë, kam mundësi të punoj më mirë nga ju të moshuarit, se jam e re dhe gjëzoj shëndet të mirë».

Universiteti, që pashë sot, më pëlqeu shumë. Të gjitha fakultetet ishin vendosur në ndërtesa të mëdha.

SHOKU ENVER HOXHA: Në universitet kemi Fakultetin e Mjekësisë, të Historisë e të Filologjisë, të Inxhinierisë, të Shkencave të Natyrës, të Shkencave Politiko-Juridike, të Ekonomisë etj. Kemi edhe institute të tjera të larta, si dhe qytetin e studentëve, ku

banojnë e ushqehen studentët. Të gjithë këta, pasi mbarojnë studimet, shkojnë për të punuar në dobi të atdheut e të popullit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të kulturës.

SHOQJA VIOLETA KAVO: Unë e kam merak dhemë sëmbon në zemër që nuk vajta në universitet, se nuk kisha mundësi, babai nuk i mbloodi dot paratë që kërkoeshin për të më dërguar atje. Më vjen mirë kur shikoj se këtu shumë të rinj e të reja janë me shkollë të lartë, por më vjen keq që unë kam mbetur me arsim të mesëm. Kur të vete në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të shkruaj një artikull në gazeten «Liria» për Shqipërinë dhe për gjithë këto që kam parë këtu. Kur ta lexojnë ata që kanë lindur në Shqipëri dhenuk kanë pasur rastin të vijnë asnjëherë këtu, do të thonë: «Edhe kjo që ka lindur në Amerikë shkoi e pa Shqipërinë. Po ne që e kemi vendlindjen tonë, përsëtë mos shkojmë?». Do të shkruaj që edhe ata të vijnë e t'i shkojnë gjithë këto të mira që janë bërë në Shqipëri.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga behari dërgojeni në Shqipëri edhe vajzën e vogël. Meqenëse Huloja tani kadalë në pension, mund të vijë ai me të.

SHOQJA LIRI KAVO: Më mban mend kur vinit atëherë nga shkolla? Po kur punoja në sixhade me Sanon¹ Ju kujtohet?

SHOKU ENVER HOXHA: Ishe e vogël atëherë.

Mirë se na erdhët, ta pimë këtë gotë për shëndetin tuaj!

¹ Sano Hoxha, e pranishme në këtë takim.

SHOQJA LIRI KAVO: Mirë se Ju gjetëm, gëzuar e të rroni sa malet për Shqipërinë!

SHOKU ENVER HOXHA: Është kënaqësi e madhe kur e shikon popullin të lumtur e të gëzuar. Me gjithë përparimet e pakrahasueshme me të kaluarën, te ne nuk është arritur akoma bollëku i madh, nuk kemi bërë akoma gjithçka që duhet të bëjmë.

Nëna e babai yt, Violeta, e njohin mirë gjendjen që ka qenë dikur këtu, por edhe ti, më duket mua, gjykon drejt. Tani po hartojmë planin e pestë pesëvjeçar, që do ta forcojë akoma më shumë Shqipërinë. I thuaj babait se këtë pesëvjeçar në Shqipëri do të shtohen gruri e misri dhe, tok me ta, do të shtohen lopët, qu-mështi, gjalpi etj. Populli, i thuaj Hulos, do të ketë për të ngrënë dhe për të pirë më mirë e më lirë se tani. Në këta pesë vjet edhe në Gjirokastër do të ndërtohen fabrika të tjera të mëdha. Të tilla do të ngrihen në gjithë Shqipërinë. Në veri të vendit do të ndërtohet një hidrocentral tjetër edhe më i madh. Ne kemi hekur dhe, për përpunimin e tij, do të ndërtojmë një kombinat të madh. I thuaj, gjithashtu, babait se do të ngremë edhe një uzinë të madhe për përpunimin e naftës. Te ne do të bëhen edhe shumë gjëra të tjera. I thuaj Hulos se Enveri të fton të vish më shpesh në Shqipëri.

SHOQJA LIRI KAVO: Po fëmijët në shkollë i keni?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Djali i madh, Iliri, studion për inxhinieri mekanike dhe është në vitin e katërt të universitetit; djali i dytë, Sokoli, studion për inxhinieri elektrike dhe është në vitin e dytë të uni-

versitetit; kurse vajza, Pranvera, është në klasën e dytë të shkollës së mesme.

SHOQJA LIRI KAVO: Shumë mirë, po më gjëzoni me këto që më thatë.

Kam një kërkesë: Po të ketë mundësi, të vizitojmë Krujën.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është punë që rregullohet kur të dëshironi ju, mund të shkoni që nesër, bile, në çfarëdo ore që të doni. Edhe koha është e bukur. Po të doni, mund të shkoni të shikoni edhe Laçin, që është një qytet i ri i ndërtuar tani. Aty kemi një uzinë të madhe që mund ta viziton. Pasnesër, po të doni, mund të shikoni edhe kalanë e Petrelës, që është afër Tiranës. Keni bërë ndonjë vizitë në qendrat tona kulturore?

SHOQJA VIOLETA KAVO: Mbrëmë vajta pashë shfaqjen «Fatosi partizan». Më pëlqeu shumë, se kercenin mirë dhe muzika, gjithashtu, ishte e bukur.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Në qoftë se nuk keni parë, mund të shihni edhe shfaqje të Ansamblit tonë të Këngëve e të Valleve Popullore.

SHOQJA VIOLETA KAVO: Më mbeti merak që do të iki pa i parë të gjitha. Isha në Durrës, po nuk i pashë zbulimet arkologjike që janë bërë atje.

SHOKU ENVER HOXHA: Amfiteatri që është zbuluar në Durrës është si Koloseu në Romë. Ju mund të shkoni përsëri në Durrës, merrni fotografi në kala, vizitoni dhe amfiteatrin. Edhe në Krujë mund të fotografoni monumentin e Skënderbeut dhe dyqanet karakteristike.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po Butrintin dhe Apoloninë i patë?

SHOQJA VIOLETA KAVO: Butrintin vajta dhe e pashë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të kishit parë edhe Apoloninë, që është shumë e pasur në monumente të kulturës dhe të artit të vjetër.

SHOQJA LIRI KAVO: Tahir Kavon e kishte marrë gazeta për aktivitetin e tij në Luftën e Vlorës. Nuk na e priste mendja këtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto i bën Partia jonë, ajo zbulon dokumente historike ku janë e ku nuk janë, me qëllim që të mos humbasë asgjë nga e kaluara e lavdishme e popullit.

SHOQJA LIRI KAVO: Kam ruajtur një pagure të vogël të qëndisur, me të cilën Tahiri pinte raki. Mendoj t'ia dërgoj muzeut në Gjirokastër.

SHOKU ENVER HOXHA: Mos e dërgo me postë, po ta sjellë Huloja kur të vijë vetë. Po të keni, ai mund të sjellë edhe ndonjë fotografi të Tahirit ose ndonjë shkresë a letërkëmbim të tij, për t'i eksposuar në muze.

Edhe ti, vajzë, t'i ruash të gjitha gjërat e babait, si ndonjë cigarishte, ndonjë defter shënimesh dhe sende të tjera, sepse ato do të na duhen për t'i vënë në muzeun e Luftës Nacionalçlirimitare. Babai yt e ka ndihmuar luftën, ai është patriot, besnik.

I patë Varrezat e Dëshmorëve në Gjirokastër? Ato janë bërë me mermer, bile në të gjitha qytetet e Shqipërisë, si në Korçë, në Shkodër, në Durrës etj. varrezat e dëshmorëve janë prej mermeri.

Tani në Tiranë për dëshmorët do të ndërtohen varreza të reja shumë të bukura, me mermer. Ato do t'i heqim prej andej ku janë dhe do t'i bëjmë më të mëdha e më të mira në një kodër tjetër mbi qytet.

SHOQJA LIRI KAVO: Teto Minoja e ka vënë fotografinë Tuaj në odën e miqve dhe, kur e shikon, thotë: «Mashalla, more djalë, që u bëre kaq i mirë!».

Tani të na falni, se do të shkojmë. Faleminderit shumë për këtë nder që na bëtë, duke na pritur përvizitë në shtëpinë Tuaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ne ju falënderojmë shumë që na erdhët. Për ju ruajmë kujtimet më të mira. T'i bësh shumë të fala Hulos dhe t'i thuash që e presim të na vijë vit përvit.

Edhe juve ju uroj shëndet, të jeni të lumtura e të gëzuara! Kur të vini prapë në Shqipëri, të na vizitoni përsëri kështu si sot.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimave të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

ZHVILLIMI I REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR DUILLET PARË KURDOHERË NË PRIZMIN KLASOR REVOLUCIONAR

Nga biseda me delegacionin e Akademisë së Shkencave dhe me delegacionin e punonjësve të shtypshkronjave të RP të Kinës

13 tetor 1970

Pas përshëndetjeve të rastit e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Ne dëshirojmë që shokët, miqtë kinezë që na vizitorjnë, të shkojnë kudo në Shqipëri, të njihen me problemet tona, të kuptojnë ndjenjat e thella të dashurisë që populli dhe komunistët shqiptarë ushqejnë për popullin kinez, të shikojnë përpjekjet dhe luftën e madhe që bën populli ynë për ndërtimin e socializmit.

Ne dëshirojmë jo vetëm t'ju njohim me sukseset, me të metat e me vështirësitë që kemi, por të përfitojmë edhe nga eksperienca e njëri-tjetrit. Të gjitha problemet e ngjarjet, duke filluar që nga ato politike, ne i shikojmë e i analizojmë në prizmin e marksizëm-lininizmit, të zhvillimit materialist dialektik të tyre, në prizmin e revolucionit proletar, që do të përbysë

borgjezinë kapitaliste e revizionistët modernë dhe do të sjellë në fuqi klasën punëtore, e cila do të vendosë kudo diktaturën e proletariatit dhe do të ndërtojë socializmin e më vonë komunizmin.

Ju jeni punonjës të shkencës e të teknikës dhe e dini se ne, marksistët, jemi për revolucionin tekniko-shkencor, por në të njëjtën kohë luftojmë tezën revizioniste, sipas së cilës revolucioni teknik sot ka arritur një shkallë të atillë zhvillimi saqë ai po «zëvendëson» dhe po e bën «të panevojshëm» revolucionin proletar. Me këtë tezë revizionistët përpiken të argumentojnë se gjoja tani nuk është më nevoja që populli dhe klasa punëtore e çdo vendi të hidhen në revolucion kundër kapitalizmit e imperializmit, për arsyen të ndryshimeve që ka pësuar teknika që nga koha e Marksit. Prandaj, sipas revizionistëve modernë, teza e Marksit për revolucionin proletar na qenka vjetruar, pra nuk është më në fuqi.

Ne marksistët, duke e shikuar revolucionin tekniko-shkencor në prizmin klasor revolucionar, argumentojmë se nuk është revolucioni tekniko-shkencor ai që përcakton karakterin e rendit ekonomiko-shoqëror, por është ky i fundit që përcakton karakterin, drejtimet dhe shkallën e zhvillimit të tij. Nuk janë shkenca dhe teknika ato që përcaktojnë zgjidhjen e kontradiktës midis punës e kapitalit, përkundrazi, zgjidhja e kësaj kontradikte me anë të revolucionit proletar krijon kushtet për zhvillimin e gjithanshëm të tyre.

Jeta shoqërore është në thelb një proces material. Në themel të saj qëndrojnë prodhimi material dhe puna e njeriut, i cili vepron ndaj natyrës si një forcë sho-

qërore e materiale. Duke vepruar kështu dhe duke dashur t'i shfrytëzojë lëndët e natyrës në dobi të tij, njeriu vë në lëvizje të gjitha forcat e veta fizike e mendore: duart, këmbët, muskujt, trupin, trurin. Puna e njeriut nuk i përngjet punës së kafshëve, ai vepron si një qenie shoqërore e ndërgjegjshme, duke vënë në veprim për këtë qëllim gjithë vullnetin e tij. Kështu, në bazë të zhvillimit dhe të transformimit shoqëror, që ndodh si rezultat i veprimitarise së ndërgjegjshme të njeriut, i luftës së të kundërtave, i konflikteve, i ndeshjeve, qëndron prodhimi material, siç vënë në dukje Marksit dhe Engelsi. Ndërsa ndryshimi i mënyrës së prodhimit, i rendit ekonomiko-shoqëror bëhet vetëm me anë të revolucionit shoqëror.

Është plotësisht e vërtetë se shkenca dhe teknika në kohën e sotme kanë bërë përparime të mëdha, me gjithëkëtë revolucioni tekniko-shkencor nuk mund të zëvendësojë në asnjë mënyrë revolucionin proletar, ashtu sikurse inteligjencia nuk mund të luajë rolin pararojë, siç duan ta paraqesin armiqtë e marksizmit, që vetëm klasa punëtore është në gjendje ta luajë. Shkenca dhe teknika, me gjithë përparimet dhe megjithëse vazhdojnë të ecin përpara, në vetvete nuk mund të bëjnë kurrsesi atë përbysje të botës së vjetër që historia ia ka ngarkuar për mision proletariatit revolucionar.

Prandaj ne, si marksistë-leninistë, i shikojmë problemet drejt dhe jemi për atë që revolucioni proletar të ecë kurdoherë përpara, derisa të vendoset kudo diktatura e proletariatit. Në këto kushte edhe teknikën me shkencën do t'i marrin në dorë e do t'i zhvillojnë

me vrull, si kurrë ndonjëherë, klasa punëtore, fshatarë-sia punonjëse dhe inteligjencia e dalë nga këto dy klasa, aleanca e të cilave është vendimtare për fitoren e revolucionit proletar.

Edhe te ne ecet në rrugën e përparimit të shkencës e të teknikës. Në sajë të politikës së drejtë të Partisë sonë, që nga Çlirimi e deri tani është bërë një përparim i madh në të gjitha drejtimet, si në zhvillimin e industrisë, të bujqësisë, të arsimit e të kulturës etj. Siç e konstatuat edhe vëtë, te ne ka një etje të madhe për dituri nga ana e punëtorëve dhe e fshatarëve. Ne kemi hapur një rrjet të gjerë dhe të përshtatshëm shkollash, duke bërë përpjekje për të krijuar një shkollë me të vërtetë revolucionare, marksiste-leniniste.

Njerëzit tanë e duan atdheun, punën e mësimin dhe, duke u ndriçuar nga teoria marksiste-leniniste, ata punojnë, mësojnë e njëkohësisht vigjilojnë në çdo moment për mbrojtjen e fitoreve të arritura. Marksizëm-leninizmin ne përpinqemi ta bëjmë mish e gjak të të gjithë njerëzve tanë dhe, në këtë drejtim, kemi arritur një përparim të kënaqshëm. Ne kemi mundur të zgjojmë një interesim të madh te punëtorët, në radhë të parë, te teknikët e inxhinierët që të mësojnë, të bëjnë shpikje e racionalizime dhe të përfitojnë nga eksperiencia e përparuar.

Shkenca është e domosdoshme të zhvillohet e të përhapet në masat e gjera të punonjësve dhe për këtë qëllim shërben shumë edhe shtypi, i cili tani, në krahasim me më parë, merret më gjerësisht me trajtimin e problemeve të shkencës e të teknikës.

Ndërsa ne po korrim suksese në të gjitha fushat,

imperialistët amerikanë, revizionistët sovjetikë, Titon me shokë i kanë mbërthyer krizat. Ata përpinqen të gjejnë ndonjë ilaç për të shpëtuar nga e keqja që i ka zënë, por sëmundja e tyre është aq e rëndë, sa nuk ka shërim nga asnje lloj ilaçi. Kontradiktat mes ujqve imperialistë po thellohen, ndërsa revolucioni dhe forcat e shëndosha të popujve kundër revizionistëve e kapitalistëve janë në ngjitje.

Imperialistët, duke ndjekur politikën e luftës aggressive, kanë rënë mes zjarresh të shumta. Posa hapin zjarr në një vend, ndizet edhe në një vend tjetër, sa arrijnë të shuajnë të parin, u ndizet diku gjetkë e kështu me radhë «hallet» e tyre s'kanë të mbaruar. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u turbulluan shumë kohët e fundit nga traktati që revizionistët sovjetikë përfunduan me Gjermaninë Perëndimore, sepse kanë frikë se u rrezikohen interesat e tyre në qendër të Evropës e në jug të saj, në Mesdhe, ku kanë një pjesë të rëndësishme të flotës së tyre ushtarake. Imperialistët amerikanë janë të shqetësuar edhe nga atrimi i Francës me Bashkimin Sovjetik, i cili, për t'i frikësuar amerikanët, përpinqet t'u japë të kuptojnë atyre sikur Franca po bëhet me të, ndërsa kësaj i fërkon krahët. Por edhe Franca vetë, meqenëse ka kontradikta me Shtetet e Bashkuara dhe ka frikë nga rritja e fuqisë së Gjermanisë Perëndimore, përpinqet ta ketë mirë të paktën me sovjetikët, se «mos i ikën autobusi» pas nënshkrimit të Traktatit Moskë-Bon.

Gjithë këto aleanca të lidhura sot në mes kapitalistëve dhe revizionistëve janë të paqëndrueshme, nësër ato mund të ndryshojnë prapë, se në gjirin e tyre

do të lindin me siguri kontradikta të tjera. Politika reaksionare e gjithë këtyre është e paqëndrueshme. Ajo goditet vazhdimesh nga krizat ekonomike, nga gretat e demonstratat, nga vala revolucionare e proletariatit dhe e gjithë popujve që luftojnë për çlirim politik, ekonomik e shoqëror.

Sa më shumë kontradikta e ndeshje të ketë midis armiqve, aq më mirë është për proletariatin, për revolucionin, aq më shpejt ata do t'ia hanë kokën njëri-tjetrit, sepse vetë po i hedhin zjarrit benzinë që të marrë flakë sa më shumë dhe me siguri armiqtë tanë do të digjen në këtë zjarr të madh.

Titoja, si armik dhe tradhtar i marksizmit që është, për të luajtur rolin e agjentit të imperializmit, bredh poshtë e lart nëpër Evropë. Në një deklaratë që bëri kohët e fundit tha se shumë herë ka bërë vizita në vendet e ndryshme të Afrikës, kurse tani e tutje do t'i kushtohet më shumë Evropës, me qëllim që në këtë pjesë të botës të vendosen «paqja» e «uniteti». Atij tani Evropa i ka mbetur «për të rregulluar», se vendin e tij e «rregulloi»! Dhe ne e dimë mirë se si e ka vënë këtë rregull atje. Në Jugosllavi kanë vajtur gjer tani me dhjetëra bankierë të huaj, deri te Maknamara, për të shkëputur sa më shumë koncesione nga pasuritë e popujve të saj. Meqenëse Titoja, siç thashë, e «rregulloi» Jugosllavinë, ai ka marrë tani përsipër «të rregullojë» Evropën! Dhe, me gjithë këto dallavere të paturpshme që bën haptazi, ai përsëri e quan veten komunist, por ai s'është veçse një renegat i socializmit.

Edhe Rumania ndjek hap pas hapi shembullin e

Jugosllavisë. Sistemi i organizimit në Rumani është afërsisht i njëjtë me atë të revisionistëve jugosllavë. Bankat dhe krediti i huaj atje kanë zënë vend njëloj si në Jugosllavi. Gjer tani në Rumani ka 15 a 20 supertruste që nuk pyesin as për qeverinë, por janë ato që bëjnë ligjin. Atje ka diplomatë për tregti, agjentë tregtarë të kualifikuar që, në interes të trusteve që përfaqësojnë, mbajnë lidhje me trustet e gjithë botës. Janë pikërisht ata që shesin e blejnë, që ulin e ngrenë çmimet e bursës. Këta janë elementët e «vetadministritë rumun». Rroga mesatare e punëtorit rumun është 4-5 herë më e vogël se ajo e drejtorit të fabrikës, pa llogaritur shpërblimet që janë barazi të paktën me 6 rroga në vit që marrin drejtori dhe ata që janë rrëth tij.

Krejt ndryshe është gjendja te ne, ku ecet sipas mësimeve të Marksit dhe sipas praktikës së Komunës së Parisit. Pagat te ne janë caktuar në atë masë sa diferençat ndërmjet tyre janë të vogla deri në një, dy ose e shumta në dyfish e gjysmë. Në vendin tonë rroga e punëtorit s'ka ndonjë diferençë të madhe, lëre me atë të drejtorit të ndërmarrjes, po as me atë të ministrit, kurse po të krahasosh pagën e punëtorit sovjetik me atë të kuadrove udhëheqës shtetërorë, do të dalë që diferenca është shumë e madhe.

Është e qartë se vetëm revolucioni do t'i vërë në vend gjithë këto padrejtësi. Popujt e botës e shikojnë se vija jonë marksiste-leniniste shkëlqen si drita. Sado të mundohen ta paraqesin veten si marksistë, armiqtë e marksizëm-leninizmit nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit.

Le ta ngremë, pra, këtë gotë për miqësinë tonë, për shëndetin tuaj, shokë. Shumë të fala shokëve, rru-gë të mbarë¹!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

1 Lidhur me këtë bisedë shoku Enver Hoxha në Ditarin e tij Politik shkruan: «U fola një orë, kurse të dy kryetarët e delegacioneve m'u përgjigjën me tri fjalë: «Ngremë dollinë për shëndetin tuaj».

Qëndrime si prej Li Hsien Nieni, po aq na bën, ne bëjmë punën tonë të drejtë».

INDUSTRIA JONË DO TË BËHET MË MODERNE

*Nga biseda me një grup punëtorësh
të Tiranës¹*

16 tetor 1970

Pasi u takua përzemërsisht me punëtorët dhe i falënderoi për urimet, shoku Enver Hoxha tha:

Ata që vijnë nga shkolla, në fillim nuk kanë eksperiencë si ju, megjithëse edhe shumë nga ju, që s'kanë pasur rast të ndjekin shkollën, po e vazhdojnë atë tani, disa kanë mbaruar edhe kurse specializimi. Natyrish, dihet se ata që mbarojnë universitetin duan një kohë më të shkurtër për të fituar eksperiencë, në krahasim me ata që kanë një kohë më të gjatë në punë, por që nuk kanë shkollë. Prandaj mësoni, shoqë dhe shokë, nëpër shkolla, pse ashtu mund ta merrni zanatin më shpejt.

1 Me rastin e 62-vjetorit të lindjes, më 16 tetor, shoku Enver Hoxha priti në shtëpi grupe punonjësish, kuadrosh e të rinjsh, të cilët e uruan në emër të organizatave të Partisë e të masave, të punëtorëve, të kooperativistëve, të punonjësve të artit e të kulturës dhe të ushtarakëve.

Synimi i Partisë është që industria jonë në të ardhmen të bëhet sa më moderne, shumë më moderne nga kjo që kemi sot. Tani, për shembull, kemi disa rafineri nafte dhe jemi të kënaqur me to, por në të ardhmen kërkesat tona do të rriten më shumë, ne duam ta bëjmë benzinën me 80 oktavë, që të jetë e pastër si qelibari. Rafineria e re që do të ndërtojmë në Ballsh, do të jetë më moderne dhe kërkon kuadro të zotë. Ajo nuk do të ngrihet dot këtë pesëvjeçar, pse është shpejt akoma, por mundet në tjetrin ose në të gjashtin, kjo varet nga zhvillimi i një sërë ndërmarrjesh të tjera, nga hovi që do të marrë zhvillimi ekonomik i vendit. Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës do të prodrojë edhe lëndë sintetike për të bërë gjithfarëlloj prodhimesh që na duhen dhe jo vetëm rroba.

Të gjitha këto do t'i japin një zhvillim të madh industrisë së vendit tonë, prandaj duhet të mendojmë qysh tani sa inxhinierë, teknikë e të tjerë do të kemi në të ardhmen, jo pas 20 vjetëve, por për një të ardhme të afërt. Prandaj ju, shokë punëtorë të Uzinës së Traktorëve apo ju të uzinave «Dinamo» e «Partizani» duhet të bëni përpjekje që t'i përvetësoni proceset e punës, pse do të vijë koha që, në vend të veglave të ndërrimit, të prodhoni traktorë, makina e të tjera pajisje, gjë që do t'i japë hov të madh zhvillimit industrial të vendit. Edhe uzina e hekur-nikelit do t'i japë hov të madh zhvillimit ekonomik të vendit. Eksporti i lëndës së hekurit tani na preokupon mjaft. Në gazeta shikojmë të botohën artikuj, ku thuhet se nuk kemi sulina që janë aq të nevojshme, mirëpo puna është se ato importohen, prandaj të bëjmë përpjekje që t'i prodrojme në vend

dhe do t'i prodhojmë. Na bië një detyrë e madhe ta ngremë më lart ndërgjegjen e klasës punëtore dhe të të gjithë të tjerëve, pse vetëm me një ndërgjegje të lartë politike në punë ne do të arrijmë t'i bëjmë të gjitha, edhe ngritjen e teknikës moderne, po për këtë çdo gjë duhet parë politikisht.

Ta ngremë këtë dolli për shëndetin tuaj, të na rrojë Partia!

PUNËTORET: Të rroni sa malet!

SHOKU ENVER HOXA: Partinë duhet ta kemi të fortë dhe një parti komuniste nuk farkëtohet në gjumë, por në luftë e në përpjekje, në punë, në fabrika, në ara, në shkolla. Kjo do të thotë që komunistët duhet të jenë në ballë të luftës dhe të përpjekjeve për të mbrojtur interesat e popullit, vijën e Partisë, për të sqaruar e për të ngritur njerëzit ideologjikisht dhe politikisht me shembullin e tyre.

Tani edhe me ndërtimin e shtëpive po ecim më mirë, megjithatë akoma nuk plotësohen si duhet të gjitha kërkesat e popullit, kjo kryesisht për mungesa materiale. Natyrish, pengesa ka dhe këto na bëjnë të marrim masa për fuqizimin e forcave prodhuese, pse, megjithëse ndërtimet e banesave janë shtuar, kërkesat për to janë të mëdha dhe ato nuk mund të përballohen me këto materiale ndërtimi që prodhojmë sot. Gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm do të merren masa që brenda tre-katër vjetëve të sistemohet një numër i mirë njerësish në apartamente. Disa vjet më parë bënim llogari se na duheshin dymbëdhjetë vjet për ta përballuar këtë nevojë, tani, me revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit, i përbysëm këto llogari. Pastaj do të ndër-

tojmë shtëpi edhe për fëmijët që do të marto

PUNËTORËT: Të rroni sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit, te rroni
ju, të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TE MËSONI MIRË NË SHKOLLË

*Nga biseda me një grup fatosash, pionierësh
dhe të rinjsh të Tiranës dhe të Durrësit*

16 tetor 1970

Në fillim një pioniere, në emër të të gjithë pionierëve e të të rinjve, e uroi shokun Enver Hoxha dhe i solli përshtendetjet më të zjarrita dhe urimet më të mira të brezit të ri. Pastaj u zhvillua një bisedë e përzemërt:

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë!

Si jeni? Si ia çoni ju djemtë me top? Me futbollin besoj se jeni mirë. Edhe vajzat luajnë me top, volejboll e basketball, por, kur vjen çështja për të mësuar në shkollë, ato e mësojnë më mirë nga djemtë marksizëm-leninizmin, më duket mua.

Shoku Enver Hoxha njihet me vajzën e Heroit të Punës Socialiste Adem Reka dhe i thotë:

Ke bërë shumë mirë që ke ardhur. Nëna si është? Ti ku mëson, në ç'shkollë je?

TATJANA REKA: Nëna mirë është, unë jam këtu në Tiranë, në Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë.

Po ju kolopuçët çfarë prisni? Sulmoni, hani nga këto çokollatat.

Me atë atje¹ jemi njohur 16 vjet më parë. Që atëherë nuk ishim takuar. Dhe ja, u takuam sot. Atëherë ai ishte i vogël, nuk kishte hyrë akoma në shkollë. Ishim në Voskopojë, rrnim nën hijen e pishave dhe bënim muhabet, luanim me guriçka. Unë i thosha të shkonte të merrte gurë e ndonjë shkop dhe bënim pushkë.

Në çfarë klase je tani?

SPARTAK KOTE: Në vitin e katërt, studioj për inxhinieri mekanike.

NJË PIONIERE: Edhe unë, xhaxhi Enver, e kam herën e dytë që takohem me ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu?! Shumë mirë, po ku jemi takuar bashkë?

PIONIERJA: Jemi takuar në festën e Vodicës. Ju më morët në krah dhe më puthët.

SHOKU ENVER HOXHA: Të kujtohet sa bukur ishte atë ditë, si ishte zbukuruar Vodica për festë?! Atje ishte edhe një plak nga një fshat i Kolonjës, i cili më mori nga krahu dhe më tha: «Shoku Enver, unë dëshiroj një gjë nga ju, do të ma jepni?». «Çfarë është ajo, thuama, pa, po të jetë për të ta dhënë, do të ta jap», — iu përgjigja. «Dua një top», më tha ai. Ky ishte një nga ata luftëtarët që nuk donte pushkë, po top për të mbrojtur kufirin. Kurse ju të mësoni mirë në shkollë dhe, kur të rriteni, të mësoni edhe armët e ndryshme, pushkën, mitralozin etj.

1 Shoku Enver Hoxha tregon të riun Spartak Kote.

Tani të bëjmë një fotografi së bashku.

*Fatosat, pionierët e të rinjtë e rrëthuan shokun
Enver Hoxha dhe dolën me të në fotografi.*

Faleminderit shumë, t'u bëni të fala gjysheve, nënave e baballarëve!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TE PUNOJMË ME TE GJITHA FORCAT QE TE REALIZOJMË VEPRA TE REJA

*Nga biseda me një grup kooperativistësh
të Tiranës dhe të Tropojës*

16 tetor 1970

Shoku Enver Hoxha përshëndetet me kooperativistët dhe veteranët që i erdhën në shtëpi. Sa zunë vend, filloj një bisedë e përzemërt. Pjesëmarrësit në këtë takim ishin plot gjëzim dhe emocione.

SHOKU AJDIN BAJRAKTARI: Në emër të veteranëve të rrethit të Tropojës, Ju sjell urimet më të përzemërtë për datëlindjen, shoku Enver. Të na rroni sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit, të na rrojë Partia!

Ditët që vizitova rrethin e Tropojës do të janë të paharruara përmua, pse pashë me sytë e mi patriotizmin, zjarrin e madh, dashurinë dhe besnikërinë për socializmin, të popullit patriot të Tropojës, i cili edhe në të ardhmen do të shquhet, ashtu sikundër është shquar në të kaluarën me Bajram Currin, në Luftën Nacionalçlirimitare dhe më vonë në ndërtimin e socializmit e në mbrojtjen e atdheut. Në rrethin tuaj janë bërë

plot gjëra të mira, megjithatë s'duhet të kënaqemi, se kemi akoma për të bërë, sidomos në malësi. Për këtë qëllim aty kanë ardhur ekipe, që kanë lënë detyra, të cilat duhet të plotësohen.

SHOQJA NURIJE MALAJ: Ne kemi filluar nga zbatimi i detyrave që na ka lënë ekipi i Komitetit Qendror të Partisë. Edhe detyrat e tjera janë realizuar dhe po realizohen. Deri tani si rrëth kemi marrë mesatarisht 18 kuintalë grurë pér hektar. Shtetit i dorëzuam edhe teprica. U realizua, gjithashtu, plani i mishit, i qumështit, i leshit, i shqemes. Që nga vizita juaj e deri tani të rinxjtë, nxënësit e shkollave, fshatarët, ushtarët janë hedhur në aksion pér mbledhjen e gështenjave, në mënyrë që të mos shkojë asnje kokërr kot.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë.

SHOKU AJDIN BAJRAKTARI: Me ne është edhe vajza e Ali Shabanit¹. Ja ku është!

SHOKU ENVER HOXHA: Oh sa mirë! Si jeni, si është baba, a është mirë me shëndet? Kur isha me shokët në Dragobi, aty ku ishim ulur e po bisetonim, Aliu u interesua të dinte çfarë po bëhet tej kufirit dhe më tregoi Kosovën. Unë me këtë rast i fola pér Kosovën, se e kuptova ku e kishte hallin. Ai më dëgjonte me vëmendje. Si është tani me shëndet baba?

SHOQJA GJYKË SHABANI: Shumë mirë është dhe ka mbetur shumë i kënaqur dhe i gëzuar që kur erdhët Ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ju, shokë të Tiranës, si jeni, si ia çoni me punët e bujqësisë? Po me ullirin?

1 Patriot, bashkëluftëtar i Bajram Currit.

Pasi kooperativistët e rrethit të Tiranës e vënë në dijeni udhëheqësin e Partisë për gjendjen e punëve në bujqësi, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

Në dy rrethet tuaja, Tiranë e Tropojë, ka pasuri mineralesh. Nxjerrja e tyre do të sjellë një përparim të madh për të gjithë vendin. Edhe Hidrocentrali i Fierzës do të ndërtohet, edhe rrugës së Dragobisë do t'i vijë dita të asfaltohet, me qëllim që të venë njerëzit e të pushojnë, se atje ka bukuri të rralla, ka male të thepisura dhe pamje të mrekullueshme. Duhet të bëjmë kujdes dhe të punojmë me të gjitha forcat që të realizohen këto vepra të reja.

SHOKU AJDIN BAJRAKTARI: Kam shkuar disa herë atje, që kurse e vizituat Ju rrethin tonë, shoku Enver dhe njerëzit më kanë porositur t'Ju them se do t'i zbatojnë të gjitha porositë që dhatë. Më parë njerëzit thoshnin me këmbëngulje që atje nuk bëhet gruri, kurse tani, po të kërkosh bukë misri, nuk gjen. Edhe kumbulla ka shumë në Tropojë.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet t'i përmirësoni kumbullat, se ato kanë vlerë të madhe.

Njerëzit tanë kuptojnë çdo gjë drejt, se janë të zgjuar, punojnë me ndërgjegje, prandaj duhet të jemi shembullorë të gjithë.

Tani të bëjmë një fotografi me cucën e Ali Shabanit dhe me Nexhmijen e t'ia dërgojmë babës, se do të gëzohet shumë.

Botohet për herë të parë sipas shënimave të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

ÇDO GJË TA BËJMË ME FRYMË REVOLUCIONARE

Nga biseda me një grup ushtarakësh

16 tetor 1970

Pasi grupi i ushtarakëve e uroi shokun Enver Hoxha me rastin e 62-vjetorit të lindjes, u zhvillua kjo bisedë e përzemërt:

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit! Si jeni me shëndet, a jeni mirë?

Partia po ngre kuadro të rinj me gatishmëri të lartë, me zanat. E tillë ështëjeta sot. Prandaj ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që dijenitë tonat'i vëmë në shërbim të popullit dhe të Partisë, të jemi të gatshëm t'ia transmetojmë brezit të ri që po rritet, se eksperiencia e Partisë është e madhe. Ju të rinjtë e merrni këtë eksperiencë në shkollë nga oficerët, nga kuadrot me përvojë, por ndihmësit imediatë të tyre duhet të vënë të gjitha forcat për ta përvetësuar eksperiencën e tyre dhe të vjetrit të mos kenë frikë se mos u zënë vendin të rinjtë, të mos janë egoistë, të mos kenë pikëpamjen, se «këta po na shtyjnë në qoshe». Ata që janë të zotë të japid, të vendosen ku duhet dhe

ne, të vjetrit, të jemi të lumtur që përgatitim kuadro të tillë, të cilët janë në gjendje të na zëvendësojnë.

Te ne të gjithë punojnë, të gjithë kanë punë. Edhe Rahman Hanku¹ ka punë plot, se çdo pesëvjeçar që vjen, është më i ngjeshur në detyra. Ju, shokë të ushtrisë, merrni gjëra të gatshme për ndërtim, por ushtria nuk duhet të presë çdo gjë nga të tjerët. Puna është se, ndërsa për ndërtime kemi nevoja të mëdha, sasitë e çimentos që prodhojmë, nuk arrijnë. Prodhimi i kësaj lënde duhet të industrializohet. Ne do t'i shtojmë fabrikat e çimentos, pse gjithë këto ndërtime të mëdha që po bëjmë, duan çimento. Sidoqoftë, ashtu siç u bë fabrika këtu në Tiranë, të bëhen edhe gjetkë, por të marrim masa për t'i forcuar ato, që me ndërtimet të ecim më shpejt, sepse kërkesat janë të mëdha.

Kur është pa apartament, tjetri kërkon, por kur merr për vete, nuk flet më, kurse ai, të cilit nuk i është zgjidhur nevoja për strhim, do të flasë. Mirëpo ç'ndodh? Kur ngrihet ndonjëri e kërkon t'i zgjidhet problemi i strehimit, shpesh drejtuesi i mbledhjes mezi pret sa të mbarojë. E mira është të dëgjohen njerëzit dhe të diskutohet për ndërtime masive, për të plotësuar sa më shumë nevoja strehimi. Problemi i strehimit zgjidhet duke ndërtuar sa më shumë shtëpi, duke gjetur për këtë forma dhe metoda të reja që më parë nuk i kemi pasur. Përpara duhej të prisnim muratorin e Gollobordës të na ndërtonte shtëpi dhe mure, kurse në Peshkopi ndërtuan këtë vit 300 apartamente të reja,

1 Në atë kohë ministër i Ndërtimit, ishte i pranishëm në këtë takim.

pra një lagje të tërë. Këtë e bënë punëtorët dhe fshatarët dibranë. Kështu e zgjidhi Partia në rreth këtë problem.

Pra, nuk duhet gjykuar sipas metodave të vjetra, duke bërë diskutime pa bukë, jo të prodrojmë tulla kështu, jo ashtu. Të mos rrimë me llogaritë e ndonjë ekonomisti të shkëputur nga masa, se kështu nuk ecet, çdo gjë ta bëjmë me frymë revolucionare, me aksion.

Pastaj shoku Enver Hoxha iu drejtua një shoqeje nga grupi i ushtarakeve.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti je oficere?

SHOQJA ERVEHE POLO: Unë vazhdoj Shkollën e Bashkuar të Oficerëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Përse vazhdon?

SHOQJA ERVEHE POLO: Për këmbësori.

SHOKU ENVER HOXHA: Mëson mirë?

SHOQJA ERVEHE POLO: Mirë mësoj.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk kam asnje dyshim që mëson mirë. Të gjithë kemi nevojë për të mësuar vazhdimit.

Faleminderit shumë të gjithëve, të rrojë Partia!

Botohet për herë të parë sipas shënimive të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

VEPRAT E SHKRIMTAREVE DHE TË ARTISTËVE TANË QËNDROJNË LART

*Nga biseda me një grup punonjësish të artit
dhe të kulturës*

16 tetor 1970

Shoku Enver Hoxha i takoi me gëzim punonjësit e artit e të kulturës dhe, pasi i falënderoi për urimet që i bënë me rastin e datëlindjes, u tha:

Tani kanë dalë kuadro plot, që shkruajnë, këndojnë, kërcejnë, piktuojnë, popullin e kënaqin, çmime fitojnë dhe lënë përshtypje të mira.

Është e kuptueshme se borgjezia ka vënë dhe do të vërë ligjin e heshtjes për sa i përket përparimit të vendit tonë, sepse ne jemi një vend socialist; ajo nuk do të tregojë për të gjitha sukseset tona. Pastaj borgjezia, nisur nga ideologjia e saj, i mat vlerat me madhësinë e një vendi dhe të një populli.

Mirëpo vendi ynë, edhe pse i vogël, ka çfarë të tregojë e është bërë i njohur, dhe tani flasin për ne jo se dëshirojnë, por sepse koniunkturat e detyrojnë borgjezinë të tregohet një çikë më e lirë, ndonëse prapë flet me zor. Veç kësaj, për të denigruar vendin tonë,

thuhet se më përpara shqiptarët ishin me sovjetikët, tani janë me kinezët, megjithëse kësaj gjëje ata nuk i besojnë as vetë. Megjithëse janë reaksionarë dhe e dinë që politika e Partisë së Punës të Shqipërisë është marksiste-leniniste konsekuente, në ndonjë rast ata e lejojnë vendin tonë të marrë pjesë në aktivitete kulturore ndërkontinentare. Mirëpo kjo shkakton atë që ndodhi kur ansamlli ynë shkoi në Francë. Duke qenë në lartësinë e duhur, ai bëri atë përshtypje të madhe e la ato mbresë të thella, që i dimë të gjithë, për artin, për freskinë, për koloritin dhe për harmoninë aq të bukur, që i habitën të gjithë, duke marrë parasysh se jashtë, nga propaganda reaksionare, janë mësuar të dëgjojnë se Shqipëria është e prapambetur. Por kudo ka njerëz realistë që thonë se një nivel kulturor dhe artistik i tillë nuk arrihet për një ditë, as vjen rastësisht. Grupi i njerëzve tanë që përbën një ansambël aq të bukur, u ka bërë përshtypje të madhe spektatorëve të huaj për sjelljen e kultuurar. Kështu, duke parë një sjellje të tillë tek artistët tanë, pa simpatizuar aspak politikën e Partisë sonë, ata mendojnë me respekt për Shqipërinë, e shikojnë se ajo nuk është siç thotë shtypi reaksionar.

E njëjtë gjë ndodhi edhe kur doli romani i Ismail Kadaresë¹. Porsa e lexuan, shumë botues bënë përpjekje kush ta shtypte më përpara. Natyrisht, ai është një roman i mirë, por në vendin tonë ne kemi edhe dhjetëra romane e vëllime të tjera të mira. Ata që botuan romanin e Kadaresë u kapën nga koniunkturat dhe nga miqësitë borgjeze, mirëpo botimi i librit atje-

1 «Gjenerali i ushtrisë së vdekur».

bëri bujë. Po sikur të përkthehen dhe të shtypen jashtë romane të tjera që kemi botuar ne, po të vejë në ndonjë vend të Perëndimit të japë shfaqje teatri ynë, me pjesë të përshtatshme, ato do të bëjnë bujë.

Këndoja një ditë shkrimin e një gazetari të huaj¹ që në esencë thoshte se qofshin të majtët, qofshin të djathtët, kudo që janë, i kanë injoruar Shqipërinë dhe ndërtimin e socializmit në këtë vend. Ky njeri, në mënyrë teorike, pa hyrë në shifra, kontribuon për të treguar rezultatet që kemi arritur ne në të gjitha fushat, në industri, në bujqësi, në arsim, në përgatitjen e kuadrove dhe, mbi të tëra këto, thekson ai, në Shqipëri nuk ka taksa. «E si mund të injorohet një gjë e tillë?» — pyet publicisti i huaj.

Mezi, pas 25 vjetësh, që nga Çlirimi i vendit tonë, doli një publicist francez i njohur, që arriti të influenconte për botimin në Francë të një libri shqiptar, të romanit të Kadaresë, ndërsa e dimë se çfarë nuk shtypen në botën perëndimore e revisioniste, që nga veprat më të mira e deri te surogatot e revisionistëve sovjetikë, rumunë, çekë e të tjerë, që në të vërtetë nuk janë komunistë, po kapitalistë. Vetëm një botim u bë për Shqipërinë në Francë, ku nuk botohet një gjë e vogël për vendin tonë e jo më romane e vepra të tjera letrare që shkruani ju, shoqe dhe shokë. «Komunistët» italianë nuk shkruajnë një artikull për Shqipërinë, që borgjezia e tyre e madhe imperialiste e sulmoi dy herë, pa le pastaj të batojnë një roman! Ata t'u marrin të keqen

1 Luciano Manegati: Dritare e hapur për Shqipërinë, në «Sette giorni», nr. 169, shtator 1970.

veprave tona letrare, muzikës, pikturës dhe përgjithësisht kulturës sonë, që qëndrojnë aq lart. Unë kam kënduar shumë materiale të rumunëve, të bullgarëve e të tjerëve dhe, pa u mburrur, mund të them se veprat që shkruajnë shkrimtarët dhe artistët e tyre s'qëndrojnë dot përballë atyre të njerëzve tanë.

GRUPI: Të rroni sa malet, shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Të rrojë Partia, të luëzojë kultura jonë socialiste!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TE POPUJT ARABË ËSHTË I MADH ZJARRI I LUFTËS PËR ÇLIRIM

*Nga biseda me kuadro të aparatit të Kryeministrisë,
të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës
dhe me disa patriotë pensionistë*

16 tetor 1970

Udhëheqësi i Partisë i takoi me radhë shokët, kuadro e veteranë, që kishin ardhur për të uruar me rastin e përvjetorit të datëlindjes së tij dhe zhvilloi me takëtë bisedë:

SHOKU ENVER HOXHA: Ne nuk e ndiejmë vreten pleq, sa kohë do të punojmë akoma!

Vajza jote është komandante në hekurudhë, o Shabë?

SHOKU SHABAN REXHA¹: Jo, ajo është mbesa ime².

SHOKU ENVER HOXHA: Është vajzë e mirë, e zonja, e kam parë njëherë kur na erdhi në një mbledhje të Sekretariatit të Komitetit Qendror. Tani kemi

1 Veteran i Luftës Nacionalçlirimtare.

2 Është fjala për shoqen Lumturi Rexha.

udhëheqëse rinie të tilla, si mbesa jote, që janë shumë të zonjat, ato sot janë me qindra dhe dallohen kudo për zotësinë dhe për gjallërinë e tyre. Në të vërtetë tanë rrallë gjen njerëz të fjetur, se nuk i lë situata të tillë.

Sot më erdhën këtu edhe çupa e Adem Rekës dhe mbesa e Mujo Ulqinakut dhe u gëzova shumë.

Vete ndonjëherë në ato fshatra që na kanë mbajtur me bukë e na kanë ndihmuar në luftë?

SHOKU SHABAN REXHA: Vete dhe, nga sa kam parë, njerëzit janë shumë të kënaqur.

SHOKU ENVER HOXHA: I ndihmuat ndonjë çikë ata të Jordanisë o Mane¹?

SHOKU MANE NISHOVA: Po, i ndihmuam me ushqime.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund t'i ndihmoni edhe më shumë. Palestinezët kanë ndesur me mbretin Hysein të Jordanisë, që ka qenë njeriu i Intelixhens Servisit dhe i Lavrensit. Por, sido që të bëjnë imperialishtët dhe revizionistët, vështirë do ta kenë në Lindjen e Mesme me popujt arabë, të cilët, në mos sot, nesër, do t'i shporrin andej. Historia, duke filluar që nga koha e Muhamedit dhe më pas, vërteton se popujt arabë janë të fortë, janë luftëtarë të shkathët. Lidhur me këta popuj ka shumë teori, materialiste dhe idealiste, që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Secila sipas mënyrës së saj përpinqet të shpjegojë ç'i shtyu beduinët e Arabisë të sulmojnë nga të tëra anët, të hidhen gjer në

¹ Mane Nishova, në atë kohë kryetar i Kryqit të Kuq Shqiptar.

Evropë, ku shkatërruan ushtritë franceze, siç shkatërruan në zona të tjera ato të persëve, të sulttanëve, të faraonëve. Këta ishin pikërisht njerëzit e rërës.

Teza e parë, që e ka burimin në teoritë idealiste, përpinqet të shpjegojë se arabët i frysmezojnë bëjnë përpara Kurani, feja islame, kurse teza shkencore materialiste na sqaron drejt se arabët ishin njerëz të shtypur e të varfër. Pikërisht varfëria dhe uria i shtytën ata të linin rërën dhe të sulmonin Veriun, prej andej të hidheshin në Mekë e në Medinë dhe të zinin kyçet e rrugëve ku kalonin karvanet tregtare për në Siri, në Irak etj. Beduinët, të shtyrë më shumë nga vuajtjet dhe nga uria, i kanë pasë sulmuar tregtarët qysh përpara Muhamedit, pse në vendin e tyre kishte vetëm rërë. Dhe nga këta njerëz të rërës, nga gjiri i luftëtarëve të popujve arabë kanë dalë gjeneralë të famshëm qysh atëherë, po edhe më vonë, siç ndodhi në kohën tonë në luftën e madhe që ka bërë populli algjerian. Algjerianët kanë luftuar me rreptësi kundër francezëve, megjithëse këta u treguan të egër me ta.

Duke parë në televizor turmat e egjiptianëve që sulmonin në rrugët e Kajros, për të prekur pak trupin e Naserit, kjo të bën të mendosh sa i madh është te popujt arabë zjarri i luftës për çlirim. Ky shpirt luftarak i tyre do t'u tregonte vendin armiqve imperialistë dhe revizionistë, në qoftë se udhëheqjet e shteteve arabe nuk do të ishin në duart e borgjezisë reaksionare, që shitet e blihet apo të borgjezisë nationale që lëkundet. Ndryshtë qëndron puna me palestinezët, të cilët ideja e çlirimit i ka bërë të jenë në pararojë të popujve arabë. Ata janë si të parët e tyre, njerëz të guximshëm,

trimë, dhe, pavarësisht se janë në pozita të vështira, armët nuk i hedhin, po luftojnë me vendosmëri dhe, nëpërmjet përpjekjeve, duke kapërcyer tradhtitë që u bëhen dhe gjithfarë vështirësish që u krijohen nga qeveritë reaksionare, siç është ajo e mbretit Hysein të Jordanisë, kaliten, ecin përpara dhe do të arrijnë me siguri në fitoren aq të dëshiruar.

Pas bisedës shoku Enver Hoxha u përrshëndet me shokët që ishin të pranishëm në këtë takim, të cilët i uruan edhe një herë: «Të rroni sa malet!».

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

ARMIQTE DO T'I DEMASKOJME EDHE NË TË ARDHMEN

*Nga biseda me të ngarkuarin me punë a.i. të ambasadës
së RP të Kinës në Tiranë*

16 tctor 1970

*Pasi u përshëndet me të ngarkuarin me punë a.i.
të ambasadës së RP të Kinës dhe e falënderoi atë për
urimet me rastin e datëlindjes, shoku Enver Hoxha
vazhdoi:*

Vendi ynë më parë ka qenë shumë i varfër dhe
dëmet e mëdha të luftës e varfëruan atë edhe më te-
për, por populli shqiptar ishte i fortë për të përballuar
vështirësitë.

Pasi u krijuar Partia, populli ynë rezistoi, luftoi
dhe fitoi. Pas Çlirimtit të vendit Partia u vuri gjoksin
punëve, ajo iu kushtua rindërtimit dhe ndërtimit so-
cialist të atdheut. Natyrisht, për të ecur përpara, na u
desh të bëjmë shumë përpjekje për një periudhë të
gjatë. Lloj-lloj armiqsh të brendshëm dhe imperialistët
e revizionistët, nga jashtë, u përpoqën të minonin luf-
tën e popullit dhe të Partisë sonë. Titistët dhe revi-
zionistët sovjetikë përdorën gjithfarë maskash e mje-

tesh për të penguar ecjen tonë përpara, por ne i përballua me aq sukses, sa ata nuk mundën të realizonin dot synimet e tyre armiqësore.

Kemi kaluar kohë të vështira këta dhjetë vjetët e fundit, por ne i kapërcyem pengesat. Tani në gjithë vendin tonë ka shpërthyer një hov i madh ndërtimtar. Shkenca, industria dhe bujqësia po përparojnë dhe, aq sa është e mundur, po ndjekim me vëmendje sukseset e zhvillimit njerëzor.

Eksperienca jonë na mëson se populli ka forca të mëdha, por Partia duhet të dijë t'i vërë ato në lëvizje në çdo kohë. Rruja e drejtë marksiste-leniniste përpërparimin shoqëror dhe për realizimin e ëndrrave të masave të gjera punonjëse jo vetëm krijon kënaqësi te këto të fundit, por njëkohësisht nxit edhe veprimet e tyre të guximshme. Ato duan ta shikojnë drejtësinë e vijës së Partisë në tërë gjerësinë e saj, duan, njëkohësisht, të shikojnë edhe pjekurinë e saj. Partia e ka për detyrë t'i paraprijë masat me punën e me shembullin e saj, se tek ajo ato shohin udhëheqjen e tyre të vërtetë, prandaj e duan dhe e mendojnë të zonjën, trimë e të matur.

Eksperienca e Partisë sonë tregon se në trajtimin e dëshirave dhe të interesave të popullit kurdoherë duhet ecur me kujdes, çdo veprim të peshohet drejt dhe asnjëherë të mos lejohet hedhja në aventurizëm, ndryshe rrezikohen besimi që kanë masat te Partia dhe lidhjet e saj me to. Populli është serioz në mendimet dhe në veprimet e tij, ne përpinqemi që udhëheqja të jetë pasqyrë e virtuteve të tij. Kjo është arsyaja që punët dhe veprimitaria e Komitetit Qendoror të Partisë

duhet të maten me kujdes, të mendohen mirë dhe pastaj të veprohet.

Duke iu referuar lajmeve të ndryshme për një shpërthim të fuqishëm bërthamor kinez, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në lajm vihej re diçka karakteristike, në të njëjtën kohë, brenda gjysmë ore, shpërthyen një bombë atomike mbi tokë dhe dy nën tokë, domethënë një e shpërtheu Kina, një Bashkimi Sovjetik dhe një Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sot shkenca ka bërë të mundur të zbulohet që më parë kur një shtet e ka gati për shpërthim bombën atomike dhe të hetohet menjëherë shpërthimi i saj. Kështu, për shembull, kur e shpërtheu Bashkimi Sovjetik në orën 7¹⁰, sizmografi e ndjeu dhe e shënoi këtë fakt, atëherë, pas disa minutash, të njëjtën gjë bën edhe Kina, por, kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës e marrin vesh këtë, për të mos mbetur pas, veprojnë edhe ato. Imperialistët dhe revizionistët janë luftënxitës, ndaj i bëjnë këto prova dhe krijojnë stoqe të raketave që kanë prodhuar e i perfekcionojnë.

Për sa i përket gjendjes në Jugosllavi, duket qartë, në çdo drejtim që ta marrësh, ajo është një shtet kapitalist i falimentuar. Titoja, për të dalë nga situata e vështirë ku ka rënë, ka kërkuar ndihmën e Niksonit, i cili shkoi në Jugosllavi, në radhë të parë, për të penguar falimentimin e plotë të vijës titiste dhe, së dyti, për t'ia ngritur ca Titos prestigjin e rënë. Punët e revizionistëve jugosllavë janë katandisur aq keq, sa Ribiçi u detyrua të pohojë që, po të mos i vihet fre ngritjes së çmimeve në Jugosllavi, regjimi titist do të

gjendet përpara pasigurive shoqërore e politike. Në këto kushte Shtetet e Bashkuara të Amerikës biseduan me Titon nëpërmjet Niksonit dhe, fill pas ikjes së tij, dhjetëra banka amerikane, belgjiane, gjermane etj., duke pasur në krye Maknamarën, janë vërsulur tanë në Jugosllavi. Maknamara, ky xhelat i popullit vietnamez, inspektoi gati të gjitha republikat jugosllave, si: Kroacinë, Serbinë, Slloveninë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe caktoi për to investime, nëpërmjet të cilave imperialistët amerikanë do t'ia hedhin akoma më shumë ganxhat Jugosllavisë. Së treti, Niksoni shkoi në Jugosllavi për t'i treguar Bashkimit Sovjetik, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa të mëdhenj në këtë vend.

Flitet se Titoja do të marrë shumë armë moderne nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si: aeroplanë «Fantom», tanke, nëndetëse dhe artileri të rëndë. Tani ajo po vjen rrotull nëpër Evropë dhe pikërisht në një kohë që punët s'po i shkojnë aspak mirë brenda në Jugosllavi, ka deklaruar me paturpësinë më të madhe se do të shëtitë në shumë vende evropiane dhe do t'u kushtohet tani më shumë punëve të këtij kontinenti.

Titoja, për të shmangur katastrofën që kërcënón Jugosllavinë dhe për të mëkëmbur emrin e tij, përpinqet ta heqë veten si «personalitet të shquar», «marksist-leninist» që «do lirinë e popujve», që «është kundër luftës në Vietnam», «për lirinë e popujve arabë» etj., etj., por dihet se të gjitha këto janë llafe. Prandaj, të kesh sadopak iluzione për titizmin, është e gabuar¹.

¹ Përmes këtyre analizave, shoku Enver Hoxha në më-

Ne do të shohim që edhe revizionistët sovjetikë do të afrohen me Titon, bile udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik, pavarësisht se kanë kontradikta me titistët, do të shkojnë edhe në Jugosllavi, që të krijojnë përshtypjen se nuk i kanë prishur punët me të. Ata manovrojnë në këtë mënyrë, në radhë të parë, pse akoma nuk e dëshirojnë një konflagracion me imperializmin amerikan, planet e tyre duan t'i realizojnë pa u ndeshur, e dyta, dëshirojnë të neutralizojnë ndikimin që ushtron shembulli i regjimit të Titos te satelitët e tyre, siç janë sidomos revizionistë rumunë. Titoja, nga ana e tij, do t'i pranojë këto manovrime, pse, siç dihet, ai kërkon të luajë në dy tabela, që të përfitojë sa më shumë si nga amerikanët, ashtu edhe nga sovjetikët. Kur ia do puna, ai hiqet kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, për t'u treguar popujve se gjoja është asnjanës.

Udhëheqësit rumunë, duke ndjekur rrugën e Titos, përshëndeten edhe ata me imperialistët amerikanë, kanë kontradikta me krerët sovjetikë dhe kopojnë vetadministrimin jugosllav; kapitalet e huaja kanë hyrë thellë në Rumani. Çaushesku, para se të shkojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka bërë një sërë bisedash me bankierë e me afaristë amerikanë, deri edhe me të dërguar të posaçëm të Niksonit. Më në fund, ai

nyrë indirekte demaskon edhe pikëpamjet e qëndrimet e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës që jo vetëm ushqente iluzione për revizionistët jugosllavë, por edhe i përkrahte, duke gjetur gjuhën e përbashkët me ta.

do të konkludojë patjetër në një takim me Niksonin¹. Çaushesku do të shkojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të marrë kredi për investime kapitale. Këto janë veprime krejt të njëlllojta si ato të Titos.

Revisionistët sovjetikë kanë frikë se ajo që po ndodh me Rumaninë mund të ngjasë nesër edhe me Hungarinë ku ndjenjat antisovjetike janë të vjetra, pse në atë vend ka ekzistuar fryma e Evropës Qendrore, por gjer sot revisionistë hungarezë s'kanë kundërshuar, sepse i mban të nënshtruar ushtria sovjetike që ndodhet prej kohësh në tokën e tyre.

Situata politike në Ballkan është mjaft e ndërlikuar. Ne shqiptarët kemi vuajtur shumë gjatë historisë prej intrigave të thurura në gadishullin tonë nga fuqitë e ndryshme imperialiste. Gjyshërit dhe babaillarët tanë kanë luftuar vazhdimisht për lirinë e atdheut kundër fuqive imperialiste e shoviniste që nga tërronin Ballkanin, prandaj çdo deklaratë, veprimtari e qëndrim të sovjetikëve, të Titos apo të Niksonit ne e ndjekim me vigjilencë të madhe. Revisionistët sovjetikë mbështeten në Jugosllavi te serbët, ku gjunjë përkrahjen e vjetër të pansllavizmit, kurse Niksoni e ka injoruar Serbinë, ai shkoi në Kroaci, të cilën e mburri në mënyrë flagrante dhe këtë e ka bërë, sigurisht, me qëllim që t'i vërë serbët e kroatët kundër njëri-tjetrit dhe revisionistët sovjetikë ta merrnin vesh se Dalmacinë, Kroacinë dhe gjithë bregdetin jugosllav të

1 Më 26-28 tetor 1970 Çaushesku ishte për vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku u takua edhe me Niksonin.

mos e prekin, mbasi ajo është zonë influence amerikane dhe e ruan Flota e 6-të. Titoja është vetë kroat. Siç shihet, pra, këtu del në pah kontradikta midis serbëve e sovjetikëve, nga njëra anë, dhe kroatëve e amerikanëve, nga ana tjetër.

Pra, siç e shikoni, në Ballkan bëhet një politikë e ngatërruar dhe e lëvizshme. Duhet mbështetur në analizën marksiste-leniniste për t'i parë dhe për t'i kuptuar këto gjëra në mënyrë të pagabueshme. Partia jonë mendon se taktika duhen përdorur në këto raste, por me kusht që të mos dëmtohet strategjia jonë.

Ne ndjekim me vigjilencë se çfarë bëjnë Flota e 6-të Amerikane dhe flota sovjetike në Mesdhe. Edhe më përpara në Jugosllavi vinin anije lufte dhe qëndronin në portet jugosllave, por në këto koniunktura, Titoja, për të mos rënë në sy vetëm prania e flotës amerikane në brigjet jugosllave, ka lejuar qëndrimin aty edhe të anijeve sovjetike. Ka pesë ditë që dy anije sovjetike po qëndrojnë në Split. Këto janë lodra me pasojë të rënda që bëjnë titistët. Natyrisht, nga këto lodra rrezikohet edhe bregdeti ynë, prandaj neve na bie detyra të vigjilojmë, se me këto veprime që bën Titoja, gjoja në emër tëasnjanësisë, Adriatiku kthehet në një rrugë kalimi për flotën amerikane dhe për atë sovjetike. Akte të tilla hyjnë në sferën e veprimtarisë së dekompozimit dhe të rikompozimit të forcave imperialiste. Ky është kursi që ndjek Titoja «për ristabilimin e situatës», kurse neve na duhet të luftojmë nga të dyja anët, edhe kundër imperialistëve, edhe kundër revizionistëve, pse të dyja palët synojnë të kombinojnë veprimet midis tyre, duke pasur si synim neutralizimin

dhe goditjen e forcave revolucionare. Ne nuk duhet të biem në këtë grackë, përkundrazi, të qëndrojmö në ballë të situatës për aktivizimin e mbrojtjen e forcave revolucionare.

Armiqtë tanë, nëpërmjet propagandës që bëjnë kundër nesh, flasin sikur gjoja Shqipëria e ka zbutur politikën e saj në marrëdhëni me armiqtë e jashtëm, megjithëse ne kemi dekluar që jo vetëm nuk e kemi zbutur politikën tonë, por do të vazhdojmë, si kurdoherë, t'i demaskojmë edhe në të ardhmen të gjithë armiqtë e paqes e të socializmit. Këtë e dinë mirë armiqtë, por me ato që thonë e shkruajnë, duan të krijojnë përshtypjen e rreme sikur forcat revolucionare të botës tani janë në qetësi.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**PARTIA MARKSISTE-LENINISTE, DUKE
U MBËSHTETUR TE MASAT, I SIGURON LIRINË
POPULLIT DHE PAVARËSINË ATDHEUT**

*Nga biseda me një delegacion të Republikës Popullore
të Kongos (Brazavil)*

17 tetor 1970

Ardhjen tuaj në Shqipëri ne e konsiderojmë si një ngjarje të rëndësishme dhe dëshirojmë që kjo të shërbejë për të forcuar më tej marrëdhëniet midis dy vendeve, tona e të njihemi akoma më mirë me njëri-tjetrin. Gjatë vizitave tona miqësore kemi mundësi të shkëmbejmë pikëpamjet për çdo problem që na intereson, si për çështje juridike, ashtu edhe për çështje ndërkombëtare, mbi lëvizjet sociale në vendet tona etj. Shkëmbimi i eksperiencës midis miqve ka rëndësi të madhe dhe ne, shqiptarët, e ndiejmë shumë të nevojshme këtë.

Në të kaluarën, ne, ashtu si edhe ju, kemi vuajtur shumë nga pushtuesit e ndryshëm dhe nga imperialistët, që janë përpjekur të na lënë në një shkallë zhvillimi sa më të ulët, me qëllim që të na shtypnin e të na shfrytëzonin më lehtë.

E gjithë historia e vendit tonë na ka mësuar se, për t'i sigruar popullit lirinë e plotë dhe pavarësinë e atdheut, duhet mbështetur te masat, pse tek ato është forca, tek ato revolucionarët gjejnë mendimin dhe gjykimin më të drejtë, tek ato është burimi i përparimit, i lirisë dhe i demokracisë së vërtetë. Prandaj ka shumë rëndësi të dish dhe ta kuptosh domosdoshmërinë, nevojën e madhe të lidhjeve me popullin.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për luftën dhe për përpjekjet që kemi bërë dhe duhet të bëjmë akoma për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut, sepse imperialistët e lakenjtë e tyre na kanë halë në sy. Për të sigruar fitoren e plotë e të përhershme, ne duhet të zhvillojmë beteja më të mëdha se gjer tani. Midis dy vendeve tonë ka disa çështje që na afrojnë, siç është lufta kundër shtypësve kapitalistë dhe imperialistë. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe.

Përpjekjet tona duhet të drejtohen në përkrahje të të gjithë atyre që, për shkaqe që dihen, kanë mbetur të varfër, pa kulturë dhe pa edukim politik. Është e domosdoshme që masat të edukohen për të arritur në një shkallë të atillë zhvillimi në vendin e vet, që të kuptojnë se të ardhurat e siguruara me punën dhe me djersën e tyre të ballit duhet t'u kthehen atyre dhe të mos shkojnë në xhepat e kapitalistëve. Duke u nisur nga kjo kërkësë, na bie detyrë të nxjerrim mësimë të rëndësishme dhe të bëjmë përgjithësime për të gjetur dhe, për të ndriçuar rrugët që do t'i çojnë popujt tanë drejt lumturisë.

Partia jonë quhet e Punës. Mund të quhej edhe Komuniste, siç quhej në kohën e Luftës sonë Nacio-

nalçlirimitare. Por, pas Çlirimtit, për popullin shqiptar u hap një perspektivë e madhe pune, jo vetëm në drejtim të ndërtimit të socializmit, por edhe për të krijuar njeriun e ri, që do ta realizonte këtë ndërtim. Prandaj ne, pas Çlirimtit të vendit, menduam ta quajmë Partinë tonë «Partia e Punës e Shqipërisë». Ky ndryshim ishte i lidhur, në radhë të parë, me përbërjen shoqërore të vendit, që pasqyrohej edhe në Parti. Këtë na e miratoi edhe populli, i cili gjer ca kohë përparrë formimit të Partisë nuk e kishte shumë të qartë ç'ishin revolucioni dhe komunizmi, kundër të cilëve qeveritë reaksionare të së kaluarës, që ne i përmbysem me revolucion, bënин një propagandë shpifëse. Por Partia, me punën e saj të palodhur e plot durim, ua bëri të qartë masave çfarë përfaqëson në të vërtetë komunizmi. Ato në vendin tonë shikonin çdo ditë e më mirë luftën dhe përpjekjet e komunistëve, të cilët nuk ishin përsaqësues ose bij të kapitalistëve, po bij të popullit, dhe luftonin, shkriheshin e derdhnin gjakun për interesat e tij.

Partia, menjëherë pas themelimit të saj, i bëri thirrje popullit të ngrihej në luftë kundër pushtuesve, por edhe për të marrë pushtetin në dorë, për të bërë më vonë reforma ekonomike, në radhë të parë, po dhe gjithfarë reformash të tjera shoqërore për përmbyssjen e superstrukturës feudo-borgjeze, për t'u hedhur në luftë për ndërtimin e së ardhmes sonë të ndritur, që u bë e qartë përparrë syve të të gjithëve vetëm pasi populli mori pushtetin në dorë, sepse vetëm e vetëm në këto kushte bëhet e mundshme të fillohet nga reformat. Ne morëm pushtetin në dorë akoma pa mba-

ruar Lufta e Dytë Botërore. Pas fitores filluam nga zbatimi i gjithë atyre reformave; në radhë të parë likuiduam koncesionet e huaja, hodhëm në dorë tregtinë e jashtme etj. Besoj se edhe ju mendoni për të gjetur rrugë të reja për likuidimin e të gjitha koncessioneve të huaja.

Ne iu përveshëm reformave, por, natyrisht, jo duke kopjuar. Socializmin filluam ta ndërtojmë sipas kushteve tona konkrete, hap pas hapi dhe të matur, duke u nisur gjithmonë nga kujdesi që, çdo gjë që bënim, populli ta kuptonte se ishte për të mirën e tij dhe të atdheut, pse vetëm kështu ai do të na ndiqte.

Kështu, pas Çlirimt, pas vendosjes së pushtetit popullor, nuk kërkuam menjëherë nga fshatarësia që të bënte kolektivizimin e bujqësisë. Ne nuk u nisëm nga ato që ishin realizuar gjer në atë kohë në Bashkimin Sovjetik, ku ishin ngritur kolkozet e sovkozet, pse ishim të bindur që populli nuk kishte asnje dijeni për to dhe nuk kishte si të na dëgjonte. Në fillim na u desh të bënim Reformën Agrare, sepse populli, gjatë gjithë jetës së tij, kishte luftuar për një copë tokë. Kushtet e vendit tonë ishin të tilla që ne kishim tokë pak, kurse njerëz më shumë. Edhe atë pak tokë e kishim rrëmbyer feudalët. Ne, pra, duhej medoemos t'ua jepnim tokën fshatarëve. Në këtë çështje patëm parasysht mësimet e marksizëm-leninizmit, i cili këshillon të mos flitet që në fillim me fshatarët për kolektivizimin, pse këta nuk kanë si e kuptojnë menjëherë atë. Më parë, mëson marksizëm-leninizmi, duhet t'i japësh tokën fshatarit, t'i japësh atë për të cilën ka luftuar, pastaj, duke përdorur metodën e bindjes, të shkohet

gradualisht më tej. Kështu vepruam edhe ne. Që në fillim, me anë të Reformës Agrare, i dhamë fshatarit tokën, që ua konfiskuam feudalëve, pasanikëve dhe gjithë atyre që kishin bashkëpunuar me pushtuesit. Për këtë tokë kishte ëndërruar fshatari shqiptar, kishte luftuar, kishte derdhur djersë dhe gjak. Gjithashtu, e ndihmuam që atë të mos e punonte me par mendë dru ri, si gjer atëherë, por me plugje që ia siguronte shteti. Dhe ai iu përvesh punës me zell për të prodhuar për vete dhe për pushtetin e vet. Më vonë, pas një pune të vazhdueshme edukuese me fshatarësinë nga Partia, u bë e mundur që fshatarët ta kuptionin vetë nevojën e ndërtimit socialist edhe në fshat, kolektivizimin e tokës dhe të mjeteve të tjera të prodhimit.

Për ndërtimin e socializmit ne u mbështetëm fort te të rinxjtë. Ata janë më të gjallë, më revolucionarë, kapin më mirë e më shpejt të renë dhe kuptojnë më drejt e më thellë marksizëm-leninizmin që i ndihmon të shikojnë më qartë të ardhmen e tyre.

Për sa i përket kuadrit, në fillim e kemi pasur shumë problem, se kishim shumë mungesa, por tashmë, këtë e kemi zgjidhur me kurajë e guxim me njerëzit tanë më të mirë, duke treguar për përgatitjen e tyre një kujdes të veçantë e duke i vënë ata në vendet kyç.

Ne ndërtuam edhe legjislacionin tonë, siç jua kanë shpjeguar më parë shokët tanë. Të gjitha ato që kemi realizuar lidhur me legjislacionin, jua dhamë në mënyrë vëllazërore t'i shikoni si kemi ecur. Nëpër rrugën që kemi kaluar, ndoshta kemi bërë edhe ndonjë gabim, po atë e kemi korrigjuar, duke iu përshtatur fazave të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë,

dhe përsëri do të vazhdojmë të bëjmë korrigjime, kur kushtet e reja të zhvillimit socialist të vendit do ta kërkojnë. Jeta na dikton që duhen bërë vazhdimisht korrigjime në çdo fushë dhe për të gjitha ato çështje që nuk i përshtaten më realitetit të kriuar. Në rast se atë që kemi bërë sot në fushën e legjislacionit, për shembull, do ta kishim bërë para 20 vjetëve, do të bënim marrëzi.

Kur shtrohet çështja për zgjidhjen e një problemi që na del përpara, ne e analizojmë atë me gjakftohësi të madhe dhe vendimin e marrim të nisur nga pikëpamja nëse ai problem është në favor të popullit apo jo. Kështu mendojmë e veprojmë edhe kur lind nevoja për nxjerrjen e ndonjë ligji, i cili duhet të përgjithësojë një situatë reale, t'i përgjigjet një momenti të dhënë. Ai nuk mund të ndryshohet sipas dëshirës apo mendimit të njërit e të tjeterit, ligji duhet të jetë mjeti me të cilin duhet të zgjidhen kontradiktat, me qëllim që këto të mos thellohen. Kur ekziston një regjim revolucionar, edhe ligji duhet të jetë revolucionar.

Ja, në këtë mënyrë ecim ne dhe asnjë pengesë apo vështirësi nuk e ka frenuar marshimin tonë përpara. Komunistët nuk dëshpërohen, nuk tremben. Vështirësi kemi pasur dhe kemi akoma, ato do të ekzistojnë për ne edhe në të ardhmen, por patjetër çdo gjë do të kapërcehet. Ju mund të thoni se në vendin tuaj keni akoma njerëz analfabetë. Ne nuk e njohim gjendjen e arsimit te ju, në ç'fazë ndodheni tani në këtë fushë dhe vështirësitë që ju dalin, po nga eksperiencia jonë mund t'ju themi se edhe ne kemi pasur vështirësi të mëdha në këtë drejtim. Çlirimi na gjeti me mbi

80 për qind të popullsisë analfabete. Në fillim e kishim jashtëzakonisht vështirë për ndërtesa shkolle, për arsimtarë; baza materiale e shkollave ka qenë shumë e dobët, por me vullnet të papërkulur iu përveshëm punës, duke u mbështetur në forcat tona. Në çdo fshat të Shqipërisë sot ka shkolla dhe jo vetëm me nga një arsimtar, siç ëndërronim dikur, por me nga 5-8 e më shumë arsimtarë. Tani kemi arritur të vendosim kudo arsimin 8-vjeçar të detyrueshëm dhe luftojmë që benda një perspektive të afërt të arrijmë të kemi të detyruar edhe arsimin e mesëm. Sot kemi ngritur, gjithashtu, universitetin tonë, ku po përgatitim me shumicë kuadro të lartë për plotësimin e nevojave të të gjithë sektorëve.

Partia na mësoi të bënim përpjekje për mobilizimin e të gjitha forcave për ta çuar vendin gjithnjë e më përpara. Në këtë rrugë na dolën vështirësi dhe pengesa të mëdha. Ne këtu patëm në fillim revizionistët jugosllavë dhe pas tyre ata sovjetikë, të cilët kanë punuar kundër vendit tonë. Tani revizionistët sovjetikë i keni edhe ju në Kongo, por, duke u nisur nga eksperiencia e hidhur e marrëdhënieve tona me ta, nuk mund të rrimë pa ju thënë shoqërisht: Kujdes! Ata janë aq të rrezikshëm sa edhe imperialistët e tjera. Këtë tua themi se i kemi vuajtur në kurrizin tonë poshtërsitë e tyre dhe për t'jua provuar këtë, mund t'ju japim shumë shembuj. Revizionistët sovjetikë janë kapitalistë të maskuar, të fshehur. Në fakt ata e kanë tradhtuar socializmin.

Revizionistët sovjetikë japid edhe «ndihma», por në dhënien e tyre ata nisen nga qëllime imperialiste,

kurse një vend socialist në dhënien e ndihmës niset nga parimet marksiste-leniniste, nga qëllime të drejta internacionliste. Ndryshimi është, pra, si nata me ditën. Megjithatë ndihma e miqve të vërtetë është kurdoherë ndihmë, ajo nuk është vendimtare për pavarësinë dhe për ndërtimin ekonomik të një vendi. Populli ynë ka një fjalë të urtë që thotë: «Nuk mbahet shtëpia me miell hua». Kjo do të thotë se, pavarësisht nga ndihma që i japid miqtë një vendi, nga prapambetja atë e nxjerrin vetëm njerëzit e tij, të zotët e vendit, me punën e me djersën e tyre. Këtë e vërteton edhe historia e Lufta Nacionalçirimitare e vendit tonë. Ushtria Sovjetike staliniane, gjatë Luftës së Dytë Botërore, bëri heroizma e sakrifica të mëdha, ajo dha prova të shkëlqyera internacionizmi, u dha goditjen vdekjeprurëse pushtuesve gjermanë. Por, në rast se nuk do të kishim luftuar vetë ne, në rast se nuk do të kishim pasur të fortë e të palëkundur Partinë tonë, nuk do të kishim arritur gjer në fitore, në çlirimin e plotë të atdheut.

Edhe në Greqi ka pasë ekzistuar një parti komuniste e fuqishme, që gjatë luftës kishte arritur pozita të shëndosha në vendin e vet. Por, për shkak të korrenteve të ndryshme që ekzistonin në gjirin e saj dhe të gabimeve të udhëheqjes, ajo i humbi pozitat e fituara. Mund të thonë disa se Greqia nuk fitoi ngaqë nuk shkeli këmba e ushtarit të kuq, po Ushtria e Kuqe e Stalinit nuk erdhi as në Shqipëri, megjithatë ne u çliruam, dhe u çliruam me forcat tona. Ndryshe, edhe vendin tonë do ta okuponin pushtues të rinj, siç bënë me Greqinë imperialistët e Perëndimit, anglezët e të tjera.

As ndihma e singertë që na jepte Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit nuk do të zinte vend, nuk do të jepte ato rezultate që kemi arritur, ne nuk do të ishim në këtë nivel zhvillimi që kemi sot, po të mos kishim punuar vetë. Me këtë dua të them se ndihma, e çdo lloji që të jetë, prapë mbetet ndihmë. Mbi të gjitha, pra, vendimtare, si për çdo vend, edhe për vendin tonë, nuk është ndihma e miqve, por puna e palodhur dhe lufta që bën populli i udhëhequr nga një parti revolucionare marksiste-leniniste për mbrojtjen e fitoreve dhe për ndërtimin e një jete më të lumtur.

Ne urojmë nga zemra që edhe populli mik kongolez, brenda një kohe sa më të shkurtër, ta bëjë vendin e vet të begatë, të flakë tej të gjitha mbeturinat obskurantiste dhe çdo ndikim të imperializmit, të nxjerrë në shesh të gjitha vlerat e mëdha të kulturës kombëtare, si dhe vlerat e kulturës së popujve të tjerë, gjë që ka rëndësi shumë të madhe.

Sipas njojurive mjaft të kufizuara që kam për historinë e vendit tuaj, di që kultura e popullit tuaj është e lashtë dhe e gjerë. Me sa di unë, bantu ka qenë një popull i madh, që zinte një territor shumë të gjerë dhe me një kulturë të lashtë. Me një frymë revolucionare të vërtetë, me një dashuri të thellë e me punë të palodhur për zhvillimin e kulturës, të gjitha vlerat e kulturës së lashtë të popullit tuaj do të ngrihen në një nivel më të lartë. Kolonialistët, edhe në rast se lanë në këmbë ndonjë nga veprat e kulturës së lashtë të popullit tuaj, këtë e kanë bërë vetëm për oportunitet

dhe në asnjë mënyrë për të nxjerrë në dukje vlerat e tij të mëdha e të lashta.

Sic përdor një gojëdhënë populli ynë, kur «Zoti» krijoi botën, i dha Shqipërisë, vendit tonë të vogël, më shumë male e gurë sesa fusha, por, kur populli me Partinë e Punës në krye mori pushtetin në dorë, gjeti në gjirin e tyre pasuri shumë të mëdha. Për t'i shfrytëzuar ato në dobi të popullit dhe të atdheut, një nga problemet më të rëndësishme, bile me një rëndësi të jashtëzakonshme, është ruajtja e forcimi i pushtetit populor dhe i unitetit të popullit rrëth Partisë. Pa krijuar këtë unitet, nuk mund të ruhet e të forcohet as pushteti, nuk mund të ndërtohet as e ardhmja e lumbtur. Uniteti mund të krijohet vetëm kur mbështetesh në mësimet e marksizëm-leninizmit, të kuptuar e të zbatuar më së miri, sipas kushteve të veçanta të vendit.

Duhet pasur kurdoherë parasysh që të kuptohen e të zbatohen drejt në çdo situatë të caktuar parimet e marksizëm-leninizmit nga ana e masave. Natyrisht, gjatë përpjekjeve për vënien në jetë të një parimi, mund të bëhen debate për t'i hapur rrugë zbatimit të tij të vërtetë ose me qëllime të tjera. Në rast se në momente të caktuara hasen pengesa për zbatimin e parimit, atëherë duhet të hapet prapë debati, me qëllim që parimi të zbatohet gjer në fund. Rëndësi të veçantë ka çështja që, përpara se të zbatohet parimi, të jenë të bindur vetë ata që do ta vënë në jetë, pastaj, si të merret vendimi, të zbatohet me përpikëri të madhe. Në këtë drejtim partia kërkon, ashtu sikurse në çdo drejtim tjetër, një disiplinë të hekurt. Militanti i partisë duhet të jetë i tillë që në çdo situatë t'i udhëheqë drejt e qartë ma-

sat. Është e domosdoshme që ai të jetë në pararojë të çdo detyre, të zbatojë me përpikëri çdo vendim që merret. Po të veprohet ndryshe, kjo të çon në shkata-tërrimin e partisë dhe në këtë rast ngjet si me revisionistët, që i kanë shpënë partitë e tyre në degjenerim.

Te ne tani kudo, në fabrika, uzina, institucione e qendra të tjera pune është duke u diskutuar plani i ri pesëvjeçar i ardhshëm. Ky do të jetë plan pesëvjeçar i madh, pse do të ndërtohen objekte të reja mjaft të rëndësishme, si: fabrika, uzina, kombinate etj. Lidhur me planin kemi parashikuar të ngrihen një sërë vepresh përfunksionimin e të cilave lëndën e parë e kemi në vend, si: bakrin, kromin, hekur-nikelin, naftën. Tani jemi duke bërë kërkime përfundburime të reja, sidomos përfnaftë.

Si kurdoherë, edhe gjatë këtij pesëvjeçari, vëmentje të posaçmë do t'i kushtojmë edukimit ideologjik të masave.

Ne shpresojmë se kjo nuk do të jetë vizita e fundit që ju bëni në vendin tonë. Ju sigurojmë se edhe njerëzit tanë do të vijnë në vendin tuaj.

Partia i porositi që në fillim shokët tanë që delegacionit kongolez t'i jepen të gjitha lehtësítë dhe sqarimet e nevojshme.

MIKU KONGOLEZ: Ju falënderojmë shumë për pritjen Tuaj kaq të ngrohtë, përsqarimet që na bëtë, për inkurajimin e madh që na dhatë. Nga vizita që bëmë në vendin tuaj, po largohemi me përshtypje jashtë-zakonisht të mëdha. Ne kemi mbetur të mahnitur nga realizimet që ka arritur Shqipëria gjatë këtyre 25 vje-

tëve që është çliruar. Dua t'Ju siguroj se Republika Popullore e Shqipërisë çmohet shumë në Republikën Popullore të Kongos. Nuk më mbetet t'Ju them tjetër tani veçse atë që të dy vendet tonë, si sot edhe në të ardhmen, do të ecin krah për krah njëri-tjetrit.

SHOKU ENVER HOXHA: Dëshiroj t'ju shpreh edhe unë dashurinë e popullit tonë për popullin kongolez dhe t'ju siguroj se vendi dhe populli ynë gjithmonë do ta përkrahin atë në luftën e në përpjekjet e tij të drejta.

Ju faleminderit për ardhjen dhe për fjalët e mira që thatë për Shqipërinë. Udhë të mbarë e mirupafshim!

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Ku-
ndër revizionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 644*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 644*

REALIZIMI I PLANIT ARRIHET ME NJË ORGANIZIM TË PËRSOSUR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

19 tetor 1970

Natyrisht, që tani, për hartimin e planit të pestë pesëvjeçar (1971-1975) na dalin probleme të mëdha për të cilat duhet të jemi të ndërgjegjshëm, në radhë të parë, ne, e pastaj të bëjmë të ndërgjegjshme gjithë Partinë dhe masat. Të mos harrojmë se, pavarësisht nga ndihma që do të na jepet nga ana e Republikës Popullore të Kinës, është e domosdoshme të shtohen sidomos investimet tona të brendshme, të cilat përbëjnë themelin e krejt planit. Në këtë plan t'i jepet përparësi përfundimit të të gjitha atyre veprave që do të mbeten pa mbaruar nga plani aktual.

Me planin e pestë pesëvjeçar ekonomia jonë do të

1 Në këtë mbledhje u diskutua për përfundimin e bisedimeve të delegacionit ekonomik qeveritar të RPSH me qeverinë e RP të Kinës dhe u reflektua për realizimin e planit, si kurdoherë, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona.

fuqizohet e do të ecë më përpara, forcat prodhuese do të shtohen më shumë në të gjitha drejtimet, me ndikime të rëndësishme edhe për pesëvjeçarin e gjashtë. Për këto duhet të jemi entuziastë, por edhe shumë realistë e të mobilizuar totalisht, se në pesëvjeçarin e ardhshëm do të ndërtohen edhe vepra, që do të vihen në shfrytëzim gjatë pesëvjeçarit të gjashtë.

Për hartimin e pesëvjeçarit të ri, si kurdoherë, të kemi mirë parasysh që nivelin e jetesës së popullit jo vetëm ta ruajmë, por, bile, ta ngremë edhe pak më lart. Prandaj, gjatë kësaj pune, të mos nisemi vetëm nga synimi për të ndërtuar të gjitha veprat që na duhen, se kjo është vetëm njëra anë e çështjes. Krahas kësaj, të mendojmë edhe për nivelin e jetesës së popullit. Investimet që do të bëjmë të jenë të matura mirë, si i thonë fjalës, ato të mos na thyejnë në mes me një normë akumulimi të rënduar. Të mos harrojmë, gjithashstu, se në përfundim të planit të ardhshëm pesëvjeçar do të jenë mbushur 30 vjet që nga Çlirimi i Shqipërisë. Edhe në pesëvjeçarin e gjashtë e më vonë, investimet tona për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës do të jenë në rritje, mëépo kjo nuk do të thotë që për këtë arsyen të dalim me pikëpamjen e qëndrimit në vend apo të uljes së nivelit të jetesës së popullit.

Me këto, shokë, nuk dua të them që në të ardhmen të mos vazhdojmë të bëjmë sakrifica, por të mos jemi as entuziastë pa bazë dhe jashtë realitetit. Çdo sukses e realizim të objektivave të pesëvjeçarit të ri ne do ta arrijmë vetëm me një organizim më të përsosur, me një punë politike më të mirë e me një entuziazëm më

të madh, por realist. Në qoftë se punën politike do të vazhdojmë ta ngremë në një shkallë më të lartë e do ta shoqërojmë atë me një punë organizative sa më të përsosur, jam i bindur se boshllëqet që janë krijuar e rezervat që na duhen do t'i plotësojmë nga burimet e brendshme që kemi. Prandaj çështja e hartimit të planit nuk ka të bëjë vetëm me vendosjen e shifrave, por më duket se, tok me shifrat, është e domosdoshme të studiojmë e të analizojmë edhe punën tonë. Për ta bërrë këtë kemi akoma edhe një vit të tërë përpara. Gjatë kësaj kohe ne mund të shohim ku janë sukseset dhe të metat në organizim, në disiplinë, në kursime, në shfrytëzimin e materialeve e të rezervave të brendshme, në dhënien e më shumë kompetencave bazës etj. Për të hartuar një plan mobilizues e më të madh nga ai që është aktualisht, del nevoja të punohet me një metodë dhe stil revolucionar, të ndryshëm nga ata që kemi pasur gjer më sot. Në rast se nuk marrim të gjitha masat për të luftuar të metat që na kanë penguar, ne nuk do të mund t'i realizojmë dot detyrat shumë të mëdha që nxjerr ekonomia jonë në zhvillim të pareshtur e të gjithanshëm.

Nuk dihet çfarë të rejash do të na sjellin më vonë ndërtimet në shkallë kaq të gjerë që do të bëhen në pesëvjeçarin e ardhshëm. Prandaj, në rast se nuk e nxitim dhe nuk e shfrytëzojmë iniciativën krijuese të njerëzve, nuk mund t'i zgjidhim me sukses problemet që do të na dalin. Nga ana tjetër të kemi kujdes që këtë iniciativë të masave ta inkadrojmë në baza realiste e të mos nxitim fantazira të kota. Çështja është që njerëzit, para se të marrin një iniciativë, të dinë

gjer ku mund të arrijë caku i realizimit praktik të saj. Ata, duke qenë realistë dhe brenda mundësive që do të krijojnë vetë, kur është fjala për interesin e përgjithshëm e rritjen e prodhimit, të veprojnë me guxim dhe jo të pyesin orë e çast ministritë përkatëse e të kërkojnë ndihmën e Qeverisë për çdo gjë. Vetëm kështu mendimi krijues i masave dhe energjitë e pashtershme të tyre do të shpërthejnë për të plotësuar me sukses; në kohë dhe me cilësi, detyrat e ngarkuara bille edhe për t'i tejkaluar ato. Këtë çështje ta kuptojmë mirë, pse, në qoftë se vazhdohet që për çdo iniciativë të kërkohet pëlqimi i dikasterit, punët kurrë nuk mund të ecin si duhet. Po u veprua kështu, iniciativat revolucionare të masave patjetër që do të pengohen.

Ministritë duhet të drejtojnë me shkathtësi dhe me kujdes iniciativat e mëdha të masave e t'u hapin atyre perspektiva. Në këtë drejtim, më duket mua, na mbetet shumë për të bërë. Në qoftë se nuk i përkrahim iniciativat e masave, në rast se ecim në mënyrë dogmatike, duke i rënë shkopit, do të frenohemi shumë. Marksizëm-leninizmi nuk na lejon që kontradiktat e brendshme të zhvillimit tonë t'i mbulojmë. Këto kontradikta, kur njihen në kohë e zgjidhen drejt, e ndihmojnë Partinë që, bashkë me masat e popullit dhe në udhëheqje të tyre, të reflektojë dhe të lusfojë për t'i zgjidhur çështjet sa më mirë.

Ne tani kemi edhe eksperiencën e punës së madhe që është bërë gjer më sot. Natyrisht, vetëjeta na ka imponuar shpeshherë që caqet e planit të kapërcehen. Për këtë qëllim janë dhënë edhe ndihma nga ana e shtetit dhe kjo ka qenë e drejtë. Ekonomia jonë nuk

është dëmtuar aspak për ndihmat e dhëna në përkrahje të iniciativave që kanë sjellë rritjen e prodhimit tej parashikimeve të planit, përkundrazi kemi pasur përfitime. Pra, duke e parë çështjen në këtë prizëm dhe duke qenë të bindur se nuk i kemi shfrytëzuar në shkallën e nevojshme gjithë këto iniciativa, më duket se kjo punë, këtej e tutje, duhet të bëhet problem në një shkallë akoma më të madhe i gjithë masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

Unë mendoj, gjithashtu, se është e domosdoshme të bëjmë përpjekje më të mëdha për rritjen e rezervave. Ato që kemi duhet t'i ruajmë me kujdes për kohë të vështira. Por, në rast se e gjykojmë me vend që për interes të zhvillimit të ekonomisë të përdorim nga rezervat që kemi, edhe këtë mund ta bëjmë, por njëkohësisht të tregojmë shumë kujdes që ato t'i zë-vendësojmë brenda një kohe sa më të shkurtër e t'i rritim më tej. Gjithashtu, të nxitim kudo punonjësit që të krijojnë edhe vetë rezerva të reja. Kur punëtorët, për shembull, krijojnë mundësi që nga mbeturinat të prodhohet një artikull i ri, kjo iniciativë e tyre përsë të mos përkrahet? Ne duhet të mbajmë qëndrim të drejtë e të rreptë edhe kur ndonjë inxhinier, që drejton punën diku, në një ndërmarrje, siç tha shoku Manush, frenon iniciativën e punëtorëve ose merr përsipër si zbulim të tij frytin e mendimit të tyre. E them këtë se, po të shkojmë gjithmonë me pikëpamjet e disa inxhinierëve nëpër ndërmarrje ose në ministri dhe të mos u vihet veshi mirë iniciativave të masave, nuk mund të realizohet gjithë kjo punë e madhe që kemi për të bërë.

Tani le të fillojmë sa më parë nga puna për hartin min e plotë të planit të ri pesëvjeçar. Gjatë këtij procesi të shikojmë me kujdes objektivat e shifrat dhe t'i vëmë ata sa më realë e mobilizues. Natyrisht, këta, në mënyrë të veçantë, lypin studime më të gjera c më të hollësishme, po më duket se studimet e hollësishme nuk duhen bërë vetëm në procesin e hartimit të planit. Ministritë duhet t'u futen në thelb çështjeve të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës dhe t'i zbërthejnë ato edhe gjatë zbatimit të planeve. Natyrisht, Komisioni i Planit të Shtetit dhe Qeveria duhet të jenë në krye të të gjitha punëve e studimeve që do të bëhen, po veç duhet pasur kujdes që të mos krijohet mendimi se studimet do t'i bëjnë më parë Qeveria apo Komisioni i Planit të Shtetit e pastaj ministritë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT TANË JANË NJËHERËSH NXENËS E MËSUES TË MASAVE PUNONJËSE

*Përshëndetje e Komitetit Qendror të PPSH
drejtuar shkrimtarëve dhe artistëve¹*

22 tetor 1970

SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË!

Të dashur shokë e shoqe,

Komiteti Qendror i Partisë ju dërgon përshëndetjet më të zjarra dhe urimet më të përzemërtat përfestën tuaj jubilare, 25-vjetorin e themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

Ky jubile është një ngjarje me rëndësi të madhe përfjetën e vendit e të popullit tonë. Në këtë ditë të shënuar, së bashku me ju shkrimtarët dhe artistët tanë të talentuar, që keni bërë e bëni një punë kaq të lavdishme e fisnike përf edukimin komunist të punojësve, përf nderin dhe përf lavdinë e atdheut, gëzohen

1 Kjo përshëndetje u dërgua me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

të gjithë, që nga kalamani e deri te më plaku, gëzohen punëtorët, kooperativistët, intelektualët, ushtarakët, gëzohen mbarë populli dhe Partia.

Një çerek shekulli më parë, me kujdesin e Partisë, u themelua Lidhja juaj. Në ato vite të vështira populli ynë artdashës, që vuante nga plagët e luftës e që akoma s'kishte bukë për të ngrënë, ëndërronte, mendonte e shqetësohej seriozisht edhe për fatet e zhvillimit të artit, pse artin ai tërë jetën e ka pasur dhe e ka në zemër. Me shëllirë e ka ngjyer kafshatën në të kaluarën populli ynë; por pjatën e drunjtë e kishte të skalitur si s'ka më bukur. Ndjenja e hollë për të bukurën dhe shija e tij e lartë estetike kanë spikatur kudo, në rapsoditë e mrekullueshme, në kostumet fantastike, në vallet e mahnitshme, në shkrimet e rilindësve apo në këngët «rebele» e të ndritshme partizane. Shkurt, gjenia artistike e popullit tonë duket ngado që të hedhësh vështrimin, ngado që të vësh dorën.

Artin populli ynë e ka konsideruar dhe e konsideron pjesë të pandarë të jetës së tij, prandaj ai e përshëndeti me entuziazëm lindjen e organizatës suaj. Dhe shpresat e tij, si kudo, nuk shkuan kot. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve u bë ashtu siç tha Partia, ashtu siç dëshironte populli, një organizatë luftarakë, militante. Shkrimtarët dhe artistët, të udhëhequr vazhdimisht nga mësimet dhe nga porositë e Partisë, e lidhën ngushtë krijimtarinë e tyre me jetën e masave punonjëse, me përpjekjet dhc luftën e tyre heroike për ndërtimin dhe për mbrojtjen e atdheut socialist.

Gjatë këtyre 25 vjetëve, e veçanërisht pas Kongresit të 5-të të PPSH, arti ynë i realizmit socialist ka

pësuar e po pëson ndryshime të papara sasiore dhe cilësore. Në luftë të pamëshirshme me çdo lloj ndikimi të huaj të ideologjisë borgjeze e revizioniste, si dhe patriarchale e konservatore, letërsia, teatri, muzika, kinematografia, piktura, skulptura dhe të gjitha gjinitë e tjera, të fryshtuara nga ideologjia dritëdhënëse e Partisë, nga heroizmi i pashembullt revolucionar i klasës punëtore dhe i mbarë masave punonjëse, si dhe të ushqyera vazhdimisht nga gurra e pashtershme e krijimtarisë popullore, ndikojnë drejtpërdrejt në edukimin e njeriut të ri me idealet e mëdha të socializmit e të komunizmit, me tiparet e moralit komunist, me shije të shëndosha dhe revolucionare.

Në pjesën më të madhe të krijimtarisë sonë letraro-artistike, që karakterizohet nga niveli i lartë ideor e artistik, njeriu ynë i ri gjen vetveten, sheh vitalitetin e popullit dhe të atdheut tonë socialist, dëgjon fjalën e dashur e të zjarrtë të Partisë dhe mbushet me kurajë e guxim për t'i ngritur kurdoherë e më lart shkallët e jetës. Kjo ngjet, sepse arti ynë revolucionar fryshtimet i merr nga populli dhe ia kthen ato prapë atij, të përgjithësuara e në format më të bucura artistike, sepse shkrimitarët dhe artistët tanë kanë përvetësuar këshillat e Partisë për të qenë njëherësh nxënës e mësues të masave punonjëse.

Partia ndjek me vëmendje e interes të madh krijimtarinë fryshtuese të letrarëve, muzikantëve, aktorëve, skulptorëve e të artistëve të tjerë. Ajo përshëndet punën e këmbënguljen tuaj vetëmohuese për t'i revolucionarizuar më tej letërsinë e artet, për të futur në to atë që ka eshtë më e çmuershme — mendimin

dhe emocionin popullor, botëkuptimin e klasës punëtore, zjarrin shqiptar. Sot arti ynë është bërë më i madhërishëm si për nga përsosmëria e bukuria ideoartistike, ashtu edhe për nga forca e madhe edukative. Kjo dëshmon se ai ecën në rrugë të mbarë, në rrugën e lavdishme që i ka caktuar Partia.

Të gjitha këto garantojnë se arti ynë, që ndodhet në duart e sigurta të shkrimtarëve, artistëve, kritikëve dhe studiuesve tanë të partishëm, edhe në të ardhmen do të dijë t'i përbushë me sukses detyrat e rëndësishme që do t'i caktojë Partia.

Tanimë që letërsia dhe artet tona kanë arritur kaq shumë suksese, sa zëri e fjala u dëgjohet me admirim të madh si brenda, ashtu edhe jashtë atdheut, tani pikërisht rritet edhe më tepër përgjegjësia e tyre ndaj çështjes së socializmit e komunizmit. Në këto kushte detyrat revolucionare që shtron Partia para krijimtarisë letraro-artistike janë të mëdha, ndoshta shumë më të mëdha se ç'mund të pandehen. Realizimi i tyre kërkon që socializmi dhe mendimi proletar marksist-leninist të ndihen dhe të përshkojnë fund e krye çdo libër, çdo pikturë, çdo varg, çdo notë muzikore, çdo kënd e qelizë të veprës artistike. Partia ka besim të thellë se shkrimtarët dhe artistët tanë, si kurdoherë, do ta kryejnë me nder këtë detyrë.

Po për këtë është e nevojshme që, krahas punës këmbëngulëse për edukimin e gjithanshëm e të thellë marksist-leninist të shkrimtarëve dhe të artistëve, të rriten pa ndërprerje kërkesat për ngritjen e nivelistideor të veprave artistike dhe për përsosjen e mëtejshme të mjeshtërisë artistike. Vitaliteti i jetës sonë

socialiste, shpirti sulumes e transformues i masave punonjëse dhe madhështia e ideve të Partisë sonë nuk mund të pasqyrohen e të trupëzohen ashtu siç janë në të vërtetë veçse në një art me nivel shumë të lartë ideoartistik. Që të arrihet kjo, artisti ynë novator lypset të kërkojë, gjithmonë të kërkojë, duke u nisur nga pozitat e ideologjisë sonë, duke u mbështetur fort në truallin tonë kombëtar, në traditat dhe në përvojën tonë artistike më të avancuar, si dhe në eksperiencën përparimtare botërore. Të kërkosh do të thotë të përpinqesh të zbulosh fenomenet thelbësore të realitetit tonë, të zbulosh ato elemente të reja të jetës sonë që përbëjnë filizat e së nesërmes. Kjo e re, pra, që kërkohet të hyjë në art, duhet jo vetëm të njihet mirë, por edhe të shndërrohet në fenomen artistik. Në këtë mënyrë letërsia dhe artet do të ecin me hapin e masave punonjëse dhe përherë e më tepër do të bëhen një mjet i fuqishëm ideologjik për edukimin e tyre.

Bartëse e ideve revolucionare, farkëtuese e filizave të rinj të komunizmit, është, në radhë të parë, klasa jonë punëtore. Ajo është rinia e përjetshme e artist revolucionar të realizmit socialist. Duke qenë kështu, figura, vepra dhe botëkuptimi i klasës punëtore në krijimtari duhet të bëhen akoma më zotërues. Kjo do bërë jo vetëm sepse klasa punëtore, si klasa më revolucionare e kohës sonë, e meriton plotësisht këtë, por edhe përfaktin se sot revisionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, sidomos që bëjnë be e rrufe se «krijojnë» në emër të klasës punëtore, në të vërtetë po bëjnë çmos që figurën e saj ta dëbojnë përfundimisht nga letërsia dhe nga arti.

Me zhvillimin e vrullshëm të revolucionit socialist te ne shtohen kërkesat dhe etja e masave punonjëse për krijime letraro-artistike të përsosura. Detyra juaj është që t'i njihni mirë këto kërkesa të masave punonjëse dhe t'u përgjigjeni atyre me vepra të fryshtuarat e një niveli të lartë ideoartistik. Prandaj Partia ju bën thirrje edhe një herë që të shkoni në masa e të jettoni vazhdimisht pranë tyre. Duke shkuar vazhdimisht në masa ju, nga njëra anë, do të mësoni prej tyre, do të dëgjoni me vëmendje vërejtjet e kritikat e tyre dhe në të njëjtën kohë do të propagandoni veprat artistike, do të ndihmoni më nga afër në edukimin ideoestetik të masave, do të shton i dashurinë e tyre për artin.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se ju, si kurdoherë, do t'i realizoni me nder detyrat që ju shtron Partia dhe do t'i jepni popullit gjithnjë e më shumë vepra artistike që të mishërojnë idealet revolucionare të Partisë, tiparet e mrekullueshme revolucionare të popullit tonë, hovin e tij të pandalshëm në rrugën e revolucionit e të socializmit.

Lavdi artit tonë revolucionar të realizmit socialist!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Në emër të Komitetit Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 253 (6917), 23 tetor 1970*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Mbi letërsinë
dhe artin», f. 313. Tiranë, 1977*

UDHËHEQJA E MINISTRISË SË MBROJTJES TË ANALIZOJË MIRË GJENDJEN E KRIJUAR NË DIKASTER

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 tetor 1970

Duke dëgjuar përgjigjet e pyetjeve rreth raportit të paraqitur, që shokët e Byrosë Politike u bënë përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrotjtjes të pranishëm në këtë mbledhje, shoku Enver Hoxha ndërhyri duke thënë:

Flas në emër të shokëve të Byrosë Politike, që pyesin, dhe në emrin tim, se përgjigjet për këto çështje i duam konkretisht, jo me fraza të përgjithshme. Pra, kapuni në problemet dhe na i shpjegoni gjérat konkretisht, se frazat e përgjithshme nuk i dheksim. Ju, kur të diskutoni, mos u përqendroni vetëm në këto, se në ushtri ka dhe të tjera gjëra që nuk janë thë-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën ideopolitike dhe për forcimin e jetës së brendshme të Partisë në ushtri.

në në materialin që kemi marrë dhe që ju duhet të na i thoni këtu.

Pasi diskutuan drejtuesit kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shokët e Byrosë Politike, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Jam edhe unë plotësisht dakord me vërejtjet që u bënë këtu, por nuk jam aspak me mendimin që u tha se gjithë këto që ndodhin në ushtri kanë të bëjnë me vështirësitë e rritjes.

Ushtria jonë gati 30-vjeçare është një masë e kallitur, një ushtri që ka bërë vazhdimisht përparime të mëdha. Kur themi kështu, këtë nuk e bëjmë pér të gënjer veten, po se kështu është realiteti. Ushtria jonë, s'ka asnje dyshim, ka bërë përparime veçanërisht nga ana ideopolitike, se kësaj ane i është vënë një kujdes i madh që nga fillimi, kujdes ky që reflektohet në gjithë punën e saj, por ushtria jonë ka bërë përparime, gjithashiu, edhe nga ana tekniko-ushtarake. Fakt është që në ushtri ka mjaft kuadro që janë shembull në punë. Tani atje ka me qindra, bile, mund të themi edhe me mijëra djem, që nuk duhet t'i konsiderojmë aspak të rinj. Të rinj kanë qenë shumica nga ne që kemi drejtuar Luftën Nacionalçirimitare, batalionet, brigadat, divizionet dhe korparmatat. Në atë kohë pjesa më e madhe e kuadrove politikë dhe ushtarakë nuk ishin me moshë më shumë se 22 gjer në 25 vjeç. Aq më tepër tani që kemi shokë të pjekur dhe me përgatitje të mirë, këta jo vetëm janë në gjendje të drejtojnë batalione e brigada, por janë plotësisht të aftë të vijnë deri në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, ku ka nevojë pér ta. Nuk dua të them me këtë se kuadrot që

punojnë aktualisht në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë dhe në drejtoritë e ndryshme të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore nuk janë të përgatitur, por është e domosdoshme që, si kudo, edhe atje, të futet gjak i ri, të ndërrohet ajo frysë familjariteti që ekziston, të pushojë ai rënkim dhe të zhduket megalomania që shfaqen te disa, të cilët mendojnë sikur janë perënditë e luftës¹, sikur pa ata atje nuk bëhet dot asgjë etj. Politikën e drejtë të qarkullimit të kuadrove, që po zbaton Partia në të gjithë sektorët e jetës së vendit, duhet ta praktikojë medoemos edhe ushtria.

Pastaj, në asnjë mënyrë të mos dëgjojmë më pikëpamjen, sipas së cilës komisari në repart do të kryejë vetëm detyra politike dhe edukative dhe nuk do të merret edhe me çështje ushtarake, pse gjoja nuk ditka ta bëjë punën e komandantit. Unë jam i bindur se me atë përgatitje që kanë sot, kuadrot politikë të ushtrisë sonë janë fare mirë në gjendje edhe të komandojnë njësinë ushtarake ku bëjnë pjesë. Kështu, po të qëllojë në luftë që të vritet komandanti i repartit, përnjëherësh dhe pa frikë komandën mund ta marrë komisari. Me këtë dua të them se ushtria jonë ka arritur tashmë në atë shkallë që kuadrot jo vetëm e kanë kuptuar rëndësinë e madhe të edukimit, në dy aspektet që lidhen ngushtë me njëri-tjetrin, qoftë ky tekniko-ushtarak, ashtu edhe teoriko-politik, por janë në gjendje të udhëheqin konkretisht në të dy drejtimet.

Petriti [Dume], duke diskutuar, u ndodh, më duket

1 Kështu e konsideronin veten armiqtë puçistë dhe disa vartës të tyre.

mua, në një gjendje shpirtërore që s'kam si ta shpjetgoj, por mendoj se mund ta gjejmë rastin që ai të na e shpjegojë vetë këtë, pse e kuption rëndësinë e një gjëje të tillë. Gjatë diskutimit, sipas mendimit tim, ai e humbi masën e kontrollit në lidhje me sukseset e gabimet që vërtetohen në përgatitjen e ushtrisë, duke kaluar në ekstrem, saqë na çuditi të tërë. Kjo tregon se ekziston një situatë e vështirë në gjendjen shpirtërore të Petritit. Gjykimet e tij për gjendjen në ushtrinë tonë pasqyrojnë se ai diçka ka. Ato që tha ai i dëgjuan të gjithë shokët, prandaj shqetësimi i të gjithëve është i drejtë e plotësish i justifikueshëm për atë që ndodh e që tregon se diçka nuk po shkon mirë në kokë të Shtatmadhorisë. Këtë situatë në asnje mënyrë nuk mund ta lejojmë, përkundrazi është e domosdoshme të marrim masa që të sqarohet sa më parë. Prandaj, me të dalë nga kjo mbledhje e Byrosë Politike, mblidhuni menjëherë, jo vetëm ju tre shokët kryesorë, por të gjithë sa jeni në ministri, hidhni tej fodullëqet, amurproprin dhe çdo gjë tjetër të dëmshme dhe, si komunistë, analizoni me seriozitet shkakat, nxirrni qartë përsë është kriuar kjo gjendje. Mbasi ta spastroni nga ndërgjegjja juaj dhe nga marrëdhëni mes jush këtë situatë jo të shëndoshë, duke u bazuar në kritikat që me të drejtë ju bënë shokët e Byrosë Politike për punën, të dilni me konkluzione të drejta në lidhje me gjendjen që ekziston në ushtri.

Le të shohim tani cila është gjendja jonë ushtarakë. Në përgjithësi të gjithë jemi dakord që në ushtrinë tonë ka shumë anë pozitive dhe kjo është kryesorja që e karakterizon atë. Por atje ka edhe të meta, disa

nga të cilat janë me të vërtetë shqetësuese. Unë nuk e dija si do të fliste Petriti, por në kopjen e materialit që na është dërguar kam shënuar disa vërejtje. Raporti¹ që na ka paraqitur Hitoja², është material i përgjithshëm, prandaj jam plotësisht dakord edhe me kritikat që i bënë këtu shokët këtij raporti. Këto tre-gojnë se më thellë duhej t'ju futeshit çështjeve ju, shokët e Drejtorisë Politike.

Këto vërejtje të miat mendoj t'i parashtroj këtu shkurt, mbasi më duket se gjithë shokët me radhë i trajtuan shumë mirë e shumë drejt çështjet, duke filluar që nga lufta kundër shfaqjeve të formalizmit e të liberalizmit në përgatitjen ushtarake etj., të cilat janë fort të dëmshme për ushtrinë. Ju duhet të gjeni rrënjet e këtyre shfaqjeve, të nxirrni nëse kuadrot tanë janë vallë pa zotësi, pa shkollë, pa njohuri ushtarake, pa ndërgjegje politike apo ka shkaqe të tjera. Përse në disa ekziston njëfarë formalizmi e liberalizmi, një moskuptim si duhet i detyrave në dhënen e mësimit? Ky është një problem me rëndësi të madhe politike, në të cilin Partia në ushtri duhet të thellohet, të nxjerrë përse ngjet një gjë e tillë me këta kuadro. Shkaku nuk qëndron në atë që mund të mendohet se disa nga kuadrot ushtarakë tani janë plakur apo u dhembin kockat. Jo. Por edhe në qoftë se dikush, për

1 Raporti «Mbi punën ideopolitike dhe forcimin e jetës së brendshme të Partisë në ushtri» ishte përgatitur nga Drejtoria Politike.

2 Hito Çako, në atë kohë drejtor i Drejtorisë Politike, pjesëtar i grupit puçist komplotist në ushtri, i dënuar për veprimitari armiqësore dhe antiparti.

shkak të moshës, është i pafuqishëm, dhe këtë ne duhet ta kuptojmë, atëherë të marrim masa që në vend të tij të vijë një tjetër, të vijë një nga ajo kategori kuadrosh që edhe nga pikëpamja fizike ka mundësi të japë, domethënë një i ri. Përse të mbahen në vende drejtuese kuadro që s'janë të aftë fizikisht? Në qoftë se edhe pasi bëhen të gjitha përpjekjet, shihet se disa, duke qenë në rënie nga ana shëndetësore, janë në pamundësi të japidh, atëherë të zëvendësohen me ata që janë të fortë dhe të mos thuhet vetëm që «përgatitja e kuadrove në ushtri nuk bëhet mirë», që «nuk shfrytëzohet si duhet koha për përgatitjen e kuadrove» etj. S'ka dyshim se duhen bërë më shumë përpjekje për një punë politike më të mirë, se në ushtri është e domosdoshme të zbatohen ligjet, rregulloret, urdhrat, disiplina etj. Për të gjitha këto folën shokët, prandaj nuk kam për t'u zgjatur, as për të përsëritur shembujt që u thanë, se nga jeta ju mund të sillni shembuj shumë më tepër nga sa u thanë këtu.

Dëshiroj të flas pak edhe për besimin që duhet pasur në zbatimin e urdhraleve. Duhet kuptuar mirë që urdhrat është e domosdoshme të zbatohen, po, para së gjithash, është mirë të kuptohet brendia politike e tyre, se, po u kuptua kjo si duhet, atëherë do të bëhen përpjekje që ata të zbatohen dhe gjatë punës të kontrollohet zbatimi i tyre, pse nga kjo varen shumë gjëra. Besimi qorrasi është i papranueshëm për ushtrinë tonë, të cilën e edukon Partia. Një besim i verbër është i përshtatshëm vetëm për një ushtri borgjeze, ku ushtari ose inferiori e zbaton urdhrin si automat, në mënyrë jo të ndërgjegjshme.

Për sa u përket raporteve dhe në përgjithësi punës, për të cilat u fol edhe këtu, kam mendimin se në ushtri ka kuadro që bëjnë shumë teorizime, flasin vetëm si duhet punuar, bile edhe ju vetë po na shpjegoni këtu si duhet punuar me këto materiale etj. Nuk është aspak e nevojshme të na thoni neve këtu ato që ua mësoni të tjerëve. E theksoj këtë se kjo është bërë si njëfarë manie apo sëmundjeje, në vend që të na thoni shkaqet përse nuk është bërë ajo që duhet, përse nuk shpjegohet mësimi sipas kërkesave e nevojave dhe të tregoni rrugët si duhet bërë, ç'situata konkrete janë krijuar me këto dobësi të theksuara nga një punë e tillë etj. E vërteta është që ka dobësi të theksuara në këto drejtime, por të gjitha këto ju nuk na i thoni. Nga një mënyrë e tillë të raportuari me fjalë të përgjithshme e plot frazeologji, duhet të ruhem, shokë. Kjo është më shumë karakteristikë e atyre drejtuesve dhe e urdhërdhënësve që vetëm transmetojnë urdhra nga lart-poshtë në të gjitha shkallët e piramidës udhëheqëse në ushtri. Përgjegjës të tillë, që nga kreua e deri në bazë, japid më shumë urdhra, bëjnë formulime frazash dhe kujtojnë se kjo është e gjithë puna e tyre, por a zbatohet urdhri, a kontrollohen dhe a ndihmohen vartësit për zbatimin e urdhrale që jepen njëri pas tjetrit nga lart-poshtë gjer në bazë, me këtë anë të punës ata nuk merren.

Po të merren vendimet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë, do të shihet se shumë probleme që janë shqyrtuar ta zëmë vjet, janë trajtuar edhe para 10 vjetësh, domethënë, janë po ato, po disa i kanë harruar, prandaj u duket sikur thuhen për herë

të parë, kurse në realitet për to është folur edhe më parë gati si sot. Megjithatë nuk mund të themi se mendja e njerëzve s'ka punuar, po në praktikë shohim se zbatimi i vendimeve dhe kontrolli i zbatimit të tyre nuk bëhen në lartësinë e duhur, prandaj detyrohemë shpesh t'i përsëritim çështjet. Kjo vjen pse drejtuesit në ushtri vetëm japid urdhra dhe nuk merren me atë që është kryesorja, me zbatimin e tyre në jetë.

Shoku Rita [Marko] imë thoshte një ditë se kur kishte shkuar në një ndërmarrje, pati konstatuar se të tërë i jepnin urdhra zinxhir njëri-tjetrit nga lart-po-shtë, po, amia, punë nuk bëhej sa duhej. Një e metë e tillë bën të mos realizohen plotësisht detyrat, të mos zbulohen shkaqet që sjellin lindjen e ngjarjeve të jashtëzakonshme, të mos merren masa me kohë me qëllim që atyre t'u pritet rruga. Është bërë zakon që, vetëm kur ndodhin të tilla ngjarje, atëherë fillojnë frazat, filozofohet, bëhet mëral etj. Një metodë e tillë pune mund të gjë dhe, në fakt, e çon organizatën e Partisë në një punë rütinë, mëndojt unë, që degjeron në muhabete pa fryt, në thashetheme, në çarjen e unitetit të mendimit dhe të veprimit të komunistëve. Kjo do të thotë se atje ku ekziston një gjendje e tillë midis mendimit dhe veprimit, s'mund të ketë unitet, koordinim, atje s'vepron ligji i parimit të shëndoshë të lidhjes së punës me teorinë, teoria qëndron në hava, çdo gjë degjeron në grindje personale dhe në ndarjen e njerëzve në grupe. Një gjendje e tillë ju ka ngjarë edhe juvë në ushtri.

Më kanë treguar se për dy vjet të tërë në Drejtorenë e Mekanikës të Ministrisë së Mbrojtjes Popu-

llore mes komunistëve ka pasur përçarje e grupazh, bëheshin llogje e bisedime të ngushta, thureshin intriga etj., ndërsa organizata-bazë e Partisë e kësaj drejtorie bënte muhabete, nuk merrte masa, nuk kontrollonte gjendjen e nuk vepronë. Mirëpo një mungesë veprimi revolucionar në raste të tilla sjell gradualisht situata të rënda, prandaj një metodë pune e tillë duhet braktisur menjëherë.

Ne duhet të na preokupojë seriozisht edhe çështja e gjithë atyre letrave që na drejtohen nga ushtarakët dhe ato nuk janë pak. Në këto letra ka qarje për probleme të interesit personal dhe aspak për çështje të interesit të përgjithshëm të ushtrisë. Ku qëndrojnë shkaqet që shkruhen të tilla letra? Dihet se disa nga ushtarakët shkelin rregulloret, shkelin disiplinën etj. Atëherë, përse nuk na shkruajnë në këto letra për këto shkelje, që bëhen deri edhe nga disa komandantë, por na drejtohen vetëm se duan një shtëpi, duan këtë, apo duan atë, pra, për kërkesa thjesht të sferës personale? Një gjendje e tillë duhet të na shqetësojë seriozisht. Kjo tregon se puna politike për të luftuar kundër tendencës për t'u marrë me çështje të vogla personale, me të cilat këta njerëz preokupojnë disa kuadro me rëndësi të shtetit e të Partisë sonë, është e pamjaf-tueshme. Prandaj kjo çështje dhe studimi i një morie problemesh të tjera është e domosdoshme të shihen me kujdes nga komitetet e Partisë në ushtri dhe në terren.

Unë nuk e them dot ekzakt si e shtroi këtu Petriti çështjen e komiteteve të Partisë në ushtri që të them nëse ai është ose jo kundër tyre. Megjithatë, në diskut-

timin e tij, çështja e komiteteve të Partisë u paraqit në një mënyrë jo fort të qartë. Edhe unë nxjerr nga kjo konkluzionin që bënë shokët e tjerë, si Hysniu, Rita, që marrja në studim e një morie problemesh nga ana e komiteteve të Partisë në reparte ushtarake, mund të ketë shkaktuar, në ndonjë rast, që t'u merren disa kompetenca komandave e shtabeve të tyre, gjë që i ka paralizuar këta e i ka hedhur në pasivitet. Një gjë e tillë nuk është aspak e drejtë, më duket mua. Si është e mundur dhe përse bëhet kjo nga ana e ndonjë komiteti partie?

Partia në ushtri as që e shtron çështjen për ç'arsye komendantët dhe shtabet lidhin duart dhe nuk po i kryejnë detyrat, kompetencat dhe funksionet që u ka dhënë Partia. Komendantët kanë kompetencat e të drejtat e tyre në repart, të cilat ua ka dhënë Partia, prandaj ata duhet t'i ushtrojnë plotësisht ato kompetenca, të veprojnë, kurse organizata e Partisë duhet të kërkojë që ato të gjejnë zbatim të plotë. Bukur bëhet pyetja: «Organizata e Partisë ç'bën?», por duhet thënë edhe ç'bën komandanti ose shefi i shtabit atje, pse edhe këta mund të janë anëtarë partie. Por edhe sikur të mos janë anëtarë partie ata janë komendantë apo oficerë të ngarkuar me detyra të rëndësishme ushtarake në shërbim të Partisë, janë kuadro partie, prandaj e kanë për detyrë të ndërhyjnë që të marrin masat përkatëse për çdo gjë që nuk shkon mirë në repart.

Unë mendoj se në ushtri nuk është kuptuar dhe nuk po zbatohet drejt orientimi lidhur me udhëheqjen e Partisë në ushtri, prandaj është e domosdoshme që kjo çështje të vihet drejt medoemos dhe sa më parë në

praktikë, sidomos të kuptohet mirë ky parim, pse parimi s'bën dallim, kurse kuptimi dhe zbatimi i tij bëhen të cekët. Këtu duhet të ngulim këmbë ne, dhe Partia në ushtri të mos sjellë pengesa, përkundrazi ajo e ka për detyrë të bëjë që secili të ushtrojë si duhet kompetencat që i janë dhënë.

Praktika na mëson se, që të ecë përpara dhe si duhet ushtria, ajo ka nevojë jo vetëm për kuadro të mësuar, por që këta të jenë edhe të rinj nga mosha. Por, siç po na raportohet, kuadrot e vjetër të ushtrisë nuk tregojnë kujdesin e duhur ndaj të rinjve, s'mungojnë të jenë fodullë përpara tyre dhe disa herë veprojnë si egoistë dhe pengues për ta. Kjo, shokë, jo vetëm nuk është e mirë, por nuk është aspak në vijën e Partisë. Ata që mendojnë dhe veprojnë kaq gabim ndaj kuadrove të rinj, që sillen jo drejt me ta, duhet të spastrohen sa më parë nga pikëpamje e qëndrime të tillë të palejueshme, të bëjnë kthesë menjëherë. Partia nuk mund të lejojë që të komprometohet e ardhmja e ushtrisë për pikëpamjet e padrejta, për egoizmat dhe meskinitetet e disave, qofshin këta edhe nga ata që kanë bërë luftën. Është e drejtë dhe në vijën e Partisë të veprohet kështu si veprojnë disa, shokë? Një praktikë të tillë duhet ta heqim qafe sa më parë, pse nuk mund të lejojmë që të komprometohet e të plaket ushtria.

Është e domosdoshme të kuptohet një herë e mirë se meritat e kuadrove, të vjetër apo të rinj qofshin, vlerësohen vetëm kur ato vihen në shërbim të interesit të përgjithshëm, përkundrazi këto merita errësohen, në rast se degjenerojnë në egoizma dhe për këtë ata vetë

bëhen shkaktarë që eklipsojnë meritat e tyre dhe jo Partia.

Tani diçka për vigjilencën. Çështjen e vigjilencës e kuptojmë të tërë q'rëndësi të madhe ka dhe sa shumë duhet t'ua shpjegojmë të gjithëve e, në mënyrë të veçantë, atyre që kanë të bëjnë me ushtrinë, me çështjet e sigurimit e të mbrojtjes së popullit e të atdheut. Prandaj atë ta shpjegojmë mirë, të bëjmë që ta kuptojnë të gjithë si duhet dhe ta zbatojnë me rreptësi në praktikë.

Në ushtri nuk mund të ketë vigjilencë politike në lartësinë e duhur pa pasur disiplinë dhe rregull të çeliktë. Prandaj të jemi shumë ekzigjentë në këtë çështje. Është tjetër punë se Petritit i shkau koka e zigjit, po disiplina në ushtri duhet të jetë e rreptë dhe jo llafe. Në ushtri në çdo rast dhe kurdoherë duhet të vendoset rregull e disiplinë e çeliktë në jetë, në stërvitje dhe në çdo punë, pse kuptohet që atje ku ka liberalizëm, diletantizëm, menefregizëm, s'mund të ketë vigjilencë, përkundrazi do të ketë patjetër fushë të lirë për të vepruar e për të punuar armiku. Ne nuk mund ta lejojmë në asnje mënyrë një gjë të tillë. Nënveftësimi i armikut dhe mbivlerësimi i vërvetes e dobëson rëndë vigjilencën në ushtri, ajo dëmton rëndë edhe disiplinën. Prandaj këto çështje t'i kuptojmë mirë, shokë.

Mungesa e rregullit, gjithashtu, dobëson stërvitjen. Edhe kjo duhet parë me kujdes të madh. Për q'arsye disa kuadro e bëjnë stërvitjen me një frymë liberalizmi e nënveftësimi? Kjo mund të vijë edhe për shkak të mendjemadhësisë te disa, ose për shkak të dembellëkut

te disa të tjerë. Por mburravecët, megalomanët e dembelët janë nga njerëzit më të dëmshëm, si kudo, po sidomos në ushtri.

Çdo gjë që i përket ushtrisë, që i përket mbrojtjes së atdheut, është e domosdoshme të konsiderohet nga të gjithë sekret ushtarët në shkallën, në madhësinë dhe në gjerësinë e çdo përcaktimi qoftë. Le të marrim një gjë që mund të duket sikur është publike, para syve të të gjithëve, tunelet, që ndërton vetë populli për t'u mbrojtur. Edhe këto, shokë, kanë karakter sekret. Vetëm naivët e syleshët mund të thonë: «Si mund të jenë sekret këto objekte gjersa ato i sheh dita-ditës, i di i gjithë populli, bile mund t'i dijë edhe një armik i kamufluar që ka punuar gjatë ndërtimit të tyre?». Mund të ndodhë që aty të ketë punuar edhe një element armik, por, po të mos i themi kurkujt që s'ka të bëjë me këtë punë se sa veta merr ky tunel, cila pjesë e banorëve të mëhallës do të vijë të strehohet këtu, sa minuta duhen për të ardhur nga shtëpitë gjér në tunel etj., elementi armik nuk do të jetë dot në gjendje t'ia japë të ngrohta llogaritë armikut të jashtëm, i cili në kohë lufte nuk do të mundë pastaj të dërgojë aeroplanin për të mitraluar popullin rrugës para se ky të futet brenda tunelit, se më vonë le të mitralojë sa të dojë ai, s'ka ç'u bën njerëzve atje. Deri edhe këtu ka rëndësi sekreti.

Unë mora një shembull që është shumë evident, po le të marrim tanë një shembull tjeter që përbën një sekret jashtëzakonisht të madh, por që komanda e xhenios, organizata-bazë dhe komiteti përkatës i Partisë nuk e konsideruan sekret, humbjen për një kohë

të hartës së punimeve të një objekti ushtarak, ngjarje që as Beqiri, as Petriti, as Hitoja nuk na e përmendën fare, shokë, në diskutimet e tyre. Mirëpo, në fakt, për dhjetëra ditë me radhë ky dokument pati humbur. Gjatë gjithë kësaj kohe as komanda përkatëse, as Drejtoria Politike, as Shtatmadhoria, as organet e sigurimit të ushtrisë nuk dinin gjë. Kështu kaluan disa ditë, gjersa u mblohdhën si «kofini pas të vjelave» komunistët e organizatës-bazë të Partisë dhe e merrni me mend përsë? Për të vendosur nëse qenqësh ky një dokument sekret apo jo! Kjo mbledhje nuk u bë posaçërisht për gjetjen e dokumentit, çështja u diskutua si diçka e zakonshme mes të tjerash dhe mbledhja vendosi që ai s'ishte dokument sekret!! Edhe komiteti i Partisë e deri dikasteri, që u informuan për këtë çështje pas rrëth 40 ditësh, kur e morën këtë problem në shqyrtim, filluan të diskutojnë si dhe ata poshtë, nëse ishte apo s'ishte ky një dokument sekret dhe mes shumë çështjesh të tjera.

Çfarë vigjilence i thonë kësaj, ju lutem, shokë? Si keni lejuar ju gjëra të tilla në ushtri? Ne duhet të jemi të rreptë në këto çështje kudo, po veçanërisht në ushtri. Si duhej vepruar në këtë rast? Të tërë me radhë duhej të kalonin në kontroll. Po të ishte vepruar kështu, të shikoje si do të gjendej menjëherë dokumenti e njëkohësisht armiku që e kishte fshehur. Na lejohet neve që në një rast të tillë kaq flagrant dhe të rëndë, shokë, të rrimë të presim sa të bëhet mbledhja për të diskutuar qenka a s'qenka sekret? Ku jemi këtu, çfarë disipline është kjo? Si lejon Partia të qëndrohet pa luftuar rreptë fenomene të tillë? Një disiplinë e një

diletantizëm i tillë me llafe, sipas të cilave pritet gjersata diskutojmë në Parti një çështje të kësaj natyre, s'lejohet, përkundrazi duhet marrë menjëherë nga zverku ai njeri që bën nga këto gjëra dhe të futet në burg, pastaj të shihet çështja e tij në Parti. Kurse disa, duke u kapur pas disa formave, thonë: «Dale, se mos na revoltohen komunistët». Po si mund të mendohet kështu për një rast të tillë? Ashtu duhet të ndodhë, komunistët duhet të shqetësohen dhe shumë bile. Gjersa aty kemi një sinjal se përpara nesh është duke vepruar një armik, është e domosdoshme që komanda dhe organizata e Partisë të marrin menjëherë masa kontrolli. Nuk duhet lejuar të na ecin kështu këto punë, përkundrazi, të vendoset një regjim i fortë discipline e kontrolli kudo e për çdo gjë në ushtri.

Çështja e ushtrisë dhe e mbrojtjes është nga më të rëndësishmet e Partisë dhe të popullit, prandaj në çdo kohë të gjithë, dhe në mënyrë të veçantë ushtarakët që janë ngarkuar posaçërisht me këtë detyrë kaq të madhe, është e domosdoshme të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm. Të jetë e qartë për të gjithë se, ashtu si është me rëndësi çdo detyrë që i ka ngarkuar Partia gjithsecilit, detyrat ushtarake janë të një rëndësie kolosale, prandaj në ushtri nuk lejohen lëshime, shthurje, diletantizëm dhe mungesa në përgatitjen politiko-ushtarake, pse këto janë shumë të rrezikshme. Në qoftë se Petriti ekzagjeroi në diskutimin e tij, pikërisht për atë ne po i heqim atij veshin, prandaj herë tjetër ai të jetë realist dhe i matur. Në rastin konkret nuk u tregua aspak realist, ai u tërroq shumë nga disa anë subjektive. Ne e dimë që në ushtri ka edhe bosh-

Ilëqe të mëdha në përgatitjen politiko-ushtarake dhe në këtë drejtim duhet punuar akoma më shumë, por veç nuk është si thotë ai, që mohon çdo gjë, sikur nuk qenka bërë asnje përgatitje e tillë, se nuk është kështu.

Ushtria jonë është një shkollë e madhe, ku mëson, stërvitet, kalitet e bëhet i gatshëm për të mbrojtur atdheun, në çdo moment e kundër çdo rreziku, i gjithë populli. Ajo është një shkollë për mbajtjen e së cilës bëhen shpenzime shumë të mëdha, por që janë të domosdoshme. Kjo nuk është si të gjitha shkollat, pse ka të bëjë me çështjet më të shenjta, siç janë pavarësia e atdheut, liria e gjaku i popullit dhe jeta e re socialistë, mbi të cilat s'ka gjëra të tjera më të rëndësishme e jetike. Ndodh që mund të mos realizohet, fjala vjen, 5 apo 10 për qind prodhimi në një fabrikë, po me çështjet e mbrojtjes nuk mund të luhet. Prandaj Partia nuk mund të lejojë që koha e shpenzuar për përgatitje ushtarake dhe fondet e caktuara për këtë qëllim të venë kot, të shkohet pa u përgatitur për të përballuar çdo rast rreziku për atdheun. Prandaj përgatitja e ushtrisë të merret me shumë seriozitet, të bëhet me pre-cizion matematik, të jetë shkencore e metodike, si nga ana tekniqe, ashtu edhe nga ana politiko-ideologjike e saj dhe jo diletantiste. Në qoftë se ne gjatë përgatitjes së ushtrisë lejojmë boshllëqe, kur armiqtë tanë janë dhe vazhdojnë të ecin përpara në zhvillimin e teknikës ushtarake, ne duhet të bëjmë alarm, të marrim masa për të zbuluar sa më parë dhe për të njojur mirë shkaqet që kanë sjellë boshllëqet, të zbulojmë e të njohim, gjithashtu, edhe anët subjektive që nuk kanë lejuar të parashikohen dhe të merren me kohë masat e

nevojshme. Në përgatitjen tonë ushtarake të kemi kurdoherë parasysh forcat e armikut që do të përballojmë, të cilat as duhet t'i mbivlerësojmë, por as edhe t'i nën-vleftësojmë, siç mund të bëjnë disa, nga mendjema-dhësia e të cilëve është e domosdoshme të kemi shumë kujdes.

Teoritë janë të bukura dhe unë s'jam kundër teorive të drejta e precise, veçanërisht kundër llogaritjeve ushtarake, por këto të bazohen mbi tokë, mbi realitetin tonë konkret, t'i përgjigjen njëkohësisht edhe realitetit e gjendjes përgatitore të kundërshtarit. Prandaj në mënyrë të ndërgjegjshme kuadrot tanë ushtarakë duhet të jenë të azhurnuar mirë, sidomos në dy drejtime, në drejtim të brendshëm dhe në drejtim të jashtëm dhe të bëjnë të gjitha korrektimet përkatëse që kërkon dialektika e zhvillimit të teorisë, ndryshe, duke qëndruar në vend, duke menduar jo drejt, siç mund të bëjnë disa që kujtojnë se paskan gjetur fundin e teorisë, është gabim i rëndë. Ne duhet t'ua themi këtë të gjithë atyre që merren me diskutime akademike etj., që të ndjekin zhvillimin dialektik të çështjeve. Shokët e ushtrisë shpeshherë ta matin mirë punën e tyre, si nga ana e vëllimit, siç thanë edhe shokët që diskutuan këtu, ashtu edhe nga ana e vështirësive, e kushteve globale dhe të veçanta të krijuara për ushtrinë, sidomos nga ana e vështirësive të terrenit dhe e zgjidhjes komplekse të problemeve të shumta e të këklavitura. Një gjë e tillë do t'ju bëjë ju, ushtarakët, më realistë ndaj detyrave që keni si qytetarë të republikës, do t'ju ndihmojë për të qenë edhe më modestë e më shumë

ekzigjentë ndaj vetes dhe shumë më tepër këmbëngulës në punë si anëtarë partie.

Në rast se marrim, për shembull, shqetësimin e drejtë përfaktin që në ushtri ka sot edhe disa me shfaqje të huaja, natyrisht ne duhet t'i vihem i punës përfakti korrigjuar këta, kudo që janë, përfakti bërë njërejt të mirë. Në ushtri problemi përfakt edukimin e njërejtve është më i lehtë, prandaj ky duhet të zgjidhet më shpejt e rrënjosht, pse atje kemi një mori kuadrosh me stazh të gjatë, që kanë kryer shkolla, që janë me kulturë, kanë fituar specialitete ushtarake dhe, mbi të gjitha, janë njërejt besnikë të Partisë. I gjithë ky kuadër është ngarkuar të përgatitë ushtarakisht një material njërežor, që është parapërgatitur më parë nga Partia, nga shkolla, nga gjithë shoqëria jonë. Kështu, duke bërë bilancin e vështirësive që mund të hasen në sektorin civil, në krahasim me ushtrinë, del se këtu kushtet dhe mundësitë janë më të favorshme përfakt, prandaj kërkohet që kuadrot ushtarake dhe gjithë ushtria në bllok, të janë në lartësinë e detyrave që u kanë ngarkuar Partia të kryejnë. Kjo ju vë detyrën që të reflektoni thellë, shokë, në të gjitha këto të meta, të jeni shumë objektivë, punën në ushtri të mos e nxini, pse në fakt nuk është e zezë, përkundrazi, atje janë bërë përparime, gjendja është e shëndoshë, vetëm është e domosdoshme t'i spastrojmë shpejt e rrënjosht të gjitha të metat që u përmendën, pse, sikundër kemi ecur përpara gjer tanë në ushtrinë tonë, do të ecim edhe në të ardhmen.

Pasi ta analizoni këtë situatë në punë ju shokë të

ushtrisë, mendoj dhe propozoj të bëjmë një mbledhje¹ tjetër të Byrosë Politike, ku shokët e Ministrisë së Mbrojtjes, Beqiri, Petriti dhe Hitoja, të na raportojnë për rezultatet e kësaj analize dhe, mbi këtë bazë, të bëjmë këtu një diskutim tjetër për t'u dhënë një ndihmë edhe më të madhe këtyre shokëve. Të gjithë kemi bindjen se Beqiri, Petriti dhe Hitoja e kuptojnë drejt se këto që po shtrojmë në Byronë Politike janë çështje shumë të rëndësishme partie, zgjidhja e drejtë e të cilave është për të mirën e ushtrisë, për të mirën e Partisë, për të mirën e atdheut dhe për të mirën tuaj, shokë të ushtrisë. Është një shqetësim i ligjshëm për ne gjendja që është kriuar në udhëheqje të dikasterit të Mbrojtjes. Sigurisht, këtë situatë ju duhet ta ndieni më shumë në veten tuaj, se jeni kuadro të lartë. Dy nga ju jeni anëtar e kandidat të Byrosë Politike dhe i treti është anëtar i Komitetit Qendror, po edhe nga të tjerët që kemi ftuar sot në këtë mbledhje nga disa reparte të ushtrisë, njëri është kandidat i Komitetit Qendror, kurse dy janë sekretarë komitetesh partie në repartet përkatëse, që i kuptojnë, gjithashtu, shumë drejt situatat e krijuara dhe shqetësimet e shokëve të udhëheqjes.

Nuk do të thotë aspak se, duke i ngritur shokët këto çështje këtu, kanë bërë ndonjë gabim të madh, po, si duket, ata janë gjendur në situata ndoshta të

1 Kjo mbledhje u bë në datën 8 dhjetor 1970. Në të shoku Enver Hoxha ngarkoi me përgjegjësi dhe kritikoi rrëptë Beqir Ballukun, Petrit Dumen e Hito Çakon për të metat në punën e ushtrisë dhe veçanërisht për gjendjen e sëmurë të krijuar në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore.

vështira për t'i ngritur më parë me njëri-tjetrin. Tani rrugën e daljes ata le ta gjejnë vetë, ne u dhamë ndihmë. Kjo rrugë u hap, të tre këta shokë vetë janë më të lirë për t'i hyrë e për ta analizuar drejt e në rrugë partie këtë situatë që është krijuar.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KODI I RI PENAL TË PASQYROJË SI DUHET ETAPËN E RE TË SHOQËRISË SONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 tetor 1970

Para se të shfaqim ndonjë mendim për projekt-kodin penal që na paraqitet për shqyrtim, e quaj të nevojshme të na sqarohen më mirë disa çështje si: Në ç'baza është studuar e hartuar ky projektkod, ku janë mbështetur shokët e komisionit në studimet e tyre dhe si kanë ardhur në konkluzionet që na paraqitin sot? Nuk e di se ç'do të thonë shokët e Byrosë Politike për këtë projekt që na është paraqitur, por mendoj se është me vend të na jepen disa shpjegime për këto çështje. Këto shpjegime mund të jepen në diskutimet që do të bëhen.

Dihet se çdo kod është një tërësi ligjesh që përbën një sistem të plotë legjislacioni në fushën e së

¹ Një ndër pikat e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje të Byrosë Politike ishte shqyrtimi i projektit të Kodit të ri Penal.

drejtës për një etapë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë. Kodi Penal, siç dihet, rregullon marrëdhëniet e njerëzve në fushën penale në këtë etapë të zhvillimit tonë. Ai mbron rendin juridik socialist nga veprat shoqërisht të rrezikshme që drejtohen kundër shoqërisë. Qëllimi i legjislacionit penal është edukimi i njerëzve me frymën e respektimit të ligjshmërisë socialiste në-përmjet zbatimit të dënimive kundër asaj kategorie njerëzish që kryejnë vepra shoqërisht të rrezikshme. Këta elementë, pasi kryejnë dënimin, futen përsëri në shoqëri si njerëz të rehabilituar.

Kodi që po përgatitim aktualisht, pas 25 vjetësh, pasqyron në kushte të reja, etapën e re shoqërore të vendit tonë. Kjo do të thotë se ne shtyhemi të bëjmë një Kod të ri Penal, pse aktualisht janë krijuar rrethana, të cilat na detyrojnë të krijojmë norma ligjore të reja, që t'i përgjigjen më mirë situatës së tanishme. Përkësht këtë situatë jo në mënyrë globale, por në mënyrë të hollësishme dhe shkencore, duhet ta keni mirë parasysh ju, shokët e komisionit, që jeni ngarkuar me hartimin e projektkodit.

Dëshiroj të vë në dukje se në material ju nuk na i jepni të arsyetuara analizat që na nevojiten. Ju duhet të na i klasifikoni grupimet e llojeve më të ndryshme të dënimive që janë dhënë në Republikën Popullore të Shqipërisë në bazë të Kodit Penal në fuqi, si ka qenë dinamika e këtyre lloje dënimesh që nga fillimi dhe deri tash, duke nisur që nga dënimini më i vogël, gjer te dënimini kapital. Është e nevojshme të na paraqitni, gjithashtu, llojet e dënimive që janë zbatuar më shumë dhe për cilat kategori krimesh janë dhënë

ato, si dhe për cilat lloje krimesh janë dhënë dënimë më të larta; të na informoni pastaj nëse krimet me rrezikshmëri më të theksuar shoqërore kanë ardhur duke u ulur apo jo dhe në rast se po, në ç'masë kanë ardhur duke zbritur. Shkalla e uljes ose jo e kimeve është mirë të pasqyrohet që nga krimet më të thjeshta e deri tek ato më të rrezikshmet.

Ju duhet të studioni nëse njerëzit e dënuar i kanë vuajtur plotësisht apo pjesërisht dënimet. Në rast se dënimet janë vuajtur pjesërisht, kjo do të thotë se efekti i edukimit shoqëror ka filluar të ndikojë pozitivisht në të dënuarit me heqje të lirisë.

Dënimini kapital, siç është ai me vdekje, duhet diskutuar mirë, se ky është më i rrepti dhe ka rëndësi të madhe për shoqërinë tonë. Prandaj duhet parë me kujdes kur dhe për çfarë krimesh duhet parashikuar në Kodin e ri Penal ky lloj dënimini. Kjo na vë përpara detyrës të shikojmë se për cilat kime e parashikon këtë lloj dënimini ligji në fuqi dhe në sa raste e kanë dhënë gjykatat tona dënimin me vdekje. Këto të dhëna na duhen për të nxjerrë përfundimin se sa duhet zbatuar tani, në kushtet aktuale të shoqërisë sonë, dënimini me vdekje. Mendoj se ky lloj dënimini duhet parashikuar dhe duhet zbatuar për kriminelët që kryejnë vepra, që paraqesin me të vërtetë një rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

Si këto që ngrita ka dhe një sërë çështjesh të tjera që mendoj të na sqarohen, pasi ju t'i keni diskutuar e përcaktuar vetë më parë. Kur jepni mendime në relacion për të mos e parashikuar më si krim një vepër, për të ulur ose për të ngritur masën e dënimit

për disa kime etj., ju nuk na thoni shkallën e përhapjes së atij krimi dhe masat e llojet e dënameve që janë zbatuar nga praktika gjyqësore gjatë dy, tre, pesë ose shtatë vjetëve. Ju vetë, ndoshta i keni pasur parasysh këto të dhëna dhe përfundimet që keni arritur mund të janë të drejta, por neve nuk na i keni relatuar.

Udhëheqja ka nevojë ta ketë një analizë të tillë të përgjithshme, se Kodi Penal ka të bëjë me një vijë politiko-morale dhe ideologjike, të cilën duhet ta kenë të qartë të tërë, me qëllim që, kur Kodi i ri Penal të aprovohet dhe të hyjë në fuqi, të marrim masa përtë orientuar gjithë Partinë dhe popullin për një politikë penale sa më të drejtë. Shokët e udhëheqjes së Partisë janë të zgjedhur edhe në funksione shtetërore, ku kanë të bëjnë vazhdimit edhe me zbatimin e Kodit Penal. Ka nga ne që janë anëtarë të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe u takon shpesh të shqyrtojnë kërkesa përfalje dënimesh. Si Kodi Penal në fuqi dhe projekt i paraqitur parashikojnë disa lloje dënimesh, që fillojnë nga qortimi shoqëror, gjer te dënimini me vdekje. Ne kemi konstatuar se nga gjykatat nuk vlerësohet kurdoherë në masën që i përket shkalla e rrezikshmërisë së fajit në dënimet që jepen. Prandaj ka pasur raste që Presidiumi i Kuvendit Popullor ka ulur nga dënimet me vdekje që kanë dhënë gjykatesit.

Në Presidium kanë ardhur propozime për uljen e dënameve të disa të dënuarve, të cilët me punën dhe me sjelljet e tyre kanë treguar se janë riedukuar. Duke pasur parasysh forcën e punës edukuese të Partisë, edhe për të dënuarit, në bazë të kritereve të drejta, ne kemi pranuar faljen, uljen ose ndryshimin e dënameve.

Edhe këto çështje duhet të kihen parasysh në hartimin e projektkosit penal.

Në praktikë ndodh që në mbledhje të popullit diskutohet përfaljen e dënimit të të dënuarve me heqjelirie. Vihet pyetja: A ka ardhur një situatë e tillë që ne ta vendosim me ligj një praktikë të tillë në mbledhjet e popullit? Mund të ndodhë që në mbledhje të tillë të ngrihen një ose dy njerëz e të bëjnë një katrahurë të madhe, duke thënë se «jam dakord të liron het filan njeri nga vuajtja e dënimit», «se ka pesë fëmijë përfërshi» etj. Mirëpo si mund ta falim ne një njeri që ka vjedhur shtetin, siç mund të kërkojnë disa njerëz që udhëhiqen nga sentimentalizmi? Në qoftë se ka pesë fëmijë, këtë keqbërësi duhej ta kishte menduar vetë para se të kryente krimin. Përkëtë çështje, sipas praktikës së ndjekur nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, tashti merret mendimi i organizatave të masave nëpërmjet komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që i njohin të dënuarit. Këto që thashë, ndoshta nuk hyjnë në sferën e Kodit Penal, por le të kihen parasysh kur të hartohen ligjet e tjera.

Pasi u dhanë disa sqarime nga shoku Aranit Çela, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Pse të quhen krimet edhe ato vepra që nuk parasesin rrezikshmëri? Prandaj mendoj se duhet të jemi më të saktë në përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të krimit dhe në klasifikimin e tyre. Po t'i gjykojmë çështjet kështu, mund të dilnim me disa shkurtime akoma më të njëdha në cilësimin e krimeve dhe në mosquajtjen krim të asaj vepre që nuk duhet konsi-

deruar e tillë¹. Disa kime duhet t'i shohim jo si statistika të thata, por t'i analizojmë, që të jenë të argomentuara, të përpunuara e të komentuara politikisht, në baza politiko-morale-ideologjike, në mënyrë që edhe ne të kemi mundësinë të nxjerrim vetë konkluzione. Shokët e komisionit kanë dy vjet që punojnë për projektkodin dhe këto gjëra mbështetëse i kanë të përpunuara, prandaj mund t'i paraqitin Byrosë Politike disa kategorë krimesh nga më kryesoret, si dhe ndryshimet e transformimit që janë bërë e do të reflektohen në projektkodin e ri.

Në qoftë se ky projektkod nuk do t'i paraqitet Kuvendit Popullor për t'u aprovuar në sesionin që vjen, por në sesionin tjetër, unë propozoj që ne, në këtë mbledhje, t'u bëjmë shokëve të komisionit edhe këshillimet e rekomandimet e tjera, të cilët mbasi t'i rishikojnë, analizojnë dhe plotësojnë kërkesat tonë, të na e paraqesin edhe një herë këtë çështje në një mbledhje tjetër të Byrosë Politike² dhe pastaj të vendosim definitivisht.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

1 Në zbatim të kësaj porosie të shokut Enver Hoxha, në Kodin e ri Penal të RPSSH u bë një klasifikim më i drejtë i veprave penale, duke u ndarë ato në kime dhe në kundërvajtje penale.

2 Projekti i Kodit Penal u shqyrtua përsëri në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, më 24 shkurt 1971.

NJOHJA E LIGJEVE EKONOMIKE KA EFEKT KUR SHOQEROHET ME ZBATIMIN E TYRE NË JETË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1970

Mendoj se vërejtjet dhe diskutimet që bënë shokët do të shërbejnë për ta thelluar më tej punën për njohjen e kërkeseve të ligjeve ekonomike të socializmit. Jam dakord, gjithashtu, me mendimin që u shfaq këtu se njohja e këtyre ligjeve objektive ka efekt më tepër, kur ajo shoqërohet me aksione për zbatimin e tyre në praktikë, në jetë. Pikërisht kështu e ngrita unë këtë çështje në Berat². Të kuptohemi drejt, këtë problem unë e shtrova jo se Partia, bashkimet profesionale ose organet shtetërore dhe ekonomike gjer atëherë

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi njohjen dhe zbatimin e ligjeve ekonomike të socializmit.

2 Në mbledhjen me punëtorë, kooperativistë dhe kuadro të rrethit të Beratit, më 26 shkurt 1969, ku shoku Enver Hoxha mbajti fjalën: «Si duhet t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim drejt disa çështje të ekonomisë sonë socialiste». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vell. 40, f. 175.

kishin lidhur duart në këtë drejtim, por sepse zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë nxirrte dhe nxjerr probleme të reja më të komplikuara, të cilat kërkojnë që kuadrot të kualifikohen shumë më tepër e të përvetësojnë më mirë kërkesat e ligjeve ekonomike të socializmit. Ato që dinë kuadrot dhe zbatimi empirik prej tyre i këtyre kërkesave, tani nuk janë të mjaftueshëm. Është e vërtetë se në këtë drejtim ne kemi bërë përparime, por megjithatë jemi akoma prapa dhe nuk mund të themi se përparimi i arritur është ai që kërkohet. Ndaj vazhdimisht duhet të ngulim këmbë që kjo punë të ecë me ritme edhe më të shpejta.

Për të ecur më tej, është e domosdoshme të mbështetemi kurdoherë te baza që njohuritë teorike, ligjet ekonomike, t'i shpjegojmë në lidhje me praktikën, me zbatimin në jetë të tyre. Njerëzit e mësuar që zotërojnë njohuri shkencore të mos humbasin në «teorira». Aftësitë e tyre ata t'i tregojnë në zberthimin e mendimit teorik, me qëllim që ky të bëhet i kuptueshëm përtë gjithë ata që nuk e zotërojnë atë në shkallën e duhur, por që e zbatojnë në praktikë gjatë punës së tyre. Ka me mijëra punëtorë që nuk e dinë karakterin e ndërlikuar teorik të normave të punës në ekonominë socialiste, megjithatë, mjaft ekonomistë dhe planovikë që e dinë këtë teori, çdo vit e çdo pesëvjeçar, janë gjendur me gisht në gojë përpara tejkalimit të normave nga ana e punëtorëve. Klasa punëtore, që është e ngritur politikisht, teorinë ekonomike nuk e njeh sa ekonomistët dhe planovikët, por ajo di q'rëndësi ka norma e punës, cilat janë elementet përbërëse të saj, se si duhet të punojë dhe cili është qëllimi i

punës. Ajo, pra, e kupton qartë dobinë e madhe të tejkalimit të normave, prandaj edhe punon e prodhon më shumë nga ç'kanë parashikuar specialistët.

Le të marrim një çështje tjetër. Kemi gjykuar që për të ngritur një fabrikë duhen, ta zëmë, 15 milionë lekë, por, në fakt, fabrika nuk ka kushtuar kaq. Duhet ta themi hapur se shumica e vlerësimeve ekonomike, që janë bërë në qendër për vleftat e objekteve, nuk kanë dalë të sakta dhe, si rrjedhim, fondet monetare të planifikuara nga specialistët tanë janë tejkaluar. Po pse ndodh një gjë e tillë, gjersa ata e dinë ekonominë dhe i njohin ligjet e saj? Kufijtë e caktuar janë tejkaluar, sepse ana ekonomike e ndërtimit të objektit nuk është studiuar sa duhet e nuk është mbështetur me masa organizative e teknike të përshtatshme dhe disa ekonomistë, duke e hequr veten si specialistë të mbaruar, i kanë marrë problemet si të ditura. Në këtë drejtim është e domosdoshme që njerëzit e mësuar të bëjnë një rishikim të vvetvetes dhe një krahasim të tyre me punonjësit e ashtuquajtur të pamësuar, që thyejnë normat e tejkalojnë planet. E kam fjalën se duhet të qëndrojmë pak më tepër «me këmbët në tokë», të jemi më modestë për të organizuar konkretisht, në bazë, njohjen e përhapjen e mëtejshme të ligjeve të ekonomisë socialiste midis punonjësve, midis klasës punëtore dhe fshatarësisë. Drejt e tha sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit¹ se duhen shkundur të gjithë ata kuadro, që janë gati të bredhin tërë ditën andej e këndej, me makina apo me biçikleta (dhe me

1 Çajup Rusmali, i pranishëm në këtë mbledhje.

këtë jatin përshtypjen sikur gjoja kanë shumë punë), por, kur u kërkon të ulen e të përpunojnë një mendim teorik ose të zgjidhin një problem ekonomik, të nxjerrin përpara «mungesën e kohës». Partia duhet t'i mësojë këta shokë që, në radhë të parë, të planifikojnë mirë kohën dhc, pasi të jenë në rregull me veten e tyre, pastaj të ndihmojnë edhe të tjerët. Kjo është një detyrë partie shumë e madhe.

Jam i mendimit se metodat që përdor aktualisht Partia për njohjen dhe për zbatimin e ligjeve ekonomike të socializmit, siç na raportuan shokët e Beratit, të Elbasanit, të Mirditës, të Durrësit dhe shokët e tjerë, janë të drejta. Është e kuptueshme se në këtë punë mund të ketë dhe ka akoma boshllëqe, por sidqoftë këto metoda po na jatin rezultate. Tani çështja është që të plotësohen këto boshllëqe dhe format e ndryshme të njohjes dhe të zbatimit të këtyre ligjeve ekonomike të pasurohen edhe më tej.

Më duket se organizimin e punës me propagandistët në këtë fushë duhet ta përmirësojmë akoma më tepër. Siç thatë edhe ju, është mirë të hiqet dorë nga ata propagandistë që e duan çdo gjë të gatshme, domethënë, që kanë nevojë t'u mësohen të tëra, që nga alfa dhe deri tek omega. Tani ne kemi me mijëra njerëz që e kanë mësuar ekonominë politike në shkolla dhe që kanë punuar e punojnë konkretisht për zbatimin e saj. Le të shkunden pak këta njerëz dhe t'i bëjmë që të hapin më shumë librat. A mund të thuhet që një drejtor apo llogaritar nuk di ç'është vlera e produkteve dhe e mallrave, ç'është çmimi, ç'është kostojë etj.? Të gjithë këta kuadro i njojin këto dhe kategoritë e tjera

ekonomike, prandaj mendoj se nuk del nevoja të shkëputen nga puna e të venë në kurse kualifikimi, por t'u vëmë detyrën të studiojnë, t'i rifreskojnë e t'i plotësojnë dijet pa u shkëputur nga puna. Për t'u thelluar në studimin e ligjeve që qëndrojnë në bazë të drejtimit të ekonomisë socialiste, ata le të lënë pak mangët gjumin pse kjo punë është një nga pjesët përbërëse më të rëndësishme të detyrave të tyre.

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe Instituti i Studimeve Ekonomike kanë marrë orientime për detyrat dhe për punët e veta. Sipas mendimit tim, të dy këto institute duhet të merren me studime e përgjithësime të ndryshme ekonomiko-shoqërore që i nevojiten Partisë dhe pushtetit. Për këtë qëllim institutet mund të përdorin jo vetëm kuadrot e tyre por, për një, dy ose disa probleme, mund të kërkojnë edhe ndihmën e bashkëpunimin e organeve të Partisë e të pushtetit, të hartojnë bashkërisht me ta një plan ndihme e bashkëpunimi reciprok dhe të marrin përsipër detyra të përbashkëta.

Kryesore është që këto dy institute dhe organizmat e tjerë studimorë të kenë plane të studiuara me tema të dobishme dhe të mundshme për t'u realizuar. Pra, të merrni përsipër aq studime, sa janë mundësítet tuaja për t'i përgatitur me cilësi të lartë dhe që ato t'u përgjigjen nevojave aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe tërë jetës shoqërore të vendit. Po të veproni kështu, studimet që do të kryeni do të jenë një ndihmë e madhe edhe për njohjen dhe zbatimin në jetë të kërkesave të ligjeve objektive të socializmit nga punonjësit tanë dhe për institucionet e tjera.

Çdo institucion ose komitet partie bën planin e vet, për ato probleme ekonomiko-shoqërore që e ndien të nevojshme t'i shtrojë për t'i njojur punonjësit e rrethit, ku ai ushtron veprimtarinë e tij. Në qoftë se, për shembull, rrathi i Elbasanit ka problem sqarimin e përbajtjes e të kërkesave të një ligji ekonomik, një rrëth tjetër këtë mund të mos e ketë problem; përkundrazi ai mund të ndiejë nevojën të sqarojë diçka tjetër të ekonomisë politike. Pra, planin e punës për njojen e ligjeve ekonomike të socializmit çdo rrëth e bën sipas kushteve dhe nevojave konkrete që ka, qofshin ato imediate apo të perspektivës.

Si përfundim, dëshiroj të them se në këtë drejtim ne kemi shumë nevoja të mëdha e të ngutshme. Megjithëse ka një përparim, duhet pranuar se ai është akoma i vogël. Është e drejtë ajo që tha shoku Hekuran Mara¹, se, ndërsa progresi teknik shkon përpëra, studimi i problemeve ekonomike nuk e ndjek me të njëtin ritëm këtë progres. Ai nuk tha se studimet ekonomike nuk pasqyrojnë fare zhvillimin e teknikës, por shtoi me të drejtë se ato kanë mbetur prapa. Nga vetë praktika e drejimit të ekonomisë dhe e punës për realizimin e planeve del se studimi i problemeve ekonomike lë mjaft për të dëshiruar. Sikurse vuri në dukje shoku Ramiz, studimet ekonomike është mirë të shkojnë bashkë me zhvillimin e teknikës dhe, në këtë raport, ligji ekonomik duhet të udhëheqë. Edhe shoku Gaqo

1 Në atë kohë, shef sektori në Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste.

Nesho¹ në diskutimin e tij drejt tha se kur mësojmë marksizëm-leninizmin është c domosdoshme të vëmë theksin mi shumë në nocionet e ekonomisë politike, që të përvetësohen mirë ato sepse ekonomia përbën bazën e zhvillimit të shoqërisë. Në qoftë se njerëzit tanë nuk do të dinë të drejtojnë e të ndërtojnë si duhet ekonominë, atëherë edhe zbatimi i politikës sonë do të bëhet me boshllëqe. Propagandimi i ideve të marksizëm-leninizmit, pa përfshirë ekonominë politike, do të jetë krejt i njëanshëm, formal e pa dobi. Kështu duhet ta kuptojë Partia këtë problem me rëndësi të madhe.

Përgëzojmë shokët e rrtheve për iniciativat që kanë marrë, të cilat, për mendimin tonë, janë të drejta. Në punë janë arritur rezultate por, natyrisht, ka edhe të meta që duhen ndrequar. Për këtë del nevoja që ju t'ju ndihmojë qendra, por me punën dhe me eksperiencën tuaj edhe ju duhet ta ndihmoni qendrën.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

1 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit.

THË BËJMË MË SHUMË PËR RESPEKTIMIN E THË DREJTAVE THË GRUAS NË SHOQËRI E NË FAMILJE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1970

Diskutimet e shoqeve dhe të shokëve për problemin që po shqyrtojmë qenë shumë interesante, sepse na dhanë një pasqyrë të rolit të grave që është me të vërtetë inkurajues. Këtu diskutuan edhe vetë shoqet, po me modesti, karakteristikë kjo e mirë e anëtarëve të Partisë sonë.

Ne nuk e teprojmuam dhe jemi realistë, por e vërteta është që roli i grave dhe i vajzave të ngritura në përgjegjësi, i aksionisteve në fshat, i luftëtareve të së resë është i madh, ato kanë bërë kudo përparime të dukshme. Organizata e Bashkimit të Grave bën shumë për-

¹ Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim raporti i kryesisë së BGSH «Mbi rolin që luajnë gratë e ngritura në përgjegjësi, luftëtaret e së resë dhe aksionistet në fshat për t'u hapur rrugë normave të reja në shoqëri e në familje».

pjekje në punë, ajo zhvillon kudo një aktivitet të gjerë e të organizuar shumë mirë me masat e grave, prandaj ka dhe rezultate, që duken gjatë gjithë punës që bëhet për zbatimin në jetë të direktivave të Partisë.

Është e vërtetë se këshillat e gruas në bazë, siç e tha shoqja Afka Gambeta¹, nuk janë në lartësinë e detyrave në rritje. Duhet ta shikojmë çështjen që në këta këshilla të zgjidhen shoqet më të mira, që kanë kualitete të shumta, e të përmirësohet më tej puna e tyre për të aktivizuar edhe më mirë të gjitha anëtaret e organizatës. Por detyrë për aktivizimin e grave nuk ka vetëm Bashkimi i Grave, kanë edhe organizatat e Bashkimeve Profesionale, të Bashkimit të Rinisë etj., që kanë në radhët e tyre shoqe të dalluara në punë e në prodhim, aktiviste shoqërore, udhëheqëse dhe heroina, që punojnë në çdo fushë, si në organet e ekonomisë e të kulturës, ashtu edhe në të gjitha instancat e zgjedhura të pushtetit.

Po ta vështrojmë punën e organizatës së gruas në drejtim të rolit që luan sot gruaja në jetë dhe në shoqëri, nuk mund të themi se ajo ka mbetur pas. Natyrisht, Partia dhe pushteti, pa përmendur përpjekjet më të mëdha që duhet të bëjnë vetë gratë, duhet t'u japid akoma më shumë ndihmë organizatës së gruas dhe grave në përgjithësi, se në këtë anë ka akoma boshllëqe. Gruaja duhet ndihmuar jo vetëm për t'u futur në punë, por, në radhë të parë, për t'u ngritur politikisht dhe ideologjikisht, sidomos për t'u çliruar nga

¹ Në atë kohë sekretare e Këshillit të Përgjithshëm të BGSH.

mbeturinat e trashëguara të së kaluarës. Njëkohësisht duhet të bëjmë më tepër përpjekje që, më shpejt e më rrënjesisht, të gjirojmë nga mbeturinat burrat, sepse janë më shumë këta që bëhen «ferrë në këmbë» në përparimin e mëtejshëm të grave. Këtë e vërtetuan edhe diskutimet e shokëve. Shoku sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Pukës tregoi se si një anëtar partie i vitit 1948, pa pikë turpi paska folur hapët në organizatën-bazë të Partisë se e rreh dhe do ta rrahë gruan dhe, në qoftë se ajo e kundërshton, ai do ta futë 7 konopë¹ nën tokë. Një anëtar partie si ky, që e konsideron gruan si një kafshë dhe e rreh atë, shkel një nga ligjet më të shenjta të Partisë, prandaj le të jetë qoftë edhe komunist i vjetër i vitit 1948, ai duhet përjashtuar pa hezitim nga Partia, pse ajo s'ka asnjë nevojë për njerëz të tillë. Mund të jetë komunist ai që rreh gruan e vet? Rrahjen dhe torturat kundër njerëzve i kanë përdorur nazistët, ndërsa komunistëve, pavarësisht nga stazhi që kanë në Parti, nuk mund t'u lejohen në asnjë mënyrë veprime të tilla të shëmtuara.

Po të analizojmë nga vijnë më shumë pengesat për emancipimin e gruas, nga prapambetja e nga konservatorizmi i disa grave, që nuk duan të dalin para burrave, apo nga pikëpamjet prapanike e nga konservatorizmi i burrave, do të na dalë se në 80 ose 90 për qind të rasteve pengesat vijnë nga burrat. Prandaj Partia, pa iu shmangur luftës dhe përpjekjeve për t'i ngritur gratë politikisht e ideologjikisht, duhet t'i bëjë ato të zonjat

1 Këtu ka kuptimin e pashit, domethënë të masës së gjatësisë që formohet me të hapurit e krahëve horizontalisht.

që të luftojnë akoma më me forcë për të drejtat që u kanë garantuar Partia dhe pushteti popullor në shoqëri dhe në familje.

Propaganda kundër zakoneve prapanike dhe veçanërisht kundër mungesës së respektit ndaj gruas dhe të drejtave të saj, duhet të thellohet më me forcë te burrat. Në respektimin e të drejtave të grave në shoqëri, janë bërë disa përparime, kurse për të drejtat e tyre në familje, megjithëse nuk kemi qëndruar në vend, jemi më pas. Kjo vjen se burrat jashtë shtëpisë nuk para tregohen aq konservatorë, se atje opinioni shoqëror sa i sheh i dënon, ndërsa ata veprojnë brenda shtëpisë, ku s'i sheh njeri. Prandaj pikërisht këtu t'i përqendrojmë mirë bateritë e propagandës sonë për edukimin moralo-politik të burrave dhe atëherë do të shohim me siguri që roli i grave do të rritet shumë më tepër.

Mendoj se Partia është e domosdoshme që ta kuptojë akoma më mirë çështjen e ngritjes së grave në përgjegjësi. Në kushtet tona duhet të jetë si parim që gruaja të mos shkarkohet nga përgjegjësia ashtu sikundër mund të shkarkohet një burrë. Këtë parim ne duhet ta zbatojmë me ndërgjegje të plotë, për arsy se në fillim puna e një gruaje të ngritur në përgjegjësi mund të mos duket, ajo mund të mos e përballojë dot menjëherë volumin e punës së re që i ngarkohet e me cilësinë që kërkohet edhe për mungesë eksperience, por jemi të bindur se, po ta ndihmojë Partia, ajo do të ecë përpara.

Partia të mos bjerë kurrë në pozitat e llafazanëve, të shpifësve dhe të atyre që nuk i durojnë dot gratë të gëzojnë të drejta të barabarta me burrat, të meritojnë

vende drejtuese në punë njëlloj si edhe burrat. Ajo duhet të shkojë me vendosmëri kundër korrentit prapanik e konservator dhe të luftojë me forcë të madhe kundër atyre që e trajtojnë keq gruan.

Si konkluzion mund të themi se gruaja ka bërë përparime dhe Partia duhet të vazhdojë ta ndihmojë atë edhe më shumë. Kjo është një rrugë shpëtimitare për vetë gruan dhe për fatet e ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Raporte e
fjalime 1970-1971»,
f. 95. Tiranë, 1972*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e
fjalime 1970-1971», f. 95.
Tiranë, 1972*

TË MËSOJME TEORINË MARKSISTE-LENINISTË NË LIDHJE TË NGUSHTË ME PRAKTIKËN REVOLUCIONARE

*Fjala në mbledhjen jubilare me rastin e 25-vjetorit
të krijimit të Shkollës së Partisë «V.I.Lenin»*

8 Nëntor 1970

Të dashur shokë dhe shoqe, studentë dhe pedagogë,

Në emër të Komitetit Qendror dhe timin ju uroj nga zemra 25-vjetorin e Shkollës sonë të Partisë që mban emrin e Leninit të madh. Ky përvjetor jubilar koïncidon me festën e sotme të 8 Nëntorit, datë me rëndësi të jashtëzakonshme për popullin shqiptar, pasi në këtë ditë, 29 vjet më parë, u themelua Partia e lavdishme Komuniste e Shqipërisë. Gëzimet sot janë të shumta. Atyre u shtohet edhe inaugurimi i ndërtesës së re e të bukur të shkollës suaj.

Shkolla e Partisë është bërë për 25 vjet me radhë dhe kështu do të jetë edhe paskëtaj, vatra e zjarrtë e edukimit të komunistëve me teorinë tonë të lavdishme, marksizëm-leninizmin, me mësimet e gjalla jetëdhënëse të Partisë sonë dhe në përgjithësi me kulturën përapimtare revolucionare.

Nga bankat e kësaj shkolle kanë kaluar më shumë se 7 000 kuadro të Partisë. Kjo është një shifër kuptimplotë, jo vetëm si numër kuadrosh, por sidomos nga puna e madhe edukative, teorike dhe praktike revolucionare që ata kanë zhvilluar e po zhvillojnë në gjirin e Partisë, në punët e pushtetit tonë të diktaturës së proletariatit, të ekonomisë e të kulturës, në gjirin e organizatave të masave. Ata kanë qenë dhe janë nga edukatorët, organizatorët dhe njerëzit e veprimit të guximshëm, nga më të mirët. Ata janë nga nxënësit, metodistët dhe ndihmësit kryesorë për përhapjen në gjerësi dhe në thellësi të teorisë marksiste-leniniste të Partisë sonë në masat e popullit.

Sigurisht, kuadrot e Partisë, që kanë mbaruar Shkollën «V.I.Lenin», i ka karakterizuar thjeshtësia dhe ata kurdoherë duhet të jenë të thjeshtë, të luftojnë në veten e tyre intelektualizmin, të mos mendojnë se, duke mbaruar shkollën, janë «elita e Partisë», se shkolla u mësoi atyre çdo gjë, prandaj të tjerët duhet vetëm të dëgjojnë e të mësojnë prej tyre, kurse ata vetë s'kanë ç'të dëgjojnë e ç'të mësojnë nga të tjerët. E kundërtë e këtyre pikëpamjeve mësohet në Shkollën tonë të Partisë «V.I.Lenin» nga përvetësimi i marksizëm-leninizmit.

Këtu, në Shkollën e Partisë, sintetizohet pasuria kolosale e pallogaritshme e doktrinës sonë, e aktivitetit të shkëlqyer revolucionar të Partisë së Punës të Shqipërisë, të dhjetëra mijë komunistëve, të klasës sonë heroike punëtore dhe të masave të gjera punonjëse. Prandaj, kjo shkollë duhet të konsiderohet një ndihmëse, një mjet, ku Partia i armatos më tej njerëzit e saj

për t'i rifutur pastaj ata me forca të përtëritura në valët e revolucionit, ku farkëtohet lumburia e njerëzve të atdheut tonë socialist.

Çdo vit shkolla përparon, ngrihet niveli i dhënies së mësimit nga ana e pedagogëve, këta vetë lartësohen, duke përvetësuar më thellë teorinë dhe praktikën revolucionare. Studentët vijnë shumë më të përgatitur se përpjekja, pasi tani atyre jo vetëm nuk u mungon kultura e përgjithshme, por kanë edhe një stazh të gjatë lufte e përpjekjesh në punë partie e shtetërore. Zhvillimi i shkollës, lidhja më e gjallë e teorisë me praktikën, revolucionarizimi i vazhdueshëm i stilit dhe i metodës së punës kanë dhënë dhe do të jepin fryte të mira. Unë ju përgëzoj për rezultatet e kënaqshme që keni arritur.

Neve, komunistëve e gjithë punonjësve, na kërkohet të jemi të armatosur me dy lloje armësh: me armët e zjarrit dhe me idetë e marksizëm-leninizmit. Të dy këto lloje armësh i duhen revolucionarit për të bërë revolucionin e për ta çuar atë deri në fund. Qyshnë ato ditë të vështira, por heroike, të Luftës Nacional-çlirimtare, kur vendosej fati i atdheut e i popullit tonë, Partia i porosiste komunistët të mësonin me këmbëngulje jo vetëm si të zotëronin pushkën, por edhe si të zotëronin armët ideologjike, idetë e marksizëm-leninizmit. Edhe pas Çlirimit të vendit, duke mbajtur kurdoherë në gatishmëri pushkën, komunistët dhe punonjësit tanë, mbi shpatullat e të cilëve ra barra e rëndë e shkatërrimit të botës së vjetër dhe e ndërtimit të një shoqërie krejt të re, socializmit, iu përveshën akoma më me këmbëngulje përvetësimi të bazave të teorisë

sonë të pagabueshme, marksizëm-leninizmit, si busulla orientuese e udhëheqje për veprim në kushtet konkrete të atdheut tonë. Kjo ka qenë dhe mbetet për të gjithë një detyrë e përhershme dhe e dorës së parë.

Në, marksistë-leninistët shqiptarë, erdhëm te filozofia e Marksit nëpërmjet praktikës revolucionare, luftuam me të gjitha forcat feudalët e borgjezinë, regjimin e tyre reaksionar, që shtypte popullin, regjimin e injorancës më të madhe, të shfrytëzimit barbar të njeriut nga një grusht njerëzish. Ne e urryem fenë me të gjithë forcën e gjykimit tonë, sepse praktika revolucionare e popullit na kishte nxjerrë qartë në dukje rolin thellësisht reaksionar e antipopullor të doktrinave fetare, të cilat mbështetnin feudalët e borgjezinë e vendit, si dhe të huajt që na shtypnин. Luftërat çlirimtare shekullore dhe të pareshtura kurrë të popullit tonë e kishin bërë këtë një popull revolucionar. Ai edhe ekzistencën e tij si popull, edhe ndryshimet pozitive në jetën e tij shoqërore, nuk mund t'i konceptonte ndryshe veçse në rrugën e luftës e të revolucionit. Kryengritjet e tij kanë pasur kurdoherë karakter të theksuar antiimperialist, antifeudal, antiborgjez, antiklerikal. Sigurisht, këtu akoma nuk mund të bëhet fjalë përfrymësim e udhëheqje nga filozofia e Marksit, e cila u kristalizua si duhet te ne me formimin e Partisë. Por Partia jonë gjeti te populli i vet dhe te klasa jonë e vogël punëtore e fillimit një fushë pjellore për transformime rrënjosore, për një revolucion të madh shoqëror, që do të përbyste sistemin e vjetër shoqëror të feudalëve e të borgjezisë dhe do të vendoste socializmin.

Me aktivitetin e tyre revolucionar, duke transformuar kushtet shoqërore, njerëzit transformojnë edhe vjetveten. Kështu, ne shohim një transformim të madh në klasën punëtore dhe në fshatarësinë tonë, që ka përqafuar kolektivizimin. Edhe inteligjencia jonë tanë nuk është më ajo e vjetra, as si numër, as si prejardhje dhe as si nivel kulturor. Niveli politiko-ideologjik i klasës punëtore jo vetëm është ngritur në rrugën revolucionare, por me ndërgjegjen e saj klasore ajo edukon dhe udhëheq fshatarësinë dhe shtresat e tjera të popullsisë në vendin tonë. Niveli arsimor e kulturor i njeriut tonë të ri është rritur dhe shkon vazhdimit në ngjitje për t'iu përgjigjur nevojave dhe kushteve të krijuara. Të gjitha këto transformime revolucionare të njerëzve tanë janë fryt i transformimit të kushteve shoqërore që solli revolucioni popullor. Pra, zhvillimi ynë eci në një rrugë të tillë, sepse Partia zbatoi me besnikëri mësimet e Marksit, filozofia e të cilit i ka ndriçuar kurdoherë rrugën politikës sonë.

Historia, na mëson Engelsi, deri në ditët tona zhvillohet si një proces i natyrshëm dhe, në përgjithësi, u nënshtrohet po atyre ligjeve objektive të lëvizjes, të cilave u nënshtrohet edhe natyra, por me veçoritë e veta specifike, sepse këtu kemi të bëjmë me veprimtarinë e qenieve të ndërgjegjshme, të njerëzve. Njerëzit janë kurdoherë në lëvizje e aktivitet, ata veprojnë për të realizuar qëllime e dëshira të caktuara dhe historia nuk është gjë tjetër veçse gjithë ky aktivitet i tyre. Mirëpo të gjithë njerëzit nuk i kanë kurdoherë të kristalizuara si duhet as qëllimet as mjetet dhe mënyrat se si do t'i arrijnë këto qëllime. Veç kësaj qëllimet dhe

dëshirat e njerëzve nuk janë të njëllojta; kjo varet nga vendi që ata zënë në shoqëri, në përputhje me marrëdhëniet shoqërore, që ekzistojnë në periudhën historike në fjalë. Prandaj, historia, siç vë në dukje Engelsi, bëhet në mënyrë të tillë që rezultati final del kurdoherë nga konfliktet, nga një numër i madh konfliktesh individuale, të kondicionuara secili nga një shumicë kushtesh të ekzistencës. Ka, pra, në procesin historik forca të panumërtë, që kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe këtej rrjedh një rezultante që është ngjarja historike.

Natyrisht, kjo është tipike për shoqërinë shfrytëzuese, ku prona private i ndan njerëzit e klasat, i kundërvë interesat e qëllimet e tyre dhe ku sundon ligji i spontaneitetit të verbër. Por edhe në socializëm, me gjithëse këtu është zhdukur prona private dhe shoqëria zhvillohet në mënyrë të ndërgjegjshme, edhe këtu, për shkak se njerëzit jetojnë e veprojnë në kushte e rrethana të ndryshme, për shkak se ekzistojnë dallime esenciale midis klasave mike, midis qytetit e fshatit, midis punës fizike e mendore etj., ndeshemi me interesat, aspirata e mendime të ndryshme, me një varg kontradiktash.

Ka komunistë që në libra e në shkollë mund t'i kenë mësuar këto mendime të Engelsit e të marksizëm-lениinizmit, po, kur vjen puna t'i analizojnë, t'i ballafaqojnë me ndodhitë e shumta të jetës e t'i zbatojnë në praktikë, atëherë ngecin, çështjet nuk i shohin drejt, nuk arrijnë të kuptojnë se njerëzit kanë mendime e dëshira të ndryshme, të cilat shpesh përpiken e kundërshtojnë njëra-tjetrën. Nga këta shokë mendohet e kërkohet që «rezultantja», për të cilën flet Engelsi, të

arrihet pa përpjekje të të kundërtave, pa rrahje mendimesh pro dhe kundër, të arrihet në mënyrë dogmatike, me një të rënë të shkopit.

Në mbledhje të ndryshme vërehet se disa drejtues kanë frikë nga diskutimet «që nuk tonojnë», që dalin jashtë formulave stereotipe. Ata mendojnë se çdo gjë duhet të shkojë si në vaj. Një metodë e tillë bën që mendimet e kundërtatë të shfaqen afëherë jashtë mbledhjes. Dhe në këtë rast bëhet alarm për diçka që «teorikisht» thuhet se është kuptuar, por në fakt nuk është kuptuar e nuk zbatohet drejt. Por, të jemi të ndërgjegjshëm, kundërshtimet është vështirë t'i myftësh. Ai që, për shembull, mori apartament, e pushoi ankesën dhe kjo kontradiktë u zgjidh, kurse ai që prej vitesh është ngushtë, do të vazhdojë të qahet. Kjo kontradiktë na shtyn të mendojmë për ta kapërcyer sa më parë, jo duke i thënë «mos fol, mbylle gojën» atij që s'i është plotësuar kërkesa, por duke gjetur forma të reja të punës e të mobilizimit të masave në aksione me goditje të përqendruar për të ndërtuar apartamente të shumta dhe sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, duke kapërcyer me luftë e me përpjekje edhe vështirësitë e kontradiktat, që lindin gjatë punës për ndërtimin e banesave me goditje të përqendruar, ne do ta zgjidhim brenda disa vjetëve problemin e strehimit në qytete. Kështu ndodh për të gjitha problemet e jetës, probleme të mëdha e të vogla, që na vihen përpara për t'i zgjidhur dhe që përbëjnë «rezultantet» e mëdha historike, ecjen përpara në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste dhe më vonë të asaj komuniste. Dëgjoni sa bukur e drejt e ka shprehur këtë ligj dialek-

tik të ndeshjes së mendimeve, si një forcë e madhe lëvizëse e shoqërisë sonë, një punëtor mekanik: «Ne mekanikëve, — tha ai, — na pëlqejnë këto fërkime, sepse kur fërkohen dy metale japin nxehësi, e cila shndërrohet në energji mekanike. Kështu edhe mendimet sa më shumë të rrihen, aq më tepër nxehësi dhe energji do të krijojnë dhe, në këtë mënyrë, prodhimi dhe mirëqenia e punonjësve do të ecin përpara».

Në qoftë se e bluajmë mirë teorinë tonë dhe dimëta lidhim atë me jetën, atëherë shumë e shumë gjëra qartësohen. Qoftë edhe vetëm nga shembulli që solla duhet të mendojmë: «Përse të kemi frikë nga diskutimet, nga rrahja e mendimeve, përse të kemi frikë nga kritika, përse ta ngsushtojmë autokritikën vetëm në disa gjëra personale dhe të mos e zhvillojmë atë në shkallë akoma më të gjerë?». Kështu nuk ulet aspak autoriteti i institucionit apo i dikasterit, por këta vihen në lëvizje për t'i zgjidhur drejt e shpejt kontradiktat që nxjerr jeta. Kjo është një edukatë e tërë që zhvillon e duhet të zhvillojë Partia në radhët e anëtarëve të saj dhe të popullit.

Na takon neve, komunistëve, në radhë të parë, të kuptojmë thellë teorinë tonë dhe pastaj t'ua mësojmë edhe masave të gjera të popullit. Çështjet e teorisë nuk janë të njëianshme, as mjafton që t'i dinë, t'i kuptojnë e t'i zbatojnë vetëm disa; ato duhet t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë drejt të gjithë, pasi të gjithë kanë detyra dhe askush, i madh o i vogël qoftë, nuk mund t'i shpëtojë as përgjegjësisë personale as asaj kolektive.

Kur ne studiojmë historinë e lashtë revolucionare të popullit shqiptar deri në ditët tona, kuptojmë sa ma-

dhështore është dialektika materialiste e Marksit dhe sa të kota janë kritikat, që janë orvatur t'i bënин dhe t'i bëjnë filozofisë së tij të pavdekshme.

Dialektika është teoria e zhvillimit. Në përpunimin e saj Marks u mbështet te dialektika hegeliane, por ai e transformoi atë rrënjesisht, e shndërroi në të kundërtën e saj, nga një dialektikë e mbështetur kryekëput në zhvillimin e idesë, në një dialektikë të mbështetur në të dyja këmbët në konceptet materialiste. Në dialektikën e Marksit «ana aktive» dhe vendimtare e zhvillimit nuk është «dinamizmi i aktivitetit shpirtëror», me fjalë të tjera ideja, por praktika njerëzore, domethënë veprimitaria praktike materiale e njerëzve për transformimin e natyrës e të shoqërisë. Këtë formulim të madh historik të filozofisë marksiste-leniniste, që karakterizon dialektikën materialiste të Marksit, në dallim nga dialektika idealiste hegeliane, e njojin të tërë. Ne, marksistë-leninistët, e mësojmë atë rrënjesisht, pasi është bazë për filozofinë tonë. Mendimtarëve tanë të mëdhenj revolucionarë, për t'i afirmuar këto parime të mëdha u është dashur për dekada e dekada të tëra të bënin një luftë të madhe, në teori dhe në jetë kundër filozofëve idealistë, antimarksistë, kundër borgjezisë reaksionare dhe shkollave të ndryshme politiko-ideologjike të tyre. Zhvillimi materialist i historisë botërore, revolucionet në periudha të ndryshme historike, deri në revolucionet proletare të shekullit tonë, që sollien në fuqi klasën punëtore dhe vendosën diktaturën e proletariatit në shumë vende, vërtetuan tezat themelore të marksizëm-leninizmit. Natyrisht, lufta vazhdon dhe do të vazhdojë në mes revolucionarëve dhe kun-

dërrevolucionarëve, në mes proletariatit dhe borgjezisë, në mes marksistë-leninistëve dhe antimarksistëleninistëve.

Në kohët tona revizionistët modernë me ata sovjetikë në krye, duke luftuar egërsisht marksizëm-leninizmin, përpiken të ruajnë pamjen e jashtme të formulimeve teorike të doktrinës marksiste-leniniste, kuptohet, për t'u maskuar, por, nga ana tjeter, ata të gjitha këtyre u marrin krahët për t'i deformuar, për t'u hequr esencën revolucionare të tyre, me qëllim që të luftojnë komunizmin dhe revolucionin. Këta armiq të marksizmit, pra, duke interpretuar në mënyrë të falsifikuar zhvillimin materialist të historisë, përpiken ta vënë me kokë poshtë dialektikën materialiste të Marks-it dhe ta ngrenë në një piedestal të ri, të transformuar, në atë të hegelianëve të rinj.

Neve, marksistë-leninistëve, na bie detyra e madhe të luftojmë në mbrojtje të teorisë sonë marksiste-leniniste kundër falsifikatorëve të rinj dhe, që ta bëjmë si duhet këtë luftë, formulimet teorike të doktrinës sonë që mësojmë në shkolla ose në libra, të mos i marrim vetëm si konsiderata të drejta historike, që paraqitin luftën revolucionare të udhëhcqësve tanë të mëdhenj në epoka të caktuara. Përkundrazi, çdo mendim i Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit duhet të përbëjë për ne objektin e një reflektimi të thellë, me qëllim që të kuptojmë thelbin e tij dhe t'ua përshtatim atë drejt, në mënyrë krijuese e jodogmatike, periudhave aktuale në të cilat jetojmë e luftojmë, rrethanave konkrete historike të vendit, zhvillimit tonë shoqëror, problemit që kërkon zgjidhje.

Pikërisht në këtë luftë komplekse për edukimin tonë me teorinë marksiste-leniniste, për zbatimin e saj krijues te ne, nuk duhet të mbyllemi kurrë në vetvete dhe nuk duhet ta quajmë të plotësuar detyrën, në rast se nuk ndjekim me vigjilencë falsifikimet që i bëhen doktrinës sonë nga revizionistët modernë dhe ideologët e tjerë të kapitalit dhe nuk zhvillojmë kundër tyre një luftë të rreptë, të papushuar ideologjike e politike, duke u kundërvënë njëkohësisht atyre sukseset tonë ndërtimin e socializmit, të arritura sipas mësimeve jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit.

Studimi i shkencës marksiste-leniniste është e vëtmja rrugë për t'i shpjeguar drejt fenomenet dhe faktet e jetës, është e vëtmja rrugë që të sqaron të tanishmen dhe të ndriçon perspektivën. Studimi i saj të armatos që në analizën e fakteve e të fenomeneve të mos mjaftohesh vetëm me paraqitjen e tyre të jashtme, me atë që duket në sipërfaqe, por të shkosh më thellë, për të zbuluar brendinë, thelbin e tyre, ligjet objektive, që drejtojnë zhvillimin shoqëror. Sepse ndodh jo rrallë që forma e jashtme e proceseve dhe e fenomeneve shoqërore paraqit në mënyrë të shtrembëruar esencën që fshihet nën to, që në pamje ajo të duket diçka e re, normale, përparamtare, ndërsa në thelb të jetë krejt e kundërtat.

Të marrim, për shembull, një nga çështjet bazë të marrëdhënieve shoqërore në kapitalizëm. Ashtu si paraqiten ato në sipërfaqe, krijojnë përshtypjen sikur midis punëtorit e kapitalistit ekzistojnë marrëdhënie barazie: «sa më jep të jap», sikur ai i paguan punëtorit

të gjithë punën e harxhuar prej tij, sikur kapitalisti është prodhuesi i kapitalit. Në të vërtetë nuk ëshië kështu. Dihet se kapitalisti i paguan punëtorit vetëm një pjesë të punës së tij, kurse pjesën tjeter ai nuk ia paguan, por e përvetëson. Është pikërisht kjo pjesë e papaguar e punës së punëtorit që prodhon e shton kapitalin. Këtu e ka burimin shfrytëzimi kapitalist, këtu qëndron zbulimi gjenial i asaj «çështjeje misterioze» në marrëdhëni et kryesore midis punëtorit e kapitalistit, të cilën Karl Marks i quajti mbivlerë.

Pra, është shkenca marksiste ajo që argumentoi se ligjet, që rregullojnë e drejtojnë prodhimin kapitalist, nga jashtë paraqiten si forma të atilla, që jo vetëm fshehin natyrën e tyre të vërtetë, por krijojnë edhe përshtypjen e së kundërtës te njerëzit, domethënë sikur ato janë format më të drejta, më të natyrshme e të përjetshme. I gjithë ky iluzion krijohet nga kapitalistët për të fshehur shfrytëzimin që u bëjnë punëtorëve dhe kontradiktat e pashmangshme, që e gjerryejnë nga brenda dhe e çojnë drejt varrit rendin kapitalist.

Edhe në kohën e sotme apologjetët e kapitalizmit dhe revisionistët modernë, duke spekuluar me disa shfaqje të jashtme të reja, si përhapja e kapitalizmit monopolist-shtetëror, krijimi i të ashtuquajturave këshilla punëtorë që gjoja marrin pjesë në drejtimin e ndërmarrjeve kapitaliste apo vetadministrimi punëtor në Jugosllavi etj., etj., përpiken të krijojnë iluzionin se është zhdukur shfrytëzimi kapitalist dhe po fshihet dallimi midis punëtorëve e kapitalistëve. Analiza shkençore marksiste-leniniste e këtyre fenomeneve demaskon

tërë këtë mashtrim të ri dhe tregon se shfrytëzimi kapitalist jo vetëm nuk është zhdukur, por është intensifikuar më tej.

Rendi kapitalist, çfarëdo ndryshimi të jashtëm që të pësojë, çfarëdo maske që të vërë, çfarëdo «teorie» që të krijojë, dhe të tilla ai krijon përherë, për t'ua përshtatur rr Ethanave që lindin nga acarimi i luftës së klasave, mbetet një rend shtypës e shfrytëzues. Ky rend duhet shkatërruar dhe ai do të shkatërrohet nëpërmjet revolucionit proletar; marrëdhëniet kapitaliste do të zëvendësohen medoemos me marrëdhëniet e reja socialiste, mjetet e prodhimit do t'u hiqen nga duart kapitalistëve dhe do të merren në zotërim nga vetë klasa punëtore.

Më kot përpiken kundërshtarët e marksizmit të sulmojnë teorinë e Marksit nën pretekstin se ajo merret me arsyetime abstrakte, me «kuintesencën abstrakte» të proceseve e të fenomeneve, duke u larguar gjoja nga faktët, nga të dhënat konkrete, nga realiteti historik. Ky është një falsifikim i trashë. Kurse ne, marksistë-leninistët, nga metoda që Marks ka përdorur përanalizën e kapitalizmit në veprën e tij të pavdekshme «Kapitali», nxjerrim mësimin e madh se për t'u thelluar në realitetin objektiv nuk mjaftojnë vetëm mbledhja dhe paraqitja e fakteve, por duhen bërë përgjithësime, konkluzione e abstraksione shkencore, duhen zbuluar ligjet që drejtojnë fenomenet e zhvillimit shoqëror, ndryshtë mbetesh në sipërfaqe të gjëra, bie në prakticizëm ose edhe në gabime të ndryshme.

Në socializëm, gjithashtu, për shkak se edhe këtu e vjetra lufton për ekzistencë, duke veshur shpeshherë

petkun e së resë, mund të ndodhë që shfaqjet e jashtme të mos pasqyrojnë thelbin e vërtetë të fenomeneve. Prandaj, duhet të dimë që, duke u mbështetur në teorinë shkencore marksiste-leniniste, të mos qëndrojmë në sipërfaqe, por të depërtojmë nga shfaqjet e jashtme në esencën e tyre, të zbulojmë shkaqet e thella që qëndrojnë në themel të gjërave dhe ligjet shoqërore, që drejtojnë zhvillimin e tyre. Vetëm kështu do të jemi në gjendje të dallojmë të renë nga e vjetra, përparimtaren nga konservatorja e reaksionarja.

Njerëzit tanë duhet t'i edukojmë që fenomenet e zhvillimit shoqëror t'i gjykojnë në baza shkencore materialiste, me qëllim që të zhdukim nga ata pikëpamjet ose mbeturinat idealiste apo mendimet e sipërfaqshme sempliste. Sipas mësimeve të Marksit, klasa punëtore nuk është dhe nuk duhet të jetë utopiste. Ajo nuk duhet t'i idealizojë dekretet dhe të mendojë se çdo gjë bëhet ose kryhet me anën e dekreteve dhe të urdhëresave. Ajo duhet të dijë të kuptojë c'janë dekretet, prejardhjen e tyre dhe përsë shërbejnë. Klasa jonë punëtore duhet të ketë të qartë, në radhë të parë, dhe kjo është kryesore, kyçin e problemit, të ketë të qartë se emancipimi i saj, çlirimi i saj nga prangat e kapitalit, zhvillimi i shoqërisë, që ajo krijoi dhe që shkon vazhdimisht duke u bërë më i përsosur, nuk është bërë aspak me dekrete, por ka kaluar dhe do të kalojë vazhdimisht nëpërmjet luftërash të gjata, përpjekjesh e procesesh të vazhdueshme historike, që sjellin si rrjedhim transformimin e shoqërisë dhe të njerëzve.

Pra, nuk duhet të krijohet përshtypja se fitoret e arritura dhe transformimet rrënjosore që janë bërë te

ne, në shoqërinë dhe në njerëzit tanë, janë rezultat i dekreteve dhe i urdhëresave; përkundrazi, dekretet dhe urdhëresat janë pasojë e disa problemeve që kanë lindur nga proceset historike objektive, nga lufta dhe përpjekjet për transformimin e gjithanshëm të shoqërisë dhe të njerëzve. Dekreti, pra, në vetvete nuk mund të sjellë zhvillimin shoqëror, ai është pasqyrim i këtij zhvillimi, një normë që ka për qëllim ta rregullojë e ta ndihmojë këtë zhvillim. Zhvillimi objektiv i shoqërisë, i cili dikton transformimet, krijon kontradikta që kërkojnë zgjidhje. Ai vjen në kundërshtim, për shembull, me ligjet dhe me zakonet e shkruara e të pashkruara të shoqërisë së vjetër të rrëzuar, të një mënyre jetese të papërshtatshme me zhvillimin e ri të forcave prodhuese e të marrëdhënieve të reja socialiste në prodhim. Këtu zë fill dalja e dekretit apo e urdhëresës, që diktohet nga nevoja për kapërcimin e kontradiktave të krijuara. Ai nuk është, pra, pjellë e arbitraritetit apo e fantazisë subjektive.

Që këtej rrjedh se ligjet, dekretet e urdhëresat tona duhet kurdoherë të dalin nga një njohje dhe analizë e thellë materialiste shkencore e kushteve të jetës reale. Që këtej rrjedh, gjithashtu, se sa herë ndryshojnë kushtet objektive, sa herë zhvillimi krijon kontradikta e probleme të reja, kjo duhet të shoqërohet me rishikimin dhe ndryshimin e dekreteve dhe të urdhëresave tona. Çdo idealizim e fetishizim i asaj që është vendosur dje, në kushte të dhëna, bëhet pengesë për zhvillimin dhe shpie në burokratizëm kur këto kushte kanë ndryshuar.

Zhvillimi objektiv i natyrës, po ashtu edhe i sho-

qërisë njerëzore, është njëkohësisht materialist dhe dialektik. Prandaj edhe shkenca jonë marksiste-leniniste, duke i pasqyruar drejt fenomenet e botës reale, është, gjithashtu, në të njëjtën kohë materialiste dhe dialektike.

Ka njerëz që, megjithëse e heqin veten si materialistë, ideve dhe ndërgjegjes u japid vendin e parë; kurse ka të tjerë që, gjithashtu, e quajnë veten materialistë, por që thonë se vetëm zhvillimi ekonomik ka rëndësi, ai gjoja sjell me vete automatikisht transformimin e tërë shoqërisë, prandaj faktori subjektiv është krejt i pafuqishëm dhe nuk luan kurrfarë roli aktiv në zhvillimin historik. Natyrisht, që të dyja këto kategoritë njerëzish gabojnë dhe nuk i kanë të qarta si duhet parimet bazë të filozofisë sonë, të dialektikës materialiste.

Jeta shoqërore është në thelb një proces material, sepse në themel të saj qëndron puna. Njeriu duhet të lidhet ngushtë me punën, ta dojë atë dhe ta kuptojë teorikisht çështë puna. Sipas Karl Marks-it puna është një proces që kryhet midis njeriut dhe natyrës. Vetë njeriu vepron ndaj lëndës së natyrës si një forcë natyrore. Prandaj njeriu nuk mund të kuptohet i shkëputur nga natyra, nuk mund të kuptohet që forcat e natyrës të reagojnë mbi të dhe ky të rrijë duarlidhur përpara tyre, të mos veprojë si një krijesë, që ka dhe duhet të luajë rolin e një force natyrore. Njeriu, për të jetuar, ka nevojë të ushqehet, të krijojë, të vërë në lëvizje të gjitha forcat e tij fizike dhe mendore, duart, këmbët, muskujt, trupin, trurin, me një fjalë të punojë, që sendet e ndryshme të natyrës t'i zbulojë, t'i përpunojë, t'i transformojë, që t'i shërbejnë për jetën e tij.

C'ngjet në këtë proces të natyrshëm? Njeriu, duke vepruar mbi natyrën e jashtme, e transformon atë, por në këtë veprimtari të tij ai transformon njëkohësisht edhe vetveten, zhvillon shijet dhe zotësitë e tij. Pra, pikënisja e njeriut, sipas Marksit, është puna, në atë formë që i përket vetëm njeriut, pasi ka edhe kafshë që kryejnë veprime të ngjashme me punën, por ato ndryshojnë nga puna e njeriut. Rezultati i arritur nga njeriu ekziston idealisht që më parë në imagjinatën e punonjësit, gjë që nuk ekziston te bleta që ndërton zgjuan, thotë Marks. Domethënë njeriu nuk u ndërron vetëm formën sendeve të natyrës, por ai realizon njëkohësisht edhe një qëllim të caktuar, për të cilin është i ndërgjegjshëm, qëllim që përcakton si ligj mënyrën e veprimeve të tij dhe të cilit ai duhet t'i nënshtrojë vullnetin e vet.

Si një proces material i veprimit të njeriut mbi natyrën, për transformimin e saj, të vetvetes e të krejt shoqërisë, puna është, në radhë të parë e kryesisht, veprimtari e masave të gjera të punonjësve, e punëtorëve dhe e fshatarëve. Janë këto forca vendimtare që mbajnë mbi shpatulla tërë jetën shoqërore e çojnë përpara zhvillimin shoqëror. Prandaj, janë krejt idealiste, antishkencore e të huaja për ideologjinë tonë marksiste-leniniste konceptet intelektualiste e burokratike, që mbivlerësojnë rolin e njerëzve të punës mendore dhe përpiken t'i vënë ata mbi klasën punëtore dhe masat punonjëse.

Engelsi na sqaron se, në fund të fundit, faktori më i rëndësishëm, faktori vendimtar në histori është «prodhimi dhe riprodhimi» i jetës reale. Kjo duhet kuptuar

drejt, na mëson ai, domethënë se ekonomia është baza, por jo i vetmi faktor determinues, pasi ka edhe elementë të tjerë siç janë format politike të luftës së klasave dhe rezultatet e tyre, kushtetutat e vendosura nga klasat fituese, format juridike, konceptet fetare, teoritë e ndryshme politike etj. Të gjitha këto influencojnë me veprimet e tyre dhe, natyrisht, lënë gjurmë. Ka, pra, — thotë Engelsi, — aksion dhe reaksion nga të gjithë këta faktorë por në mes të tyre del në pah, shquhet, ndikon faktori ekonomik. Është ky faktori më i rëndësishëm që, më në fund, çan rrugën, në mes gjithë këtyre faktorëve të tjerë.

Po të studiohet procesi objektiv i zhvillimit të shoqërisë sonë, do të shihet qartë edhe mbi ç'bazë u bë transformimi i ndërgjegjes së njerëzve tanë dhe si vërshuan ide të reja, të krijuara nga kushtet e reja shoqërore. Që të kuptohet si duhet ky proces dhe të mos lejohen konkluzione vulgare, të gjitha ndryshimet që sjell zhvillimi i shoqërisë sonë, sipas metodës dialektike duhet të studiohen kur lindin, kur zhvillohen e përparojnë, kur zhduken dhe, më në fund, kur transformohen e zëvendësohen me të reja.

Por roli i ideve në zhvillimin shoqëror, sikundër na mësojnë klasikët e marksizëm-leninizmit, nuk mund të mohohet. Engelsi e kritikon «materializmin ekonomik», atë që pretendon se vetëm zhvillimi i forcave ekonomike ka rëndësi. «Ky është materializëm vulgar» thotë Engelsi.

Megjithëkëtë duhet pasur kurdoherë parasysh se idetë nuk luajnë rolin vendimtar dhe këtë Marks i shpjegon në mënyrë të shkëlqyer. Vetë idetë janë pro-

dukt dhe pasqyrim i zhvillimit material të shoqërisë. Njerëzit, duke transformuar kushtet materiale të shoqërisë, krijojnë një ndërgjegje të re, në procesin e zhvillimit shoqëror ata krijojnë edhe parime e ide të reja, të përshtatshme me situatat materiale të krijuara. Pra, janë ndryshimet në zhvillimin material të shoqërisë që qëndrojnë në bazë, nga të cilat lindin idetë e reja dhe krijohet një ndërgjegje e re. Ashtu si materializmi në përgjithësi e shpjegon ndërgjegjen nga qenia dhe jo njeriun nga ideja, edhe ndërgjegjja shoqërore duhet të shpjegohet me qenien shoqërore.

Partia jonë, duke luftuar rrezikun e subjektivizmit idealist, që injoron rolin vendimtar të faktorit ekonomik, në të njëjtën kohë vlerëson në mënyrë marksiste-leniniste rolin e madh aktiv të ideve e të superstrukturës përgjithësisht, duke flakur tej çdo shfaqje të fatalizmit e të përuljes përparrë spontaneitetit. Procesi i madh i revolucionarizimit të tërë jetës së vendit tonë, për ta çuar përparrë pa ndërprerje revolucionin socialist dhe për t'i prerë rrugën rrezikut të revizionizmit e të kthimit prapa në kapitalizëm, ka të bëjë, në radhë të parë e mbi të gjitha, me revolucionarizimin e superstrukturës socialiste, të Partisë e të shtetit të diktaturës së proletariatit, të shkollës e të kulturës, sidomos të ndërgjegjes së punonjësve. Ky është zbatim në praktikë, konkretizim e zhvillim i mëtejshëm i mësimave të marksizëm-leninizmit mbi rolin e madh aktiv të faktorit subjektiv në histori.

Zhvillimi i vazhdueshëm i shoqërisë sonë socialiste, që kryhet nëpërmjet lindjes dhe kapërcimit të kontradiktave të ndryshme, ka çuar në revolucionarizimin

e prodhimit dhe, tok me të, edhe të ndërgjegjes së njerëzve tanë. Këto ndryshime materiale në forcat prodhuese e në marrëdhëniet në prodhim krijojnë kushte të atilla që njerëzit, që marrin pjesë gjallërisht në këtë revolucion të pandërprerë, krijojnë ide të reja, në përshtatje me gjendjen e krijuar. Në zhvillimin e revolucionit provohen edhe idetë, ato që nuk i përshtaten gjendjes dhc bëhen frenuese luftohen, zhduken, zëvendësohen. Por nuk është lufta e ideve që bën të ecë përpara zhvillimi shoqëror objektiv, por ky i fundit është baza që çon në lindjen e kontradiktave të reja, për pashojë edhe në lindjen e ideve të reja e përparimtare, në luftë me idetë e vjetra ose reaksionare që vdesin.

Prandaj është kryesore të dihet nëse njerëzit, klasat, veprojnë në përputhje me ecjen objektive të historisë apo kundër saj. Çështja vendimtare është që, duke bërë analiza objektive, të arrihet që klasën punëtore, klasën më revolucionare, dhe klasat e shtresat e tjera aleate të natyrshme të saj t'i edukosh dhe t'i bësh të ecin në përputhje me ecjen objektive progresive të historisë. Këtu del roli i madh i teorisë revolucionare që, siç thotë Marks, «bëhet një forcë materiale kur pushton masat».

Njerëzit, klasat, në përputhje me kushtet shoqërore objektive në të cilat jetojnë, kanë interesat, dëshirat dhe qëllimet e tyre. Interesat objektivë kthehen në ndërgjegje dhe në veprim revolucionar ose reaksionar.

Kur analizojmë zhvillimin shoqëror të vendit tonë, shohim se njerëzit dhe klasat (punëtorë dhe fshatarë) dëshironin që të ndryshonte gjendja e tyre e vajtueshme shoqërore, të ndryshonin marrëdhëniet e vjetra në

prodhim. Kjo dëshirë ishte rezultat i vuajtjeve reale, i gjendjes shoqërore materiale, që ata e ndienin në kurrizin e tyre, ishte rezultat i njohjes së kësaj gjendjeje, që solli tek ata një ndryshim në ndërgjegje dhe në ide, që u hapte atyre perspektivën e organizimit të forcave për të bërë ndryshime materiale në shoqërinë tonë, e cila zhvillohej ngadalë. Qe, pra, zhvillimi objektiv që krijoi kushtet për përhapjen e ideve të reja, të cilat, gradualisht, u konkretizuan dhe hodhën në veprim masat e gjera punonjëse. Pra, veprimi i masave që bënë historinë në vendin tonë, iu nënshtrua ligjeve të zhvillimit historik, siç na mëson filozofia materialiste e krijuar nga Karl Marks.

Kuptimi i thellë i doktrinës sonë marksiste-leniniste tregon sa drejt i ka shikuar Partia jonë problemet kardinale të zhvillimit të shoqërisë sonë dhe, në radhë të parë, forcën lëvizëse të zhvillimit shoqëror, luftën e klasave dhe «prodhimin e riprodhimin» e jetës reale, si faktorin përcaktues, pa harruar, natyrisht, edhe faktorët e tjera. Po të lexohen me kujdes materialet e rëndësishme të Partisë në periudha të ndryshme të zhvillimit historik të vendit tonë pas Çlirimt, do të shihet se si problemi ekonomik çan rrugën duke krijuar kushtet materiale për zgjidhjen e shumë problemeve të superstrukturës. Atje duken qartë konfliktet, ndeshjet, «aksioni dhe reaksiuni i të gjithë këtyre faktorëve» përtë cilët na flet Engelsi.

Ai që nuk e kupton këtë dialektikë materialiste të zhvillimit shoqëror, që nuk kupton se ky zhvillim është një proces relativisht i gjatë, që kryhet nëpërmjet luftës së të kundërtave, ai që çdo gjë e nxjerr vetëm

nga idetë, nuk është në gjendje të kuptojë etapat e zhvillimit dhe detyrat e problemet që i përkasin çdonjërës prej tyre. Një njeri i tillë fare lehtë mund të vihet përpara një dileme dhe të thotë: «Përse Partia jonë, e cila është atciste, nuk mbajti qysh në fillim ndaj fesë, kishave e xhamive, qëndrimin që mbahet sot?». Ai nuk arrin ta kuptojë se Partia i është përmbajtur kurdoherë e me konsekuençë botëkuptimit ateist, antiidealit, materialist të saj. Por vetëm në etapën e sotme të zhvillimit, kur për këtë u krijuan edhe kushtet materiale të domosdoshme, masat e gjera të popullit tonë u bënë luftëtare të ndërgjegjshme kundër botëkuptimit fetar dhe shqelmuani kishat, xhamitë dhe dogmat e tyre.

Të njëjtat mendime të paqarta ka një njeri i tillë edhe për çështjen e pronës së vogël private e të zhdukjes së saj, sidomos në fshat. Ai nuk mund të kuptojë përse Partia, në hapat e parë të revolucionit tonë, kur Reforma Agrare ua mori tokën me luftë çifligarëve e bejlerëve, fajdexhinjve e fshatarëve të pasur dhe ua dha në pronësi fshatarëve pa tokë e me pak tokë, thoshte se nuk duhej prekur prona private e fshatarit punonjës. Por në këtë çështje jetike për të ardhmen e socializmit Partia nuk mund të vepronët në mënyrë të pamatur e t'i digjte etapat. Ajo veproi sipas mësimave të Marksit e të Engelsit, të cilët kanë thënë: «Proletariati të mos bëjë fjalë menjëherë për «zhdukjen e pronës», çështja të shtrohet që fshatari të vijë në kolktivizim në rrugën ekonomike». Dhe kështu erdhi ai në vendin tonë. Si rrjedhim, prona e vogël private mbi tokën u shndërrua në pronë kolektive kur për këtë u

krijuan kushtet e nevojshme ekonomike dhe ideo-politike.

Ose të marrim çështjen e nacionalizimit të tokës, si mjeti i parë i prodhimit në bujqësi. Siç dihet, këtë akt ne nuk e kemi bërë shprehimisht¹ dhe, për kushtet e arsyet objektive të atëhershme të Shqipërisë, Partia veproi drejt. Por te ne janë marrë të gjitha masat ligjore që toka të mos mund të përdorej më si prona e dikurshme private. Si pronë personale aktualisht përdoret vetëm oborri kooperativist, por as toka që përfshin ky oborr nuk mund të shitet, të jetet me qira ose të lihet trashëgim. Kjo copë tokë është lënë vetëm në shërbim personal të familjes kooperativiste.

Revolucioni ynë popullor bëri ligje të atilla, me të cilat praktikisht tokën e nacionalizoi, ai zbatoi Reformën Agrare dhe suprimoi pronën, që përdorej për të shfrytëzuar punën e të tjerëve. Gradualisht, me bindje dhe duke ecur «nga rruga ekonomike», siç këshillojnë Marksit dhe Engelsi, fshatari ynë erdhi në kolektivizimin e tokës e të mjeteve të tjera të prodhimit etj. Ai ruan vetëm oborrin e vogël, që e punon personalisht. Në po këtë «rrugë ekonomike», edhe këtë oborr fshatari shkon duke e zvogëluar, derisa ta zhdukë krejt si pronë të përdorimit personal dhe ta bashkojë me atë kolektiv, të cilën, pas një procesi akoma të gjatë, do ta kthejë edhe këtë nga prona e përbashkët e grupit

1 Kushtetuta e re e RPSSH e miratuar nga Kuvendi Popullor më 27.12.1976 e shpall tokën pronë të shtetit, duke shprehur kështu juridikisht atë realitet që në fakt ishte arritur prej kohësh në vendin tonë.

në pronë të të gjithë popullit. Pikërisht kjo nuk do të bëhet me dekrete, por do të jetë «rezultantja» historike e një procesi të vazhdueshëm zhvillimi ekonomik, shoqëror, ideopolitik të krejt vendit e sidomos të fshatit dhe të masave kooperativiste.

Siq jeni në dijeni, këto ditë u shpall përfundimi me sukses, një vit para afatit të caktuar, i elektrifikimit të të gjitha fshatrave të vendit tonë. Kjo është një fitore tjetër e madhe e Partisë dhe e popullit tonë në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Vajtja e energjisë elektrike në fshat është hapi i parë i rëndësishëm drejt elektrifikimit të thellë të tij, drejt atij transformimi të madh në mjetet dhe në teknologjinë e prodhimit bujqësor, ku synon Partia, i cili do ta vërë plotësisht bujqësinë tonë në rrugën e zhvillimit intensiv modern. Por elektrifikimi i fshatit do të shënojë, në të njëjtën kohë, një impuls të ri të fuqishëm në revolucionarizimin e ndërgjegjes së fshatarit tonë kooperativist, në përhapjen dhe në rrënjosjen e mëtejshme të ideve e të kulturës socialiste, të mënyrës së re të jetesës. Kjo fitore e re e shkëlqyer u arrit si rezultat i vrullit revolucionar të masave, i cili nuk shpërtheu vetveti, por si pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimeve objektive e subjektive në jetën e tyre. Realizimi me sukses dhe para afatit i këtij aksioni të madh, jo vetëm ekonomik, por edhe politik, ideologjik e kulturror, tregoi se vendimi i marrë nga Partia ishte i drejtë dhe në kohën e duhur, pasi zbatimi i tij ishte përgatitur nga gjithë zhvillimi i vendit tonë. Pra, edhe në këtë rast Partia veproi në përputhje me botëkuptimin marksist, i cili na mëson se çdo hap në jetë duhet bërë

pasi të jenë krijuar të gjitha premisat materiale e shpirtërore.

Shokë dhe shoqe,

Ne e mësojmë marksizëm-leninizmin në shkollë jo për të kënaqur kureshtjen apo vetëm pér të pasuruar e pér të zhvilluar intelektin, po pér të qenë sa më të dobishëm në jetë, pér t'i kryer sa më me sukses detyrat e Partisë, pér të qenë revolucionarë të ndërgjegjshëm e të aftë pér ta çuar përparrë çështjen e socializmit e të komunizmit në vendin tonë. Kjo arrihet kur teoria marksiste-leniniste mësohet jo në mënyrë abstrakte, akademike, libreske, por në lidhje të ngushtë me jetën, me praktikën revolucionare të masave.

Të përvetësosh marksizëm-leninizmin do të thotë të zotërosh parimet dhe ligjet themelore, botëkuptimin dhe metodologjinë e tij, mënyrën marksiste-leniniste të interpretimit të gjërave e të zgjidhjes së problemeve. Ka rëndësinë e vet njohja e përkufizimeve marksiste-leniniste pér këto ose ato çështje, pér këto ose ato ligje të filozofisë marksiste apo të ekonomisë politike. Por ajo që ka më tepër rëndësi është të mësojmë si të udhëhiqemi në jetë nga këto ligje, si t'i zgjidhim në bazë të tyre problemet konkrete që na dalin përparrë. Ka rëndësi të njohim historinë e Partisë, rrugën e saj të lavdishme, por ka mië shumë rëndësi të kuptohet thellë se nga është nisur e ç'metodë ka përdorur Partia pér zgjidhjen e problemeve në rrethanat e ndryshme dhe nga kjo të mësojmë si t'i zgjidhim ato sot,

në kushte të reja historike. Detyra e Shkollës së Partisë është pikërisht që jo tu japë kuadrove të Partisë thjesht disa dije marksiste, por t'i armatosë ata në mënyrë të tillë që të orientohen vetë në jetë, të formojë tek ata mënyrën marksiste të të menduarit e të vepruarit. Në këtë kuptim ne themi që marksizëm-leninizmi duhet të na shërbejë si busull orientimi.

Jeta është kurdoherë në lëvizje e zhvillim, ajo shtron vazhdimisht probleme të reja, kushtet shoqërore ndryshojnë pareshtur. Të marrim si shembull jetën e vendit tonë. Ne kemi hyrë në një etapë të re të zhvillimit të revolucionit e të ndërtimit socialist. Kjo etapë ka nxjerrë një sërë problemesh të reja, siç janë ndërtimi i plotë i bazës materialo-teknike të socializmit, përsosja e tërë sistemit të marrëdhënieve në prodhim, forcimi i diktaturës së proletariatit dhe lufta kundër rrezikut të burokratizmit, zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor, kontrolli punëtor e mjaft të tjera. Përgjigje të gatshme për probleme të tilla nuk gjen dhe as mund të pritet që ato të na i zgjidhin të tjerët. Prandaj, përvetësimi i marksizëm-leninizmit nuk duhet të jetë dogmatik, por krijuar.

Kjo do të thotë që në punën e shkollës një vend të rëndësishëm duhet të zërë studimi i thellë e i gjith-anshëm i realitetit të kohës sonë, i problemeve të mëdha që nxjerr jeta e që shtron Partia, duke i analizuar e duke i interpretuar ato në dritën e teorisë marksiste-leniniste.

Nga kjo pikëpamje, praktika e vajtjes së studentëve dhe e pedagogëve në bazë për studimin e temave të ndryshme, si dhe pjesëmarrja e tyre në punë pro-

dhuese, në stërvitje ushtarake apo në lëvizje e aksione masive, është një gjë e mirë, që duhet zhvilluar e duhet përsosur më tej. Natyrisht, të gjitha këto nuk duhen bërë në dëm të përvetësimit të teorisë, e cila zë dhe duhet të zërë vendin kryesor në punën e shkollës. Përkundrazi, ato duhet t'i shërbejnë një përvetësimi sa më të thellë, më të gjallë e më konkret të teorisë.

Partia jonë, krah për krah me të gjitha forcat marksiste-leniniste të botës, ka bërë e bën një luftë të vendosur e parimore kundër tradhtisë revizioniste. Në këtë luftë marksizëm-leninizmi ka marrë e po merr një zhvillim të ri. Në procesin e kësaj lufte ne i kemi përvetësuar edhe më thellë mësimet e marksizëm-leninizmit, kemi mësuar të njohim edhe më mirë miqtë dhe armiqtë, të mirën e të keqen, revolucionaren dhe kundërrevolucionaren. Pra, ligji i luftës së të kundërtave, si burim i çdo lëvizjeje e zhvillimi, gjen zbatim të plotë edhe në zhvillimin e vetë marksizëm-leninizmit, si dhe në procesin e njoħjes e të përvetësimit të tij. Këtej del një detyrë e rëndësishme e Shkollës së Partisë, e cila duhet t'i njoħë kuadrot e komunistët me historinë e kësaj lufte dhe t'ua mësojë atyre marksizëm-leninizmin jo thjesht, duke parashtruar në mënyrë «të qetë» tezat, parimet e konkluzionet marksiste, por në luftë me pikëpamjet e argumentet e kundërshtarëve të tij ideologjikë, në radhë të parë të revizionistëve modernë. Vetëm kështu janë të mundur përvetësimi i thellë e i gjallë i ideve të marksizëm-leninizmit dhe formimi i bindjeve të qëndrueshme ideologjike marksiste.

Koncepti revolucionar mbi studimin, që duhet të

rrënjosë shkolla në çdo kuadër, është që secili jo të lexojë për të lexuar, por të ballafaqohet me atë që lexon, të reflektojë mbi të, të gjejë ku i ka anët e mira, cila është eksperienca pozitive, ku janë pikat e dobëta dhe q'detyra dalin.

Misioni i shkollës sonë është që jo thjesht t'u japë njerëzve dije, por edhe t'i edukojë ata si revolucionarë, jo vetëm t'u japë një botëkuptim të drejtë teorik, por edhe të kultivojë në ta cilësi të larta moralo-politike.

Shokët që mbarojnë shkollat dhe kurset e Partisë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh se jo çdo gjë zgjidhet me përfundimin e shkollës. Çdo komunist duhet të mësojë vazhdimit me vullnet e këmbëngulje. Nuk mund të ecet pa mësuar dhe pa mësuar seriozisht. Me prakticizëm nuk mund të drejtohet. Prandaj Partia na porosit: Mos u lodhni kurrë së mësuari, mos e ndërpritni asnjëherë studimin! Ta vazhdosh studimin edhe pas shkollës do të thotë t'i thellosh e t'i zgjerosh më tej ato që ke studiuar në shkollë.

Kontributi i Shkollës së Partisë është i madh dhe ai duket kudo. Atë e shohim në të gjitha sukseset që po korr Partia, në qëndrimet e drejta revolucionare të kuadrore, në hovin e madh për revolucionizimin e jetës së vendit, në luftën e masave për zbatimin e vijës së Partisë në jetë etj., ku duket qartë sa shumë janë pjekur kuadrot tanë. Kjo vjen pasi ata kanë përvetësuar teorinë marksiste-leniniste në punë e sipër, por e kanë mësuar atë edhe në Shkollën e Partisë.

Le të mobilizohemi me të gjitha forcat, shokë dhe shoqe, për të përvetësuar marksizëm-leninizmin, ideo-

logjinë e Partisë sonë, e cila ndrit me shkëlgim dhe na tregon rrugën e fitores, rrugën e komunizmit, rrugën e lumturisë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Lavdi Partisë sonë!

Rroftë 25-vjetori i Shkollës së Partisë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 268 (6932), 9 nëntor 1970*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fja-
lime 1970-1971», f. 100.
Tiranë, 1972*

T'U KUNDËRVËME FUQIMISHT TAKTIKAT TONA REVOLUCIONARE TAKTIKAVE REAKSIONARE TË BORGJEZISË KAPITALISTE E REVIZIONISTE

*Nga biseda me një anëtar të Byrosë Politike
të KQ të PK (m-l) të Indisë*

14 nëntor 1970

Ju faleminderit shumë që morët një rrugë kaq të gjatë dhe erdhët të takohemi e të bisedojmë së toku këtu, në Shqipëri. Ne jemi një vend i vogël në Evropë dhe anëtarë të një partie, gjithashtu, të vogël; ju e kuptioni vetë ç'nevojë të madhe kemi për konsultime me shokët tanë të partive marksiste-leniniste.

Ne kemi një dashuri të madhe dhe të sinqertë për popullin e madh e të lashtë indian, që ka një histori të pasur e shekullore. Populli juaj ka luajtur një rol me rëndësi në historinë e njerëzimit dhe mendojmë se si tani, edhe në të ardhmen, ai do të luajë përsëri një rol edhe më të madhi në revolucion.

Popullit tuaj e keqja i ka ardhur nga kontinenti ynë, Evropa, e cila vazhdon të jetë akoma çerdhe e imperializmit dhe e kolonializmit. Nga Evropa kanë dalë jo vetëm imperialistët francezë, anglezë dhe të tjera,

por këtej e kanë origjinën edhe pasardhësit e tyre që u vendosën në Amerikën e Veriut, ku sot ekziston imperializmi më i egër në botë, SHBA.

Tani kohët kanë ndryshuar shumë në dëm të imperializmit e të kolonializmit dhe në favor të popujve e të revolucionit. Armiqtë e popujve janë në krizë të madhe, ndërsa revolucioni është vazhdimisht në ngritteje. Ne do të vazhdojmë të luftojmë gjithnjë e më shumë kundër imperialistëve, sepse në mënyrë paqësore ose me anën e rrugës parlamentare, siç predikojnë revizionistët modernë, armiqtë imperialistë, borgjezia dhe reaksiuni nuk i lëshojnë armët. Lenini, si teoricien dhe mendimtar i pavdekshëm i proletariatit botëror, na mëson të luftojmë me të gjitha forcat kundër imperializmit dhe borgjezisë reaksionare. Midis nesh dhe atyre nuk mund të ketë dhe nuk do të ketë kurrë pajtim.

Në Evropë, revolucioni dhe socializmi kanë fituar dhe po triumfojnë vetëm në Shqipërinë e vogël. Revolucioni kishte fituar edhe gjatkë, si në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të Evropës Lindore, por më vonë atje u bë kundërrevolucion dhe kapitalizmi fitoi përsëri si në të gjitha vendet e tjera të botës ku sundon borgjezia. A do të lejojnë vallë marksistë-leninistët që popujt e botës, proletariati botëror dhe fshatarësia heroike në të gjitha vendet që po vuajnë shfrytëzimin e egër kapitalist, të gënjen? Jo, as mund të durojnë e as mund të lejojnë. Në këtë drejtim ne mund të marrim si shembull vuajtjesh Indinë ku, si rezultat i shfrytëzimit të egër kapitalist, vdesin qindra mijëra njerëz në vit. Le të llomotitin sa të duan Brezhnjevi dhe Kosigini me shokë se gjoja në Indi socializmi do të

fitojë në mënyrë paqësore, gjendja te ju nuk ka për të ndryshuar pa luftë. Proletariati dhe fshatarësia indiane nuk mund të presin që Indira Gandhi dhe maharaxhatë, bijtë dhe bijat e tyre t'i dorëzojnë vetë tokat e çelësat e pasurive të tyre. Brezhnjevi e Kosigini me shokë ose pasardhësit e tyre, le të cirren sa të duan se gjoja Bashkimi Sovjetik, si një forcë e madhe, do të ndryshojë fatet e botës! Jo, fatet e botës do t'i ndryshojnë vetëm popujt, revolucioni i shpërthyer me armë në dorë në rrugën që na mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini. Me llafe, siç pretendojnë revizionistët, nuk ndryshohet gjëkafshë. Me llafe Niksonët dhe gjithë kapitalistët mund të rrojnë sa të duash.

Tani, pas gjithë këtij diversioni që i krijuan revolucionit tradhtarët revizionistë sovjetikë, gjendja është bërë diçka më e vështirë. Ja, për shembull, në Indi revizionistët, me tradhtinë e tyre, përveç mbështetjes që i japid qeverisë reaksionare të Indira Gandit dhe borgjezisë indiane, edhe ish-partinë komuniste e kanë çorientuar e përcarë në tri pjesë, nga të cilat dy nuk janë marksiste-leniniste, por vetëquhen të tilla, kurse vetëm pjesa e tretë, partia juaj, qëndron në pozita marksiste-leniniste.

Përballë tradhtisë së revizionistëve, ne marksistë-leninistët dhe revolucionarët, duhet të qëndrojmë fort në pozita revolucionare marksiste-leniniste, pse vetëm në këtë rrugë do t'i mposhtim sulmet e imperializmit, të revizionizmit sovjetik dhe të socialdemokracisë të mbushura me një bagazh të madh rrenash, «teorish», dinakërish e të tjera gjëra. Ne do t'u bëjmë ballë sulmeve të tyre, se jemi revolucionarë, pse na udhëheq

ideologjia e proletariatit, marksizëm-leninizmi, ideologjia më e përparuar e njerëzimit, që përfaqëson dëshirën e masave më revolucionare të popujve: të klasës punëtore dhe të fshatarësisë.

Ne duhet të shkojmë të organizuar në luftë, pse kjo ka rëndësi të madhe. Partia jonë, duke përfituar nga eksperiencia e gjithë partive marksiste-leniniste dhe e proletariatit botëror, i ka përballuar armiqtë dhe ka fituar në luftë kundër tyre, vetëm duke qenë e organizuar dhe duke shtrënguar fort radhët e veta në një unitet të çeliktë mendimi e veprimi. Ndërsa ne sot jemi mur graniti i ngritur mbi bazat e ideologjisë sonë revolucionare, revisionistët janë si muri me qerpiçë. Ata janë si një shportë karavidhesh që shqyejnë njëra-tjetrën.

Proletariati indian dhe fshatarësia qindramilionëshe indiane, e uritur për bukë dhe e etur gjatë shekuve për tokë, kanë luftuar vazhdimisht kundër anglezëve, kundër ideologjisë reaksionare «të rezistencës pasive» të Gandit, kundër maharaxhave dhe qeverive të tyre dhe sot po çajnë përpara si një rulo-kompresor që vjen e do të zmadhohet vazhdimisht për të shtypur armiqtë dhe për të sheshuar rrugën e së ardhmes nga do të kalojë populli indian.

Historia e popullit tonë, e popullit tuaj dhe e gjithë popujve të botës na mëson se paraardhësit tanë kanë luftuar kundër shfrytëzuesve, por kryengritjet e tyre kurdoherë janë shtypur, sepse secilit popull i ka munguar gjëja kryesore, një shtab drejtues i paepur, një parti e fortë dhe e zonja, siç është partia marksiste-leniniste, e vetmja që mund të udhëheqë popu-

Ilin me vendosmëri në fitore. Këtë mësim të historisë, sipas pikëpamjes së Partisë sonë, duhet ta kenë parasysh marksistë-leninistët e botës që të mundin të vënë të gjitha forcat për të krijuar e për të konsoliduar partitë e tyre marksiste-leniniste në zjarrin e luftës dhe sipas kushtevc reale të secilit vend.

Ka rëndësi që, për krijimin e partive me të vërtetë komuniste, të merren parasysh kushtet konkrete, të brendshme dhë të jashtme të çdo vendi, duke ditur se faktori i brendshëm është vendimtar, kurse faktori i jashtëm, sado i rëndësishëm, mbetet vetëm ndihmës. Revolucioni do të shpërthejë medoemos nga masat revolucionare brenda çdo vendi; ai do të fitojë në qoftë se në krye është partia marksiste-leniniste, ndryshe, edhe në qoftë se fitohet pavarësia, nuk mund të arrihet çlirimi shoqëror i punonjësve, vendin do ta qeverisin jo populli, po qeveritë borgjeze, antipopullore.

Në qoftë se populli shqiptar nuk do të kishte luftruar vetë i udhëhequr nga Partia Komuniste e tij, edhe sikur me luftën e tij, pa këtë Parti, të fitonte njëfarë pavarësie, prapë ai do të mbetej nën zgjedhën e një mbreti. Populli shqiptar luftoi, fitoi dhe e mori push-tetin në duart e veta, se kishte në krye Partinë e vet Komuniste. Ushtria sovjetike na ndihmoi, megjithëse asnje ushtar sovjetik nuk hyri në Shqipëri; kjo ndihmë përbënte një faktor të jashtëm me rëndësi të madhe, por, po të mos kishim luftuar ne, vetë, sot nuk do të kishte socializëm në Shqipëri, pse kishte forca të jashtme që vinin rrrotull për ta skllavëruar përsëri popullin tonë, siç ishin imperialistët anglezë, amerikanë, renegati Tito e të tjerrë, të cilët ne i kemi luftuar

rreptë që të gjithë dhe asnjëherë nuk u përkulëm.

Pikërisht, duke pasur parasysh rolin e këtij faktori vendimtar, revizionizmi aktual sovjetik sot bën të gjitha përpjekjet për ta luftuar Partinë Komuniste (marksiste-leniniste) të Indisë, pra, për t'ju luftuar ju, pse partia juaj është ajo që do t'i organizojë proletariatin dhe fshatarësinë, që do të udhëheqë gjithë popullin indian në revolucion, duke u mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit. Ju zhvilloni në Indi një luftë të shumëfishtë e në shumë drejtime dhe me siguri do të fitoni, pse nuk jeni vetëm. Me ju janë të gjithë ata që luftojnë kundër forcave imperialiste, kundër revisionistëve sovjetikë dhe kundër këlyshëve të tyre.

Nga sa dimë ne, partia juaj i ka hedhur bazat e veta dhe aktualisht po vepron në shumë vende me anë aksionesh kundër çifligarëve dhe pasanikëve. E përsëris, ne flasim për aq sa dimë, nga jashtë, megjithëkëtë mendojmë se rruga që ka zgjedhur partia juaj është e drejtë. Fshatarësia indiane që është shumë e varfër, nuk ka mundësi t'i shohë e t'i gjykojë makinacionet e fshehta të qeverisë së Delhit, e cila qëndron shumë larg popullit, por ajo shikon çdo ditë qartë dhe e ndien mbi shpinën e vet zgjedhën e rëndë të çifligarit, që i merr bukën dhe e lë të vdesë nga uria. Kur çifligarit i rrëmbehet toka dhe këtë e merr fshatari, atëherë ky bindet se kjo është rruga që duhet ndjekur dhe kupton ç'forca të mëdha ka populli për t'i rezistuar jo vetëm dhunës së çifligarit, por edhe vetë qeverisë reaksionare e ushtrisë së saj.

Ne komunistët, duke ndjekur parimet leniniste,

jemi kundër terroristit individual, për arsyen se jemi të ndërgjegjshëm që vrasja e një personi nuk i kushton gjë borgjezisë, e cila e zëvendëson lehtë atë me një tjetër, po aq ose më shumë të përshtatshëm se i pari. Ne komunistët punojmë dhe luftojmë, nëpërmjet një programi të caktuar, për të vrarë jo individë, por për të zhdukur borgjezinë si klasë, për të arritur që t'i rrëmbejmë asaj nga duart pushtetin politik, ekonomik dhe ushtarak.

Ju e dini vetë, por edhe ne nga eksperiencia e jetës themi se borgjezia me anë të forcës dhe të goditjeve përpinqet të krijojë frikë e panik në masat, me qëllim që t'i shtypë ato gjithnjë e më shumë e të paralizojë çdo lëvizje të tyre. Kur ne filluam luftën e aksionet nëpër qytete, populli shqiptar mori një gjallëri të madhe. Ai nuk e ka zakon të jetë frikacak, bile trimëria është në traditën e vet, se ka jetuar kurdoherë me pushekë në dorë dhe i ka goditur pa mëshirë armiqjtë e vet. Sidoqoftë pushtuesi në vendin tonë zhvilloi një terror të madh me anë të forcave të armatosura. Në fillim të pushtimit, reaksiuni, për të mbjellë panik, hapi parulla, si: Italia është një fuqi e madhe me 45 milionë njerëz, prandaj ne nuk ngrihem dot kundër saj etj. Por, sa filluam aksionet e para në mes të qyteteve, si rrymë elektrike u përhapën lajmet në popull. Pastaj hodhëm traktet. Krijuam njësitet e para guerile që kryenin aksione çdo natë, vazhdimisht e në të katër anët e vendit, si: djegie deposh të armikut, prerje telesh telefonikë e elektrikë, vrasje spiunësh e tradhtarësh të rrezikshëm e me damkë e kështu me radhë, duke rritur intensitetin e luftës të organizuar e të

udhëhequr nga Partia. Populli filloi kështu gradualisht të bëhet i ndërgjegjshëm për forcën dhe drejtësinë e çështjes të tij dhe shtoi pjesëmarrjen në luftë. Çdo shtëpi e popullit fukara u bë çerdhe luftëtarësh. Kështu u bë pluhur e hi parulla e armikut se gjoja ne nuk ishim në gjendje të luftonim kundër një shteti të madh, siç ishte Italia fashiste.

Veç kurdoherë patëm parasysh çështjen se në luftë duhej shkuar gjithmonë i organizuar. Këtë Partia është përpjekur t'ia shpjegojë mirë popullit. Ne, pra, kishim parasysh të ishim të organizuar dhe mirë, bile në radhë të parë të ishin anëtarët e Partisë të organizuar dhe të ndërgjegjshëm për atë që do të bënim. Për këtë qëllim, për t'i bërë të ndërgjegjshëm të gjithë ata shokë që nuk e kuptionin vijën, kemi përdorur, në radhë të parë, bindjen marksiste. Megjithatë, përpëra luftës, goditjeve dhe rrezikut të armikut, ne nuk jemi torolisur shumë me këta njerëz. Këta, kur s'kanë ecur me Partinë, i kemi lënë ta ndiqnin luftën jashtë radhëve të saj. Rreth Partisë që është majë e heshtës, u mblodhën grusht: ushtria, Fronti, rinia, gruaja. Çështja ishte të goditej armiku frontalisht në mënyrë të organizuar e me masa të planëzuara. Nuk e kam çështjen kryesisht te lufta frontale, por, në radhë të parë, tek ajo që i gjithë populli është e domosdoshme t'i kundërvihet me ndërgjegje të plotë armikut.

Nga eksperienca e partive marksiste-leniniste dhe e Partisë sonë mund t'ju themi se armiku është përpjekur dhe vazhdon të përpinqet të godasë partinë dhe, në parti, në radhë të parë, udhëheqjen dhe unitetin e saj, kurse në luftë, njerëzit më të guximshëm. Pastaj

shigjetat e armikut kurdoherë janë drejtuar në organizatat e masave për të shthurur mobilizimin e tyre, duke hedhur parulla të dëmshme propagandistike të mbështetura në konceptet e vjetra filozofike, për të çoroditur masat me të gjitha mundësitë, për të ngjallur në popull panikun dhe për të bërë që të dështojë puna e Partisë. Ja një shembull, shumica e shqiptarëve përpara ishin të besimit mysliman. Megjithatë pjesa dërrmuese e tyre merrnin pjesë gjallërisht në luftë. Atëherë, për të thyer unitetin e tyre në luftë nën udhëheqjen e Partisë sonë Komuniste, fashistët dhe tradhtarët e vendit bënин provokime, deri duke u përpjekur të shfrytëzonin ndjenjat fetare të masave. Dihet që feja myslimane rritjen e derrit e quan për gjynah. Ata, duke shfrytëzuar këtë, merrnin derra, i futnin natën në xhami dhe, të nesërmen u thoshin fshatarëve: «Ja ç'kanë bërë komunistët». Për arritjen e qëllimeve të tyre armiqtë, pra, përdornin çdo gjë.

Taktika të tilla kundërrevolucionare e të poshtra kanë mësuar e po ndjekin sot ndaj partive të vërteta marksiste-leniniste edhe revizionistët modernë. Ju këto i ndieni tani vetë në kurrizin tuaj, pse në Indi keni dy parti përballë, atë të Danges dhe atë të neorevizionistëve që kamuflohen me parullat shumë të dashura për komunistët e vërtetë dhe për masat, si: «Rroftë Lenini, Marks, Engelsi» etj. Të tilla parulla ata hedhin vazhdimisht e nuk është çudi që të nxjerrin edhe të tjera. Ne i njohim taktikat e tyre se revizionistët i kemi këtu, në Evropë. Por të gjitha manovrat e kurthet e tyre e kanë jetën të shkurtër, pse të gjitha ato janë pjellë e kapitalizmit dhe e imperializmit në kalbëzim,

që po vdes, kurse ideologjisë sonë, që përfaqëson të renë, nuk mund t'i rezistojë asnje sofizëm,asnje gjenjeshtër.

E dimë se lufta e proletariatit e udhëhequr nga partia, siç na mësojnë Marks i Lenini, ka rëndësi jastëzakonisht të madhe dhe veçanërisht në Indi, mendoj unë. Nuk e di konkretisht, po ma merr mendja se proletariati indian duhet të jetë shumë i shtypur, shumë i vuajtur, prandaj te ju duhet të ketë një fushë të madhe veprimi revolucionar.

Mundësi të mëdha pune për të organizuar luftën, për të bërë një luftë të koordinuar ka edhe në fshat, edhe në qytet. Ne e dimë se, imperializmi dhe kapitalizmi botëror sot i kanë përqendruar forcat atje ku janë pasuritë më të mëdha. Mirëpo pikërisht atje është dhe shfrytëzimi më i madh, si pasojë edhe rezistenca më e madhe. Patjetër qeveria reaksionare e Gandit dërgon nëpër fshatra edhe policinë, por ajo nuk ka mundësi që të gjitha forcat e represionit që disponon t'i shpërndajë në gjithë Indinë, kështu që për partinë tuaj ekziston mundësia për ta organizuar edhe fshatarësinë, për t'i dhënë reaksionit të vendit tuaj një goditje edhe nga ana e fshatit. Natyrisht, kur forcat i ke të organizuara edhe në qytete, atëherë goditja bëhet nga të dyja anët, kështu që borgjezia dhe feudalët, në këto kushte, do të gjenden mes dy zjarreve.

Por të kemi parasysh dhe të mos harrojmë në asnje çast se fshatari nga natyra e punës, e jetës së tij është një borgjezi i vogël, që, kur fiton diçka, kënaqet me aq dhe nuk ecën më tutje. Me të marrë copën e tokës, ai e ndien veten të kënaqur. Po t'i hedhësh një sy

historisë së kryengritjeve fshatare të Evropës, të dalin përpara të gjitha flukset dhe refluksat e këtyre kryengritjeve dhe pikërisht për arsyen që thashë ato kanë dështuar, kurse proletariati është krejt ndryshe. Ai i shkon revolucionit gjer në fund, se nuk ka ç'humbet, veç prangave, thotë Marks. Proletariati e di se fabrika dhe pushteti duhen marrë në dorë dhe për këtë duhet rrëzuar pushteti i vjetër i borgjezisë. Këtë parim e pati parasysh dhe e ndoqi me besnikëri Partia jonë, teorikisht dhe në praktikë. Në vendin tonë nuk kishte shumë punëtorë, pse industria gati nuk ekzistonte, kishët vetëm disa fabrika e punishte të vogla, prandaj klasa punëtore qe e vogël, kurse fshatarësia përbënte numrin dérrmues të popullsisë. Megjithatë, që në fillim, fshatarësisë sonë patriote e luftarake ne ia bëmë të qartë thelbin e doktrinës sonë, e edukuam atë me ideologjinë proleta, prandaj ajo u bë me Partinë dhe na erdhi në njësitë partizane, e bëmë të mendojë si proleta. Ajo vërtet luftoi për tokën, po kuptoi se krahas tokës duhet të luftonte edhe për pushtetin, psekështu do të shkatërrrohej borgjezia e okupatori dhe do ta kishte të sigurt tokën e fituar. Sigurisht këtë mësim marksist e ka parasysh edhe partia juaj.

Çështja se si të veprohet me sindikatat është një problem tjetër me rëndësi e i vështirë për ju dhe përgjithë partitë e reja marksiste-leniniste të Evropës që janë ngritur, si: në Itali, në Francë, në Austri, në Gjermani etj. Pothuajse e gjithë klasa punëtore në këto vende është e inkuadruar në sindikatat borgjeze, revisioniste, reformiste. Kapitalistët kanë një eksperiencë të gjatë e të madhe pune me këto sindikata, ata e kanë

lidhur punëtorin me një pyll ligjesh të ndryshme: me trajtimin ekonomik, me sigurimet shoqërore, me rrogat e të tjera me radhë, kështu që klasa punëtore e kontinentit tonë nuk lëviz jashtë rregullave që kanë vendosur këto sindikata dhe e ndien frikën e izolimit individual, pse, në qoftë se një punëtor simpatizon dhe bashkohet me partinë marksiste-leniniste, pronari kapitalist atë e pushon nga puna dhe sindikatat ekzistuese, të udhëhequra nga partitë borgjeze e revizioniste, nuk e mbrojnë.

Tani shtrohet problemi që cdo parti marksiste-leniniste ta studiojë medoemos thellë çështjen e sindikative, të reflektojë si t'i marrë krahët kësaj situate, si ta çajë këtë mur dhe ta bëjë të ndërgjegjshme klasën punëtore që të mos mashtrohet nga sindikatat borgjeze, nga imperialistët dhe nga revizionistët. Ky është një problem me rëndësi të madhe. Çështja tani shtrohet të futemi brenda tyre apo të krijojmë sindikata të reja tonat që të jenë në pozita revolucionare luftarake e të mos bien në pozitat e socialdemokracisë, qoftë për luftën politike, qoftë për luftën ekonomike. Këtu, në Evropë, në Perëndim, duket sikur bëhet luftë politike dhe ekonomike, por, në fakt, në radhët e sindikative bëhen vetëm pazarllëqe mes krerëve të këtyre organizatave, aristokracisë punëtore dhe borgjezisë. Edhe të ashtuquajturat demonstrata që bëhen kanë për qëllim vetëm të mbështetin tratativat.

Natyrisht për ne çështja e luftës që duhet të bëjmë, nuk shtrohet kështu, ne jemi për një luftë politike dhe ekonomike nga ana e klasës punëtore, natyrisht, jashtë normave e ligjeve të imponuara nga ka-

pitali. Po të mundim ta drejtojmë këtë luftë nga jash-të, kjo do të jetë shumë mirë, po të mundim ta drejtojmë nga brenda, pa rënë në pozitat e kapitalistëve e të socialtradhtarëve, edhe kjo nuk është gabim, po ta drejtojmë atë edhe nga jashtë kur të kemi njëkohësisht edhe brenda forcat tona, atëherë do të shkatërrohen reformistët, revisionistët e të tjerë dhe do të forcohen pozitat tona në radhët e klasës punëtore.

Fitorja varet kurdoherë nga proletariati, prandaj është e domosdoshme ta bëjmë atë të ndërgjegjshëm për rolin e tij historik, që ta kuptojë ideologjikisht dhe politikisht rolin e forcës së tij si klasë dhe jo si individ i izoluar, ta kuptojë teorikisht që ka përballë një armik të egër, kapitalizmin dhe gjithë organizmat e tij shtypës, të kuptojë se vetëm me bashkim, me unitet rreth një partie dhe me një program të qartë lufte, e udhëhequr vendosmërisht nga ideologjia e marksizëm-leninizmit, mund t'u bëjë ballë armiqve dinakë të çdo ngjyre qofshin.

Prandaj, mendoj se duhet studiuar ky problem. Ne bisedojmë nganjëherë për të tilla probleme me shokët e partive të tjera marksiste-leniniste që vijnë në vendin tonë, por vetë nuk jemi në gjendje të themi si duhet bërë kjo punë, pse gjendjen secili e njeh më mirë se kushdo për vendin e vet. Detyra jonë është vetëm të shkëmbejmë mendime.

Kapitalistët dhe revisionistët, për të zgjatur jetën e tyre, përdorin lloj-lloj formash e taktikash në përsh-tatje me situatat dhe me rritjen ideopolitike të klasës punëtore. Në Gjermani, për shembull, përdoret tanë një taktikë e re. Çfarë taktike? Ja: U bëhet thirrje pu-

nëtorëve të marrin pjesë «në drejtimin» konkretisht të kapitalit. Atje ku kapitalistët duan të ngrihet një impiant i madh siderurgjik, bëhen përpjekje për të marrë pjesë edhe punëtorët me aksione, po shumica dërrmuese e aksioneve janë të kapitalistëve, si të kapitalistikët të madh Tisen, i cili mund të ketë në ndërmarrje me dhjetëra mijë punëtorë. Atëherë, po të evitohen grevat dhe demonstratat e punëtorëve, 95 për qind të aksioneve ai i fut në xhepin e tij dhe vetëm 5 për qind ua shpërndan punëtorëve. Në këshillin administrativ të kësaj ndërmarrjeje formalisht punëtorët kanë të drejtë të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në proporcion me aksionet që disponojnë. Po edhe këta, si caktohen dhe, në fakt, kush vete atje? Atje venë përfaqësues të aristokracisë punëtore dhe veprimet manipulohen në bazë të 95 përqindshit, kështu vendimet merren gjoja në mënyrë demokratike, punëtorëve u bëjnë edhe ndonjë favor, bëhen debate të zjarrta, nganjëherë edhe ndonjë «grevë pasive», që të lënë përshtypje se diçka po bëhet, kurse në të vërtetë çdo gjë është vendosur nga padroni që në fillim, ai vendos edhe sa do t'u japë punëtorëve. Ja, kështu veprohet në Gjermani. Këtë dimë ne, po mund të ketë edhe taktika të tjera.

Këtë donte të bënte dhe Dë Goli, pas ngjarjeve me studentët, në majin e vitit 1968 në Francë. Nga gjithë ato demonstrata të fuqishme që u bënë atëherë në Francë, kapitali monopolist francez pësoi njëfarë tronditjeje. Dë Goli u përpoq të bënte një reformë të tillë, por padronët e kapitalit nuk e pranuan, atëherë ai i kërcënoi ata me largimin e tij nga pushteti, prandaj

organizoi referendumin, duke e paralajmëruar popullin se, po të mos votonte për të, ai do të largohej. Në këto manovra referendumi, presidenti i tanishëm i Francës, Pompidu, luajti një rol kundër Dë Golin, natyrisht, jo haptazi, rol që e bëri Dë Golin të mos merrte dot atë sasi votash që i duheshin për të dalë në krye edhe një herë dhe për të zbatuar atë lloj reforme që përmenda. Në këto rrrethana u largua Dë Goli.

Te ju, për shembull, ata shfrytëzuan shumë Mahatma Gandin, që zhvillonte idenë e «rezistencës pasive». Në kushtet e Indisë rol të madh ka partia juaj mark-siste-leniniste, e cila mendojmë se e ka parasysh eksperiencën shoqërore dhe historinë e lëvizjes punëtore e fshatare të Indit, të shteteve të ndryshme të vendit tuaj, shfrytëzon eksperiencën e luftërave kundër anglezëve, kundër kapitalistëve në përgjithësi, se në veçanti ka dhe duhet të ketë edhe veçori që duhen pasur parasysh, pse, siç ka qenë situata në një shtet, nuk ka qenë në shtetin tjetër, siç është sot në një shtet, nuk është në tjetrin. Duhen pasur parasysh, gjithashtu, gjithë çështjet e botëkuptimit, duke filluar që nga ai fetar, shkalla e zhvillimit ekonomik e kulturor të çdo shteti etj. Nga studimi i këtyre veçorive e kushteve rrjedh dhe qëndrimi i drejtë, konsekuent e revolucionar i partisë, mbi këtë bazë përcaktohen edhe taktika e strategjia e saj. Unë mund të gaboj, po rëndësi ka që strategjia të jetë e njëjtë, kurse për sa i përket taktikës, kjo, në të njëjtën kohë, mund të jetë e ndryshme, duke marrë parasysh kushtet e çdo shteti apo province. Partia juaj mund të përdorë një taktikë në Kalkuta, një tjetër në Bombei dhe ndryshe në Bihar etj.

Të thuhet, gjithashtu, se kudo duhet të bëhet ash-
tu siç ka bërë PPSH në kushtet e Shqipërisë, nuk
është e drejtë, nuk ecën. Për zgjidhjen e problemeve
që i dalin partisë në vendin tuaj vetëm gjykimi juaj do
të jetë më i drejtë, ndërsa gjykimi ynë edhe mund të
mos jetë i drejtë, pse duhet të jesh në Indi, ta njohësh
mirë situatën, ta kesh njohur mirë gjendjen ose pro-
blemin, pastaj të flasësh me kompetencë.

Megjithatë edhe eksperiencia e njëri-tjetrit është
një pasuri e madhe. Kur të dëshironi dhe kur të gjeni
mundësinë, mund të vini në Shqipëri, ne do t'ju presim
si miq e si shokë lufte.

Le ta pimë këtë gotë për miqësinë midis dy parti-
ve dhe popujve tanë në luftën kundër imperialistëve
amerikanë, dhe revisionistëve sovjetikë, për shëndetin e
udhëheqjes suaj, për shëndetin tuaj!

Rrugë të mbarë dhe mirupafshim! Shumë të fala
të gjithë shokëve!

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Kun-
dër revizionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 654*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 654*

PËR NJË FORMË TË NDËRMJETME MIDIS KOOPERATIVËS BUJQËSORE DHE NDËRMARRJES BUJQËSORE

Nga një bisedë¹

23 nëntor 1970

Para disa ditësh i dhashë një mendim ministrit të Bujqësisë për çështjen e organizimit të një forme të ndërmjetme të ekonomive bujqësore². Dëshiroj ta shtjelloj ca këtë mendim edhe sot.

1 Kjo bisedë u zhvillua me shokë të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Ministrave.

2 Në këtë bisedë shoku Enver Hoxha kishte parasysh formën e kooperativave bujqësore të tipit të lartë. Kjo ide filloj të zbatohej në vitin 1971 në zonat fushore të vendit. Organizimi i këtyre kooperativave, siç e përcaktoi edhe Kongresi i 6-të i PPSH, ishte me rëndësi të madhe teorike dhe praktike, ai ishte një hap i ri me përbajtje të thellë politike, ekonomike dhe shoqërore në fushën e përsosjes së marrëdhënieve në prodhim, për shpejtimin e procesit të intensifikimit të prodhimit bujqësor e blegtoral dhe për zhvillimin e pronës së grupit në rrugën e afrimit të saj me pronën e të gjithë popullit.

Nga u udhëhoqa unë në këtë çështje? Nga ajo që ne duhet të bëjmë përpjekje për të stabilizuar prodhimet bujqësore e blektorale, sidomos drithërat e bukës, bimët industriale, mishin, qumështin dhe yndyrat, duke përdorur më mirë mundësitë që janë krijuar për intensifikimin e bujqësisë.

Nuk ka asnje dyshim se në bujqësi ne kemi përparime të mëdha dhe projektplani që kemi hartuar për pesëvjeçarin e pestë jep mundësi dhe shpresat të mira për realizimin e të gjitha shifrave që kemi parashikuar, të cilat baza jo vetëm i ka pranuar, por i ka shpënë dhe më përpara, ka planifikuar dhe ka propozuar rendimente edhe më të larta nga sa i qenë caktuar. Kjo tregon se në bujqësi ekzistojnë mundësi dhe rezerva për t'i realizuar të gjitha problemet dhe rendimentet që kemi caktuar me format ekzistuese të organizimit e të drejtimit të prodhimit bujqësor.

Siq e vërteton jeta, në bujqësi ka edhe vështirësi të shumta, objektive dhe subjektive, vështirësi të punës, vështirësi organizative, vështirësi në drejtim të kuptimit të direktivave e të zbatimit të agroteknikës, vështirësi atmosferike etj. Me një fjalë, ekzistojnë një sërë faktorësh që pengojnë të kemi një prodhim bujqësor të qëndrueshëm. Detyra jonë është tani që, në mos t'i zhdukim, të paktën t'i zvogëlojmë sa më shpejt dhe sa më shumë që të jetë e mundur këto vështirësi, sepse ato e sidomos vështirësitë natyrore, ekzistojnë dhe do të ekzistojnë vazhdimesh, nuk ke si i ndalon dot. Megjithatë ka mundësi që jo vetëm vështirësive të tjera, por edhe vështirësive si: shiu, thatësira, bryma e fatkeqësi të tjera, duke marrë masa më serioze orga-

nizative t'ua zvogëlojmë sa të jetë e mundur më shumë pasojat e tyre negative.

Nga sa shohim, si kudo, ka një hov të madh revolucionar edhe në bujqësi, por me gjithë punën e mirë që po bëhet, vitet e fundit na janë krijuar deficite të ndjeshme. Këto na krijojnë vështirësi, të cilat do t'i kapërcejmë, por kjo kërkon mobilizim dhe punë krijuese e organizuese. Prandaj, duke marrë parasysh se pesëvjeçari i ri do të jetë mjaft i ngarkuar, sidomos me ndërtimë të mëdha, gjë që do ta rritë në masë të ndjeshme numrin e punëtorëve në ndërtim, të cilët vërtet do të ndërtojnë e do të mësojnë, por nuk do të prodhojnë, ndërsa do të duhet të ushqehen e të paguhen, kuptohet se gjithë furnizimet dhe të hollat për ta ne do t'i përballojmë nga të ardhurat që do të nxjerrim prej prodhimeve të industrisë aktuale dhe të bujqësisë sonë. Ndonjë shtrëngim ne, natyrisht, mund dhe duhet të bëjmë, po ligjet objektive të socializmit kërkojnë që të rritet mirëqenia e popullit. Prandaj duhet të sigurojmë sasi të mjaftueshme prodhimesh për t'i përgjigjur kërkesave të punonjësve, për ta mbajtur në një gjendje normale situatën që të mos lejojmë që në treg të mungojnë prodhimet, sidomos ato të nevojës së parë dhe të përditshme. Për të mos arritur në një situatë të tillë, ne duhet të parashikojmë me kohë masat për të përballuar normalisht nevojat në rritje të popullit, për produkte industriale, por, sidomos, për produkte bujqësore e blegtoriale.

Një çështje tjeter që më ka preokupuar, ka të bëjë me dhënien e kompetencave më të gjera komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Këtej e

tutje atyre do t'u japim në vartësi edhe NB-të e SMT-të dhe mendoj se shumë mirë bëjmë. Por në këtë situatë, kur shtrohet me të madhe edhe nevoja e shtimit të prodhimeve bujqësore e blegtoriale, kam mendimin sikur Ministria e Bujqësisë të studiojë nëse mund të krijojmë me kooperativat e mëdha fushore një formë organizative të ndërmjetme midis kooperativës bujqësore dhe ndërmarrjes bujqësore, ku të bëhen përmirësime organizative, por të ruhet parimi i pasurisë së përbashkët të grupit, pse akoma nuk ka ardhur koha që kjo të ngrihet në nivelin e pronës së të gjithë shoqërisë. Në këto momente, kur shteti është i angazhuar të bëjë investime të mëdha, duhet pasur parasysh që buxheti të mos ngarkohet me fonde e paga mbi ato që janë parashikuar. Kjo na detyron ne që ta ruajmë organizimin e pronës së grupit për kooperativat që mund të përfshihen në këtë formë të ndërmjetme, sepse ndryshe kalojmë etapat e nevojshme dhe shteti do të jetë i shtrënguar të paguajë shuma të mëdha për të shpërbllyer anëtarët e kooperativave si punëtorë të ndërmarrjes bujqësore. Po të kthehen menjëherë kooperativat në ndërmarrje bujqësore, do të thotë të vësh në duar të fshatarësise fonde monetare të mëdha që, për t'i thi-thur, do të duhet të hedhësh mallra të bollshme në treg, të cilat nuk i kemi dhe akoma nuk mund t'i sigurojmë. Veç kësaj, me këto masa do të influencohej negativisht te mjaft njerëz, pse, duke pasur të ardhura më të mëdha pa dhënë prodhimin e nevojshëm, edhe në punë mund të mos dilnin në rregull.

Për të gjitha këto arsyen, mendoj unë, të shikohet mundësia e adaptimit të një forme të ndërmjetme orga-

nizimi të disa kooperativave, duke i mbajtur ato ashtu siç janë nga pikëpamja e pronësisë, po me pjesëmarrje shtetërore, kuptimin e së cilës do ta shpjegoj më pas, pasi të shohim më parë se sa do të zgjerohemë në adaptimin e kësaj forme, pse kjo ka shumë rëndësi.

Për këtë qëllim duhet bërë, së pari, një studim se sa drithë na nevojitet për të përballuar nevojat e gjithë republikës, duke përcaktuar sa për qind duhet të marrim nga ndërmarrjet bujqësore, plus edhe nga kooperativat më të mira të fushës që do të zgjedhim e do të futen në formën e ndërmjetme të organizimit, për të garantuar më mirë nevojat për prodhime bujqësore e blegtorale si shtet. Për të siguruar këtë sasi drithi që do të përbëjë, ta zëmë, 50-60 për qind të të gjithë sasisë për të cilën ka nevojë shteti, është e domosdoshme të bëhen të gjitha përpjekjet, të përdoren të gjitha metodat e punës dhe të zbatohen plotësisht të tëra kërkesat e agroteknikës. Pjesën tjetër shteti do ta plotësojë nga të gjitha kooperativat e tjera, ku, natyrisht, do të bëhen, gjithashtu, përpjekje të vazhdueshme për shtimin e prodhimit. Krahas drithit ne duhet të llogaritim, gjithashtu, sa oriz, pambuk, lulëdielli, sa lopë do të na duhet të sigurojmë. Pasi t'i kemi bërë këto llogari, atëherë mund të veprojmë për adaptimin e këtij organizimi dhe të themi, fjala vjen, që në rrethin e Durrësit ne do të përfshijmë në këtë formë të re 4-5 kooperativa, duke ruajtur në to pronësinë e grupit, ashtu siç janë. Nevojat dhe interesat e shtetit, pra, do të na diktojnë neve se sa do të zgjerohemë në adaptimin e kësaj forme të re të ekonomisë bujqësore.

Çfarë duhet të kuptojmë me «pjesëmarrje shtetë-

rore». Meqenëse këto ekonomi janë pronë e grupit, atyre nuk mund t'u jepen SMT-të, po shteti, nëpërmjet SMT-ve, do të rritë shkallën e mekanizimit dhe do të krijojë mundësi për një intensifikim më të madh të prodhimit.

Eshtë e domosdoshme të kemi parasysh që lopët e racës që kemi importuar, në vend që t'i shpërndajmë në shumë kooperativa të republikës, t'i përqendrojmë, në radhë të parë, në këto kooperativa. Kështu duhet të veprojmë edhe me farërat më të mira etj.

Për investimet që do të bëjnë këto ekonomi, mendoj që shteti të mos japë më kredi, por ndërtesat dhe investimet në përgjithësi të bëhen me fondet e kooperativave dhe me ndihmën e shtetit në formën e pjesëmarrjes shtetërore të pakthyeshme. Natyrisht këto fonde, lopët e mjete të tjera që jep shteti si pjesëmarrje, do të janë pronë e shtetit, por që përdoret nga kooperativa në interes të shtimit më të shpejtë të prodhimit, por edhe të përsosjes së mëtejshme të marrëdhënieve ekonomike në këtë fushë. Banka Bujqësore duhet të ndërhyjë për kontroll e administrim, sikurse ndërhyjë edhe në ndërmarrjet bujqësore. Natyrisht, të gjitha këto punë do të bëhen edhe me pëlqimin e masës së anëtarëve të këtyre kooperativave, por shteti do të ketë në to edhe udhëheqjen e vet, nëpërmjet njerëzve të emëruar që do të paguhen me rrrogë nga pjesëmarrja e shtetit¹. Pra, shteti, sipas madhësisë së këtyre formave të reja të ekonomisë bujqësore, do t'u sigurojë atyre shtabin drejtues, i cili do të punojë që të vendosë atje

1 Kjo normë u zbatua deri në vitin 1977.

metodat e punës dhe të drejtimit, njëloj si në ndërmarrjet bujqësore. Me këtë formë ne do ta ruajmë asamblenë e përfaqësinë, populli do të thotë dhe duhet ta thotë atje fjalën e tij për çdo gjë dhe ne kemi nevojë për të, por aty do të thuhet edhe mendimi zyrtar i shtetit. Do të sigurohet, me një fjalë, njëfarë drejtimi i përbashkët nga kooperativa dhe nga shteti.

Në këto kooperativa do të punohet përgjithësisht sipas rregullave të ndërmarrjeve bujqësore, domethënë, do të vëmë disiplinë më të fortë në çdo gjë, do të zbatohen rreptësisht metodat agroteknike, do të shpejtohen masat për specializimin e përqendrimin e prodhimit dhe në drejtime të tjera për një punë më të organizuar, me baza më shkencore dhe me efektivitet më të lartë.

Me këtë formë organizimi, fshatarësinë do ta mësojmë gradualisht të jetë edhe më e disiplinuar si në punë, ashtu edhe në zbatimin e agroteknikës. Kjo është futur tani, djemtë dhe vajzat kooperativiste kanë mësuar dhe luftojnë për zbatimin e saj, por ndryshe është puna kur ke një organizim më të fortë e shkencor dhe u kërkon njerëzve ta zbatojnë atë më mirë dhe jo si ndodh tani në mjaft raste në kooperativë, ku fshatari shikon ditët e punës si numër dhe jo si duhet cilësinë që kërkon shërbimi i bimëve dhe i kafshëve.

Për sa u përket pagave, maksimale dhe minimale, nuk do të adaptohet sistemi i pagave i ndërmarrjeve bujqësore, por do të bëhet një kombinim i këtyre me ato të kooperativës, duke mbajtur parasysh edhe të ardhurat vjetore që anëtari do të ketë nga oborri.

Ne nuk duhet të nxitohemi për zhdukjen e oborrit gjatë zbatimit të kësaj forme të re organizimi, por do

ta porositim anëtarin e kooperativës të mbajë edhe një lopë, qumështin e së cilës mund ta përdorë si të dojë, të mbajë shpendë, të mbjellë edhe ca perime, jonxhë etj. Në disa raste anëtarët do t'i orientojmë edhe për drejtimin çfarë të prodhojnë në oborrin personal, me gjithëse të ardhurat prej tij do të janë personale. Në zbatimin e kësaj forme të re rëndësi ka çështja që të përdorim forma të tillë organizimi që asnje të mos mbetet pa dalë në punë, oborri të mos ndikojë që anëtarë i kooperativës të thyejë disiplinën e punës, përkundrazi në punë ai të dalë si punëtorët e bujqësisë.

Oborrin kooperativist do të vazhdojmë ta mbajmë edhe me këtë formë të re organizimi, por anëtarët e këtyre kooperativave nuk mund të marrin të ardhura më shumë se punëtorët e ndërmarrjeve bujqësore. Në nivelin e pagës së këtyre të fundit, mund të arrihet pasi të janë realizuar në mënyrë sistematike të gjithë objektivat për intensifikimin dhe shtimin e ndjeshëm të prodhimit bujqësor e blektoral, duke llogaritur, natyrisht, edhe të ardhurat nga oborri.

Pra, megjithëse gjendja do t'i përmirësohet fshatarit, prapë oborri i duhet atij për një përmirësim të mëtejshëm të ekonomisë së familjes së vet. Pas disa vjetësh zbatimi të këtij sistemi, atëherë mund të shihet çështja e oborrit, kurse për të tjerat do të duhet të bëhen akoma studime.

Në çështjen e planifikimit shteti, Ministria e Bujqësisë do të luajnë rol të madh dhe do të veprojnë për këto kooperativa si me ndërmarrjet bujqësore. Me formën e re do të kemi mundësi të gjera edhe për zbatimin e plotë të qarkullimit bujqësor dhe për specializim. Sy-

nimi ynë është që gradualisht në këtë lloj forme të përfshijmë fushat e mëdha e më pjellore të vendit. Pastaj përvoja do të na tregojë se si dhe ku do të shtrihemi më tej.

Mua më duket se, po ta organizojmë këtë formë ndërmjetëse në kooperativat e zonave me tokat më të mira, krijohen mundësi të stabilizojmë prodhimin bujqësor e blegtoral, të realizojmë ato që kemi vendosur dhe në të ardhmen të mos na ndodhin lëkundje të mëdha në rendimentet e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Ne nuk mund të qëndrojmë pa i siguruar shtetit fondin e domosdoshëm të drithërave, të bimëve industriale dhe të prodhimeve blegtorale. Në të vërtetë ne për këtë qëllim i krijuam ndërmarrjet bujqësore në fillim. Me këtë formë të ndërmjetme të kooperativës ne do të zgjerojmë mundësitë për prodhime më të shumta e më të stabilizuara, por hapim edhe perspektiva të reja për zhvillimin dhe përparimin e pareshtur të rendit kooperativist, në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë.

Mendoj se do të kemi avantazhe nga kjo formë, nga e cila më vonë, pa u shpejtuar dhe pa e ngarkuar shtetin me shpenzime të mëdha, të kalojmë në ndërmarrje bujqësore.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimëve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

T R E G U E S I T

TREGUESI I LËNDËS

A

Aksionet, lëvizjet dhe iniciativat revolucionare të masave — 5-6, 176, 185, 250, 318, 349-350

Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto-amerikane — 36-38, 39-42, 58-59, 84-86, 207, 214, 216-217, 268-269, 302, 332-333

Anglia — politika e jashtme; qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 58, 77, 164-165, 264, 271, 285-287

Aristokracia e klasës punëtore — 164-165, 438-439

Armiqtë e brendshëm dhe armiqëtë e jashtëm, lufta kundër tyre — 64-65, 118-119, 190, 191-192, 327-328, 334, 433-434

Arsimi — politika e Partisë për zhvillimin dhe masivizimin e tij — 6, 22-23, 108, 176-177, 182, 340-341, 424

B

Ballkani — synimet e shteteve imperialiste dhe të social-

imperializmit sovjetik ndaj Ballkanit dhe vigjilencia e popujve të këtij gadishulli — 332-333

Bashkimi Sovjetik, revisionizmi sovjetik — degjenerimi i jetës politike dhe shoqërore — 191, 201-203

— strategjia globale, politika e jashtme demagogjike, hegemoniste dhe ekspansioniste ndaj Vietnamit, popujve arabë dhe vendeve të tjera — 35-39, 54-56, 58-59, 60-62, 82-83, 196-197, 201-204, 208-209, 211, 216-218, 329, 331-332

— afrimi, lidhjet dhe bashkëpunimi me RF të Gjermanisë dhe me vendet e tjera imperialiste. Traktati sovjeto-gjerman — 40, 73-89, 209-212, 302

— qëndrimet armiqësore dhe demagogjike ndaj RPSH — 36-39, 56-57, 70-71, 194-195, 341

Blegtoria — përmirësimi ra-

cor; rritja e rendimenteve në blektori — 114-115, 447

Bujqësia

- politika e Partisë dhe ndihma e shtetit për zhvillimin e bujqësisë — 149, 174-175, 179, 442-450
- agroteknika dhe shërbimet kulturore. Ujita, mekanizimi i bujqësisë. Rendimentet e kulturave bujqësore — 113-118, 128, 150, 276, 277-280
- drithërat e bukës, bimët industriale dhe pemëtaria — 113-118, 121-122, 125, 146-152, 275
- toka, trajtimi shkencor dhe rritja e pjellorisë së saj — 117-118, 278-280

Eurokratizmi — lufta kundër shfaqjeve të tij — 19-21, 244-245, 246-248

D

Demokracia socialiste dhe demokracia borgjeze — 161-165
Dialektika materialiste marksiste — 405-406, 412, 416-421
Dokumentet historike, fototeka — vlerat, ruajtja dhe mësimdhënësia e tyre — 96-98, 100-101, 262-263, 296

E

Engels, Frederik — 3, 10, 103,

300, 401, 402-403, 406, 413-414, 417, 418, 419, 428

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 17, 48, 90, 92, 107, 130, 136, 137, 158-159, 281-284, 285-288, 294-295, 311, 314

Edukimi komunist, puna e Partisë me njerëzit — 13-24, 109-112, 140-141, 142, 167, 181-186, 301, 401, 433

Europa «sigurimi europian» — ndërhyrjet e imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik në Europë — 39-40, 41-42, 70, 73-77, 82-87, 112, 190-191, 207-208, 209-210, 211-214, 269-270, 271-272, 426-427, 436-437

F

Faktori i brendshëm dhe faktori i jashtëm; roli i tyre në jetën shoqërore — 33-35, 205, 341-343, 430

Faktori objektiv dhe faktori subjektiv; roli i tyre në jetën e shoqërisë — 401-404, 410-421

Familja socialiste — krijimi dhe konsolidimi i saj — 21-22, 93-94, 110

Feja — 92-93, 418, 434

Franca — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme — 77, 152, 165, 207, 270, 302, 436-437, 439-440

Fshatarësia, fshatarësia koooperativiste; politika dhe kujdesi i Partisë për të — 116-117, 173-174, 338-339, 436

G

Gruaja dhe BGSH — politika e Partisë për emancipimin e gruas — 91, 94, 110, 155-157, 185, 392-396

GJ

Gjermania — problemi i traktatit të paqes me Gjermaninë — 75-82, 89, 209-211

— Republika Demokratike Gjermane në pazarllëqet sovjeto-gjermane — 78-79, 210-211

— Republika Federale e Gjermanisë — politika e ekspansionit dhe synimet gllabëruces ndaj RD Gjermane — 73-89, 210-211, 212-213, 267, 438-439

H

Historia e popullit shqiptar dhe e kulturës së tij — 59-60, 183, 404-405

Historia, kuplimi marksist-leninist i saj — 401-402, 405-406, 413-414

I

Idetë dhe roli i tyre — 412, 414-416

Imperializmi — strategja globale; bashkëpunimi dhe kontradiktit midis shteteve imperialiste — 84-85, 87-89, 197-198, 203-204, 208, 215-216, 271-272, 302

India, Partia Komuniste (m-l) e Indisë — 426, 427-428, 429, 431, 434-435, 440-441

Industrializimi socialist i vendit. Zhvillimi, modernizimi i industrisë — 170-173, 178-179, 307-308

— industria minerale, ajo e naftës dhe e gazit. Industria elektrike dhe elektrifikimi i vendit — 108, 126-127, 128-129, 171-172, 230-235, 307, 420-421

— industria mekanike; prodhimi në vend i pjesëve të ndërrimit dhe i makinave — 172-173, 307-308

— industria e lehtë dhe ushqimore, zhvillimi i saj — 152, 173

Iniciativa, vetëveprimi — 29-30, 237-238, 349-351

Intelektualizmi dhe teknokratizmi; lufta kundër shfaqjeve të tyre — 243-257

Investimet; politika e Partisë në këtë fushë — 348, 447
Italia, gjendja e brendshme dhe politika e jashtme — 265-266, 436-437

J

Jugosllavia — lidhjet dhe bashkëpunimi me imperializmin amerikan; marrëdhëniet dhe kontradiktat me revolucionistët sovjetikë — 42-43, 270-271, 303, 329-331, 332-334

K

Kapitalizmi. Marrëdhëniet kapitaliste në prodhim; kriza politike dhe ekonomike. Kontradiktat në gjirin e tij — 92, 162-165, 171-172, 177, 187-188, 190-191; 197-198, 203-204, 215-216, 232, 407-409, 438-440

Këshilli i Ministrave i RPSII (Qeveria) — 27, 41, 118, 177, 188, 233, 241, 352, 365-366

Klasa punëtore — roli i saj në ndërtimin socialist të vendit. *Edukimi dhe përmirësimi i kushteve të punës* — 17-18, 169-170, 306-307, 357, 436

Kodi i ri Penal

Shih: Legjislacioni. Kodi i ri Penal

Komunisti — cilësitë, detyrat

dhe revolucionarizimi i komunistëve; edukimi i tyre — 8-9, 104-105, 308, 394, 399-400, 402-403

Komunizmi — 106

Kontradiktat si burim zhvillimi — 411-412, 415-416

Kolektivizimi socialist i bujqësisë

— politika e Partisë për kolektivizimin e bujqësisë — 173-174, 338-339, 418-420

— organizimi dhe drejtimi i punës në kooperativat bujqësore. *Kuadrot e tyre* — 11-12, 123-124, 258-261, 448

— organizimi i një forme të ndërmjetme midis kooperativës bujqësore dhe ndërmarrjes bujqësore — 442-450

Kuadrot — metoda e punës, përgatitja, kualifikimi dhe qarkullimi i tyrc. *Marrëdhëni kuadër-masë* — 20, 141, 142-144, 182, 241-242, 250-257, 316-317, 339, 386, 387-389

Kultura dhc arti, kultura dhe arti popullor — zhvillimi i tyre — 183, 354-355, 356, 357

L

Legjislacioni. Kodi i ri Penal — 339-340, 379-384, 411

Lenin, Vladimir Iliç — 3, 34, 38, 42, 103, 185, 202, 406, 427, 428, 435

Letërsia dhe artet; politika e Partisë për revolucionarizmin e tyre. Shkrimtarët dhe artistët-nxënës dhe mësues të masave — 183, 353-358

Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombe të — domosdoshmëria e krijimit të partive të reja m-l; roli udhëheqës dhe organizues, strategjia dhe taktika, puna e tyre me sindikatat — 3-4, 197-198, 429-433, 436-438, 440-441

Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare, revolucionare e përparrimtare të popujve të botës — 41-42, 51, 53-54, 214-215, 217-218, 336, 429-430

Ligjet ekonomike të socializmit, njohja dhe zbatimi i ndërgjegjshëm i tyre — 169-170, 385-391

Ligjet objektive të shoqërisë dhe të natyrës, njohja dhe zbatimi i ndërgjegjshëm i tyre — 10-11, 401-402, 407-408

Lindja e Mesme — synimet grabitqare të shteteve imperialiste e të socialimperializmit sovjetik dhe qëndresa e popujve të këtij rajoni kundër tyre — 36, 56, 58-59, 63-64, 268

Luftha Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar — roli udhëheqës i Partisë, përvaja, mësimet dhe rëndësia e saj — 47-50, 68-69, 104-107, 342, 432-434, 436

Luftha e PPSH dhe e forcave marksiste-leniniste kundër imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit — 32-33, 38, 42-43,

56, 64-65, 71-72, 194-196, 198, 199, 205, 206-207, 208-209, 333-334, 406-407, 423, 427, 428-429

Luftha — shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të saj — 190-191, 200, 203-204

M

Marksizëm-leninizmi — armë dhe busull për udhëheqje e reprim, studimi dhe zbatimi i tij në kushte konkrete — 103-104, 187, 190, 301, 338-339, 344-345, 350, 398-425

Marks, Karl — 3, 103, 299, 300, 304, 400, 401, 405, 406, 408, 409, 410, 412, 413, 414-415, 416, 417, 418, 419, 428, 435, 436

Mbëshitetja në forcat e veta — 205, 342-343, 347, 430

Mbrojtja e atdheut — përgatitja e ushtrisë dhe e popullit për mbrojtje — 64-65,

118-119, 185-186, 195, 371,
373-376

N

Mendimi si pasqyrim i realitetit objektiv — 9-10

Ministrítë, kuadrot — kompetencat, metoda e punës së tyre — 248-249, 251-255, 350, 351-352

— Komisioni i Planit të Shtetit — 253-254, 352

— Ministria e Bujqësisë — 445, 449

— Ministria e Mbrojtjes Popullore. Kritikë kundër të metave dhe gjendjes jo të shëndoshë në këtë Ministri — 359-363, 372, 377-378

— Ministria e Punëve të Brendshme, organet e punëve të brendshme dhe kuadrot e tyre — 236-242, 383

— Ministria e Shëndetësisë — 254

— Ministria e Tregtisë — 228, 254-255

Mirëqenia materiale dhc ngri-tja e nivelit kulturor — rrugët dhe treguesit e rrithjes së saj — 156-157, 175-176, 180, 304, 348-349, 444

Monumentet e kulturës — ruajtja dhe mirëmbajtja e tyre — 97-98, 137-138, 295

Ndërgjegjja socialiste — forcimi i saj — 14

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit — 1-6, 91-92, 93, 105-110, 180-187, 327-328, 337-341, 344-345, 409-411, 422, 450

Ndihmat midis shteteve.

Ndihmat e shteteve imperialishte e revizioniste dhe qëllimet grabitqare të tyre — 33-36, 38-39, 54-56, 341-343

NJ

Njeriu — kujdesi i Partisë për edukimin, shëndetin dhe zhvillimin e gjithanshëm të tij — 92-93, 94-95, 99, 106-108, 156-157, 167, 273-274, 287-288

Njohja — 400, 407-411, 416-417, 421-422, 423-424

O

Organizata-bazë e Partisë, revolucionarizimi i saj — 8, 366, 368

Organizimi socialist i punës dhe përsosja e vazhdueshme e tij — kuptimi teorik dhe praktik i organizimit të punës — 5-13

P

*Palestina, palestinezët — luf-
ta nacionalçirimitare e popu-
llit palestinez kundër push-
tuesve izraelitë, imperialistë-
ve dhe reakzionit arab —
45, 46-47, 50-54, 57-58, 60-
-66, 68, 218, 324, 325-326*

*Paqja — kuptimi m-l i paqes
dhe i bashkëekzistencës pa-
qësore — 34, 70, 87, 199-201*
Partia e Punës e Shqipërisë

- kushtet e krijimit të Partisë. Themelimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Tiparet marxiste-leniniste revolu-
cionare të saj — 133, 139, 159
- roli udhëheqës i Partisë;
vendime e direktiva të saj, njojja dhe zbatimi i tyre — 7-9, 24-25, 29,
328, 336-337, 365-366, 397,
429
- kuptimi dhe rëndësia e organizimit dhe e drejtimit të punës së Partisë.
Përsosja e vazhdueshme e tyre — 1-30, 388
- Kongresi i 5-të i PPSH — 162, 168
- Kongresi i 6-të i PPSH — 29, 162
- Komiteti Qendror, Byro-

- ja Politike — 27, 168,
169, 177, 259, 328-329, 359,
384
- Plenumi i 8-të i KQ të PPSH (26-28 qershor 1969) — 176
- Plenumi i 10-të i KQ të PPSH — (25-26 qershor 1970) — 1-30
- Komitetet e Partisë të rrëtheve Gjirokastër, Kor-
çë dhe Tiranë — 244,
248, 258, 259, 261
- komitetet dhe organiza-
tat e Partisë në ushtri — 366-369, 372-373

*Peshkimi, rritja dhe shtimi i peshkut; studimet shkencore
në këtë fushë. Gjuetia —
136-137, 152-154, 222-229*

Planifikimi

- metodologja e planifikimi-
mit, pjesëmarrja e ma-
save në hartimin e pla-
neve — 27-29, 118, 122-
-123, 177-178, 347-352
- plani i katërt, i pestë
dhe ai i gjashtë pesëvje-
çar; detyra dhe arritje të
tyre — 25-29, 122-123,
126-129, 140, 162, 168-
-180, 222, 228-229, 285,
294, 308, 345, 347-352,
443, 444

Politika e jashtme e RPSH
— parimet themelore të po-
litikës së jashtme. Rrit-

- ja e prestigjit dhe e autoritetit të RPSH në botë — 53-54, 187-189, 191-192, 193, 200-201, 205-207, 208, 212-214
- marrëdhënet me Jugosllavinë, Greqinë dhe me vende të tjera — 110-112
- qëndrimi parimor m-1 ndaj kosovarëve dhe shqiptarëve të tjerë që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi — 66
- përkrahja për Vietnamin — 31-36, 40-42, 43-44, 219
- përkrahja për lëvizjen e çlirimit të Palestinës dhe për popujt arabë. Marrëdhënet me Kongon (Brazavil) — 45-47, 50-53, 54-55, 57-59, 60-62, 63-64, 65-66, 67-72, 217-218, 335, 340, 341, 343-346

Populli shqiptar — virtytet moralo-politike, traditat patriotike, të punës dhe kulturore të tij. Lëvizjet dhe lushterat e tij për liri, pavarësi e përparim shoqëror — 18, 68-69, 102-103, 109, 165-167, 180, 354, 400, 416-417

Prodhimi material — bazë e zhvillimit të shoqërisë — 299-300, 412-415, 417-421

Proletariati — roli hegemon dhe domosdoshmëria e organizimit të tij në revolucion — 3-4, 300, 410, 436-438

Prona

- prona e grupit (kooperativiste); shndërrimi gradual i saj në pronë të të gjithë popullit — 445-450
- oborri kooperativist, politika e Partisë për zvogëlimin dhe për zhdukjen e tij — 419-420, 448-449

Propaganda dhe shtypi borgjezo-revisionist — 80, 83-85, 112, 192-193, 204, 264, 319-322, 334, 434

Propaganda, shtypi. Propaganda e prodhimit; përhapja e përvojës së përparuar — 20-21, 24-25, 28, 124-125, 157

Puna — kuptimi, roli dhe rëndësia e saj — 92, 94, 178-179, 183-184, 299-300, 412-413

Pushteti popullor — roli dhe detyrat e tij në shndërrimet ekonomiko-shoqërore dhe në ndërtimin socialist të vendit — 337-338, 444-445

Q

Qenia shoqërore dhe raporti i saj me ndërgjegjen shoqërore — 411-412, 414-420

R

Revizionizmi modern — roli sabotues i tij ndaj revolucionit dhe luftës çlirimtare të popujve. Lufta e tij kundër PPSH dhe RPSH — 70-71, 187-188, 202, 406, 434-435, 438

Revolucionarizimi i jetës së vendit — 415-416, 420-421
Revolutioni proletar, rrugë e vetme për fitoren e socializmit. Forcat lëvizëse të tij. Kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizoniste për rrugën paqësore të kalimit në socializëm — 189-190, 197-198, 299, 300-301, 427-428, 435-436

Revolucioni tekniko-shkencor; kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizoniste për këtë revolucion — 299, 300-301

Rinia — traditat patriotike, edukimi dhe roli i saj në ndërtimin socialist të vendit — 93, 141-142, 155-157, 166-167, 185, 339

Rumania — rivendosja e kapitalizmit dhe lidhjet e saj me imperializmin — 41, 303-304, 331-332

S

Stalin, Josif Visarionoviç — 3, 34, 77, 103, 131, 406, 428

Strehimi i popullsisë, ndërtimi i banesave — 123, 176, 308-309, 317-318

SH

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme e luftës dhe e ekspansionit — 37, 58, 77, 82-83, 163-164, 190-191, 198-199, 214-215, 264-272, 329
Shkenca. Shkencat shoqërore dhe teknike; përvetësimi dhe zbatimi i tyre. Studimet ekonomiko-shoqërore — 11, 169-170, 299-300, 301, 329, 390-391

T

Teoria dhe praktika. Lidhja ndërmjet tyre — 375, 386-387, 400, 404, 422-423

Të huajt, miqtë, dashamirët për PPSH dhe RPSH — 192-193, 220, 290-297, 320-321

TH

Thelbi dhe shfaqja — 407-410

U*Ushtria Popullore*

— roli udhëheqës i Partisë në ushtri. Forcimi dhe konsolidimi i saj — 360-

- 361, 368-369, 376
 - kuadrot e saj; harmonizimi i kuadrove të vjetër ine kuadro të rinj. Marrëdhëniet kuadër-ushtar — 22-23, 316-317, 360-361, 363-364, 365-366, 367, 368, 369-370
 - përgatitja ideopolitike e ushtarake — 362-364, 365, 373-376
 - disiplina dhe urdhrat ushtarakë; zbatimi i tyre. Vigjilencia, sekreti ushtarak — 364, 365-366, 370-373
- Shih edhe: Ministratë... — Ministria e Mbrojtjes Popullore. Kritikë kundër të metave dhe gjendjes jo të shëndoshë në këtë Ministri'*

V

Vendet arabe; historia e popujve arabë — 42, 45-46, 52-

- 53, 65-66, 69-70, 217-219, 324-326

Vendet revizioniste — 38-39, 191, 196-197, 201-202, 322, 427

Vietnam — luftha e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë dhe politikës demagogjike të revizionistëve sovjetikë — 31-36, 37, 41-42, 43-44, 55-56, 219

Vija e masave, lidhjet me masat, dëgjimi i zërit të masave — 247-248, 260-261, 336, 383

Z

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor, këshillat popullore dhe gjykatat popullore — 24-25, 160-162, 220-221

ZH

Zhvillimi dialektik i shoqërisë — 401-402, 410-414, 416-421

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 390

Arafat, Jaser — 72

Aristotel — 46

Asllani, Asllan dhe Haxhi
(vëllezërit) — 282

B

Bajraktari, Ajdin — 313, 314,
315

Balluku, Beqir — 372, 377

Bilbili, Abdurrahim — 139-
-140, 142-144

Brand, Vili — 85, 86

Bratko, Idhomene — 90, 92,
94, 95

Brezhnjev, Leonid — 39, 77,
82, 209, 212, 427, 428

Buhali, Larbi — 62

Bumedien, Huari — 59

C

Cfiri, Tefik — 286

Curri, Bajram — 313

C

Çarçani, Adil — 230

Çela, Aranit — 383
Çako, Hito — 363, 372, 377
Çaushesku, Nikolac — 331-332

D

Dode, Petro — 227

Dajan, Moshe — 62, 218

Dange, Shripad — 434

Dë Gol, Sharl — 439-440

Dë Kastër — 34

Dubçek, Aleksandër — 209

Dume, Petrit — 361-362, 363,
367-368, 370, 372, 373-374,
377

F

Faisal, (mbreti i Irakut) —
52-53

Franko, Francisko — 265, 267

G

Gambeta, Afka — 393

Gambeta, Afrovti — 137

Gambeta, Nesti — 135-136

Gambeta, Vladimir — 136

Gandi, Indira — 428, 435

Gandi, Mahatma — 429, 440

Gérmenji, Evdhoksi — 96-98

- Gérmenji, Themistokli — 96-
-98
- Grameno, Androniqi — 99-101
- Grameno, Dhimitër — 100-101
- Grameno, Mihal — 99-101
- Greçko, Andrei — 212
- Gromiko, Andrei — 60-61, 80
- Guri, Spiro — 145-146
- Gurion, Ben — 62
- GJ**
- Gjermenji, Rrapi — 273-277
- H**
- Hoxha, Nexhmije — 90, 96,
134, 137, 294-295, 296, 315
- Hoxha, Ilir — 294
- Hoxha, Pranvera — 292, 295
- Hoxha, Sokol — 107, 294-295
- Hanku, Rrahman — 317
- Ho Shi Min — 31
- Hitler, Adolf — 74, 213
- Hrushov, Nikita — 39, 70-71,
76, 201
- Hysein, Abdullah — 42, 52-
-53, 61, 63, 71, 324, 326
- J**
- Jaring, Gunar — 36, 216
- K**
- Kapo, Hysni — 368
- Kadare, Ismail — 320-321
- Karame, Rashid — 57
- Kavo, Hulusi — 290-291, 292,
293, 294, 296, 297
- Kavo, Liri — 290, 291-292,
293-295, 296, 297
- Kavo, Tahir — 296
- Kavo, Violeta — 290, 291, 292,
293, 295-296, 297
- Kodheli, Riza — 283-284
- Kosigin, Aleksei — 39, 74, 77,
78, 82, 209, 427, 428
- Kote, Spartak — 311
- Kraja, Fadil — 262
- Kristo, Alqi — 132
- Kristo, Pandi — 133
- Kupi, Abaz — 49
- Kushi, Vojo — 159
- L**
- Lako, Miha — 130-134
- Lavrens, Tomas — 63, 324
- Lon Nol — 38, 219
- M**
- Marko, Rita — 366, 368
- Myftiu, Manush — 246, 248,
351
- Malaj, Nurije — 314
- Malaj, Qazim — 283
- Maknamara, Robert — 303,
330
- Mame, Misto — 159
- Manegati, Luciano — 321
- Mara, Hekuran — 390
- Marubi, Gegë — 262-263
- Marubi, Kel — 262
- Masari — 70-71

Mejer, Golda — 62
 Myslimi, Ilmi — 283, 285, 288
 Myslimi, Mehmet — 281-286,
 287-289

N

Nushi, Gogo — 159
 Nesho, Gaqo — 390-391
 Naser, Gamal Abdel — 59, 325
 Ngjela, Kiço — 254
 Nikolla (Knjaz i Malit të Zi)
 — 60
 Nikson, Riçard — 36, 264-272,
 329, 330, 331, 332, 428
 Nishani, Omer — 283
 Nishova, Mane — 324
 Noli, Fan S. — 101

P

Platon — 46
 Polo, Ervehe — 318
 Pompidu, Zhorzh — 440

R

Reka, Tatjana — 310, 324
 Rexha, Lumturi — 323-324
 Rexha, Shaban — 323, 324
 Ribiçiç, Mita — 329-330
 Roxhers, Uiliam — 60-61

S

Said, Nuri — 53
 Saragati, Xhuzepe — 265, 266
 Sazanov, Sergei — 60

Sihanuk, Norodom — 37
 Sokrat — 46
 Stafa, Qemal — 159

SH

Shanto, Vasil — 159
 Shabani, Ali — 314, 315
 Shabani, Gjykë — 314
 Shahollari, Zenun — 122
 Shamblli, Peti — 147, 151, 153

T

T., Gjik — 126
 Tërpo, Nesti — 152-154
 Tisen — 439
 Tito, Josip Broz — 42, 43, 66,
 112, 265, 270-271, 302, 303,
 329, 330-331, 332, 333, 430
 Treska, Aleksandra — 93

TH

Themeli, Palo — 145-152
 Theodhosi, Koço — 225, 228,
 249

V

Vullkani, Sotir — 133

X

Xoxe, Koçi — 133
 Xoxe, Niko — 133

Z

Ziçishti, Mihallaq — 125
 Zogu, Ahmet — 53, 103, 163

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Afrikë — 36, 40, 41, 58, 212,
217, 265, 303
Agjencia franceze e lajmeve
— 80
«Al Fatah» (organizata) —
47, 50-51, 52, 63-64
Algjeri — 59, 62, 325
Amfiteatri i Durrësit — 225
Amerika Latine — 40, 41
Ansambli Shtetëror i Këngëve
dhe i Valleve Populllore — 320
Austri — 74, 436-437
Azi — 40, 85, 217

B

- Banka Bujqësore — 447
Beduinët e Arabisë — 324-325
Berat — 137-138, 385
Berlin — Berlini Perëndimor
— 81-82
Biblioteka Kombëtare — 100-
-101
Boshti «Romë-Berlin» — 266
Bretanjë (Francë) — 152

C

- CIA — 213-219

Ç

- Çekosllovaki — 83, 84, 111,
202, 208, 209, 211

D

- Dalmaci (Jugosllavi) — 332-
-333
Deti Adriatik — 333
Deti Mesdhe-
ut — 56, 58, 87, 264-265, 267,
268, 269, 271-272, 302
Devoll, fusha e Devollit —
102-103, 113-118, 126, 130-131,
141
Dibër — 279, 292
Dien Bien Fu (Vietnam) — 34
Dragobi (Tropojë) — 314, 315
Durrës — 12, 193, 296

E

- Egjipt — 36-37, 56
Elbasan — 156, 193

F

- Fabrikat e çimentos — Fu-
shë-Krujë, Elbasan — 129
Finlandë — 41
Flota e G-të Amerikane — 264,
265, 267, 268-269, 272, 333

Flota sovjetike në Mesdhe —
268-269, 333

Fusha e Myzeqesë — 115

G

Greqi — 110-111, 342

Grupi i «Të rinjve» — 133

Grupi Komunist i Korçës —
133

GJ

«Gjenerali i ushtrisë së vdekur» (libri ~, Ismail Kadarë) — 320-321

Gjirokastër — 136, 137-138,
140-141, 147, 291, 294, 296

H

Hekurudha Rrogozhinë-Fier
— 292

Helmës (Skrapar) — 282, 283,
288

Hidrocentrali i Fierzës — 178,
315

Hidrocentrali i Vaut të Dejës
— 126, 178

Hungari — 332

I

Indokinë — 32, 33, 37-38, 87,
212, 219

Instituti i Studimeve Ekonomike — 389

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste — 389

Instituti i Studimeve të Naf-

tës dhe të Gazit dhe ai i
Gjeofizikës — 234

Itali — 104, 165, 264, 265, 287,
436-437

Intelixhens Servis — 271, 324

Irak — 59, 325

Izrael — 36, 50, 56, 62

J

Jordani — 42, 52, 57, 70-71

K

Kamboxhia — 32, 37-38, 41,
219

Kanali i Suezit — 218

«Kapitali» (libri ~, Karl
Marks) — 409

Kinë — 46, 212, 217, 219, 329,
347

«Koha» (gazeta ~) — 100-
-101

Kombinati metalurgjik i he-
kur-nikelit — Elbasan — 173,
307

Konferenca e Ambasadorëve
e Londrës e vitit 1913 — 60

Konferenca e Jaltës dhe ajo e
Potsdamit (1945) — 76

Konferenca e Shteteve të In-
dokinës — 37

Kongo (Brazavil) — 335, 336,
341, 343-344, 345-346

Kongresi i Përmetit (24 maj
1944) — 287

Kooperativa Bujqësore —
Vranisht - Korçë — 130

Kooperativa bujqësore e bash-

kuar «Skënderbeu» — Devoll
 -Korçë — 102, 116-118, 119-
 -120, 121-126
 Kooperativa e bashkuar «Partizani» — Picar - Gjirokastër
 — 258-261
 Korçë, fusha e Korçës — 90-
 -91, 92-93, 103-104, 125-126,
 131, 136, 137-138, 140-141,
 145, 284, 296
 Kosovë — 60, 66, 314
 Kroaci — 330, 332
 Kufiri Oder-Najse — 211
 Kurbatët — 140-141
 «Kur lindi Partia (Kujtime)»
 (libri ~, Enver Hoxha) — 133
 «Kur u hodhën themelat e
 Shqipërisë së re» (libri ~,
 Enver Hoxha) — 282

L

Laç (Krujë) — 295
 Laos — 32, 37, 41
 «Lejbër parti» (partia labu-
 riste) — 164-165
 Libi — 58
 Lidhja e Shkrimtarëve dhe e
 Artistëve të Shqipërisë —
 353-354
 Lindja e Afërt — 217
 Lufta Ballkanike (1912-1913)
 — 59-60
 Lufta e Dytë Botërore (1939-
 1945) — 74-75
 Lumi i Drinos (Gjirokastër)
 — 136
 Lushnjë — 116, 274-277

M

Malet e Dragobisë — 17
 Mali i Zi — 60, 66, 330
 Maqedoni — 66, 330
 Marrëveshja (Traktati) e Mu-
 nihut — 74-75, 211
 Medinë (Arabia Saudite) —
 52, 325
 Mekë (Arabia Saudite) — 325
 Moskë — 62, 73, 79

N

Napoli — 264
 NATO — 82, 83, 208, 212, 267,
 269, 270, 271
 Ndërmarrja Bujqësore e Dvo-
 ranit - Korçë — 145-152
 Ndërmarrja Bujqësore e Lla-
 katundit-Vlorë — 115
 Norvegji — 41

O

OKB — 62, 216

P

Pakti Briand-Kellog — 213
 Perandoria Otomane — 59-60
 Peshkopi — 317-318
 Përmet — 287
 «Plani Roxhers» — 58-59, 60-
 -61, 218, 268
 Poloni — 211

Q

Qeveria e RPSH — 27, 41,
116, 118, 174, 177, 188, 233,
241, 253, 352, 365-366

R

Reforma Agrare në RPSH —
49, 338, 339, 418, 419

Rusia cariste — 60

S

Serbi — 60, 330, 332

Siri — 36, 59, 325

Skrapar — 285

Sloveni — 330

Spanjë — 46, 264, 265, 266-
-267

Stacioni i Kërkimeve Shkencore
të Peshkimit — Durrës
— 225

Suedi — 41

SH

«Shkëndijat» (romani ~,
Alqi Kristo) — 132

Shkodër — 12, 60, 226, 262,
296

Shkolla e Partisë «V.I.Lenin»
— 397-399, 422-425

Shkolla trevjeçare e mamive
— Elbasan — 155-157

T

Tiranë — 26, 158-159, 169, 193,
255, 297, 314-315, 317

Traktati i Varshavës — 82,
202, 208-209, 211, 271

Tregu i Përbashkët Evropian
— 83-84, 212-213

Tropojë — 17, 313-314, 315

U

Universiteti Shtetëror i Tiranës — 292-293, 341

Uzina «Dinamo», «Partizani»
dhe ajo e Traktorëve — 307

Uzina e Përpunimit të Thellës
të Naftës — Ballish — 178,
307

V

Vlorë — Porti dhe Baza Ushtarake
e Vlorës — 38, 56, 129

Vodicë (Kolonjë) — 311

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~)
— 12, 112, 262

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 44-t V-IX

1970

MBI KUPTIMIN TEORIK E PRAKTIK TË ORGANIZIMIT TË PUNËS — Fjala e mbylljes në Plenumin e 10-të të KQ të PPSH (26 qershor 1970)	1—30
PAS «NDIHMËS» SOVJETIKE FSHIHET NJË DEMAGOGJI E RREZIKSHME E REVIZIONISTËVE HRUSHOVIANË — Nga biseda me një delegacion të Asamblesë Kombëtare të Republikës Demokratike të Vietnamit (27 korrik 1970)	31—44
VËSHTIRËSITË KAPËRCEHEN DHE FITORJA ARRIHET VETËM ME NJË VIJË POLITIKE TË DREJTË E ME UNITET TË SHËNDOSHË — Nga biseda me një delegacion të Lëvizjes për Çlirimin Kombëtar të Palestinës «Al Fatah» (3 gusht 1970)	45—72
TRAKTATI SOVJETO-GJERMAN — NJË KOMPLOT I RREZIKSHËM KUNDËR POPUJVE TË EVROPËS DHE GJITHË BOTËS — Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit» (22 gusht 1970)	73—89
NË SUKSESET E PUNËS ME NJERËZIT QËNDRON FORCA E IDEVE TË PARTISË — Nga biseda me patriotin Idhomene Bratko (26 gusht 1970)	90—95

LUFTA E THEMISTOKLI GËRMENJIT FRYMË-ZON GJITHË BREZAT — Nga biseda me shoqen Evdhoksi Gërmjenji (26 gusht 1970)	96—98
PËR DOKUMENTET ME VLERË HISTORIKE ËSHTË E INTERESUAR TËRË SHOQËRIA — Nga biseda me shoqen Androniqi Grameno (26 gusht 1970)	99—101
RRITJA E RENDIMENTEVE KËRKON DIJE DHE PUNË TË PALODHUR — Fjala në mitingun e organizuar në kooperativën bujqësore të bashkuar «Skënderbeu» të Devollit (27 gusht 1970)	102—120
TË NDËRTOJMË ATË METODË PUNE QË U PËRSHTATET MË MIRË DETYRAVE TË KOHËS — Nga biseda në drekën e shtruar në kooperativën bujqësore të bashkuar «Skënderbeu» të Devollit (27 gusht 1970)	121—129
TY TË KEMI KOMUNIST VETERAN — Nga biseda me shokun Miha Lako (27 gusht 1970)	130—134
NGA ZEMRA JEMI E DO TË JEMI PËRHËRE PROLETARE — Nga biseda me shokun Nesti Gambeta (27 gusht 1970)	135—138
KURRË TË MOS CENOHERET DIKTATURA E PROLETARIATIT — Nga biseda me shokun Abdurrahim Bilbili (27 gusht 1970)	139—144
KËTU MËSUAM SHUMË GJERA TË MIRA — Nga biseda me kuadrot drejtues të Ndërmarrjes Bujqësore të Dvoranit në rrethin e Korçës (28 gusht 1970)	145—154
BASHKË ME DETYRËN SI MAMI TË JENI EDHE AGJITATORE TË ZJARRTA TË PARTISË — Letër drejtuar 40 vajzave të rrethit të Elbasanit që mbaruan të parat shkollën trevjeçare të mameve (12 shtator 1970)	155—157

NË UNITETIN E PLOTË PARTI-POPULL-PUSH-TET QËNDRON FORCA JONË — Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës elektorale nr. 219 (18 shtator 1970)	158—221
PROBLEMEVE TË PESHKIMIT T'U HYJMË THELLË E SHKENCËRISHT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shtator 1970)	222—229
NAFTA DHE GAZI NDODHEN NËN TOKË, POR GABIMET NË PUNË DUKEN SHESHIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shtator 1970)	230—235
KUDO TË NGRIHET VIGJILENCA, GATISHMËRIA TË JETË E PLOTË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shtator 1970)	236—242
SHFAQJEVE TË INTELEKTUALIZMIT DHE TË TEKNOKRATIZMIT T'U BËHET NJË LUFTË E VAZHDUESHME — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 shtator 1970)	243—257
PARTISË I DUHET UNITET I VERTETË, JO UNITET FALS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 shtator 1970)	258—261
GJEST PATRIOTIK QË E ÇMON SHUMË JO VETËM POPULLI I RRETHIT TË SHKODRËS, POR EDHE I GJITHË SHQIPERISË — Letër drejtuar fotografit Gegë Marubi (29 shtator 1970)	262—263
Ç'KËRKON NIKSONI NË EVROPE? — Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit» (30 shtator 1970)	264—272
RRITJA E PRODHIMIT BUJQËSOR KËRKON NJË GJENDJE TË MIRE TË TRANSPORTIT — Nga biseda me shokun Rrapi Gjermeni (2 tetor 1970)	273—280

TI JE NJË PATRIOT I NDERUAR, PAÇ PLEQËRI TË BARDHË! — Nga biseda me patriotin Mehmet Myslimi dhe me djalin e tij Ilmi Myslimi (8 tetor 1970)	281—289
ATDHEU YNË, NË KRAHASIM ME TË KALUA- RËN, KA NDRYSHUAR SI DITA ME NATËN — Nga biseda me Liri e Violeta Kavon (12 tetor 1970)	290—297
ZHVILLIMI I REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKEN- COR DUHET PARË KURDOHERË NË PRIZMIN KLASOR REVOLUCIONAR — Nga biseda me dele- gacionin e Akademisë së Shkencave dhe me dele- gacionin e punonjësve të shtypshkronjave të RP të Kinës (13 tetor 1970)	293—305
INDUSTRIA JONË DO TË BËHET MË MODERNE — Nga biseda me një grup punëtorësh të Tiranës (16 tetor 1970)	306—309
TË MËSONI MIRE NË SHKOLË — Nga biseda me një grup fatosash, pionierësh dhe të rinjsh të Tiranës dhe të Durrësit (16 tetor 1970)	310—312
TË PUNOJMË ME TË GJITHA FORCAT QË TË REALIZOJMË VEPRA TË REJA — Nga biseda me një grup kooperativistësh të Tiranës dhe të Tro- pojës (16 tetor 1970)	313—315
ÇDO GJË TA BËJMË ME FRYMË REVOLUCIO- NARE — Nga biseda me një grup ushtarakësh (16 tetor 1970)	316—318
VEPRAT E SHKRIMTARËVE DHE TË ARTISTËVE TANË QËNDROJNË LART — Nga biseda me një grup punonjësish të artit dhe të kulturës (16 tetor 1970)	319—322

TE POPUJT ARABË ËSHTË I MADH ZJARRI I LUFTËS PËR ÇLIRIM — Nga biseda me kuadro të aparatit të Kryeministrisë, të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës dhe me disa patriotë pensionistë (16 tetor 1970)	323—326
ARMIQITË DO TI DEMASKOJMË EDHE NË TË ARDHIMEN — Nga biseda me të ngarkuarin me punë a.i. të ambasadës së RP të Kinës në Tiranë (16 tetor 1970)	327—334
PARTIA MARKSISTE-LENINISTE, DUKE U MBË-SHTETUR TE MASAT, I SIGURON LIRINË POPULLIT DHE PAVARËSINË ATDHEUT — Nga biseda me një delegacion të Republikës Popullore të Kongos (Brazavil) (17 tetor 1970)	335—346
REALIZIMI I PLANIT ARRIHET ME NJË ORGANIZIM TË PËRSOSUR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 tetor 1970)	347—352
SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT TANË JANË NJË HERËSH NXËNËS E MËSUES TË MASAVE PUNONJËSE — Përshëndetje e Komitetit Qendorr të PPSH drejtuar shkrimtarëve dhe artistëve (22 tetor 1970)	353—358
UDIIËHEQJA E MINISTRISË SË MBROJTJES TË ANALIZOJË MIRË GJENDJEN E KRIJUAR NË DIKASTER — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 tetor 1970)	359—378
KODI I RI PENAL TË PASQYROJË SI DUHET ETAPËN E RE TË SHOQËRISË SONË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 tetor 1970)	379—384
NJOHJA E LIGJEVE EKONOMIKE KA EFEKT KUR SHOQËROHET ME ZBATIMIN E TYRE NË JETË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 tetor 1970)	385—391

TË BËJMË MË SHUMË PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË GRUAS NË SHOQËRI E NË FAMILJE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 tetor 1970)	392—396
TË MËSOJMË TEORINË MARKSISTE-LENINISTE NË LIDHJE TË NGUSHTË ME PRAKTIKËN REVOLUCIONARE — Fjala në mbledhjen jubilare me rastin e 25-vjetorit të krijimit të Shkollës së Partisë «V. I. Lenin» (8 nëntor 1970)	397—425
T'U KUNDËRVËMË FUQIMISHT TAKTIKAT TONA REVOLUCIONARE TAKTIKAVE REAKSIONARE TË BORGJEZISË KAPITALISTE E REVIZIONISTE — Nga biseda me një anëtar të Byrosë Politike të KQ të PK (m-l) të Indisë (14 nëntor 1970)	426—441
PËR NJË FORMË TË NDËRMJETME MIDIS KOOPERATIVËS BUJQËSORE DHE NDËRMARRJES BUJQËSORE — Nga një bisedë (23 nëntor 1970)	442—450
TREGUESI I LËNDËS	453
TREGUESI I EMRAVE	463
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA	467

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1985